


Friedrich
NIETZSCHE

Kështu foli Zarathustra

BOTIM I PLOTË



Plejad

Plejada e mendimit filozofik

Friedrich
NIETZSCHE

Kështu foli
ZARATHUSTRA

BOTIM I PLOTË

Përktheu nga origjinali

Iliriana Angoni

Dritan Thomollari

Plejad

Shënimi "botim i plotë" nën titullin e kësaj vepre duhet kuptuar në këndvështrimin e botimit të mëparshëm.

Në dallim nga ai, botimi që po i jepet lexuesit vjen i plotë jo vetëm në të gjithë pjesët që i mungojnë botimit të mëparshëm, por edhe në pasazhet që u mungojnë disa pjesëve të paplota të atij botimi.

Për të dhënë një pasqyrë sa më të saktë për lexuesin, po rendisim në fillim emrat e pjesëve të reja që i janë shtuar këtij botimi, ashtu siç ato janë edhe në origjinal:

Për priftërinjtë, Këngë vallëzimi, Për poetët, Për shpëtimin dhe Mes Bijave të shkretëtirës.

Ndërsa përsa i përket pasazheve që janë shtuar e plotësuar në pjesët e librit të mëparshëm do të përmendim:

Për vdekjen e lirë, Në ishujt e bekuar, Për të mëshirshmit, Për të virtytshmit dhe Bashkëbisedim me mbretërit.

KUSH ËSHTË ZARATHUSTRA I NIETZSCHE-S?

nga
Martin HEIDEGGER

Duket e lehtë t'i përgjigjesh kësaj pyetje, sepse ne e gjejmë përgjigjen e saj në vetë shkrimet e Nietzsche-s, nën formën e parashtrimeve qartësisht të formuara dhe, për më tepër, të shtypura në gërma italiane. Libri, ku Nietzsche paraqet kryesisht figurën e Zarathustrës, përbëhet nga katër pjesë, shkruar në rrjedhën e viteve 1883-1885 dhe mban titullin *Kështu foli Zarathustra*.

Nietzsche i ka dhënë këtij libri, si shok udhe, një nëntitull: *Një libër për të gjithë e për askënd*. "Për të gjithë", në të vërtetë, nuk do të thotë: për një ndokënd në sensin e kujtdo. "Për të gjithë" do të thotë: për çdo njeri që shfaqet i tillë si njeri, për një dikë që në çdo rrethanë dhe në çdo masë bëhet për vetveten, në qenien e tij, i denjë për të qenë i menduar. "...ndërsa për askënd" nënkupton: për asnjë ndër kureshtarët, të arritur nga të gjitha anët me anijen e fundit; pra për njerëz që dehen thjesht me copëza të veçuara apo fraza të shkëputura nga libri dhe që janë të marrosur prej gjuhës së tij gjysmë-kënduese e gjysmë-klithëse, herë të matur e herë të rrëmbyer, shpesh të një niveli të lartë, por nganjëherë edhe të sheshtë, në vend që të angazhohen pikërisht në udhën e mendimit që kërkon këtu fjala e tij.

Kështu foli Zarathustra. Një libër për të gjithë dhe për askënd. Sa shqetësuese është mënyra në të cilën është justifikuar nëntitulli i kësaj vepre - par *a contrario* - gjatë 70 viteve që kanë pasuar botimin e saj. Ai është kthyer në një libër për çdokënd e deri më sot nuk është gjendur asnjë njeri i aftë të mendojë, që të

jetë ngritur në lartësinë e mendimit të tij themelor dhe të ketë mundur ta vlerësojë origjinën e këtij mendimi në gjithë rëndësinë e vet.

Po kush është Zarathustra? Le të lexojmë me kujdes titullin kryesor të veprës dhe do të gjejmë menjëherë një tregues: *kështu foli Zarathustra*. Zarathustra flet. Ai është një folës. I çfarë lloji? Një orator popullor, madje një predikues? Jo, folësi Zarathustra është një zëdhënës (*Fürsprecher*). Ne takojmë këtu një fjalë mjaft të vjetër të gjuhës gjermane dhe, me thënë të vërtetën, edhe me sense të shumëfishta kuptimi. *Für*, fjalë për fjalë, do të thotë “përpara” (*vor*). Akoma sot *Fürtuch* (“copë për përpara”) është në gjermanisht fjala e zakonshme për përparësen, ndërsa *Fürsprech* (“avokat”) flet përpara dhe mban fjalën. Por *für* do të thotë gjithashtu „në favor të“, „për mbrojtjen e“. Kështu, zëdhënësi përfundimisht është ai që interpreton dhe shpjegon atë nga e cila, e për çfarë, ai flet.

E Zarathustra është zëdhënës pikërisht në këtë sens të trefishtë kuptimi. Çfarë shpall ai? Në favor të kujt flet? Çfarë do të shpjegojë? Më tej, a është Zarathustra vetëm zëdhënësi çfarëdo i s’ka rëndësi se çfarë gjëje apo ai është zëdhënësi i një gjëje të vetme, i asaj që, arrin ta shqetësojë njeriun përpara çdo gjëje tjetër dhe në çdo moment?

Drejt fundit të pjesës së tretë të *Kështu foli Zarathustra*, një pasazh është nëntitulluar “I shëruari” (*Der Genesende*). Ky është Zarathustra. Por çdo të thotë “i shëruari”? *Genesen* (“shëroj”) është e njëjta fjalë me greqishten dheome, dhostos. Një sens tjetër është “kthehem në shtëpi”; “nostalgjia” është e keqja e vendit, dhimbja e largimit. *Der Genesende* (“i shëruari”) është ai që e përmbledh dhe e përqëndron veten për kthim, dmth për hyrjen në rrjedhën e tij. I shëruari është në rrugë drejt vetvetes, në atë mënyrë që të arrijë të thotë nga vetvetja se kush është. Në pasazhin në fjalë, i shëruari thotë: “Unë, Zarathustra, zëdhënësi i jetës, zëdhënësi i vuajtjes, zëdhënësi i rrethit...”

Pra, Zarathustra flet në favor të jetës, të vuajtjes, të rrethit e kështu, ai i shpall ato. Të treja: “jetë-vuajtje-rreth” janë të ndërvarura, ato janë e njëjta gjë. Ndaj, nëse do të mund ta mendonim rregullisht këtë gjë të trefishtë si një gjë të vetme, atëherë patjetër që do të jemi në gjendje të parathonim se zëdhënësi i kujt është Zarathustra dhe se kush ai vetë, si zëdhënës, mund të jetë fare mirë. Padyshim, që mund të ndërhyjmë që tani, të armatosur me një shpjegim të trashë dhe të thonim me një siguri të pakontestueshme se: “jeta”, në gjuhën e Nietzsche, nënkupton vullnetin për fuqi, natyrën themelore të gjithçkaje që është, e jo vetëm të njeriut. Ndërkohë që ajo çka duhet nënkuptuar me “vuajtje”, na e shpjegon vetë Nietzsche në termat e mëposhtëm kur thotë: “Gjithçka që vuan dëshiron të jetojë...” (Op. VI, f. 469), dmth edhe gjithçka që është në mënyrën e vet vullnetit për fuqi. Prej kësaj ne kuptojmë: “forcat transformuese përplasen” (XVI, 151). “Rrethi” është shenja e unazës, kurbatura e të cilit kthehet tek vetvetja dhe qarkorja e saj prodhon atë identike që rivjen tek ne gjithmonë.

Për pasojë, Zarathustra paraqitet kështu si zëdhënësi i një mendimi të tillë: “Që gjithçka që është lehtësisht vullnet fuqie, që si vullnet krijues vuan duke u ndeshur me vetveten dhe që e paraqet veten pikërisht kështu, zë vend në Rikthimin e përjetshëm të identikes.

Me këtë parashtrim ne kemi arritur të përkufizojmë, siç thuhet në gjuhën shkollore, qenien e Zarathustra-s. Madje mundemi edhe ta shënojmë këtë përkufizim, ta ngulisim atë në memorien tonë dhe ta prodhojmë në çdo rast që na nevojitet. Mundemi gjithashtu të rekomandojmë edhe atë përkufizim të nxjerrë nga ato fraza të shtypura në gërma italike që, në vetë shkrimet e Nietzsche-s, na thonë se kush është Zarathustra.

Kështu, në pasazhin tashmë të përmendur „I shëruari“ ne lexojmë:

“Ti (Zarathustra), ti je ai që mëson Rikthimin e përjetshëm...!”

Dhe në prologun e veprës së plotë gjendet:

“Unë (Zarathustra), unë ju mësoj Mbinjeriun.”

Sipas këtyre frazave, Zarathustra, zëdhënësi, është një mësues që “mëson”. Ai mëson dukshëm dy gjëra: Rikthimin e përjetshëm të Identikes dhe Mbinjeriun. Vetëm se në fillim ne nuk arrijmë të shohim nëse është vallë e mundur një gjë e tillë dhe se si rekomandohet ajo që ai mëson. Sidoqoftë, edhe sikur rakordimi të bëhej i qartë, patjetër që ne nuk kishim për ta kuptuar gjithmonë, pra në çdo rast, në është pikërisht zëdhënësi ai që dëgjojmë e nëse mund të arrijmë vallë të mësojmë diçka nga ky mësues. Sepse, në mungesë të të dëgjuarit dhe të mësuarit nga ai, ne s’kemi për ta ditur asnjëherë saktë se kush është Zarathustra. Kështu që nuk mjafton të afrojmë fraza nga ku mund të nxjerrim atë çka zëdhënësi thotë për vetveten. Përkundrazi, lipset të shohim se si ai arrin ta bëjë diçka të tillë, në çfarë rasti dhe me ç’përqëndrim vemendjeje. Fjalën vendimtare: “Ti je ai që mëson Rikthimin e përjetshëm!”, nuk është Zarathustra që ia thotë spontanisht vetvetes, po janë kafshët e tij ato që ia thonë një gjë të tillë mësuesit të tyre. Ato janë emërtuar që në fillim të prologut dhe, më qartë, në konkluzionin e tij. Aty lexojmë: “... ndërsa dielli ishte në zenit, ai (Zarathustra) nisi të kërkojë qiellin me vështrim, sepse dëgjonte nëpër të klithmën e mprehtë të një zogu. Dhe ja! tek pa një shqiponjë të fluturonte në ajër duke formuar rrathë të mëdhenj, ndërsa një gjarpër të rrinte i ngritur pezull mbi të, jo si një pre, por si një mik: sepse mbahej fort i mbështjellë rreth qafës së saj”. Në këtë përqafim të mistershëm, ne ndjejmë tashmë sesi rrethi dhe unaza, në një mënyrë të pashprehur, mpleksen në qerthujt ajrorë të shqiponjës dhe në mbështjelljet e gjarpërit. Ndjejmë se si shkëlqen kjo unazë që quhet *anulus, aeternitatis*: unaza vulosëse dhe viti i përjetësisë. Spektakli i dy kafshëve tregon atë që, duke u rrotulluar apo duke

u mbështjellur, ato lidhen ndërmjet tyre. Sepse nuk janë ato që krijojnë rrethin dhe unazën, por ato që përfshihen në të, për të pasur kështu qenien e tyre. Në spektaklin e dy kafshëve na shfaqet pikërisht ajo që i intereson Zarathustrës, teksa ai nis të kërkojë qiellin me vështrim. Ja përse teksti vazhdon:

“-Janë kafshët e mia! thotë Zarathustra dhe gëzohet me gjithë zemër.

“Kafsha më krenare dhe kafsha më e zgjuar që mund të jetë nën këtë diell - të dyja bashkë janë nisur të njohin.

“Ato duan të dinë nëse Zarathustra jeton akoma. Në fakt, a jetoj unë vallë akoma?”

Pyetja e Zarathustra-s e ruan peshën e saj vetëm nëse ne e kuptojmë fjalën e vagullt “jetë” në sensin e “vullnetit të fuqisë”. Zarathustra pyet: a i përgjigjet vullneti im këtij vullneti që, si vullnet fuqie, drejton gjithçka që është?

Dy kafshët, pra, duan të zbulojnë qenien e Zarathustra-s. Ndaj, ai pyet vetveten nëse është akoma, dmth tashmë, ai që është me të vërtetë. Në një shënim mbi *Kështu foli Zarathustra* (Op., XIV,279), lexojmë:

“A ndjej vallë kënaqësi të pres kafshët e mia? Po nëse janë vërtet kafshët e *mia*, atëherë ato duhet ta dinë mirë si të më gjejnë (“Heshtja e Zarathustra-ës”).

E janë po këto kafshë që - në pasazhin e treguar me titull *I shëruari* - i thonë atij një frazë me gërma italice që nuk duhet ta anashkalojmë. Ato thonë:

“Sepse kafshët e tua e dinë mirë, o Zarathustra, ai që je dhe duhet të bëhesh: shiko, *ti je ai që mëson Rikthimin e përjetshëm*, - i tillë është tani fati *yt!*”

Prej kësaj, del në dritë që Zarathustra, para së gjithash, duhet të bëhet ai që është. Mirëpo, Zarathustra zbrapset përpara një të ardhmeje të tillë. E frika është e ndjeshme përgjatë gjithë këtij libri që përshkruan historinë e tij. Kjo frikë shënon stilin, ajo shpjegon hapin ngurues dhe gjithnjë e më të ngadalësuar,

të mbarë veprës. Kjo frikë madje, mbyl tek Zarathustra, që në fillim të udhës së tij, çdo siguri dhe pretendim. E kush, para së gjithash, nuk e ka kuptuar këtë frikë, kush nuk e ndjen atë vazhdimisht, përgjatë gjithë atyre diskutimeve që shpesh duken shumë pretenduese, e me pamje të cilat u përkojnë gjithmonë atyre të një dehjeje ekstaziake, atëherë ai s'ka për ta kuptuar kurrë se kush është vërtet Zarathustra.

Pasi, nëse duhet që Zarathustra të bëhet pikësëpari ai që mëson Rikthimin e përjetshëm, ai nuk mundet të vihet përnjëherë në mësim të saj. Ja, përse ne lexojmë këtë frazë tjetër në nismën e udhëtimit të tij: “Unë ju mësoj Mbinjeriun.”

Ç’ është e vërteta, në lidhje me fjalën “Mbinjeri”, na duhet së pari të flakim tej të gjitha romancat e rreme dhe shqetësuese që shoqërojnë këtë fjalë në opinionin e përgjithshëm. Me emrin “Mbinjeri”, Nietzsche nuk përshkruan pikërisht një njeri të ngjashëm me ata që ne njohim dhe thjesht të përmasave më të mëdha. Ai nuk mendon aspak më shumë as edhe për një lloj njerëzish që do të hidhnin poshtë çdo humanitet, që do të ngrinin në ligj arbitraren më të pastër dhe do ta bënë vendosjen e rregullit të saj me një furi titanësh. Mbinjeriu, për ta marrë këtë fjalë krejtësisht shkronjë për shkronjë, është shumë më parë ai që ngrihet sipër njeriut të sotëm e të djeshëm, por vetëm e vetëm për ta çuar këtë njeri, para së gjithash, deri në qenien e tij - që është gjithnjë nën vuajtje - e për ta lënë të vendosur pikërisht aty. Një shënim postum (XIV, 271) në lidhje me *Zarathustra-ën* thotë:

“Zarathustra nuk do asgjë të humbasë nga e kaluara e humanitetit, ai do gjithçka ta hedhë në përzierje”.

Por nga ku vjen vallë thirrja e alarmit ndaj Mbinjeriut? Përse njeriu i dikurshëm dhe ai i sotëm nuk është më i mjaftueshëm? Sepse Nietzsche e njeh çastin historik ku njeriu përgatitet për të hyrë në dominimin e plotë të tokës? Nietzsche është mendimtari i parë që shtron pyetjen tonë vendimtare, duke u vendosur në krahun e pikëpamjes së kësaj historie të botës që shfaqet për

herë të parë, e që e mendon këtë pyetje në gjithë rëndësinë e saj metafizike. Kjo pyetje parashtrohet si më poshtë: A është i përgatitur vallë njeriu si i tillë, d.m.th në qenien e tij ashtu siç ajo është zbuluar deri tani, për të marrë përsipër dominimin e tokës? Nëse jo, si të transformohet, që të mundet “të nënshtrojë” tokën dhe të arrijë të përmbushë kështu edhe fjalën e një “Testamenti të Vjetër”? Njeriu i sotëm, a s’duhet vallë të përcillet *përtej* vetes për të qenë në lartësinë e këtij misioni? Nëse është pikërisht kështu, “Mbinjeriu” i menduar korrektësisht, nuk mund të jetë produkt i një imagjinate të degjeneruar, pa fre e të arratisur në zbrazëti. Po kaq pak është e mundshme që të zbulohet “historikisht” natyra e tij nga një analizë e epokës moderne. Nuk duhet pra kërkuar trajta thelbësore e Mbinjeriut në ato personazhe, vullneti i fuqisë së të cilëve, shkurtpamës dhe i keqinterpretuar, i mbrun pikërisht kështu funksionet e vet kryesorë dhe i shtyn përpara në majat e formave të tij të ndryshme të organizimit. Ka një detaj, për të qenë të vërtetë, që ne do të duhej ta shënonim menjëherë: ky mendim, që është kthyer drejt figurës së një mësuesi që mëson Mbinjeriun, na përket neve, ai i përket Europës, tokës mbarë, jo vetëm “sot akoma”, por sidomos dhe pikësëpari, nesër. Megjithatë, shtrohet pyetja: na lipset ta aprovojmë këtë mendim apo ta luftojmë atë, na duhet të kalojmë përtej tij apo ta imitojmë me ndihmën e shënimeve të rreme. Dihet, që çdo mendim thelbësor kalon rrëshqanthi turmës së partizanëve apo kundërshtarëve të tij.

Duhet pra që ne të mësohemi së pari të mësojmë nga ai që mëson, dhe kjo të ndodhë vetëm që të mësohemi të pyesim edhe më larg se ai. Është vetëm kështu që ne do të zbulojmë një ditë kush është Zarathustra i Nietzsche-s, ose përndryshe s’kemi për ta zbuluar kurrë.

Mbetet padyshim për të konsideruar nëse është i mundur vallë vazhdimi i tij, duke pyetur më larg sesa nuk shkon mendimi i Nietzsche-s, apo lipset patjetër të bëhet një hap prapa.

herë të parë, e që e mendon këtë pyetje në gjithë rëndësinë e saj metafizike. Kjo pyetje parashtrohet si më poshtë: A është i përgatitur vallë njeriu si i tillë, d.m.th në qenien e tij ashtu siç ajo është zbuluar deri tani, për të marrë përsipër dominimin e tokës? Nëse jo, si të transformohet, që të mundet “të nënshtrojë” tokën dhe të arrijë të përmbushë kështu edhe fjalën e një “Testamenti të Vjetër”? Njeriu i sotëm, a s’duhet vallë të përcillet *përtej* vetes për të qenë në lartësinë e këtij misioni? Nëse është pikërisht kështu, “Mbinjeriu” i menduar korrektësisht, nuk mund të jetë produkt i një imagjinate të degjeneruar, pa fre e të arratisur në zbrazëti. Po kaq pak është e mundshme që të zbulohet “historikisht” natyra e tij nga një analizë e epokës moderne. Nuk duhet pra kërkuar trajta thelbësore e Mbinjeriut në ato personazhe, vullneti i fuqisë së të cilëve, shkurtpamës dhe i keqinterpretuar, i mbrun pikërisht kështu funksionet e vet kryesorë dhe i shtyn përpara në majat e formave të tij të ndryshme të organizimit. Ka një detaj, për të qenë të vërtetë, që ne do të duhej ta shënonim menjëherë: ky mendim, që është kthyer drejt figurës së një mësuesi që mëson Mbinjeriun, na përket neve, ai i përket Europës, tokës mbarë, jo vetëm “sot akoma”, por sidomos dhe pikësëpari, nesër. Megjithatë, shtrohet pyetja: na lipset ta aprovojmë këtë mendim apo ta luftojmë atë, na duhet të kalojmë përtej tij apo ta imitojmë me ndihmën e shënimeve të rreme. Dihet, që çdo mendim thelbësor kalon rrëshqanthi turmës së partizanëve apo kundërshtarëve të tij.

Duhet pra që ne të mësohemi së pari të mësojmë nga ai që mëson, dhe kjo të ndodhë vetëm që të mësohemi të pyesim edhe më larg se ai. Është vetëm kështu që ne do të zbulojmë një ditë kush është Zarathustra i Nietzsche-s, ose përndryshe s’kemi për ta zbuluar kurrë.

Mbetet padyshim për të konsideruar nëse është i mundur vallë vazhdimi i tij, duke pyetur më larg sesa nuk shkon mendimi i Nietzsche-s, apo lipset patjetër të bëhet një hap prapa.

Më tej, mbetet të konsiderojmë më parë nëse kjo “prapa” përfaqëson një të kaluar “historikisht” të konstatueshme dhe që ne do të donim ta restauronim (psh botën e Goethe-s) apo nëse kjo “prapa” çon në mënyrë të përmbledhur në një qenie, fillimi i së cilës pret akoma një mendim-kujtim (pra mendim që luan edhe rolin e kujtimit), për t’ u kthyer në një fillim që të na e bëjë të dukshëm ora më e parë e mëngjesit.

Për momentin, sidoqoftë, le të kufizohemi të mësojmë disa gjëra mbi Zarathustra-ën. Metoda më e përshtatshme është që ne të përpiqemi të shoqërojmë hapat e parë të “mësuesit”, ashtu siç ato hidhen. Ai mëson duke treguar. Ai e para-sheh qenien e Mbinjeriut dhe i jep atij një formë të dukshme, sepse është vetëm Zarathustra ai që mëson dhe jo Mbinjeriu në vetëvete. Edhe Nietzsche nga ana e tij nuk është Zarathustra, por ai që pyet, që përpiqet të kapë - duke menduar - qenien e Zarathustra-ës.

E kjo për shkak se Mbinjeriu kalon përtej mënyrës, deri tani të njohur, të të qenurit të njeriut: ai është një kalim, një urë. E me qëllim që ta ndjekim, duke mësuar, mësuesin që mëson Mbinjeriun, na duhet - duke ruajtur imazhin tonë - të arrijmë deri tek ura, për ta menduar kështu kalimin në një mënyrë pothuaj të plotë, vetëm nëse konsiderojmë tre pika:

1. Vendin nga ku largohet ai që kalon.
2. Kalimin vetë.
3. Vendin ku shkon ai që kalon.

Ky vend i fundit duhet të jetë i shikuar mirë nga ne, dhe sidomos nga ai që kalon, po më parë nga vetë mësuesi që duhet ta tregojë atë. Nëse nuk shohim që në fillim se ku shkojmë, kalimi mbetet pa drejtim dhe ajo së cilës kalimtari duhet t’ i largohet mbetet e papërcaktuar. Por, nga ana tjetër, ajo drejt kujt kalimtari është thirrur të kalojë shfaqet nën një dritë të plotë vetëm atëherë kur ai të ketë arritur aty. Për kalimtarin, e akoma më shumë për mësuesin që duhet të tregojë kalimin, për Zarathustra-ën vetë, pika e arritjes mbetet gjithmonë e largët. Afërsia e së largtës, e

asaj që arrin të kujtohet për të, në gjuhën tonë shprehet saktësisht nga fjala nostalgji (*die Sehnsucht*. Është gabim që ne lidhim *die Sucht* me *suchen* (kërkoj) dhe me “qenien e nxitur”. Fjala e vjetër *Sucht* do të thotë sëmundje, e keqe, dhimbje. (Shiko *Gelbsucht*, “zverdhje”, *Schwindsucht*, “dobësim”, “hollim”.)

Nostalgjia është dhimbja që na shkakton afërsia e së largtës.

Aty ku shkon ai që kalon, aty është dhe vendi i nostalgjisë së tij. Ai që kalon, siç ka bërë përpara tij edhe ai që e drejton, pra mësuesi, është, ashtu si e thamë në fillim, në rrugën drejt kthimit kah vetë qenies së tij. Ai është i shëruari. Në pjesën e tretë të *Kështu foli Zarathustra*, pasazhi *I shëruari* pasohet menjëherë me një tjetër, të titulluar *Nostalgjia e Madhe*. Në këtë pasazh, që është një para pasazhit të parafundit të pjesës së III, mbarë vepra kap pikën e saj kulminante. Në një shënim postum (XIV, f. 285) Nietzsche vëren:

“Një e keqe *hyjnore* formon përmbajtjen e *Zarathustra-ës*, pjesa e III.”

Në pasazhin *Nostalgjia e Madhe*, Zarathustra bisedon me shpirtin e tij. Sipas doktrinës së Platon-it, që është një autoritet për metafizikën perëndimore, qenia e mendimit qendron në dialogun e shpirtit me vetveten.

“Mbledhja në vetvete është një thënie, që nënkupton se shpirti vetë rend në rrugë drejt vetvetes, duke bërë kështu rrotullimin e gjërave që ai sheh në çdo moment” (*Théctète*, 189, shiko dhe *Sofisti-Platon* 263).

Ndërkohë që në dialogun me shpirtin e vet Zarathustra mendon “mendimin e tij më të thellë” (*I shëruari*, 1; shiko pjesën III, *Për Vizionin dhe Enigmën*, 2). Ja si fillon pasazhi *Nostalgjia e Madhe* në gojën e Zarathustra-ës.

“Oh! shpirti im, të kam mësuar për të thënë “Sot” njëlloj siç të kam mësuar për të thënë edhe “Një ditë” edhe “Dikur” e për të kaluar duke kërcyer përsipër gjithçkaje: Këtu, Aty dhe Atje”.

Të tre fjalët “Sot”, “Dikur”, “Një ditë” janë të shkruara me

gërmë të madhe dhe ndërmjet thonjzave. Ato përshkruajnë trajtat themelore të kohës. Mënyra me të cilën Zarathustra i emëron ato, të lë të kuptosh që, tani e tutje, ai detyrimisht duhet të thotë fjalën e fundit të qenies së tij. Po ç'është ajo vallë? Që "Një ditë" dhe "Dikur", pra e ardhmja dhe e shkuara janë si "Sot". E "Sot" nga ana e saj është si e shkuara dhe si ajo që do të vijë, sepse të tre fazat e kohës konvergojnë njëllor si e Njëjta drejt së Njëjtës dhe bashkohen në një të Sotme unike, në një Tani të qëndrueshme. Këtë Tani të së gjithmonshmes, metafizika e emërton: përjetësi. Edhe Nietzsche, gjithashtu, i mendon të tre fazat e kohës nisur nga pikëpamja e përjetësisë si Tani e së gjithmonshmes. Vetëm, permanenca (*Stete*) nuk qëndron për të në një pozicion fiks (*Stehen*), por në një Rikthim të Identikes. Ndaj dhe Zarathustra, kur arrin t'ia mësojë këtë thënie Shpirtit të tij, bëhet ai që mëson Rikthimin e përjetshëm të Identikes. Në një kohë kur ky Rikthim nga ana e tij, është pikërisht plotësia e pashtershme e jetës së gëzuar dhe të dhimbshme: ajo kah së cilës kthehet "Nostalgjia e madhe" e atij që mëson Rikthimin e përjetshëm të Identikes.

Ja pse, në të njëjtin pasazh, "Nostalgjia e madhe" është quajtur gjithashtu edhe "Nostalgjia e Mbi-bollëkut".

"Nostalgjia e madhe" jeton sidomos aty ku kjo nostalgji arrin të nxjerr ngushëllimin (*Trost*) e saj të vetëm, dmth tek besimi. Në vend të fjalës tejet të vjetër *Trost* (prind i *trauen*, "të kesh besim", *zutruen*, "të besosh"), ne mund të shërbehemi në gjuhën tonë me fjalën *Hoffnung* ("shpresë"). "Nostalgjia e madhe" që mban Zarathustra-ën zgjon tek ai sentimentin e "Shpresës së tij më të madhe", duke e shënjuar atë në mënyrë të qartë.

Por çfarë e justifikon Zarathustra-ën dhe e çon atë drejt Shpresës së tij më të madhe?

Cila është ura që i jep atij kalimin drejt Mbinjeriut dhe i lejon që - duke kaluar nëpër të - të largohet nga njeriu i sotëm, në atë mënyrë që të arrijë të shkëputet përfundimisht prej tij?

Arkitektura e veçantë e *Kështu foli Zarathustra*, vepër që duhet të tregojë kalimin e njeriut që kalon përtej, kërkon që përgjigjja e kësaj pyetje të jetë e dhënë në pjesën përgatitore të veprës, që është e dyta. Këtu, në pasazhin *Merimangat*, Nietzsche e bën Zarathustra-ën të thotë:

“*Çlirimi i njeriut nga hakmarrja*, është për mua ura drejt shpresës më të lartë dhe një ylber pas stuhish të gjata”.

Frazë, sa e veçantë për opinionin e zakonshëm, aq edhe e çuditshme në raport me idenë komode që ne kemi formësuar rreth filozofisë së Nietzsche-s. Pse vallë, nuk merret ai si promotor i vullnetit të fuqisë, si nxitës i politikës së forcës dhe luftës, si ai që ka shpërthyer çmendurinë e tërbuar të “kafshës bjonde”?

Ndërkohë që fjalët “*Çlirimi i njeriut nga hakmarrja*, në tekst, janë të shtypura madje me gërma italice. Mendimi i Nietzsche-s duket kështu i kthyer drejt çlirimit që na shkëput nga shpirti i hakmarrjes. Mendimi i tij kërkon të jetë kështu në shërbim të një shpirti që, si liri e fituar mbi etjen për hakmarrje, i paraprin jo vetëm çdo vëllazërimi të thjeshtë, por dhe çdo “dëshire - vetëm - për të ndëshkuar”, një shpirti që të shfaqet paraprirës, si ndaj çdo përpjekje paqeje ashtu dhe ndaj çdo përcjellje lufte dhe i huaj ndaj atij shpirti që, mbi pakte, do të bazojë dhe të sigurojë *pax*, paqen. Fusha e kësaj lirie të fituar mbi hakmarrjen është, po njëlloj e huaj, edhe ndaj pacifizmit, politikës së forcës dhe një neutraliteti që përllogarit. Ajo është po njëlloj e huaj edhe ndaj një dobësie që i lë gjërat të rrëshqasin, apo ndaj një përvjedhjeje në orën e sakrificës, që ndodh përgjatë ndërhyrjeve të verbëra dhe detyrimit për të vepruar me çdo kusht.

Është ndaj këtij shpirti të një lirie të fituar mbi hakmarrjen që ngjitet i pretenduari mendim i lirë i Nietzsche-s.

Çlirimi i njeriut nga hakmarrja. Ndaj, nëse mund ta konsiderojmë veçse nga larg këtë shpirt lirie, të kuptuar si trajtën themelore të mendimit të Nietzsche-s, atëherë imazhi i pranuar

deri më sot për të e që ka qenë i tillë gjithmonë, që nga fillimi, duhet detyrimisht të bjerë.

“Sepse, *çlirimi i njeriut nga hakmarrja*: është për mua - thotë Nietzsche - ura drejt shpresës më të lartë”, duke thënë kështu në të njëjtën kohë, në një gjuhë që e fsheh atë për të cilën ai përgatitet, edhe se drejt kujt drejtohet “Nostalgjia e tij e madhe”.

Por ç’kupton Nietzsche këtu me hakmarrje? Ku konsiston, sipas tij, çlirimi që na largon nga hakmarrja?

Ne do të mjaftohemi për të sjellë pak dritë vetëm mbi këto dy detaje e ndoshta më pas kjo dritë do të na lejojë për të parë më qartë urën që, sipas një mendimi të tillë, duhet ta çojë njeriun që ne njohim tek Mbinjeriu. Në vendin e kalimit shfaqet dhe vendi ku shkon kalimtari. Ndaj, ne mundemi të kuptojmë më herët, se në çfarë mase Zarathustra, si zëdhënës i jetës, i vuajtjes, i rrethit, është gjithashtu edhe mësuesi që mëson njëkohësisht si Rikthimin e përjetshëm ashtu dhe Mbinjeriun.

Por përse diçka kaq vendimtare varet nga largimi ynë nga hakmarrja? Ku fle shpirti i hakmarrjes, ku i ushtron ai rrënimet e tij? Nietzsche na përgjigjet në pasazhin e paraparafundit të pjesës së dytë të *Kështu foli Zarathustra*. Ajo është titulluar *Për Shpëtimin*. Aty lexojmë:

“*Shpirti i hakmarrjes*: miqtë e mi, i tillë ishte deri tani meditimi (*Nachdenken*) më i mirë i njeriut; ndaj aty ku ka dhimbje duhet gjithmonë të ketë dhe një ndëshkim”.

Kjo frazë rilidh përnjëherësh hakmarrjen me çdo vepër meditimi të kryer ndonjëherë nga njerëzit. Meditimi për të cilin flet Nietzsche nuk përshkruan çfarëdolloj refleksioni (*Ueberlegen*), por atë mendim ku pushon dhe përpëlitet lidhja e njeriut me atë që është, me qenien. Ndaj, njeriu përfytyrohet qenie, në masën që ai arrin të mbajë lidhje me qenien: duke konsideruar që ai është, atë që ai është, si ai është, si do të mund të ishte dhe si do të duhej të ishte, me një fjalë: ai përfytyrohet

qenie sipas raportit me Qenien e tij (*Sein*). Kjo (ri)-paraqitje, (*Vor-stellen*) ose filozofikisht, ky përfaqësim është mendimi.

Sipas frazës së Nietzsche-s, ky përfaqësim deri tani ka qenë i determinuar nga shpirti i hakmarrjes, pasi njerëzit e mbajnë raportin e tyre, kështu të determinuar, me atë që është dhe për atë çka është më e mira.

Kështu, në çfarëdolloj mënyre që njeriu të përfytyrohet si qenie, ai përfytyrohet si i tillë vetëm në perspektivën e Qenies së qenies. Prej asgjëje tjetër, por veçse prej kësaj perspektive, ai mund ta kapërcejë qenien dhe të arrijë të kalojë deri tek Qenia. "Përtej" në greqisht do të thotë meta. Ja pse çdo lidhje e njeriut me qenien si të tillë është në vetvete metafizikë. Rrjedhimisht, kur Nietzsche e kupton hakmarrjen si një shpirt që jep ndaj raportit të njeriut me qenien, tonalitetin dhe determinimet e tij, ai e mendon atë (hakmarrjen) njëherazi edhe në mënyrë metafizike.

Hakmarrja nuk është këtu një temë e thjeshtë morali, dhe të çliruarit nga ajo nuk është një detyrë e edukimit moral. Po aq pak hakmarrja dhe etja për hakmarrje mbeten objekte të psikologjisë. Përkundrazi, Nietzsche e trajton metafizikisht qenien dhe peshën e hakmarrjes. Por, në fillim le të kuptojmë se ç'do të thotë hakmarrje?

Nëse, me largësinë e nevojshme të shikimit, ne qëndrojmë së pari në sensin e fjalës, ne mund të gjejmë aty një tregues. *Rache* ("hakmarrje"), *rächen* ("hakmerrem"), *wreken* (i njëjti sens), *urgere* do të thotë: ndeshem, shtyj, bëj të ecë përpara vetes, përndjek, jam në gjurmë të... Në çfarë kuptimi hakmarrja është në gjurmë të...? Ajo nuk kërkon vetëm për të kapur, mbërthyer, patur zotërimin e... Ajo kërkon më tepër, kërkon ta vërë për fund atë që ndjek në bazë të gjurmëve që ka. E kjo gjueti (*Nachstellen*) që hakmarrja përfaqëson në vetvetvete vihet së pari përballë asaj mbi të cilën ajo hakmerret. E vihet në atë mënyrë që të synojë ta vërë atë poshtë, për t'u gjendur vetë, përballë asaj që ka vënë poshtë, në një pozicion superior e për të venë kështu

në vend rëndësinë e vet, të përllogaritur si e vetmja që duhet të ruhet. Sepse etja për hakmarrje është e eksituar nga ndjenja e të qenurit i mundur dhe i prekur. Në rrjedhën e të njëjtave vite ku ai krijonte veprën e tij *Kështu foli Zarathustra*, Nietzsche ka shënuar vërejtjen:

“Do t’i këshilloja të gjithë martirët të pyesnin veten nëse nuk është vallë etja për hakmarrje ajo që i ka shtyrë ata deri në cakun e fundit” (XII³, f. 298).

Po ç’është hakmarrja? Përkohësisht mund të themi vetëm se: hakmarrja është përndjekja që vihet përballë diçkaje dhe e vë atë poshtë. E më tej, a është vallë kjo përndjekje ajo që ka mbështetur dhe ka depërtuar nëpër tërë veprën dhe refleksionin tonë të kryer deri tani, aq sa dhe përfytyrimet që kemi mbi qenien të jënë bërë nën raportin e Qenies së saj? Nëse i duhet atribuar shpirtit të hakmarrjes një ngarkesë e tillë metafizike, atëherë ajo patjetër duhet të jetë e dukshme në konstituimin e vetë metafizikës. E me qëllim që të arrijmë, deri në njëfarë mase, ta shohim një gjë të tillë, ne duhet të shqyrtojmë më parë se me çfarë gjurme thelbësore Qenia e qenies arrin të shfaqet në metafizikën moderne. Kjo gjurmë thelbësore e qenies është përshkruar nga Schelling, sipas një forme klasike, në disa fraza të veprës *Kërkime filozofike mbi thelbin e lirisë humane dhe subjektet që raportohen në të* (1809). Aty lexojmë:

Në një instancë të fundit dhe supreme, nuk ka Qenie tjetër (*Seyn*) veç të dëshiruarit. Të dëshiruarit është qenie origjinale dhe vetëm ndaj tij (të dëshiruarit) arrijnë të përshtaten të gjitha atributet (e qenies origjinale) që ai ka si: mungesë baze, përjetësi, pavarësi ndaj kohës, afirmim i vetvetes. Çdo përpjekje e filozofisë synon veçse të gjejë këtë shprehje supreme.” (F.W.J. Schelling, *Shkrime filozofike*, vëll. I, Landshut, 1809, f. 419)

Atributet të cilat, që nga antikiteti më i herët, mendimi metafizik ia mvesh qenies, Schelling i gjen, nën formën e tyre të fundit dhe supreme, pra të përkryer, tek të dëshiruarit. Sidoqoftë,

në vullnetin e këtij të dëshiruari, ai nuk sheh një mundësi të shpirtit njerëzor. Fjala “dëshirë” emërton këtu Qenien e qenies në tërësinë e saj. Kjo qenie është vullneti, pavarësisht se kjo gjë na duket e çuditshme - e ashtu është në fakt - për aq kohë sa do të na mbeten të huaja mendimet që mbështesin metafizikën perëndimore. Dhe ato do të mbeten kështu, për aq kohë sa ne nuk i mendojmë ato, por kufizohemi gjithnjë vetëm për t’i “eksponuar”. Mundemi, psh, të konstatojmë “historikisht”, me saktësi, vërejtjet e Leibniz-it mbi Qenien e qenies, por s’mendojmë asgjë mbi atë që ai ka dashur të nënkuptojë, kur e karakterizonte Qenien e qenies nisur nga monada, si unitet të *perceptio* dhe *appetitus*, të perceptimit dhe prirjes, dmth, si vullnet. Më pas, ajo që mendonte Leibniz-i u arrit të shprehej nga Kant-i dhe Fichte, si një vullnet i arsyeshëm mbi të cilin do të meditojnë edhe Hegel e Schelling, secili sipas mënyrës së vet. Për këtë vullnet flet gjithashtu edhe Schopenhauer-i kur e titullon veprën e tij kryesore *Bota* (jo njeriu) si *Vullnet dhe Përfaqësim*. E kjo është pikërisht edhe ajo që mendon Nietzsche, kur dallon dhe pëshkruan qenien origjinale të qenies si vullnet fuqie.

E që ngado, pra nga të gjitha këndvështrimet, Qenia e qenies arrin të na shfaqet si vullnet, ky nuk është një fakt që qëndron vetëm tek opinionet që disa filozofë ngrenë mbi të. Asnjë erudicion nuk do të zbulojë ndonjëherë atë që nënkupton kjo shfaqje e qenies si vullnet; vetëm mendimi që pyet mund ta kapë një nënkuptim të tillë, ta vlerësojë atë si të tillë, pra si të denjë për t’u pyetur, për t’u konsideruar si ajo që duhet menduar dhe për t’u ruajtur kështu në mendimin-kujtim, si një gjë që ka qenë menduar edhe më parë.

Pra, posaçërisht dhe veçanërisht, Qenia e qenies për metafizikën moderne dhe prej saj, shfaqet si vullnet. Mirëpo, njeriu është njeri për aq sa, duke menduar, ai mban një raport me qenien dhe vendoset kështu tek Qenia (*Sein*). Ndërkohë që dhe mendimi, nga ana e vet, duhet të përgjigjet, në qenien

(*Wesen*) e tij, ndaj asaj me të cilën ai mban një raport, pra, ndaj Qenies së qenies si vullnet.

Sipas fjalëve të Nietzsche-s, mendimi i njohur deri më sot është i determinuar nga shpirti i hakmarrjes. Si e mendon pra Nietzsche qenien e hakmarrjes, kur e ka menduar atë njëherazi edhe metafizikisht?

Në pjesën e dytë të *Kështu fliste Zarathustra*, në pasazhin tashmë të cituar *Mbi Shpëtimin*, Nietzsche në gojën e Zarathustrës thotë:

“Kështu, po, vetëm kështu është *hakmarrja*: mëri e vullnetit kundrejt kohës dhe “ishte” e saj.

Duket që, duke përkufizuar qenien e hakmarrjes, Nietzsche nxjerr në pah atë që në vetvete kundërshton dhe kundërvihet: atë që përgjigjet ndaj kësaj përndjekje nga e cila ne kemi karakterizuar hakmarrjen. Por Nietzsche nuk thotë vetëm: hakmarrja është mëri, çka është e vërtetë dhe për urrejtjen. Nietzsche thotë: hakmarrja është mëria e vullnetit. Mirëpo, “vullneti” emërton Qenien e qenies në tërësinë e tij, dhe jo vetëm dëshirën humane. Nga ky karakterizim i hakmarrjes si “mëri e vullnetit”, përndjekja dhe kundërvënia e saj mbeten, që nga origjina, në brendësi të lidhjes me Qenien e qenies. E që është pikërisht kështu, kjo bëhet e qartë nëse vëzhgojmë edhe atë ndaj së cilës vërsulet mëria e hakmarrjes. Hakmarrja është “mëria e vullnetit kundrejt kohës dhe “ishte” e saj.

Në leximin e parë, madje dhe në të dytin, e akoma dhe në të tretin, të këtij përkufizimi të hakmarrjes, mund ta gjejmë të çuditshme, të pakuptueshme e përfundimisht arbitrare lidhjen kështu të theksuar ndërmjet hakmarrjes dhe “kohës”. Dhe nuk mund të gjejmë ndryshe, nëse bazohemi vetëm këtu (tek përkufizimi) dhe heqim dorë nga të konsideruarit e asaj që nënkupton fjala “kohë”.

Nietzsche thotë: hakmarrja është “mëria e vullnetit kundrejt kohës...” Ai nuk thotë: kundrejt diçkaje kohore. Ai nuk thotë

as edhe: kundrejt një karakteri të veçantë të kohës. Ai thotë thjesht: "mëri kundrejt kohës..."

Është e vërtetë që të tjera fjalë pasojnë menjëherë: "kundrejt kohës dhe "ishte" e saj". Por ato duan të thonë se: hakmarrja është mëria kundrejt "ishte", që është një cilësor i veçantë i kohës. E këtu mund të vërejmë me të drejtë që kohës i përkasin, jo vetëm cilësorë si "ishte", por në një mënyrë po aq thelbësore dhe "do të jetë" e krejt po ashtu edhe "është tani"; sepse koha nuk kualifikohet vetëm nga e kaluara, por dhe nga e ardhmja dhe e tashmja. Nëse Nietzsche, pra, është kthyer në mënyrën më të posaçme, për të karakterizuar qenien e hakmarrjes, drejt "ishte" të kohës, është e dukshme që ai nuk e mendon aspak kohën si të tillë në vetvete, por kohën e parë në njëfarë krahu. Po ç'është atëherë "qenia" e kohës? Qenia e saj e qëndrueshme, është ajo që shkon. Ajo shkon (*geht*), dmth ajo kalon (*vergeht*). Koha që vjen nuk vjen asnjëherë për të mbetur, por për të shkuar. Ku kështu? Në "të shkuarit" e saj. Kur një njeri ka vdekur, ne themi se ai u ka lënë lamtumirën gjerave kohore. Kohorja kalon, pra, për të qenë ajo që kalon.

Nietzsche e përcakton hakmarrjen si "mëri të vullnetit kundrejt kohës dhe "ishte" të saj. Ky përcaktim i shtruar në këtë mënyrë, nuk bën të dalë në pah një aspekt i veçuar i kohës, i konsideruar njëanshmërisht jashtë dy të tjerave, por ai karakterizon qartë trajtën themelore të kohës në qenien e saj totale dhe të veçantë. Me këtë "dhe" në shprehjen e kohës e këtë "ishte" të saj, Nietzsche nuk na çon thjesht drejt "pajisjes" së kohës me një karakter të saj të veçantë. Fjala "dhe" këtu ka të njëjtin sens si: "dhe kjo do të thotë". Hakmarrja është mëria e vullnetit kundrejt kohës dhe kjo do të thotë: kundrejt "të shkuarit" dhe asaj që kalon në të. Kalimtarja, për vullnetin, përfaqëson diçka kundër të cilit ky vullnet është i paforcë dhe atë ndaj të cilit dëshira e tij ndeshet vazhdimisht. Koha dhe "ishte" e saj është pengesa që vullneti nuk mund ta shmangë. Koha si "të shkuarit"

është pikërisht ajo gjëja e kundërt nga e cila vuan vullneti. Si vullnet vuajtës, ajo bëhet vetë vuajtja e të shkuarit, vuajtje që kërkon atëherë të shkuarit e saj të veçantë dhe e kërkon një gjë të tillë ngaqë gjithçka, pa përjashtim, meriton të shkojë. Mëria kundrejt kohës e vë poshtë kalimtarin. Gjërat tokësore, toka dhe gjithçka që bashkëngjitet me të, përbëjnë atë që për të folur troç, nuk do të duhej të ishte e që në thelb nuk ka aspak një qenie të vërtetë. Platon-i e quante këtë mi on, mosqenie.

Sipas tekstit të Schelling, që s'bën asgjë tjetër veçse shpall idenë drejtuese të çdo metafizike, "pavarësia kundrejt kohës" dhe "përjetësia" janë cilësorët ose atributet themelore të qenies.

Por mëria më e thellë kundrejt kohës nuk konsiston në zhvlerësimin e thjeshtë të asaj që është tokësore. Hakmarrja më e thellë konsiston për Nietzsche në atë meditim (*Nachdenken*) që shtron si absolute ide të tilla mbi-kohore, vlerësuar ndaj të cilave, kohorja mundet vetëm ta zhvlerësojë vetveten për të qenë pikërisht veçse një mosqenie.

Ndaj, si do të mundej vallë njeriu të hynte në dominimin e tokës, si do të mundej vallë të merrte nën mbikqyrje tokën si tokë, në qoftë se dhe për aq kohë sa ai zhvlerëson atë që është tokësore, e lë shpirtin e hakmarrjes të determinojë meditimin e tij? Nëse është fjala për të shpëtuar tokën si tokë, duhet fillimisht që shpirti i hakmarrjes të zhduket. Ja pse, të çliruarit nga hakmarrja është për Nietzsche-n ura drejt shpresës më të lartë.

Por në çfarë konsiston ky çlirim që na largon nga mëria jonë kundrejt "të shkuarit"? A konsiston ajo në atë që, ne të çlirohemi nga vullneti në përgjithësi? E kjo mos nënkuptohet vallë edhe në sensin e përdorimit të vullnetit nga Schopenhauer-i dhe budizmi? Në masën që qenia e qenies, sipas metafizikës moderne, është vullnet, të çlirohesh nga vullneti do të shpinte në të çliruarit nga qenia dhe kështu në të rënit në zbrazëtinë e asgjësë. Për Nietzsche-n të çlirohesh nga hakmarrja është padyshim të çlirohesh nga ajo që është përballë vullnetit, e

kundërt, zhvlerësuese, por aspak të largohesh nga çdo dëshirë. Çlirimi e largon mërinë nga “jo”-ja e saj dhe e bën atë të lirë për një “po”. Kush e afirmon vallë këtë “po”? Saktësisht ajo, që mohon mërinë e shpirtit të hakmarrjes: koha, të shkuarit.

Kjo “po” e thënë ndaj kohës është vullneti që të shkuarit të mbetet dhe të mos jetë i rënë në një gjendje të hiçit. Por si mundet vallë të shkuarit të mbetet? Në një mënyrë të vetme: që, si e shkuar, ai të mos kufizohet gjithmonë për të ikur, por të jetë gjithmonë në të ardhur. Në një mënyrë të vetme: që, në ardhjen e vet, të shkuarit dhe ajo që shkon, të rikthehen si Identike. E në vetvete ky rikthim, do të jetë një rikthim i qëndrueshëm vetëm nëse ai është një Rikthim i përjetshëm. Ndërkohë që cilësori “përjetësi”, sipas doktrinës së metafizikës, i përket Qenies së qenies.

Të çlirohesh nga hakmarrja, pra do të thotë të kalosh nga mëria kundrejt kohës në vullnetin që përfaqëson qenien në Rikthimin e përjetshëm të Identikes, dhe që bëhet kështu zëdhënës i rrethit.

Me fjalë të tjera, ndodh vetëm kur Qenia e qenies arrin t’i paraqitet njeriut si Rikthim i përjetshëm i Identikes, që njeriu mund të kalojë urën dhe, i çliruar nga shpirti i hakmarrjes, të jetë ai që e kapërcen atë, pra Mbinjeriu.

Zarathustra është mësuesi që mëson Mbinjeriun. Por nëse ai mëson këtë doktrinë, kjo ndodh vetëm pse ai është ai që mëson Rikthimin e përjetshëm të Identikes. Ky mendim i Rikthimit të përtejshëm është, nga rangu i tij, i pari, mendimi “më i thellë”. Ja pse Zarathustra e mëson atë të fundit, dhe madje gjithnjë duke nguruar.

Kush është, pra, Zarathustra i Nietzsche-s? Ai është mësuesi, doktrina e të cilit do të donte të çlironte nga shpirti i hakmarrjes meditimin e kryer deri atëherë dhe ta mundësonte atë t’i thosh “po” Rikthimit të përjetshëm të Identikes.

Zarathustra mëson Mbinjeriun, si të tillë, ngaqë ai mëson Rikthimin e përjetshëm. Refrenin e kësaj doktrine, ne e njohim

nga një shënim postum i autorit (XIV, f. 276): Ja cili është ai: *Vetëm dashuria duhet të gjykojë...* (dashuria krijuese që *harron* veten në veprat e saj)."

Duke mësuar Rikthimin e përjetshëm dhe Mbinjeriun, Zarathustra nuk mëson dy gjëra të ndryshme. Ajo që ai mëson është në vetvete koherente, sepse njëra nga dy doktrinat fton detyrimisht tjetrën për t'iu përgjigjur. Këtë korespondencë, vendin e qenies së saj, mënyrën me të cilën ajo fshihet: ja ç'fsheh në vetvete e ja ç'lë në të njëjtën kohë të shihet figura e Zarathustra-ës, duke e bërë atë kështu, gjënë më të të denjë që, lipset të mendohet para çdo gjëje tjetër.

Sidoqoftë mësuesi e di mirë që ajo që ai mëson mbetet një vizion dhe një enigmë. Madje ai këmbëngul në këtë dije që mediton një gjë të tillë.

Nërkohë që ne të tjerët, njerëzit e sotëm, për shkak të supremacisë së veçantë të shkencave moderne, gjendemi të dalldisur në një gabim të çuditshëm: ne besojmë se njohja mund të arrihet nisur nga shkenca dhe se mendimi është i justifikueshëm po nga shkenca. Ndërkohë që gjëja e vetme që një mendimtar mund të thotë ndonjëherë nuk mund të jetë, as e provuar, as e rrëzuar nga udha logjika apo nga eksperiencia. Ajo nuk është kështu as edhe objekt i ndonjë besimi. Përkundrazi, duke pyetur e duke menduar, ne mundemi vetëm ta bëjmë atë të tillë që të shihet, në mënyrë që ajo që tashmë shihet të shfaqet kështu rregullisht si Ajo që *meriton* të shtrohet në pyetje (20).

Ndaj, për ta kapur në vështrimin tonë dhe për ta ruajtur aty fytyrën e kësaj enigme që tregohet nën figurën e Zarathustra-ës, le të konsiderojmë edhe një herë spektaklin e dy kafshëve, ashtu siç ai i paraqitet atij në fillim të zhvendosjeve të veta.

"... ndërsa dielli ishte në zenit, Zarathustra nisi të kërkoji qiellin me vështrim, sepse dëgjonte nëpër të klithmën e mprehtë të një zogu. Dhe ja! kur pa një shqiponjë të fluturonte në ajër

duke formuar rrathë të mëdhenj, teksa një gjarpër rrinte i ngritur pezull mbi të, jo si një pre, por si një mik: sepse mbahej fort i mbështjellë rreth qafës së saj”

“Janë kafshët e mia! thotë Zarathustra dhe gëzohet me gjithë zemër”.

Dhe ja fraza e plotë e pasazhit *I shëruari*, e, që qëllimisht ne e kemi cituar veçse pjesërisht:

“Unë, Zarathustra, zëdhënës i jetës, zëdhënës i vuajtjes, zëdhënës i rrethit - unë të thërras, o mendimi im më i thellë!”

Është në të njëjtat terma që Zarathustra e emërton mendimin e Rikthimit të përjetshëm të Identikes në pasazhin e pjesës së II-të, Për *Vizionin dhe Enigmën*. Këtu Zarathustra përpiket për herë të parë, në shpjegimin e tij me xhuxhin, të mendojë enigmën e asaj që ai e sheh si objekt të nostalgjisë së tij. Për të, Rikthimi i përjetshëm i Identikes mbetet padyshim një vizion, por gjithashtu edhe një enigmë. Ai nuk lihet për t'u vërtetuar apo hedhur poshtë nga udha logjike apo empirike. Në thelb, kjo vlen për çdo mendim thelbësor e për çdo mendimtar: mendimi është *diçka e rangut të parë*, por ai mbetet një enigmë -duke merituar kështu shtrimin e tij në pyetje.

Kush është, atëherë, Zarathustra i Nietzsche-s? Tashmë ne mundemi t'i përgjigjemi kësaj pyetje zyrtarisht: Zarathustra është ai që mëson Rikthimin e përjetshëm të Identikes dhe ai që mëson Mbinjeriun. Tashmë ne mund të shohim gjithashtu akoma dhe më qartë, përtej formulës, se Zarathustra nuk është një mësues që mëson dy gjëra të ndryshme. Zarathustra mëson Mbinjeriun, sepse ai mëson Rikthimin e përjetshëm të Identikes. Por dhe anasjelltas: Zarathustra mëson Rikthimin e përjetshëm të Identikes, sepse ai mëson Mbinjeriun. Të dy mësimet mbajnë njëra-tjetrën dhe formojnë një rreth. Nga lëvizja e saj rrethore mësimi përgjigjet ndaj asaj që është, ndaj rrethit që, si Rikthimi i përjetshëm i identikes, konstituon Qenien e qenies, dmth atë që është e qëndrueshme ndaj së ardhmes.

Mësimi dhe mendimi i tij arrijnë në këtë lëvizje rrethore, kur ato kalojnë mbi urën që quhet: çlirim nga shpirti i hakmarrjes. Pasi vetëm prej këtej, mendimi i njohur deri tani, lipset të kapërcehet.

Një shënim i vitit 1885, dmth i kohës që ka pasuar menjëherë mbarimin e *Kështu foli Zarathustra*, figuron në nr 617, në ato letra postum të mbledhura e të bashkuara nën titullin *Vullneti i fuqisë*. Shënimi mban mbishkrimin e nënvizuar: "Rikapitullimi". Nietzsche kondenson këtu në pak fraza, por me një qartësi të jashtëzakonshme, thelbësoren e mendimit të tij. E Zarathustra është emërtuar posaçërisht kështu në një vërejtje kalimthi të vendosur ndërmjet parantezash: "*Të shtypurit në të ardhmen e karakterit të qenies - i tillë është vullneti më i lartë i fuqisë*".

Vullneti më i lartë i fuqisë, dmth ajo çka është më e gjalla në çdo jetë, rivjen për ta përfaqësuar "të shkuarit" si të ardhme të qëndrueshme në Rikthimin e përjetshëm të Identikes dhe për ta bërë atë kështu të qëndrueshme dhe permanente në vetvete. Ky përfaqësim është një mendim që, siç vëren dhe thekson vetë Nietzsche, i "shtyp" qenies karakterin e Qenies (*Sein*) së saj. Ky mendim merr nën mbikqyrje, nën mbrojtjen e tij, të ardhmen ndaj së cilës është e qenësishme një përplasje e vazhdueshme, pra vetë vuajtja.

Mos vallë është kapërcyer nga ky mendim meditimi i kryer deri tani, e prej këtej është kaluar vallë dhe shpirti i hakmarrjes? Apo pikërisht, ajo që fshihet në këtë gjurmë që merr çdo të ardhme nën mbikqyrje të Rikthimit të përjetshëm të Identikes, mos është vallë, megjithatë dhe akoma, një mëri e kthyer *kundër* të shkuarit të pastër e të thjeshtë, e bashkë me të një shpirt hakmarrjeje i spiritualizuar në pikën më të lartë?

Sapo shtrojmë këtë pyetje, ne gjendemi në krahët e pikëpamjes më të lakmuar që është dhënë për Nietzsche-n, pra idesë se ajo që ai do të kapërcejë është pikërisht ajo që atij i është më e vetja, e që është njëlloj sikur ne të ushqenim shpresën se

nga një demonstrim i tillë, mendimi i këtij mendimtari do të gjendej i rrëzuar.

Por zelli që dëshiron ta hedhë atë poshtë nuk arrin kurrë deri në udhën e një mendimtari. Ai bën pjesë në ato lojra të shpirtrave të vegjël që janë të nevojshëm për zbavitjen e publikut. Veç kësaj, që prej shumë kohësh, vetë Nietzsche i është përgjigjur edhe më përpara pyetjes sonë. Libri që paraprin menjëherë *Kështu foli Zarathustra* është shfaqur më 1882 me titullin *Njohja e hareshme*. Në copëzën e saj të parafundit, nr. 341, "mendimi më i thellë" i Nietzsche-s është shfaqur për herë të parë nën titullin *Pesha më e rëndë*. Copëza nr. 342, që pason, është rimarrë fjalë për fjalë nga *Kështu foli Zarathustra*, duke formuar pikërisht fillimin e prologut.

Në veprat postum (*Op.*, vëll.XIV, f.404 e më poshtë) gjenden projekte të ndryshme të hyrjes së *Njohjes së hareshme*. Aty lexojmë:

"Në një shpirt të fortifikuar nga luftërat dhe fitoret, për të cilin pushtimi, aventura, rreziku, vetë dhimbja janë kthyer në nevoja; në një përshtatje me ajrin e gjallë të lartësive, me marshet e dimrit, me akullin dhe malin - në të gjitha senset e këtyre fjalëve; në një lloj ligësie sublime dhe tërbimi të fundit të hakmarrjes, ja ku gjendet *hakmarrja* - një hakmarrje kjo e ushtruar ndaj vetë jetës e që ndodh pikërisht atëherë kur një njeri që ka vuajtur shumë e merr atë nën mbrojtje të vet".

Ç'të thuash tjetër, veçse që mësimi i Zarathustra-ës nuk na çliron aspak nga hakmarrja? Ne e themi këtë, vetëm se ne nuk e themi në sensin e një rrëzimi të pretenduar të filozofisë së Nietzsche-s. As madje si vërejtje ndaj këtij mendimi të Nietzsche-s. Por ne e themi këtë për të kthyer vështrimin tonë mbi faktin që, edhe mendimi i Nietzsche-s gjithashtu, lëviz në shpirtin e meditimit të shkuar dhe të tanishëm, për t'u orvatur kështu të shohim se deri në ç'pikë ai lëviz aty. Më tej, ne nuk do të shqyrtojmë as se nëse ky shpirt i mendimit deri tani të njohur

është, në një mënyrë të përgjithshme, i kapur në qenien e tij e në atë që është determinuese, vetëm kur arrin të interpretohet si shpirt hakmarrje. Në të gjitha rastet mendimi deri tani i njohur është metafizikë e mund të supozohet me plot të drejtë që mendimi i Nietzsche-s e realizon plotësisht përkryerjen e kësaj metafizike.

Për këtë arsye, në të shfaqet diçka që ky mendim nuk mundet më ta mendojë. E fakti që mendimi të qëndrojë prapa asaj që ai mendon, karakterizon pikërisht atë çka ai ka më krijuese. Madje edhe aty ku një mendim çon metafizikën në përkryerjen e saj, ai tregon, në mënyrën e një rasti të privilegjuar, diçka që ai nuk e mendon dot e që është njëkohësisht e qartë dhe konfuze. Por ku janë vallë sytë për ta parë atë?

Mendimi metafizik qëndron mbi dallimin e asaj që është në të vërtetë me atë që, vlerësuar nga zanafilla, konstituon atë që nuk është në të vërtetë. Për *qenien* (Wesen) e metafizikës, megjithatë, pika vendimtare nuk është fakti që ky dallim të marrë formën e kundërvënies së supervetëdijshtes ndaj së vetëdijshtes, por pikërisht që ai të mbetet, në sensin e një shkëputjeje, të një gjëje parësore dhe fundamentale. Ky dallim ngulmon akoma, edhe atëherë madje kur hierarkia platoniane e të supervetëdijshtes dhe të vetëdijshtes është përmbysur dhe kur e vetëdijshtja është objekt i një eksperience më esenciale dhe më të gjërë, në sensin që Nietzsche e sugjeron me emrin e *Dionysos* (Dionizit). Sepse tepria ndaj së cilës aspiron "Nostalgjia e madhe" e Zarathustra-ës është permanenca e pashtershme e së ardhmes, ajo që si vullneti i fuqisë e paraqitet veten në Rikthimin e përjetshëm të Identikes.

Atë që është thellësisht metafizike në mendimin e vet, Nietzsche e ka bërë të futet në formën ekstreme të mërisë, dmth në rreshtat e fundit të veprës së tij të fundit *Ecce homo: Si të bëhesh ai që je*. Nietzsche e ka shkruar këtë libër në nëntor 1888. Ajo u publikua për herë të parë veçse 20 vjet më vonë, në tirazh të kufizuar, dhe është më 1911 që zuri vend në vëllimin XV të

edicionit të të mëdhenjve. Rreshtat e fundit të *Ecce homo* janë:

“- Më kanë kuptuar vallë? *Dionizi kundër të Kryqëzuarit...*”

Kush është Zarathustra i Nietzsche-s? Ai është zëdhënësi i Dionizit. Kjo do të thotë: Zarathustra është mësuesi që, në doktrinën e tij të Mbinjeriut dhe për të, mëson Rikthimin e përjetshëm të Identikes.

A i përgjigjet vallë kjo frazë pyetjes sonë? Jo. Ajo nuk i përgjigjet asaj edhe atëherë kur ne u shkojmë përshtat treguesve që e kanë sqaruar, për të ndjekur edhe vetë udhën e Zarathustra-ës, pavarësisht se mund të mos kalojmë aspak me hapin e tij të parë mbi urë. Megjithatë, fraza e mësipërme që ka dukjen e një përgjigje do të mundej gjithsesi të na e zbuste veshin dhe të na përqaste në mënyrë akoma dhe më të vëmendshme, me titullin e kësaj eseje.

Kush është Zarathustra i Nietzsche? Në këtë fazë ku kemi arritur kjo pyetje mund të shtrohet si : Kush është ky mësues që mëson? Kush është kjo figurë që shfaqet në metafizikë në stadin e përkryerjes së saj? Askund tjetër në historinë e metafizikës perëndimore, figura esenciale e mendimtarit që e përfaqëson atë në një moment të dhënë nuk kthehet kështu, posaçërisht, si tema e një krijimi poetik, ose e thënë në një mënyrë më të drejtë dhe letrare, si tema e një krijimi të mendimit (*erdacht*); askund tjetër, përveçse në fillimet e mendimit perëndimor, tek Parmenidi, por dhe këtu vetëm në trajta të mbuluara.

Ajo që mbetet thelbësore në figurën e Zarathustra-ës, është që mësuesi mëson dy gjëra që mbajnë njëra-tjetrën: Rikthimin e përjetshëm dhe Mbinjeriun. Vetë Zarathustra është, në njëfarë mënyre, ky kohezion i brendshëm. Nga ky këndvështrim, ai mbetet gjithashtu edhe një enigmë për të cilën ne akoma mezi sa jemi bërë të vetëdijshëm.

“Rikthimi i përjetshëm i Identikes” është emri i dhënë ndaj Qenies së qenies. “Mbinjeriu” është emri i dhënë ndaj qenies së njeriut që korrespondon me këtë Qenie (të qenies).

Po nga vjen që Qenia (*Sein*) e qenies dhe qenia e njeriut (*Menschenwesen*) të jenë të pandara? Si mbahen ato tek njëra-tjetra, nëse qenia nuk është një fabrikim i njeriut dhe nëse njeriu nuk është më shumë se sa një rast i thjeshtë dhe i veçantë në brendësi të Qenies?

E më tej, a mundet të diskutohet vallë ky solidaritet i Qenies (së qenies) dhe i qenies së njeriut, për aq kohë sa mendimi të mbetet i lidhur ndaj konceptit të njeriut të pranuar deri më sot? Sipas këtij koncepti, njeriu është *animal rationale*, kafshë e arsyeshme. Është vallë rastësi apo zbukurim i pastër poetik, nëse dy kafshët, shqiponja dhe gjarpëri, gjenden pranë Zarathustra-ës, e nëse janë pikërisht ato që i thonë se çfarë duhet të bëhet për të qenë ai që është? Për atë që mendon, është pikërisht bashkimi i krenarisë dhe i zgjuarsisë ai që duhet të shfaqet në figurën e këtyre dy kafshëve. Megjithatë duhet ditur mirë ajo çka Nietzsche mendon për njerën kafshë dhe për tjetrën. Në shënimet që datojnë në epokën kur qe shkruar *Kështu foli Zarathustra*, lexojmë:

“Më duket që zgjuarsia dhe krenaria janë ngushtësisht të lidhura... Pika e tyre e përbashkët është vështrimi i ftohtë dhe i sigurtë, që në të dy rastet di të vlerësojë”. (Op, XIV, f. 99).

Pak më larg gjendet pasazhi:

“Thuhen kaq marrëzira mbi *krenarinë*, madje kristianizmi e ka bërë atë të ndihet edhe si një *mëkat!* Në fakt: *kush kërkon dhe merr nga vetja diçka të madhe* duhet të ndjehet mjaft larg atyre që nuk e bëjnë këtë gjë; e kjo *distancë* interpretohet nga të tjerët si një “mendim i lartë për vetveten”; ndërkohë që ai vetë nuk e njeh atë (distancën) ndryshe, veçse si punë të palodhur, luftë, fitore, ditën dhe natën, kur nga e gjitha kjo, të tjerët nuk dinë asgjë!” (Op., XIV, f. 101).

Shqiponja: kafsha më krenare; gjarpëri: kafsha më e zgjuar. E që të dy të dalldisur në rrethin ku gjejnë shtrat për vrullin e tyre, në unazën që shtrëngon qenien e tyre: pra, rrethi dhe unaza, që të vëna në rradhë janë të angazhuar tek njëri tjetri.

Enigma: kush është Zarathustra, që si i tillë mëson Rikthimin e përjetshëm dhe Mbinjeriun? Kjo enigmë na bëhet e dukshme në spektaklin e dy kafshëve. Në këtë spektakël ne mundemi për të mbërthyer dhe mbajtur, në një mënyrë më të shpejtë dhe më të lehtë, atë që ekspozoja jonë është përpjekur për ta treguar si të denjë për t'u shtruar në pyetje: raportin e Qenies (*Sein*) me këtë qenie të gjallë që është "njeriu".

“Dhe ja! Tek shihet një shqiponjë të fluturojë në ajër duke formuar rrathë të mëdhenj, teksa një gjarpër rri ngritur pezull mbi të, jo si një pre, por si një mik: sepse mbahet fort i mbështjellë rreth qafës së saj”

“Janë kafshët e mia!, - thotë Zarathustra dhe gëzohet me gjithë zemër”.

PJESA E PARË

Prologu i Zarathustrës

1

Me të mbushur 30 vjeç, Zarathustra e la vendin dhe liqenin e tij të lindjes dhe u tërhoq nëpër male. Aty, për 10 vjet, pa u lodhur, shijoi shpirtin dhe vetminë. Por, më në fund, zemra e tij heshti; një ditë ai u ngrit bashkë me aurorën e nisi të ecë përkundrejt diellit, për t'i folur kështu:

“O i madhi yll! Ç’do ishte vallë gëzimi yt, po të mos qenë të gjithë ata që ti ndriçon?!

Për 10 vjet ke zbritur këtu poshtë në shpellën time e, patjetër do të qe bërë i mërzitshëm udhëtimi dhe drita pa mua, shqiponjën dhe gjarprin tim.

Po ne të prisnim çdo mëngjes, ti na dhuroje pasurinë tënde e merrje si shpërblim bekimet tona.

Tash shiko! Jam përvjelë nga mençuria ime, si një bletë që ka bërë më shumë mjaltë sesa duhet; kam nevojë për duar që të shtrihen kundrejt meje.

Do të doja parà për t'i dhuruar pa u kursyer, deri kur të mençurit të gazmoheshin përsëri me marrëzinë e tyre dhe të varfrit me pasurinë e tyre.

Për t'ia arritur kësaj, më duhet të zbres, siç bën ti, kur në mbrëmje zbret e perëndon në det, për të sjellë dritën tënde në mbretërinë e të vdekurve, o yll plot pasuri e plot jetë!

Edhe unë, si ti, duhet të perëndoj, siç thonë njerëzit, drejt atyre kah të cilëve dua të zbres.

Ndaj, bekomë, o sy i paqtë, që të mund të kundrosh pa zili edhe një gaz të tillë kaq të madh!

Bekojë kupën që dëshiron të derdhet, derisa të shpërthejë uji i praruar, që do të çojë kudo pasqyrimin e gëzimit tënd!

Vështroje: kupa do të zbrazet sërish e Zarathustra do sërish të jetë njeri.

Kështu filloi zbritja e Zarathustrës

2

Zarathustra zbriti i vetëm nga malet, pa takuar askënd. Po kur mbërriti pyllin, befas u ndesh me një plak që e kish lënë kasollen e vet për të kërkuar rrënjë nëpër pyll. Kështu, plaku i foli Zarathustrës:

“S’më duket i panjohur ky shtegtar; shumë vite më parë kaloj këtej, por tash ka ndryshuar. Atëherë hirin tënd e çojë në male, tash ndoshta do ta çosh zjarrin tënd në luginë? Por, a nuk i frikohesh ndëshkimit që i pret zjarrndezësve?”

Po, unë e njoh Zarathustrën. I kulluar është vështrimi e në gojë të tij nuk ka çerdhen e vet asnjë ndjenjë neverie. Pse nuk ecën ai vallë si një valltar?

Zarathustra ka ndryshuar, Zarathustra është bërë fëmijë, Zarathustra është zgjuar. Po ç’kërkon të bësh me të fjeturit?

Atë që, kur i vetëm jetoje në mes të detit, bëri detin duke të marrë në gji të tij.

Medet, tash ti do të zbresësh në tokë?! A mos vallë do ta nxjerrësh trupin nga vetja?”

Zarathustra iu përgjigj: “Unë i dua njerëzit!”.

“Pse, cila është arsyeja, - tha shenjti, - që u tërhoqa në pyll e në vetmi? S’është ndoshta se edhe unë i dashurova njerëzit aq shumë?”

Po tani unë dashuroj Zotin, nuk dashuroj më njerëzit.

Njeriu është diçka goxha e papërsosur për mua. Dashuria e njerëzve do të më vriste.”

Zarathustra u përgjigj: “Por unë nuk fola për dashuri! Unë njerëzve po u sjell një dhuratë”.

“Mos u jep atyre asgjë, - tha shenjti. - Më mirë hiqja diçka nga barra që mbajnë, e mbarte atë bashkë me ta; do të jetë gjëja më e mirë që mund t’u bësh, mjaft që të të bëjë mirë edhe ty.

E, nëse do t’u japësh diçka, mos u jep më shumë se lëmoshë, e prit të të përulen, që t’ua japësh!”

“Jo, - kundërshtoi Zarathustra, - unë nuk jap lëmoshë. Nuk jam aq i varfër sa ta bëj këtë gjë.”

Shenjti qeshi me Zarathustrën e iu përgjigj: “Atëherë, provoje nëse do t’i pranojnë dhuratat! Janë shumë dyshimtarë ndaj eremitëve e nuk besojnë se misioni ynë është t’u shpërndajmë atyre dhurata.

Hapat tona trokasin si shumë vetmitarë nëpër rrugë. U ngjajnë netëve, teksa rrinë shtretërve të tyre, e dëgjojnë ndonjë njeri të ecë shumë më parë se të gdhijë dita, të pyesin veten se ku po shkon ky hajdut.

Mos shko mes njerëzve! Rri në pyll!

Shko më mirë mes kafshëve! Pse nuk do të jesh si unë, ari mes arinjve, zog mes zogjve?!”

“E ç’bën vallë një shenjt në pyll?” - pyeti Zarathustra.

Shenjti iu përgjigj: “Kompozoi këngë e i këndoj e, kur kompozoi, qesh, qaj e belbëzoj me vete. Kështu i lartoj Zotit lavdet e mia.

Duke kënduar, duke qarë e duke bluar brenda vetes, unë lëvdoj atë Zot që është Zoti im. Po ti, ç’dhuratë na sjell?

Në këtë moment, Zarathustra e përshëndeti shenjtin dhe tha: “Ç’gjë mund t’ju jap? Lërmëni të shkoj më mirë, përpara se t’ju heq diçka!”

Kështu u ndanë me njëri-tjetrin, plaku dhe njeriu, duke buzëqeshur ashtu siç buzëqeshin dy vogëlushë.

Por kur Zarathustra mbeti vetëm, kështu i foli zemrës së vet: “Si është e mundur? Ky shenjt plak në pyllin e tij nuk e ditka akoma se Zoti ka vdekur”.

3

Kur Zarathustra mbërriti në qytetin më të afërt, të vendosur në kufij me pyllin, gjeti një turmë të madhe të mbledhur në treg. Ish shpërhapur lajmi se një pehlivan do të jepte koncert. E Zarathustra, kështu i foli popullit:

“Unë po ju shpall Mbinjeriun. Njeriu është diçka që duhet tejkaluar. Ç’keni bërë ju vallë për ta tejkaluar?

Çdo qenie deri më sot ka krijuar diçka sipër vetes. Po ju, a dëshironi të jeni zbatice e kësaj batice goxha të madhe e të riktheheni te kafshët, në vend që ta tejkaloni njeriun?

Po ç’është vallë majmuni për njeriun? Një tallje, një turp i dhimbshëm. Ky duhet të jetë njeriu për Mbinjeriun: një tallje, një turp i dhimbshëm.

Deri tani keni përshkruar rrugën që shkon nga krimbi te njeriu; nga krimbi keni akoma shumë brenda jush. Njëherë e një kohë ishit majmunë e, akoma edhe sot njeriu është më majmun se çdo lloj majmuni. Ai, që mes jush është më i mençuri, nuk është veçse një qenie çharmonioze, një hibrid mes bimës dhe fantazmës. Mos po ju them vallë të bëheni bimë apo fantazma?

Dëgjomëni, unë po ju mësoj Mbinjeriun!

Mbinjeriu është sensi i tokës. E kështu le të thotë dëshira juaj: Mbinjeriu duhet të jetë sensi i tokës!

Po ju përgjerohem, o vëllezër, qëndrojeni besnikë tokës e mos u besoni atyre që ju flasin për pritshmëri pastokësore! Janë helmatisës, të vetëdijshtë ose jo; janë përçmues të jetës, njerëz në prag të vdekjes, të helmuar edhe vetë nga vetvetja; toka është e lodhur prej tyre. Oh, sikur të zhduken përgjithmonë!

Një kohë, krimi ndaj Zotit ishte mëkati më i madh, por Zoti ka vdekur e, bashkë me të kanë vdekur edhe fajtorët e këtij krimi. Sot, faji më i tmerrshëm është të mëkatosh kundër tokës e të lartosh lavdinë e brendisë së të padepërtueshmes më shumë se sa sensin e tokës.

Një kohë, shpirti e kundronte trupin në përçmim; e ky përçmim ishte vlera më e lartë: ai e donte të thatë, të frikshëm, të uritur. Kështu imagjinonte t'i arratisej trupit dhe tokës.

Po medet, ishte vetë shpirti ai që ish i thatë, i frikshëm, i uritur. E mizorshmja ishte dëshirimi i tij!

Po edhe ju, o vëllezërit e mi, pa më thoni: ç'ju thotë trupi për shpirtin tuaj? Nuk është ai vallë meskinitet, ndyrësi e kënaqësi e trishtë?

Njeriu është vërtet një lumë njelmësi-shumë. Lipset të jesh det, për të pritur një lumë kaq të fëlliqur, për të mos mbetur edhe vetë i fëlliqur.

Dëgjoni, unë po ju mësoj Mbinjeriun: ai është ky det, në të mund të hidhet gjer në thellësi përçmimi juaj i madh.

Cila është eksperiencia më e lartë që mund të jetoni? Ora e përçmimit të madh. Ora, në të cilën edhe gëzimi juaj do të shndërrohet në neveri, ashtu si edhe arsyeja e virtyti juaj.

Ora, në të cilën ju do të thoni se ç'më intereson lumturia ime. Është diçka mjerane, e ndyrë, një ngushëllim i mizershëm, kur vetëm lumturia do të mjaftonte për të justifikuar ekzistencën.

Ora, në të cilën ju do të thoni se ç'më intereson arsyeja ime. A mos ndoshta ju keni uri për diturinë, si luani për ushqimin e tij? Ajo s'është veçse diçka mjerane, e ndyrë, një ngushëllim i mizershëm.

Ora, në të cilën ju do të thoni se ç'më intereson virtyti im. Ai s'ka arritur ende të më bëjë të çmendur. Sa i lodhur jam me të mirën e të keqen time. E gjitha kjo nuk është veçse diçka mjerane, e ndyrë, një ngushëllim i mizershëm.

Ora, në të cilën ju do të thoni se ç'më intereson drejtësia ime. Unë s'po shoh akoma të jem bërë thëngjill i ndezur. Kur i drejti, në të vërtetë është një thëngjill i ndezur.

Ora, në të cilën ju do të thoni se ç'më intereson dhembshuria ime! Nuk është vallë dhembshuria kryqi, në të cilin gozhdohet ai që dashuron njerëzit? Mirëpo, dhembshuria ime nuk është kryqëzim.

A keni folur ndonjëherë në këtë mënyrë? A keni bërë titur ndonjëherë në këtë mënyrë? Ah, sikur t'ju kisha dëgjuar të bërtisni në këtë mënyrë!

S'është mëkati juaj: është kënaqësia juaj e përmbushur ajo që bërtet hakmarrje faqe gjithë qiellit, është vetë makutëria që, në mëkatin tuaj bërtet hakmarrje faqe gjithë qiellit.

Ku është rrufeja, që do t'ju lëpijë me gjuhën e saj? Po marrëzia, prej së cilës duhet të ishit vaksinuar?

Shikoni, unë po ju mësoj Mbinjeriun; ai është ajo rrufe, ai është ajo marrëzi!”

Kur Zarathustra foli kështu, njëri nga populli ulëriti: “Kemi dëgjuar të flitet shumë për pehlivanin; më në fund, lërnani ta shohim!”.

Dhe i gjithë populli qeshi me Zarathustrën. Ndërkohë, pehlivani, që pat besuar se ligjërimi ishte bërë për të, nisi të përgatitej.

4

Zarathustra vështroi popullin dhe u mrekullua, Atëherë foli kështu:

“Njeriu është një litar i tendosur mes kafshës dhe Mbinjeriut, një litar mbi një humnerë, një përtejkalim i rrezikshëm, një lëvizje e rrezikshme, një kthim i rrezikshëm prapa, një fërgëlli dhe një ndalim i rrezikshëm.

Ajo ç'ka e bën të madh njeriun është se ai është një urë, dhe jo një qëllim. Ajo ç'ka mund t'i dashurohet është se ai është një kalim dhe një katastrofë.

I dua ata që nuk dinë të jetojnë, qoftë edhe si dekadentë, sepse janë ata që shkojnë përtej.

I dua përbuzësit e mëdhenj, sepse janë adhuruesit dhe shigjetat e mëdha të nostalgjisë për në bregun tjetër.

I dua ata që nuk kërkojnë përtej yjeve ndonjë arsye për t'u kredhur e sakrifikuar, por sakrifikohen për token, për të bërë që një ditë toka të jetë e Mbinjeriut.

E dua atë që rron për të njohur vetveten e që do të njohë edhe të tjerët, për të bërë që një ditë të rrojë Mbinjeriu. Se kështu ai do edhe perëndimin e vet.

E dua atë që punon e zbulon se ku t'ia ndërtojë shtëpinë Mbinjeriut, t'i përgatisë terrenin, kafshë dhe bimët, sepse është një njeri që do shkatërrimin e vet.

E dua atë që e dashuron virtytin e tij, sepse virtyti është një vullnet kredhjeje dhe një shigjetë nostalgjie.

E dua atë që nuk mban për vete as edhe një pikë të shpirtit, por do të jetë tërësisht shpirt i virtytit të tij, sepse është një njeri që ecën përpara, si shpirt mbi një urë.

E dua atë që e bën virtytin kahun dhe fatin e tij, sepse është një njeri që, për shkak të virtytit të vet do dhe s'do më të jetojë.

E dua atë që nuk do të ketë shumë virtyte. Një virtyt është më shumë se dy, sepse është akoma dhe më tepër një nyje, ku varet një fat.

E dua atë, shpirti i të cilit shpërhapet bujarisht; atë që nuk do të falënderohet e as të falënderojë, sepse është një njeri që gjithmonë dhuron e nuk interesohet për ruajtjen e vetvetes.

E dua atë që turpërohet, kur zari i fatit bie në favor të tij e që pyet veten se mos jam vallë një lojtar hileqar, sepse është një njeri që do të gremiset në humnerë.

E dua atë që do t'i paraprijë veprimet e veta me fjalë të arta e që gjithmonë bën më shumë sesa premtion, sepse do shkatërrimin e vet.

E dua atë që i justifikon brezat e ardhshëm dhe është një realizim për ata të shkuarit, sepse është një njeri, i cili do që e tashmja ta rrënojë.

E dua atë që e keqtrajton zotin e vet, sepse është një njeri që e do Zotin, e i duhet të shkojë në rrënim nga zemërimi i zotit të tij.

E dua atë, shpirti i të cilit është i thellë edhe në lëndim, që mund të shkojë në shkatërrim edhe për ngjarjen më të vogël, sepse është një njeri që kalon vullnetarisht mbi urë.

E dua atë, shpirti i të cilit grafullon, aq sa arrin ta harrojë edhe vetveten; të gjitha gjërat janë në të e të gjitha gjërat shndërrohen në rrënimin e tij.

E dua atë që e ka shpirtin dhe zemrën të lirë, kështu që mendja e tij s'është veçse një brendi e zemrës, ndërkohë që zemra është ajo që e shtyn drejt humnerës.

I dua të gjithë ata që janë pika të rënda shiu, që bien një nga një prej resë së zezë që rri pezull mbi njerëzit; që shpallin se rrufeja do të vijë e, si lajmëtar i tillë shkon kah rrënimin e vet.

Shikoni, unë jam një lajmëtar i rrufesë dhe një pikë e rëndë e resë së zezë së shiut, kurse rrufeja quhet Mbinjeriu.

5

Kur Zarathustra i tha këto fjalë, i vështroi edhe një herë njerëzit në fytyrë dhe heshti. "Ja tek janë, - i tha zemrës së vet, - qeshin e nuk më kuptojnë, s'jam një zë i përshtatshëm për veshët e tyre."

Mos është e nevojshme, së pari, t'ua presësh veshët, që të mësohen të dëgjojnë me sy? Është e nevojshme të bësh zallamahi, si daullet dhe predikatoret e pendesave? Apo ata u besojnë veç atyre që belbëzojnë?

Kanë në vetvete diçka, për të cilën janë krenarë. Po si e quajnë? Kulturë, e quajnë atë që i dallon nga çobanët e dhive.

Ndaj, i dëgjojnë dashakeqës ata që u drejtohen me shprehje përçmuese. E, atëherë, unë do t'i flas krenarisë së tyre.

Do t'u flas për gjënë më të përçmueshme nga çdo gjë: njeriun e fundit.

E kështu i foli popullit Zarathustra:

"Është koha që njeriu të ravijëzojë qëllimin e vet. Është koha që njeriu të mbjellë farën e shpresës së tij më të epërme.

Për një gjë të tillë terreni i tij është mjaft i pasur. Por ndonjë ditë ai do të varfërohet e do të shterpëzohet, aq sa asnjë pemë shtatlartë s'do të rritet më.

Mjerë ju! Do të vijë koha kur njeriu nuk do ta vërvitë më shigjetën e nostalgjisë së tij përtej njeriut; koha kur krina e harkut të tij nuk do të dijë më të vibrojë.

Unë ju them se duhet të keni kaos akoma brenda vetes, që të mund të lindni një yll vallëzues. Unë ju them se e keni akoma kaosin brenda jush.

Po mjerë ju! Do të vijë koha kur njeriu nuk do të ketë më yje për të lindur. Mjerë ju! Do të vijë koha e njeriut të mbërritur në skajin më fundor të përbuzjes së tij, kur ai nuk do të dijë më ta përbuzë as veten.

Ja! Unë po ju tregoj njeriun e fundit.

Ç'është vallë dashuria? Ç'është krijimi? Ç'është nostalgjia? Ç'është ylli? Kështu pyet njeriu i fundit, e shkel syrin.

Toka asokohe do të jetë bërë e vogël e mbi të do të shkojë duke brofur njeriu i fundit, që do ta shndërrojë gjithçka akoma dhe më të vogël. Raca e tij do të jetë e pa shkatërrueshme, si pleshti i tokës; njeriu i fundit do të rrojë më gjatë se të gjithë.

Ne kemi shpikur lumturinë, do të thonë njerëzit e fundit, e do të shkelin syrin.

I kanë braktisur vendet, ku ish e vështirë të jetoje, se u nevojitej ngrohtësi. E dashurojnë ende fqinjin e fërkohen pas tij, se kanë nevojë për ngrohtësi.

Të sëmuresh e të dyshosh për ta është mëkat: duhet ecur gjithmonë syçelët. Është i çmendur ai që ende ngatërrohet mbi gurët e mbi njerëzit.

Herë pas here pinë ndonjë helm; ai të bën të ëndërrosh ëmbëlsisht. E, në fund, pinë shumë helm, për të vdekur ëmbëlsisht.

Punojnë akoma, se puna është një mënyrë për të kaluar kohën. Por ajo kërkohet të bëhet në atë formë që kjo zbavitje të mos i dëmtojë.

Nuk ka më të varfër a të pasur: të dyja situatat janë goxha angazhuese. Kush do të kërkojë të sundojë akoma? Kush do të bindet akoma? Si njëra dhe tjetra janë goxha angazhuese.

Nuk ekziston më asnjë bari dhe grigja e tij. Çdokush do të njëjtën gjë, çdokush është i barabartë me të tjerët; kush ndihet ndryshe, shkon drejt e në çmendi.

Në kohët e shkuara të gjithë ishin të çmendur, thonë më të diturit, e shkelin syrin.

Janë të mençur e dinë gjithçka që ka ndodhur; kështu nuk rreshtin kurrë së buzëqeshuri. Ka akoma ndonjë që inatoset; por ripaqësohet shpejt, për të mos e rënduar stomakun.

E ruajnë ende atë gëzim të vogël e të shkurtër për ditën dhe atë kënaqësi të vogël e të shkurtër për natën, por e respektojnë shëndetin.

Kemi shpikur lumturinë, thonë njerëzit e fundit, e shkelin syrin.

Këtu mbaroi ligjërata e parë e Zarathustrës, e quajtur ndryshe edhe "prolog", sepse, në këtë pikë, atë e ndërpreu alegria dhe poterja e turmës. "Na e jep këtë njeri të fundit, o Zarathustra! - ulërinin ata, - bëj që ne të jemi këta njerëz të fundit! Mbinjeriun tënd po ta dhurojmë ty!". Dhe i gjithë populli brohoriste dhe nxirrte gjuhën.

Por Zarathustra u bë i trishtë e i tha zemrës së vet: "Nuk më kuptojnë, s'jam zë i përshtatshëm për veshët e tyre. Kam jetuar shumë gjatë nëpër male e kam dëgjuar gjatë zërin e përrenjve e të pemëve; tash po ju flas atyre, siç u flitet çobanëve të dhive.

I pamposhtur është shpirti im e i qartë si mali, në orën që i paraprin mesditës. Por ata besojnë se unë jam i ftohtë e nuk di veçse të shpotisë me shaka mizore.

Ndaj, më shohin e qeshin e, teksa qeshin vazhdojnë të më urrejnë. Në të qeshurën e tyre ka ngricë".

6

Mirëpo, atëherë ndodhi diçka që e bëri memece çdo gjuhë e të shtangur çdo sy. Pehlivani akrobat kish nisur numrin e tij: kish dalë nga një portë e vogël e po ecte mbi një tel të tendosur midis dy kullave. Pezull, aty lart, ai rrinte mbi turmën dhe tregun. Kur

mbërriti në mes të rrugës, dera e vogël u hap përsëri dhe një shok i tij, me një veshje ngjyrë lakër, i ngjashëm me një kloun, brofi jashtë dhe me hapa të shkathëta e ndoqi pas. “Përpara, këmbë të ëmbla, - briti zëri i tij i tmerrshëm, - përpara, o përtac, kontrabandist, o fytyrëzbehtë! Dua të të bëj ta shijosh thembrën time! Ç’po bën vallë këtu mes kullave? Brenda kullave duhet të rrish! Në birucë duhet të të rrasin, ti që pengon kalimin e atij që është më i mirë se ty!” E, në çdo fjalë që thoshte i afrohej gjithnjë e më shumë, por, kur arriti një hap larg ndodhi gjëja më e frikshme, që i bëri të heshtnin të gjithë e të qëndronin me sy të zgurdulluar. Fishkëlleu në ajër një britmë si e djallit dhe ai individ bëri një kërcim të shpejtë e të menjëhershëm, duke e kapërcyer atë që ia pengonte kalimin. Kur e pa veten të kaluar nga shoku, akrobati humbi litarin dhe toruan, hodhi tej shtangën dhe u rrokullis teposhtë, edhe më shpejtë se ajo, si një lëmsh këmbësh e krahësh të ngatërruara në ajër. Tregu dhe turma ngjanin si deti kur trazohet nga furtuna: gjithçka që turbullirë dhe grumbullim, veçanërisht aty ku duhet të binte trupi.

Po Zarathustra qëndroi i palëvizur në vendin e vet; pikërisht pranë tij u rrëzua trupi i copëtuar e i shqyer si mos më keq, po jo akoma i vdekur. Pas pak çastesh, fatkeqit iu kthye ndërgjegjja dhe ai dalloj Zarathustrën në gjunjë përpara tij. “Ç’bën këtu ti? - i tha më në fund. - Unë e dija prej kohësh se djalli do të më kish dhënë një shqelm e do të më kish rrëzuar. Tani do të më zvarrisë për në ferr. A mund t’i kundërvihesh dot atij?”

“Në të vërtetë, o mik, - u përgjigj Zarathustra, - nuk qëndron fare kjo që po thua: nuk ka as djall e as ferr. Do të vdesë më shpejt shpirti se trupi yt. Mos ki frikë nga asgjë!”

Tjetri e vështroi dyshimtar. “Nëse po thua të vërtetën, - bërtiti, - atëherë unë s’humbas asgjë, nëse humbas jetën. Nuk jam më shumë se sa një kafshë, së cilës i është mësuar të vallëzojë me zor, për hir të frikës së të rrahurit dhe kafshatës së bukës së gojës.”

“Oh, jo, - tha Zarathustra, - ti e ke shndërruar rrezikun në profesionin tënd e për këtë nuk ke ç'të thuash. Tani po vdes si pasojë e këtij profesioni. Unë, nga ana ime, kam për qëllim të të varros me duart e mia.”

Kur Zarathustra i tha këto fjalë, i dergjur për vdekje, s'u përgjigj më, por lëvizi vetëm dorën, sikur të donte të kërkonte dorën e tij për ta falënderuar.

7

Ndërkaq ra mbrëmja, tregu u mbështoll nga hijet; njerëzit filluan të iknin, sepse dhe tmerrri e kurioziteti lodhen.

Por Zarathustra qëndronte pranë të vdekurit që dergjej në tokë, i mbytur nga mendimet; e kishte harruar fare kohën që po shkonte.

Më në fund u bë natë dhe një erë e ftohtë fryu mbi vetmitarin. Atëherë Zarathustra u ngrit e i tha zemrës: “Sot Zarathustra pati vërtet një peshkim të mbarë. Nuk peshkoi një njeri, por një kufomë.

Qenia njerëzore është e çuditshme dhe e pakuptimtë: një palaço mund të bëhet fatal për të.

Unë dua t'u mësoj njerëzve kuptimin e qenies së tyre: kush është Mbinjeriu, vetëtimja që shndrit nga rreja e zezë njeri.

Por, për fat të keq, jam ende larg tyre e sensi im nuk i flet dot sensit të tyre. Jam akoma për njerëzit diçka mes të çmendurit dhe kufomës.

E errët është nata, të mugëta janë rrugët e Zarathustrës.

Eja, o shoku im i ftohtë e i akullt! Do të të marr prej këtej e do të të varros me duart e mia.

8

Pasi ia tha zemrës këto fjalë, Zarathustra e ngriti mbi supet kufomën e u nis për udhë. Nuk kish bërë as njëqind hapa, kur një njeri i doli përballë e i pëshpëriti në vesh diçka...dhe ja! Ai që i fliste ishte tamam palaçoja.

“Ik nga ky qytet, o Zarathustra, - i thoshte. - Këtu ka shumë që të urrejnë! Të urrejnë të mirët e të drejtët, e të quajnë armik dhe përbuzës; të urrejnë besimtarët e fesë së drejtë, e të quajnë rrezik publik. Fati yt ishte që të tjerët të qeshnin me ty se, për të thënë të vërtetën, ti po u flisje si një palaço. Fati yt ishte që ta shoqëroje këtë qelbësirë; vetëm se u poshtërove në këtë mënyrë, sot shpëtove paq. Por tash dil nga ky qytet, përndryshe, nesër do vërsulem mbi ty, si i gjalli një të vdekuri.”

Pasi tha këto fjalë, njeriu u zhduk. Mirëpo, Zarathustra vazhdoi të ecte nëpër shtigje të errëta.

Te porta e qytetit u ndesh me varrmihësit; ata ia vunë pishtarët përpara fytyrës, njohën Zarathustrën e nisën ta qesëndisin: “Zarathustra po mbart qenin e ngordhur. Epo, Zarathustra qenka bërë varrmihës! Duart tona janë shumë të pastra për këtë plehrë. Apo, mos ndoshta edhe Zarathustra do t’ia zhvatë kafshatën djallit? Kështu qoftë! Oreks të mbarë! Mjaft që djalli të mos jetë hajdut më i mirë se ti se, ndryshe, do t’ju mbërthejë të dyve e do t’ju kollofisë!

E ata qeshnin e komplotonin të gjithë së bashku.

Zarathustra nuk tha asnjë fjalë e vazhdoi rrugën. Pasi kish ecur për nja dy orë nëpër pyje e moçale, pasi kish dëgjuar gjatë ulërimën e ujqërve, i erdhi uri edhe atij.

Ndali atëherë në një kasolle vetmitare, ku shndriste një dritë.

“Uria po më shqyen, - tha Zarathustra, si një kaçak. - Po më shqyen nëpër pyje e nëpër kënetë, përgjatë natës së thellë. Trille të çuditshme ka uria ime. Shpesh më zë pas buke, ndërsa sot nuk më ka zënë përgjatë gjithë ditës. Po ku ka qenë?”

Duke menduar kështu, Zarathustra trokiti në portën e shtëpisë.

U duk një plak me një kandil në dorë, që pyeti: “Kush vjen të më kërkojë në mes të gjumit tim të keq?”

“Një i gjallë e një i vdekur, - tha Zarathustra. - Më jep për të ngrënë e për të pirë, se sot harrova ta bëj gjatë ditës. Ai që i jep

për të ngrënë një të urituri, i fal lehtësim shpirtit të tij: kështu thotë mençuria.”

Plaku doli, por u kthye shpejt, duke i ofruar Zarathustrës bukë dhe verë. “Është një vend i keq për të uriturit. Ha andaj, unë banoj këtu. Njerëz dhe kafshë vijnë tek unë vetmitari. Po thuaji edhe mikut tënd të hajë e të pijë, se është më i lodhur se ti.” Zarathustra u përgjigj: “Shoku im është i vdekur, do të jetë e vështirë ta bind”. “Kjo s’më intereson, - tha plaku me humor të shprishur. - Kush troket në portën time duhet ta marrë atë që i ofroj. Hani dhe qofshi mirë!”

Zarathustra vazhdoi të ecë edhe për dy orë të tjera, duke i zënë besë rrugës dhe dritës së yjeve. Ish mësuar të ecte natën dhe dëshironte t’i shihte në fytyrë të gjithë ata që flinin. Kur filloi të përhihej, e gjeti veten në një pyll të thellë, pa kurrfarë gjurme shtegu. Atëherë e vuri të vdekurin në zgavrën e një trungu pas kokës së tij, sepse donte ta mbronte nga ujqërit e uritur, e u shtri përtokë mbi myshk. E zuri shpejt e shpejt gjumi, ashtu i lodhur për vdekje, por me shpirtin ende të fortë.

9

Zarathustra fjeti gjatë e, jo vetëm aurora u harkua mbi të, por edhe gjithë mëngjesi. Së fundi hapi sytë; i habitur, Zarathustra kundroi pyllin dhe heshtjen, por, i habitur kundroi edhe veten. Pastaj u ngrit me të brofur, si një lundërtar që zbulon papritur tokën dhe ngazëllehët, sepse pa një vërtetësi të re. E kështu i foli pas kësaj zemrës së vet:

“Një dritë është ndezur brenda meje: kam nevojë për shokë, por të gjallë, jo për shokë të vdekur e kufoma, që t’i mbaj me vete e t’i çoj kudo ku të dua.

Dua shokë që rrojnë, që më ndjekin, sepse duan të ndjekin veten e tyre e tamam aty ku dëshiroj unë.

Një dritë është ndezur brenda meje: jo turmës duhet t’i flasë

Zarathustra, por shokëve. Zarathustra nuk duhet të bëhet qen dhe bari i një tufe!

Unë kam ardhur për të zhvatur shumë nga tufa. Turma dhe tufa duhet të më urrejnë; për barinjtë Zarathustra duhet të jetë si një kaçak.

I quaj barinj, por ata quhen të mirët e të drejtët.

I quaj barinj, por ata quhen besimtarë të fesë së drejtë. Shihini atje tej, të mirët e të drejtët! Kë urrejnë ata më shumë? Atë që thyen rregullat e vlerave të tyre, shkatërruesin, vrasësin; mirëpo ky është tamam krijuesi. Shihini atje tej besimtarët e të gjitha feve! Kë urrejnë ata më shumë? Atë që thyen rregullat e vlerave të tyre, shkatërruesin, vrasësin; mirëpo ky është tamam krijuesi.

Shokë kërkon krijuesi, shokë të të korrave, sepse gjithçka në të është pjekur gati për t'u korrur. Por atij i mungojnë njëqind drapër; e kështu nis t'i zhvoshkshi vetë kallinjtë, edhe pse është i shqetësuar.

Shokë kërkon krijuesi, ata që dinë t'i mprehin mirë draprit e tyre. Do të donte t'i quante asgjësuesit dhe përbuzësit e së mirës dhe së keqes.

Mirëpo ata janë kortarët dhe festuesit. Bashkëpunëtorë kërkon Zarathustra, që të korrin e festojnë më të: ç'ka vallë ai për të ndarë me tufat, barinjtë e kufomat?

Dhe ti, o shoku im i parë, qofsh mirë! Për së mbari të varrosa në pemën tënde zgavër, për së mbari të vura të mbrojtur nga ujqërit. Tash po ndahem nga ti, sepse kaloj shumë kohë. Nga njëri agim te tjetri mbërriti tek unë një e vërtetë e re.

S'duhet të jem më bari, as varrosësh kufomash. S'dua të flas më me turmën; për herë të fundit fola me një të vdekur.

Dua të tërheq pas vetes krijuesit, kortarët, banquetuesit festimtarë; dua t'u tregoj atyre ylberin dhe të gjitha shkallët për te Mbinjeriu.

Vetmitarëve do t'u këndoij këngën time, ashtu si dhe çifteve; kush ka ende veshë për të padëgjuarën, atyre dua t'ua bëj zemrën t'u rëndojë nga gëzimi im.

Dua të shkoj përgjatë udhës sime, drejt qëllimit tim, duke kërcyer mbi kokën e atyre që ngurrojnë e tërhiqen mënjanë me dëshirë. Hapi im qoftë rrënimi i tyre!”

10

Kështu i tha Zarathustra zemrës së vet, kur dielli po ngrihej lart në mesditë; kundroi atëherë me vështrim tejqyrës qiellin, sepse iu bë sikur dëgjoji brenda vetes britmën therëse të një zogu.

Dhe ja! Një shqiponjë rrotullohëj, duke formuar qerthuj të mëdhenj në ajër. Në të rrinte varur një gjarpër, jo si viktimë, por si mik, sepse rrinte pështjellë pas qafës së saj!

“Janë kafshët e mia, - ulëriti Zarathustra, duke e ngazëllyer zemrën. - Kafsha më krenare dhe ajo më dinake nën këtë diell, ja tek ato po shkoj në kërkim të së vërtetës. Duan të dinë, nëse Zarathustra rron akoma. Po unë vallë, a jam realisht gjallë? Ishte më e rrezikshme për mua të jetoja mes njerëzve sesa në mes kafshëve. Shtigje të rrezikshme përshkon Zarathustra. Le të më udhëheqin kafshët e mia!”

Kur Zarathustra tha kështu, mendoj për fjalët e shenjtit në pyll, psherëtiu e i foli kështu zemrës: “Sikur të isha më i mençur! Sikur të isha krejt i mençur, si gjarpri im!

Por unë dua të pamundurën; andaj i lutem krenisë të shkojë gjithnjë mbarë me mençurinë time! Nëse një ditë mençuria do më braktisë - medet, ajo do gjithnjë të fluturojë - atëherë qoftë krenaria ajo që të fluturojë së bashku me marrëzinë time!”.

Kështu filloi zbritja e Zarathustrës.

LIGJËRIMET E ZARATHUSTRËS

Për tri metamorfozat

“Unë po ju shpall tri metamorfozat e shpirtit: se si shpirti bëhet deve, nga deve luan e nga luan fëmijë.

Shumë gjëra janë të vështira për shpirtin e fortë, të duruar e të respektueshëm prej natyre; fuqia e tij lakmon vështirësinë dhe gjëra tej masës të rënda.

Por ç'gjë vallë është e rëndë? - pyet shpirti i duruar, teksa gjunjëzohet po njëlloj si një deve, duke dashur të ngarkohet paq.

Ç'është vallë gjëja më e rëndë, o ju heronj? - pyet shpirti i duruar - që ta marr mbi vete e të gazmohem me fuqinë time?

Nuk është ky një nënshtrim për të lënduar krenarinë? Të lësh të shkëlqejë budallallëku yt, për të përqeshur mençurinë tënde?

Apo është ky: të braktisësh kauzën, kur ajo është gati në të triumfuar? Në male të larta të ngjitesh e tunduesin të tundosh?

Apo është ky: të ushqehesh me lendet dhe barin e shkencës e për dashurinë e së vërtetës të lëngosh me urinë e shpirtit?

Apo është ky: ta lësh veten të shuhet e t'i largosh të gjithë ngushëlluesit, për të zënë miqësi me shurdhët, që kurrë ndonjëherë s'mund ta dëgjonin atë që ti do?

Apo është ende ky: të zhytesh në ujin e qelbur, kur ai është uji i së vërtetës, e të mos i largosh prej vetes as bretkosat e ftohta, dhe as thithëlopat lakmitare?

Apo është ky: të dashurosh ata që të përçmojnë e t'ia shtrish dorën fantazmës, kur do të kallësh frikë?

Ja, të gjitha këto gjëra të rënda do të durojë shpirti i duruar. Pastaj, si ajo deveja e mirë ngarkuar, që shkon me një hap gjigant e të shpejtë nëpër shkretëtirë, edhe ai do të ecë drejt shkretëtirës së tij.

Mirëpo, në vetmitaren shkretëtirë ndodh metamorfoza e dytë: shpirti bëhet luan, do të zërë pre lirinë e tij e të jetë padron i shkretëtirës.

Niset kështu në kërkim të padronit të tij të fundit: do ta bëjë armikun si zotin e vet të fundit e t'ia arrijë fitores duke luftuar me dragoin e madh.

Po ç'është vallë dragoi i madh, që shpirti nuk do ta quajë më zotin dhe padronin e tij?

"Ti duhet!" quhet dragoi, ndërkohë që shpirti i luanit thotë: "Unë dua!".

"Ti duhet!" ia pengon rrugën. Duke përshkënditur floririn është bisha e mbuluar me luspa brinore, ku në secilën prej tyre rishndrit e praruar "Ti duhet!".

Vlera mijëvjeçare ndriçojnë mbi ato luspa; kështu flet më i fuqishmi i të gjithë dragonjve: "Çdo vlerë e gjërave rishndrit mbi trupin tim".

"Çdo vlerë tashmë është e krijuar e çdo vlerë e krijuar jam unë vetë. Në të vërtetë, nuk duhet të ketë më asnjë "unë dua të ekzistoj!" Kështu foli dragoi.

Vëllezër, po përse kemi nevojë për luanin në shpirt? Nuk mjafton vallë kafsha e duruar, që e mohon veten dhe bindet?

Të krijojë vlera të reja, këtë s'mund ta bëjë madje as luani; kurse të fitojë lirinë për vepra të reja, këtë po, ai mund ta bëjë.

Të fitosh lirinë do të thotë t'i thuash një "jo" të shenjtë detyrimit. Ja, o vëllezër, për ç'ka është i nevojshëm luani!

Aftësia për të pohuar vlera të reja: kjo është ajo që u ngjan me një paudhësi të tmerrshme shpirtrave të duruar e të nënshtruar. Në fakt, ajo u duket si një hajdutëri e si një veprim kafshësh grabitqare.

Një kohë ai e dashuronte "ti duhet" si më të shenjtën e të gjitha gjërave; tani i nevojitet ta gjejë arbitraritetin e marrëzinë edhe në gjënë më të shenjtë, për t'ia nënshtruar dashurisë së vet e për të fituar lirinë. Është luani ai që duhet për ta bërë realitet këtë hajdutëri.

Pa thomëni, o vëllezër, ç'mund të bëjë vallë vogëlushi, që luani s'e bëri dot? Përse, pra, grabitqari luan pre-zënës duhet të kthehet në një vogëlush?

Vogëlushi është harrim e pafajësi, rikthimi në origjinë, te loja, te rrota që rrotullohet vetë, lëvizje zanafillore, pohim i shenjtë.

Po, për hir të lojës së krijimit, o vëllezër, u themi gjërave një po të shenjtë. Mirëpo, ja, shpirti kërkon vullnetin e tij; ai që e ka humbur universin do ta fitojë përsëri universin e vet.

Për tri metamorfozat e shpirtit ju fola: se si shpirti u bë deve, se si deveja u bë luan e luani, më së fundi, fëmijë”.

Kështu foli Zarathustra. Atëherë ai rronte në qytetin që quhej “Lopa laroshe”.

Katedrat e virtytit

I lëvdonin Zarathustrës një të urtë, që dinte të fliste mirë për gjumin dhe virtytin e që për këtë gjë ishte shumë i nderuar e i shpërblyer; të gjithë të rinjtë bëheshin gardh përreth katedrës së tij. Zarathustra shkoi tek ai dhe bashkë me të rinjtë e tjerë u ul përballë katedrës. E kështu foli i urti:

“Nderim dhe droje për gjumin! Kjo është gjëja e parë! Përvindhuni të gjithë atyre që flenë keq e rrinë zgjuar natën!

Përpara gjumit është ngurrues edhe vetë hajduti. Ai punon gjithmonë gjatë natës dhe në heshtje. Në të kundërt, patrulla e natës është e pacipë, i bie pa pikë droje borisë së vet.

Të flesh nuk është zanat i lehtë; ndërkaq nevojitet të rrish zgjuar edhe një ditë të tërë pa ndërprerje.

Dhjetë herë në ditë duhet të fitosh mbi vetveten. Kjo prodhon në fund një rraskapitje të paqtë dhe është një lulëkuqe e hijshme për shpirtin. Dhjetë herë në ditë duhet të bësh edhe paqe me veten tënde, përderisa fitorja mbi veten është hidhërim; ai që nuk paqohet me veten e tij, fle keq.

Dhjetë të vërteta në ditë duhet të zbulosh, përndryshe, edhe gjatë natës do shkosh të kërkosh të vërtetën, e shpirti yt do të jetë i trazuar.

Dhjetë herë në ditë duhet të qeshësh e të gëzohesh, përndryshe, gjatë do të të dhembë stomaku, që është ati i çdo mundimi.

Pak e dinë këtë gjë, por duhet të zotërosh të gjitha virtytet. Do bëj vallë dëshmi të rreme? Do shkel kurorën? Do dëshiroj gruan e fqinjit? Të gjitha këto nuk pajtohen me gjumin e mirë. Por, edhe kur i zotërojmë të gjitha virtytet, duhet të dimë të bëjmë edhe diçka tjetër: t'i vëmë të flenë në kohën e duhur këto virtyte.

Përse vallë nuk grinden në mes tyre edhe vetë këto zonjëza! Madje, edhe për ty, o i mjerë!

Paqe me Zotin dhe me fqinjin! Këto duhen për një gjumë të qetë. Paqe edhe me djallin e fqinjit, përndryshe do të vijë e do të të sikletosë netëve!

Nderim dhe respekt për autoritetet, edhe për autoritetet e korruptuara! Këto dëshiron gjumi i qetë. Ç'faj kam unë që autoriteti ecën shpesh dhe me dëshirë këmbëçalë?

Bariu më i mirë, për mua, do të jetë gjithmonë ai që do t'i udhëheqë delet e tij në livadhin më të blertë: kjo pajtohet me gjumin e qetë.

Nuk dua shumë ndere, as shumë thesare: ta mahisin shpretkën. Por flihet keq, pa një emër të mirë e një thesar të vockël.

Një shoqëri e vogël më është më e këndshme sesa një shoqëri e keqe; veçse ajo duhet të dijë të shkojë e të vijë në momentin e volitshëm. Vetëm kjo pajtohet me gjumin e qetë!

Shumë kënaqësi më japin të varfrit në shpirt: ata më puqin me gjumin. Janë njerëz të lumtur, veçanërisht kur u jep gjithmonë të drejtë.

Kështu e kalon ditën njeriu i virtytshëm. Pastaj, kur zbret nata, kujdesem që të mos e lus gjumin, sepse gjumi, që është padroni i virtyteve, nuk dëshiron që t'i lutesh.

Ndaj, kthehem me mendim tek ato që kam thënë e kam bërë gjatë ditës.

Duke bluar, pyes veten, i duruar si një lopë qumështore, se cilat ishin sot dhjetë fitoret që pata mbi vetveten.

Cilat qenë dhjetë ripaqësimet, dhjetë të qeshurat, me të cilat e lumturova zemrën?

Kështu, duke menduar e i përkundur në dyzet mendime, befas më mbërthen gjumi i palatur, ai, padroni i virtyteve.

Gjumi rreh qepallat e mia, e ato bëhen të rënda. Gjumi më palpon gojën, e ajo mbetet e hapur.

Mbërrin vërtet tek unë me hap të lehtë, si një hajdut i shumëdashur, e i vjedh tinëz mendimet e mia, aq sa unë mbetem aty, në këmbë, budalla si kjo katedër.

Por s'qëndroj gjatë kështu: ja tek shtrihem."

Kur Zarathustra dëgjoji të urtin të thoshte këto gjëra, qeshi në zemrën e vet, sepse një dritë i ish ndezur përbrenda. E kështu i foli zemrës: "Si një i çmendur më ngjan ky i urtë me këto mendimet e tij. Por, gjithsesi, besoj se e kupton mirë gjumin. I bekuar qoftë ai që rron afër këtij të urti!

Një gjumë i tillë është ngjitës e kalon duke përshkuar edhe një mur të trashë.

Një magji e ka folenë e vet në katedrën e tij. Ja se përse më të rinjtë ulen gjithmonë përreth predikuesit të virtyteve.

Mençuri e tij quhet: rrini zgjuar, për të fjetur mirë më pas.

Në të vërtetë, nëse jeta nuk do të kishte asnjë kuptim tjetër, edhe mua më duhej të zgjidhja një gjë pakuptim; ky do të më dukej pakuptimi më i denjë që mund të zgjidhet.

Tani e mësova atë që, një herë e një kohë kërkohej me ngulm, sa herë që duhej të gjendej një mjeshtër virtytesh. Një gjykim i shëndoshë e virtyte hashishi.

Për të gjithë këta të aq shumë shpallur të urtë, mençuria nuk do të thotë asgjë tjetër, veçse një gjumë pa ëndrra. Për ta jeta nuk kishte kuptim më të mirë se ky.

Edhe sot ka disa të tillë, por jo gjithmonë kaq të ndershëm sa ai. Por ora e tyre tashmë ka mbaruar e s'do të qëndrojnë më gjatë në këmbë, pasi shpejt do të shtrihen përdhe.

Të lumtur qofshin ata që kanë gjumë, sepse do t'u varet koka e do të dremisin me të shpejtë!”.

Kështu foli Zarathustra.

Për transhendentalistët

“Njëherë, edhe Zarathustra desh ta hidhte iluzionin e vet përtej njerëzimit, si të gjithë transcendentalistët. Bota m'u paraqit atëherë si vepra e një zoti të vuajtur e të torturuar.

Bota m'u duk ëndrra dhe poezia e një zoti; mjegull e ngjyruar në sytë e një qenie të shenjtë e të pakënaqur.

E mira dhe e keqja, gëzimi dhe dhimbja, unë dhe ti, si një mjegull lara-lara më ngjanin përpara shikimit të krijuesit. Ai kish dashur t'i hiqte sytë nga vetvetja, e kështu kish krijuar botën.

Për atë që vuan, t'i heqë sytë nga dhimbja e të harrojë vetveten është një gëzim dehës. Harresë e gëzim dehës më ngjau bota një ditë.

Kjo botë, përjetësisht e papërsosur, imazhi i kondadiksionit të përjetshëm, kopje e, për më tepër e papërsosur, gëzim dehës për krijuesin e saj të papërsosur. Ja, kështu më ngjau bota një ditë!

Kështu që edhe unë e lëshova një ditë marrëzinë time përtej njerëzimit, si të gjithë transcendentalistët. Po vallë, pikërisht përtej botës së njerëzimit?

Medet, o vëllezër, ai zot që unë krijova ishte vepra e një njeriu dhe një marrëzi, si të gjithë zotat!

Ishte një qenie njerëzore. Një fragment i mjerueshëm i njerëzimit dhe unit; kish lindur nga hiri dhe pasioni im, vërtet një fantazmë! Jo, ai nuk vinte nga bota e përtejme!

Po ç'ngjau vallë, o vëllezër? Unë i mjeri e tejkalova vetveten, e çova hirin tim në mal, e shpika për veten time zjarrin më shkëlqimtar. Dhe ja, fantazma m'u zhduk nga sytë.

Tani që ia mbërrita të shërohem, më sjell dhimbje dhe tmerr të besoj në fantazma të këtij lloji: dhimbje dhe ligështim. Kështu, unë u flas ëndërrimtarëve të botës së përtejme.

Ishin dhimbja e pafuqia ato që krijuan çdo botë të përtejme, si dhe atë të vocklën marrëzi të lumturisë, që e njeh veç ai që vuan më shumë. Lodhja, që me një brofje do të donte të arrinte qëllimin e mbarmë, po, me një brofje mortore, ajo mjerania, injorantja lodhje, që nuk mundet më as të dëshirojë. Ajo i krijoji të gjithë zotat dhe botët e përtejme.

Besomëni, o vëllezër! Ish trupi që, i dëshpëruar e i pashpresë nga vetja, nisi të kërkojë me gishtërinjtë e shpirtit të dalldisur muret më të skajshme.

Besomëni, o vëllezër! Ish trupi që, i dëshpëruar e i pashpresë nga toka, nisi të dëgjojë se ç'thoshte barku i qenies.

E atëherë deshi të depërtojë me kokë muret më të skajshme, e jo vetëm me kokë, për të arritur në "botën tjetër".

Mirëpo, "bota tjetër" është e fshehur mjaft mirë për qeniet e tokës; ajo botë çnjerëzore dhe jo njerëzore, që s'është gjë tjetër, veçse një asgjë qiellore; se barku i qenies nuk i flet njeriut, në mos si një njeri.

Në të vërtetë, është goxha e guximshme që çdo qenie njerëzore të arrijë të demonstrohet, është e vështirë që ajo të yshtet të flasë. Thomëni, vëllezër, a s'është ndoshta më e lehtë të demonstrohet më e çuditshmja e të gjitha gjërave?

Po, ky un, me kontradiktat dhe konfuzionet e tij, është ende më i përshtatshmi për ta pohuar qenien e vet. Ky un që krijon, që dëshiron, që gjykon e që është masa e gjërave.

E kjo Qenie për së mbari, ky Un, nuk flet veçse për trupin e do veçse trupin, edhe atëherë kur ai mediton, fantazon dhe fluturon krahë-thyer.

Gjithnjë e më ndershmërisht mëson të shprehet ky Un; e sa më shumë mëson, aq më shumë fjalë e ndere gjen për trupin e për tokën.

Uni im më mësoi një krenari të re, e unë po ia mësoj njerëzimit: mos e fusni më kokën në rërën e gjërave hyjnore, por mbajeni lart e të lirë këtë kokën tuaj tokësore, që krijon kuptimin e tokës!

Një vullnet të ri unë po i mësoj njerëzimit: ndiqeni me ndërgegje këtë rrugë që njerëzimi e ka ndjekur verbërisht, kijeni të shtrenjtë dhe mos kërkoni të zvarriteni mënjanë, si të sëmurët e të dergjurit për vdekje!

Të sëmurët e të dergjurit për vdekje ishin ata që patën përçmuar trupin dhe tokën e zbuluan parajsën dhe pikat shëlbyese të gjakut; por edhe helme të ëmbla e të zymta ata nxorën nga trupi dhe nga toka.

Donin t'i arratiseshin mizeries së tyre dhe yjeve, për ta qenë shumë larg. Atëherë psherëtinë: "Oh, sikur të ekzistonin rrugë qiellore, për të depërtuar në një tjetër ekzistencë, në një tjetër lumturi! E shpikën kështu rrugë dinake e ato pijet e tyre të vockla të gjakut.

Besuan kështu të ishin çliruar nga trupat dhe nga toka, të ngratët! Po kujt vallë ia dedikonin tmerrin dhe argëtimin e këtyre ekstazave? Vetë trupave të tyre dhe tokës!

Zarathustra është dashamirës me të sëmurët. Në të vërtetë, nuk e zemërojnë mënyrat e tyre ngushëlluese, as mosmirënjohja. Le të shërohen, le ta tejkalojnë vetveten e të ndërtojnë një trup të fortë!

Zarathustra nuk do të zemërohet as me të shëruarin, kur sheh me ëmbëlsi iluzionin e tij e në mes të natës të sillet për qark varrit të zotit të vet. Por lotët e tij mbeten për mua sëmundje dhe trup i sëmurë.

Shumë njerëz të sëmurë ishin gjithmonë mes atyre që thurin poezi e kërkojnë Zotin; ata urrejnë egërsisht ata që digjen me

gjithë shpirt për dijen, si dhe për më të riun e virtyteve, që quhet sinqeritet.

Kthehen gjithnjë pas, kah kohëve të errëta. Në ato kohë, padyshim që feja dhe marrëzia qenë diçka tjetër; arsyeja e mjegulluar ishte një mënyrë për t'i ngjarë Zotit, kurse dyshimi mëkat.

I njoh mirë ata që besohen të njëllojtë me Zotin. Ata pretendojnë t'u besosh veç atyre, dhe se të dyshuarit në ta është mëkat. E di mjaft mirë se në ç'gjë ata besojnë më shumë.

Në të vërtetë, ata nuk besojnë as te bota e përtejme, e as te pikat e gjakut shëlbues, por, mbi të gjitha te trupi. Trupi për ta është gjëja më e vërtetë në vetvete.

Halli është se ai është i sëmurë e ata do të dëshironin të dilnin jashtë lëkurës së tyre. Ndaj, i dëgjojnë me kënaqësi predikuesit e vdekjes, duke predikuar edhe vetë botën e përtejme.

Dëgjoni më mirë, o vëllezër, atë çka thotë trupi i shëndetshëm: një fjalë më të sinqertë e më të pastër!

Trupi i fortë e i shëndetshëm, i përsosur e i drejtë, flet me më shumë sinqeritet: flet prej vetë kuptimit të tokës”.

Kështu foli Zarathustra.

Për përçmuesit e trupit

“Tani dua t'u them fjalën time edhe atyre që e përçmojnë trupin.”

Për mua s'ka dobi, nëse ata ndryshojnë fjalët apo mësimet, por, nëse më në fund lodhen nga trupat e tyre e bëhen memecë.

“Jam trup e shpirt,” - thotë fëmija. E përse vallë nuk do të duhet të flasim si fëmijët?

Ndërkohë që ai më i zgjuari, më i provuari, thotë: unë jam i gjithi trup, e asgjë tjetër, e shpirti nuk është veçse një fjalë për të shprehur diçka thelbësisht trupore.

Trupi është një arsye e madhe, një shumësi me një kuptim të vetëm: luftë dhe paqe, bari dhe grigjë.

Instrument i trupit është edhe ajo arsyeja jote e vockël, o vëlla, që ti e quan "shpirt", instrument i vockël e lojë e arsyes tënde të madhe.

Thua "unë" e je krenar me në fjalë të tillë. Por gjëja më madhështore - edhe pse ti nuk do ta besosh - është trupi yt dhe arsyeja e tij e madhe; ajo nuk thotë Unë, por është Unë.

Ajo ç'ka perceptojnë shqisat, ç'ka kupton shpirti, nuk ka kurrë fund në vetvete. Mirëpo, shqisat dhe shpirti do të donin të bindeshin të jenë fundi i çdo gjëje: kaq budallenj janë.

Instrumente dhe lodra janë shqisat dhe shpirti: pas tyre fshihet qenia e vërtetë. Qenia kërkon edhe me sytë e shqisave, dëgjon edhe me veshët e shpirtit.

Është gjithmonë Qenia që dëgjon e kërkon: ngushëllon, detyron, fiton e shkatërron, komandon e është dhe zotëria e Unit.

Pas mendimeve e sentimenteve të tua, o vëlla, qëndron një sundues i fortë, një i urtë i panjohur: është Qenia.

Banon në trupin tënd, është vetë trupi yt.

Ka më shumë arsye në trupin tënd sesa në mençurinë tënde më të mirë.

E përse vallë trupi yt do të kishte nevojë për mençurinë më të mirë?

Qenia jote qesh me Unin dhe me brofje të tij. "Ç'janë vallë për mua këto brofje e fluturime të mendimit," - thotë me vete.

"Një rreth vicioz, për të mbërritur qëllimin tim. Unë jam prita e unit dhe sugjeruesi i mendimeve të tij."

Qenia i thotë Unit: "Ja, a po provon dhimbje?". E ai vuan e mendon si t'ia dalë e të çlirohet nga dhimbja; veç për këtë i duhet të mendojë.

Qenia i thotë Unit: "Ja, a po ndjen kënaqësi? E ai kënaqet e mendon se si ta shijojë atë kënaqësi; veç për këtë i duhet të mendojë.

Atyre që e përçmojnë trupin, unë dua t'u them një fjalë. Është përçmimi ai që përbën vlerësimin e tyre. Kush e krijoi vallë vlerësimin dhe përçmimin, vlerën dhe dëshirimin?

Qenia krijuese krijoi vlerësimin dhe përçmimin, lumturinë dhe dhimbjen. Trupi krijues krijoi shpirtin, si një dorë të stërzgjatur të dëshirës së tij.

Edhe në marrëzinë e përçmimin tuaj, o përçmues të trupit, ju i shërbeni Qenies. Unë po ju them se është vetë Qenia ajo që dëshiron të vdesë e i kthen krahët jetës.

Nuk mund të bëjë më atë që i është më e shtrenjtë: të krijojë përtej vetvetes. Kjo është ajo që do të donte të bënte me aq shumë pasion, kjo është e gjithë zjarrmia e saj frymëzuese. Por tashmë është tepër vonë; ndaj Qenia juaj kërkon të vdesë, o përçmues të trupit!

Të perëndoje do Qenia juaj. Ja përse ju jeni shndërruar në përçmues të trupit! Sepse, nuk arrini më ta tejkaloni vetveten.

Prandaj jeni të zemëruar me jetën e me tokën.

Një zili budallaqe përndrit në shikimin e mugëlluar të përçmimit tuaj.

Por unë nuk do të ndjek rrugën tuaj, o përçmues të trupit! Për mua ju jeni ura për te Mbinjeriu.”

Kështu foli Zarathustra.

Për kënaqësitë dhe pasionet

O vëlla, nëse zotëron një virtyt dhe ai është i yti, atë nuk e ke të përbashkët me askënd!

Por ti do t'i japësh një emër e ta përkëdhelësh; ti do t'ia tërheqësh veshët e të argëtohesh me të. Mirëpo ja! Duke bërë kështu, përfundon të kesh një emër të përbashkët me vetminë e të bëhesh vetë turmë e vulg me virtytin tënd.

Më mirë do të bëje të thoshe: “E pashprehshme dhe paemër është ajo që bën tmerrin dhe ëmbëlsia e shpirtit tim, e që është uria e rropullive të trupit tim”.

Qoftë virtyti yt fort i lartë për t'u domethënë me një emër; kur flet për të, mos u turpëro të belbëzosh!

Pra, fol e belbëzo: “Kjo është e mira ime, kjo është ajo që dua, ajo që mua më pëlqen tërësisht; vetëm kështu e dua të mirën time.

Nuk e dua si një ligj të Zotit; jo si një rregull e si një shpëtim të njeriut, as si një shenjë dalluese të rrugës për në botën e përtejme e për në parajsë.

Një virtyt tokësor është ai që dua: pak maturi ka në të, e akoma më pak gjykim.

Mirëpo, ky zog këtu tek unë e ka bërë folenë e tij. Për këtë e dua dhe e kam për zemër; ai banon këtu tek unë e ngroh aty vezët e tij “të arta”.

Kështu, duke belbëzuar, t’i duhet të lëvdosh virtytin tënd.

Një kohë ti kishe pasione e i quaje të këqija. Po tash, nuk ke veçse virtyte: ato kanë dalë prej vetë këtyre pasioneve.

Ti ke vendosur qëllimin tënd më të epërm te këto pasione; kështu që ato janë bërë virtytet edhe lumturia jote.

Edhe sikur t’i përkisje racës së të tërbuarve ose epsharakëve, ose maniakëve fetarë apo të hakmarrësve, në fund të gjithë pasionet e tua do të bëheshin virtyte, kurse djajtë e tu do të shndërroheshin në qengja.

Një kohë kishe në bodrumin tënd qen të egër, por më në fund ata u transformuan në zogj e në këngëtarë të hijshëm.

Prej helmeve të tua e nxore melhemin; mole lopën e dhimbjes tënde e tani pi qumështin e ëmbël të gjinjve të saj.

Asgjë e keqe s’do të lindë më prej teje, përveç së keqes që lind nga lufta e virtyteve të tua.

Vëlla, nëse do të kesh fat, do të kesh vetëm një virtyt e asgjë më shumë. Kështu mund të kalosh më lehtë përtej urës.

Është nder të kesh shumë virtyte, por ky është një fat i vështirë. Shumë shkuan në shkretëtirë dhe u vranë, sepse ishin lodhur së qeni betejë dhe fushë betejash e virtyteve.

Vëlla, a janë vallë lufta dhe beteja një e keqe? Mirëpo, e domosdoshme është kjo e keqe, i domosdoshëm është mllëfi, mosbesimi dhe shpifja mes virtyteve.

A e sheh se çdo virtyti yt dëshiron atë që është më e epërme? Ai do gjithë shpirtin tënd, do të jetë stema e tij, do gjithë fuqinë tënde në hidhnim, në urrejtje e në dashuri.

Çdo virtyt është ziliqar me një tjetër, por një gjë goxha e shëmtuar është zilia. Madje, virtytet prej zilisë mund të shkojnë edhe në rrënim.

Kush është i mbështjellë nga flaka e zilisë, në fund e kthen si akrepi nga vetja thumbin e tij helmues.

Medet, o vëlla, a s'ke parë ndonjëherë një virtyt që të shpifë e të përpohet nga vetvetja?

Njeriu është diçka që duhet të tejkalohet, prandaj duhet t'i dashurosh virtytet e tua, sepse ato do të të shpien në rrënim".

Kështu foli Zarathustra.

Për kriminelin fytyrëzbehtë

Ju magjistarë e flijues, ju nuk doni ta vrisni kafshën përpara se ajo të pohojë me kokë? Po ja, krimineli fytyrëzbehtë pohoi me kokë: nga ai vështrim flet një përçmim i madh.

"Uni im është diçka që duhet tejkaluar. Uni im është për mua përçmimi më i madh i njeriut." Këtë thotë vështrimi i tij.

Çasti kur gjykoi vetveten ishte çasti i tij më sublim; mos bëni që sublimja të rizbresë përsëri në ultësinë e natyrës se tij!

Nuk ka çlirim për atë që vuan nga vetvetja, përveçse një vdekje e shpejtë.

Vendimi juaj i vrasjes, o gjykatës, qoftë për mëshirë, e jo për hakmarrje! Ndërsa vrisni, kërkoni të justifikoni jetën, por edhe vetveten!

Nuk mjafton të pajtoheni me atë që vrisni. Trishtimi juaj qoftë dashuria për Mbinjeriun. Vetëm kështu mund ta justifikoni mbijetesën tuaj.

“Armik”, duhet të thoni, por jo “keqbërës”! “I sëmurë”, duhet të thoni, por jo “maskara”! “I çmendur”, duhet të thoni, por jo “mëkatar”!

E ti, o gjyqtar faqekuq, nëse do të kishe kurajën të thoshe atë që mendon, çdokush do të ulërinte: “Largohuni nga kjo fëlliqësirë e nga kjo nepërkë!”.

Tjetër gjë është mendimi e tjetër veprimi; e tjetër akoma imazhi i veprimit. Rrota e shkakësisë nuk kalon mes tyre.

Një imazh e bën të zverdhë këtë njeri fytyrëzbehtë. Kur kreu veprimin, ishte i njëllojtë me të, por nuk arriti dot ta duronte imazhin, pasi e kreu atë. Nisi ta konsideronte veten si aktor të një veprimi. Për mua kjo është marrëzi: veçantia e një çasti u bë vetë thelbi i tij.

Litari e mban të lidhur pulën; goditja që ai dha e lidhi arsyen e tij të mjerë. Unë këtë e quaj marrëzi, pas veprimit.

Dëgjoni, o ju gjyqtarë, ka edhe një tjetër marrëzi! E kjo ndodh përpara veprimit. Medet, ju që nuk i fusni duart kurrë kaq thellë në këtë shpirt!

Kështu foli gjyqtari faqekuq: “Ç’gjë vallë e vrau në thelb këtë vrasës? Në të vërtetë, ai deshë vetëm të vidhte”. Unë po ju them se shpirti i tij donte gjak, jo grabitje, pasi kishte etje për kënaqësinë e thikës.

Arsyeja e tij e mjerë nuk arriti ta kuptojë këtë marrëzi dhe e bindi, duke i thënë: “E ç’do të bësh me gjakun? S’do vallë të bësh veç një grabitje, apo do të marrësh hak?”.

Ai ia vuri veshin arsyes së tij të mjerë, si plumb fjala peshoi mbi të. Atëherë arriti të grabiste, kur vrau. Nuk donte të turpërohej nga marrëzia e vet.

Përsëri si plumbi, pesha e fajit rëndoi mbi të e përsëri arsyeja e tij e mjerë u bë aq e akullt, aq e paralizuar, aq e rëndë.

Mjaft të tundte kokën, e do ta lëshonte peshën e saj. Po kush vallë e tund kokën?

Ç’është vallë ky njeri? Një shumësi lëngatash që, për faj të shpirtit shpërhapen nëpër botë e aty kërkojnë prenë e tyre.

Ç'është vallë ky njeri? Një droçkë gjarpërinjsh të egër, që rrallë rrinë në paqe mes tyre, e që secili shkon për llogari të vet të kërkojë viktimë në botë.

Shiheni këtë trup të mjerë! Ajo ç'ka vuajti, e kah së cilës u pri, është vetë ajo që ky shpirt imagjinoi si kënaqësi për të vrarë e etje për dëshirimin e kënaqësisë së thikës.

Ai që tash po sëmuret, ishte ai që u zhbë nga ligësia. Tani është vetë ligësia e që do të lëndojë me atë që e lëndon.

Ndërkohë që ka pasur edhe kohë të tjera, tjetër të keqe e të mirë.

Njëherë dyshimi dhe vullneti egoist quheshin e keqe. Në atë kohë i sëmuri bëhej shtrig dhe heretik: vuante si shtrig e si heretik e po ashtu donte të vuanin të gjithë.

Por kjo nuk hyn në veshët tuaj. Sipas jush, do t'u bënte keq. Po ç'më intereson mua vallë e mira juaj?!

Shumë nga kjo e mirë më neverit, ndërkohë që, në të vërtetë, nuk më neverit e keqja juaj. Do të më pëlqente që ajo të kishte një goditje marrëzie që ta shkatërronte, si këtë kriminel fytyrëzbehtë.

Do të më pëlqente vërtet që marrëzia e tyre të quhej e vërteta apo besnikëria, apo drejtësia. Mirëpo, ata zotërojnë virtytin e tyre, që i bën të jetojnë gjatë e, mjerisht të kënaqur me veten.

Unë jam ajo ura ndanë lumit, që më arrin ai që do të më arrijë. Por nuk jam paterica juaj."

Kështu foli Zarathustra.

Për të lexuarin dhe të shkruarin

"Nga gjithçka që është shkruar, unë dashuroj vetëm atë që është shkruar me gjak. Shkruaj me gjak e do të kuptosh se gjaku yt është shpirt. Nuk është e lehtë ta kuptosh gjakun e të tjerëve: unë i urrej ata që kanë vesin e leximit.

Kush e di se ç'është një lexues, nuk ndjen të bëjë asgjë për të. Mjafton edhe një shekull lexuesish, e vetë shpirti do të zhduket nga bota. Që çdokush tashmë mund të mësojë të lexojë, është një fakt që në perspektivën afatgjatë përthith jo vetëm të shkruarin, por edhe të menduarin.

Një kohë, shpirti ishte zot, pastaj u bë njeri, por tash nuk është asgjë, veçse një plebe. Kush shkruan me gjak dhe me aforizma, nuk do që të lexohet, por të ngulitet në kujtesë.

Nëpër male, shtegu më i shkurtër është nga maja në majë. Por, për ta përshkuar është e nevojshme të kesh këmbë të gjata.

Aforizmat duhet të jenë maja. E ata, të cilëve u drejtohen, duhet të jenë të mëdhenj e shtatlartë.

Ajri i lehtë e i kulluar, rreziku i afërm dhe shpirti i mbushur plot me ligësi të hareshme: këto janë ato gjëra që harmonizohen aq mirë bashkë.

Dua të kem përreth vetes burracakë, sepse unë jam guximtar. Guximtari që largon fantazmat krijon burracakë; është një kurajë që do të qeshë me të tjerët.

Sentimenti im nuk është më dakord me tuajin. Kjo re që shoh poshtë meje, kjo re e zezë e kjo rëndësi, me të cilën unë qesh, është tamam ajo reja juaj oguruese e stuhisë.

Ju shikoni lart, kur prireni kah lartësimin; unë shoh poshtë, në thellësi, sepse tashmë jam i lartuar.

Kush prej jush mund të qeshë e njëherësh të jetë i lartuar?

Kush ngjitet nëpër male të larta, qesh sipër të gjitha tragjedive e të gjitha trishtimeve të shtira.

Lipset të jemi të shkujdesur, rebelë, ironikë; kështu na do mençuria. Ajo është një vashë që dashuron gjithmonë vetëm luftëtarët.

Ju më thoni: "Jeta është e vështirë për t'u duruar". Po përse vallë do të kishit aq shumë krenari në agim dhe aq devotshmëri në mbrëmje?"

Jeta është e vështirë për t'u duruar, por mos u krekosni që të më zbusni! Të gjithë bashkë jemi ca gomarë të hijshëm, meshkuj e femra.

Ç'kemi të përbashkët me atë gonxhen trëndafil që nis të drithërojë, sepse një pikë vese i rëndon përmbi?

Është e vërtetë: e duam jetën, jo se jemi mësuar me të, por se jemi mësuar me të dashuruarin.

Ka gjithmonë pakëz marrëzi në dashuri. Por ka gjithmonë edhe pakëz arsye të marrëzia.

Edhe mua, që jam i mirë kundrejt jetës, më ngjan se fluturat dhe fluskat e sapunit, ashtu si dhe njerëzit e ngjashëm me ta, janë ata që e dinë më mirë se ç'është lumturia.

Këto shpirtëza të lehtë, lozonjarë e të luhatshëm, fërfëllojnë andej-këtej për kuriozitet. Kjo e shpuri Zarathustrën të mallëngjehej e të këndonte.

Sa për mua, unë do t'i besoja vetëm një zoti, që do të dinte të vallëzonte.

Kur pashë djallin tim, zbulova se ish serioz, shterues, i thellë, solemn: ishte shpirti i gravitetit, i rëndesës, në sajë të të cilit bien të gjitha gjërat. Nuk është me tërbim, por me të qeshur që vritet. Le ta vrasim pra kështu shpirtin e gravitetit, shpirtin e rëndesës!

Kam mësuar të eci: që atëherë e lëshoj veten. Kam mësuar të fluturoj: që atëherë nuk dua më të pësoj shtysa për të lëvizur.

Tani unë jam i lehtë, tani unë fluturoj, tani unë shoh përposh meje, tani një zot vallëzon tek unë”.

Kështu foli Zarathustra.

Për pemën në mal

Syri i Zarathustrës kish vënë re një djalë që kërkonte t'i përvidhej. Kur një mbrëmje po shëtiste vetmitar nëpër malet që rrethonin qytetin, të quajtura “lopa laroshe”, ja tek u ndesh duke ecur me atë djalë që rrinte i mbështetur pas një peme, duke kundruar me sy të lodhur në luginë. Zarathustra kapi pemën ku mbështetej i riu e foli kështu: “Nëse do të doja ta tundja këtë

pemë me duart e mia, s'do t'ia arrija. Mirëpo, era që ne s'e shohim e torturon dhe e përkul si të dojë. Janë duar të padukshme ato që më shumë na përkulin e na torturojnë”.

Atëherë i riu u çua i alarmuar e tha: “Po dëgjoj Zarathustrën, kur pikërisht për atë po mendoja”. Zarathustra ia ktheu: “Përse frikësohesh për këtë gjë? Me njeriun ndodh po ajo që ndodh me pemën. Sa më shumë rritet kah dritës, aq më me këmbëngulje rrënjosen rrënjët e saj në terren, thellë në errësirë, në të keqe. “Po, në të keqe, - ulëriti i riu. - Si mundet vallë që ti arrite të zbulosh shpirtin tim?!”

Zarathustra buzëqeshi e tha: “Ka shpirtra që nuk zbulohen kurrë me të vërtetë, qofshin edhe shpirtra të zbuluar nga vetë ne”.

“Po, në të keqe, - briti përsëri djaloshi. - The të vërtetën Zarathustra! Qëkur dua të ngjitem lart, unë s'kam më besim te vetja, askush s'beson më tek unë. Ç'po më ndodh kështu?!”

Unë shndërrohem shumë shpejt: e sotmja shkatërron të djeshmen time. Shpesh i kapërcej shkallët teksa ngjitem, e shkallët nuk ma falin këtë gjë.

Përderisa jam vetëm lart, ndihem gjithmonë vetëm. Askush nuk flet me mua, akulli i vetmisë më bën të dridhem. Po ç'gjë dua vërtet atje lart?

Sa më vjen turp nga ngjitja dhe këmbëngatërimi im! Sa qesh me gulçitjen time astmatike! Sa e urrej atë që merr arratinë! Sa i lodhur jam së qëndruari lart!”

E këtu djaloshi heshti. Zarathustra vështroi pemën, ku po rrinin të mbështetur që të dy, e foli kështu:

“Kjo pemë rri e vetme këtu në mal; është rritur lart mbi njeriun dhe kafshën. Nëse do të donte të fliste, nuk do të gjente askënd që ta kuptonte, aq shumë lart është rritur. Tani pret e pret. Po ç'pret vallë? Është shumë afër nga vendi ku rrinë retë. Mos pret gjë rrufenë e parë?”

Kur Zarathustra i tha këto fjalë, i riu ulëriti duke bërë gjeste të ndryshme: “Po, Zarathustra, t'i po thua të vërtetën! Kur desha

të ngjitesha e të ngjitesha, priresha kah shturjes, shpërbërjes sime, e ti je rrufeja që prisja. A e sheh vallë se ç'jam bërë, qëkur u shfaqe ti? Është zilia për ty ajo që më ka shkatërruar!”.

Kështu foli i riu, e nisi të qajë me hidhërim.

Mirëpo, Zarathustra ia vuri dorën përreth mesit dhe nisi të ecte bashkë me të. Kur patën bërë një copë udhë së bashku, ai filloi të fliste kështu: “Po më shtrydhet zemra. Më mirë se fjalët e tua, është syri yt ai që më thotë se ç'rrezik po të kanoset. Ti nuk je akoma i lirë; vetëm se po e kërkon lirinë. E ky kërkim të ka bërë të zbehtë, të lodhur e të pagjumë.

Nëpër qiejt e lirë do të ngjitet e për yjet ka etje shpirti yt. Por edhe instinktët e tua të këqija kanë etje për liri.

Qentë e tu të egër duan liri; lehin nga gëzimi në bodrum, kur shpirti yt tundohet t'ua hapë të gjitha dyert e burgjeve.

Për mua ti je ende një i burgosur që ka etje për liri. Medet, të burgosurve të llojit tënd shpirti u bëhet i mençur, por edhe hidhnisht dinak e i keq.

Edhe i çliruari nga shpirti duhet të pastrohet. Shumë arsye e myk i ka mbetur ngjitur pas vetes; syri i tij duhet të pastrohet ende edhe sot. Po, e njoh rrezikun tënd, por të betohem për dashurinë dhe shpresën time: mos e flak tej dashurinë dhe shpresën tëndel!

Ti edhe tani ndihesh fisnik. Fisnik të ndjejnë edhe të tjerët, që s'të duan e që të shohin me sy të keq. Dije se të gjithëve fisnikja u ngjall bezdi.

Edhe të mirëve u ngjall bezdi fisnikja. Edhe kur e quajnë të mirë, synojnë ta lënë mënjane.

Fisniku kërkon të krijojë të renë dhe një virtyt të ri, kurse i miri do vetëm të vjetrën dhe ruajtjen e gjithçkaje që është e vjetër.

Megjithatë, nuk është ky rreziku i fisnikut që ai të bëhet i mirë, por që të bëhet i lig një përçmues, një asgjësues.

Medet, kam njohur njerëz fisnikë që e humbën shpresën e tyre e përfunduan duke mohuar çdo shpresë tjetër!”.

Kështu foli Zarathustra.

Për predikuesit e vdekjes

“Ekzistojnë predikues të vdekjes: toka është plot me njerëz, të cilëve duhet t’u predikohet arratia nga jeta.

Toka është plot me njerëz të panevojshëm; jeta është e korruptuar nga shumësia. Sa mirë është që, me mirazhin e “jetës së përjetshme” t’i shtysh ata jashtë kësaj jete!

“Ikteristë” (të sëmurë me verdhëz). Kështu quhen shpesh predikuesit e vdekjes, ose “njerëz të zinj”. Po unë dua t’ua rrëfej me të tjera ngjyra.

Në të vërtetë, janë njerëz të frikshëm, që mbartin mbi vete një bishë grabitqare e që nuk kanë zgjedhje tjetër, përveçse kënaqësisë ose trup-sflitjes. Madje, dhe kënaqësitë e tyre janë veç trup-sflitje. Nuk janë shndërruar as në njerëz këto qenie të shpifura, Predikofshin, pra, edhe mohimin e jetës e shkofshin në djall!

Janë tuberkuloz-vuajtësit e shpirtit: sapo lindin, nisin të vdesin e të priren kah doktrinave të lodhjes dhe mohimit.

Duan të vdesin e ne duhet ta përshëndesim me gëzim këtë vullnet të tyre.

Le të përkujdesemi, pra, që të mos i zgjojmë të vdekurit e të mos i profanojmë sarkofagët e gjallë!

Takojnë një të sëmurë a një plak, a një kufomë, e thonë menjëherë: “Ja edhe hedhja poshtë e jetës! Kur janë ata vetë hedhësit poshtë të saj e kur syri i tyre sheh vetëm këtë fytyrë të ekzistencës njerëzore.

Të mbështjellë nga një solemnitë i rëndë, shkojnë në kërkim të rastësive të vockla funebre: rrinë në pritje e skërmisin dhëmbët.

Ose kërkojnë ca sheqerka e, ndërkaq shpotisin foshnjërinë e tyre; kapen pas lëmishtes së tyre të jetës e qeshin me të qenin të kapur pas një lëmishteje.

Mençuria e tyre kumbon kështu: i çmendur qoftë ai që rri në jetë, të çmendurit jemi vetë ne. Kjo është në të vërtetë marrëzia më e madhe e jetës”.

“Jeta është vetëm dhimbje!” Kështu thonë të tjerët, e nuk gënjejnë. Atëherë bëjeni ju të parët të reshtë! Bëni që ajo të shuhet, nëse është vetëm dhimbje!

Kështu kumbon doktrina e virtytit tuaj: “Ti duhet të vrasësh veten! Ti duhet t’i japësh fund jetës me duart e tua!”.

“Dëshirimi nuk është mëkat!” Kështu thonë unët që predikojnë vdekjen: “Lërnani të ecim në zgrip të rrugës pa lënë pas fëmijë!”.

“Të lindësh është e dhimbshme,” - thonë të tjerët. - Për ç’qëllim duhet të lindet akoma? Nuk lindin veçse fatkeq. Edhe ata janë predikues të vdekjes”.

“Duhet dhembshuri, - thonë ca të tretë. - Merreni atë që kam! Merreni atë që jam, se më pak do të më lidhë pas vetes jeta!”

Po nëse do të ishin vërtet njerëz të dhembshur e të mëshirshëm, do të kërkonin t’ua hiqnin jetën të afërmve të tyre. Të qenit të keq do të qe, në fakt, në një rast të tillë, mirësia e tyre më e vërtetë.

Mirëpo, ata duan vetëm të çlirohen nga jeta e tyre. E ç’u prish punë t’i lidhin njerëzit akoma edhe më shumë me zinxhirët dhe dhuratat e veta.

Po ju të tjerët, që jeta u është një punë e ankthshme, plot halle e shqetësime, a s’jeni vallë të lodhur prej saj?

Nuk jeni vallë të pjekur për predikimin e vdekjes? Ju të gjithë, që dashuron punën këmbëngulëse dhe zhdërvjelltësinë, të renë, të panjohurën, thellë vetes mezi e duroni atë, ndaj punëdashësja juaj është mallkim e vullnet vetëharrimi.

Nëse do të besonit pak më shumë te jeta, do të ishit më pak pre e momentit. Por nuk keni aq shumë brumë sa të dini të prisni, po aq sa dhe të jeni përtimtarë. Nga të gjitha anët kumbon zëri i atyre që predikojnë vdekjen. Toka është plot me ata që u nevojitet predikimi i vdekjes.

Ose “jeta e përjetshme” që, për mua është e njëjta gjë, kah së cilët ata le të aviten me ngut!”

Kështu foli Zarathustra

Për luftën dhe luftëtarët

“Nga armiqtë tanë më të mirë ne nuk duam të kursehemi, por as edhe nga ata që dashurojmë me gjithë shpirt. Lërmëni atëherë, që t’ju tregoj të vërtetën!

Vëllezërit e mi në luftë! Unë ju dua nga thellësia e shpirtit, unë isha dhe jam i barabartë me ju, por jam edhe armiku juaj më i mirë. Lërmëni atëherë t’ju them të vërtetën!

Unë e njoh mirë urrejtjen dhe mllefin e zemrës tuaj. Ju nuk jeni aq të mëdhenj sa ta injoroni urrejtjen dhe mllefin. Qofshi, të paktën të mëdhenj sa të mos turpëroheni prej tyre!

Nëse nuk jeni shenjtët e njohjes, qofshi të paktën luftëtarët e saj. Ata janë bashkudhëtarët dhe shteg-çelësit e një shenjtërie të tillë.

Unë shoh shumë ushtarë. Oh, sikur të shihja po kaq luftëtarë! Uniformë quhet ajo që veshin, për shembull sikur të mos qe “uniformë” ajo që fshehin nën të! Ju për mua duhet të jeni ata, syri i të cilëve kërkon gjithmonë një armik - armikun tuaj. Në disa prej jush urrejtja përflaket që në shikim të parë. Armikun tuaj duhet të kërkonit, luftën tuaj duhet të luftoni, edhe për vetë idealet tuaja!

Nëse ideali dorëzohet, besimi juaj i mbarë duhet të trumbetojë përsëri triumf. Duhet ta dashuronit paqen si një mjet për luftëra të reja dhe paqen e shkurtër më tepër se paqen e gjatë. Nuk ju këshilloj punën, por të luftuarin.

Nuk ju këshilloj paqen, por fitoren.

Qoftë puna juaj të luftuarit, paqja juaj një fitore!

Nuk mund të heshtet e të qëndrohet qetësisht ulur me harkun dhe shigjetën në krah; përndryshe, llomotitet dhe grindet. Paqja juaj qoftë një fitore!

Ju thoni se është kauza e drejtë ajo që shenjtifikon luftën.

Por unë ju them se është lufta e drejtë ajo që shenjtifikon çfarëdolloj kauze.

Lufta dhe kuraja kanë përmbushur gjëra më të mëdha se sa dashuria për tjetrin. Jo dhembshuria, por vlera juaj ka arritur deri më sot t'i shpëtojë viktimat.

“Ç’gjë është e mirë?” - pyesni ju. Të jesh i guximshëm është gjë e mirë. Lëruani vashëzave ta thonë, se një gjë e mirë është njëherësh e hijshme dhe prekëse.

Ju quajnë jo të dashur, por zemra juaj është e kulluar dhe unë e dashuroj drojën e mirëdashësinë suaj. Ju keni turp nga batica juaj, ndërsa të tjerët kanë turp nga zbatica e tyre.

Jeni të shëmtuar? Epo mirë, o vëllezërit e mi, mbështilluni me sublimen, që është manteli i shëmtisë!

Kur shpirti juaj të bëhet i madh, do të bëhet edhe kokëkrisur e në sublimitetin tuaj do të ketë dhe ligësi. Unë ju njoh.

Te ligësia puqet kokëkrisuri me të dobëtin. Por keqkuptohen me njëri-tjetrin. Unë ju njoh.

Ju do të donit të kishit vetëm armiq për të urreyer, jo armiq për të përçmuar. Duhet të jeni krenarë për armikun tuaj, se atëherë fitoret e armikut do të jenë edhe fitoret tuaja.

Revoltë: kjo është shenja dalluese e skllavit. Shenja juaj dalluese qoftë bindja! Komanda juaj qoftë bindja!

Një luftëtari të mirë i tingëllon më e dashur “ti duhet” se sa “unë dua”. Gjithçka u është më e shtrenjta, duhet ta lini që më parë t’ua komandojnë.

Dashuria për jetën qoftë dashuria për shpresën tuaj më të lartë. Shpresa juaj më e lartë qoftë ideali më i lartë i jetës!

Mirëpo, idealin më të lartë ju duhet ta lini që ta komandoj unë: ai thotë se njeriu është diçka që duhet tejkaluar.

Pra, rroni jetën tuaj të bindjes e të luftës. Ç’ju duhet një jetë e gjatë? Cili luftëtar vallë do të donte të kursehej në luftë?

Unë nuk do t’ju kursej, sepse ju dua nga thellësia e shpirtit, o vëllezërit e mi të luftës!”

Kështu foli Zarathustra

Për idhullin e ri

“Ka ende diku nëpër botë popuj e kope, por jo këtej nga ne, o vëllezër!” Ne kemi shtete.

Shtet? Po ç’është vallë? Epo mirë! Dëgjomëni me kujdes, se dua t’ju them fjalën time për vdekjen e popujve.

Shtet quhet më i ftohti i të gjitha mostrave më të ftohta. I ftohtë edhe në të gënjer; me një gënjeshtër të jargët prej gojës së tij: “Unë, shteti, jam populli!”.

Është e gjitha një mashtrim! Krijues ishin ata që krijuan popujt dhe transmetuan në ta besimin dhe dashurinë. E kështu i shërbyen jetës.

Ndërsa shkatërrues janë ata që ngrenë kurthe dhe e quajnë shtet, për t’ju varur sipër një shpatë me njëqind makutëri.

Aty ku ekziston akoma një popull i vërtetë, ai nuk e pranon shtetin, por, përkundrazi, e urren si një prapësi dhe një mëkat kundra zakoneve dhe së drejtës.

Unë po ju jap këtë shenjë: çdo popull flet gjuhën e tij të së mirës e së keqes: fqinji nuk e kupton. Kjo është, në fakt, një e folur e krijuar vetë, sipas zakoneve dhe së drejtës së secilit.

Mirëpo shteti gënjen në të gjitha gjuhët, në lidhje me të mirën e të keqen. Gënjen, në çfarëdo që thotë; madje edhe atë që zotëron e ka të vjedhur.

E shtirur është çdo gjë në të; me dhëmbë të vjedhur kafshon grabitqari. Madje, dhe rropullitë i ka të shtirura.

Korruptimi i shprehjeve, si për të mirën ashtu dhe për të keqen, është shenja dalluese e shtetit. Në të vërtetë, kjo shenjë dalluese dëfton vullnetin e vdekjes. Në realitet, ajo josh predikatoret e vdekjes. Shumë, goxha njerëz lindin në botë: për njerëzit e tepërt u krijuan shteti. Shikoni, pra, se si i ngashëren ai të shumtit! Si i gëlltit e si i përtyp e i ripërtyp! “Nuk ka më të madh në tokë se unë: unë jam gishti urdhërues i Zotit!” Kështu gjëmon bisha. Bien në gjunjë të saj jo vetëm ata që kanë veshë të gjatë e shikim dritëshkurtër.

Se medet, edhe juve, o shpirtra të mëdhenj, ai ju mërmërit gënjeshttrat e tij të trishta. Medet, se ç'i shquan zemrat e pasura, që dinë të jepen!

Po, ju ka shquar edhe juve, o fitimtarë të zotit antik! Ju, që jeni lodhur së luftuari, e tash lodhja juaj i shërben idhullit të ri!

“Me heronj e njerëz të fjalës së nderit do të rrethohet ky idhulli i ri. Me aq dëshirë kënaqet në dritën solare të ndërgjegjes të pastër, kjo e ftohta bishë!

Gjithçka kërkon t'u japë, nëse ju e adhuroni këtë idhull të ri. Kështu fiton madhështinë e virtyteve tuaja dhe shkëlqimin e shikimit të syve tuaj krenarë.

E me to kërkon të joshë shumicën në tepri. Është një vepër skëterre ajo që arriti të shpikëj kështu, një kalë vdekjeje, që tringëllin stolitë e nderimeve hyjnore.

Një epidemi në masë u ideua kështu, që rri e krekosur si të ish jeta, por që në realitet është një shërbim i bërë nga zemra për gjithë predikuesit e vdekjes.

Ja shteti, ku të gjithë pinë helm, të mirë e të këqij! Shteti, ku të gjithë humbasin vetveten, të mirë e të këqij; shteti ku vetëvrasja e avashtë e të gjithëve quhet jetë.

Shikojini këta të tepërt! Ata vjedhin veprat e shpikësve dhe thesaret e të urtëve. E quajnë mësim këtë vjedhje dhe, për shkak të tyre, gjithçka kthehet në sëmundje e fëlliqësi.

Shikojini këta të tepërt! Janë gjithnjë të sëmurë, vjellin zemërimin e tyre dhe e quajnë “gazetë”. E gëlltisnin njëri-tjetrin, po nuk arrijnë dot as ta tresin.

Shikojini këta të tepërt! Grumbullojnë pasuri e me të bëhen më të varfër. Duan autoritet e, më parë akoma levën e pushtetit, si dhe shumë parà, impotentët!

Shikojini se si kacavirren, të shkathëtit majmunë! Aviten me njëri-tjetrin e kështu zvarriten në njelmësi e në humnerë.

Të gjithë duan të arrijnë fronin; kjo është marrëzia e tyre, sikur lumturia të gjendej veç mbi fron. Por shpesh mbi fron

ka vetëm njelmësi; shpesh edhe vetë froni është i zhytur në njelmësi.

Të gjithë të çmendur e majmunë, të gjithë të mbieksituar. Idhulli i tyre, e ftohta bishë, qelbet; për mua qelben edhe të gjithë idhujtarët.

Vëllezër, mos doni vallë t'ju zihet fryma nga kundërmimi i frymimit dhe i makutërisë së tyre? Shkallmojeni më mirë dritaren e brofni jashtë në ajër të pastër!

Shpërndahuni nëpër rrugë nga kutërbimi i erës së keqe! Arratisuni nga idhujtaria e të tepërmve!

Shpërndahuni nëpër rrugë nga kutërbimi i erës së keqe! Arratisuni nga avujt e këtyre sakrifikimeve njerëzore! Ende edhe sot toka është e lirë për shpirtrat e mëdhenj.

Të lira janë edhe shumë vende për vetmitarët dhe shpirtrat binjakë, përreth të cilëve fryn aroma e deteve të paqtuara.

Ka akoma një jetë të lirë për shpirtrat e mëdhenj. Kush zotëron pak, aq më pak është i pushtuar. Qoftë e lëvduar, pra, varfëria e vogël!

Aty ku mbaron shteti, fillon njeriu që nuk është i tepërt; fillon kënga e së nevojshmes, melodia e veçantë dhe e papërsëritshme.

Atje ku mbaron shteti, atje, pra shikoni, o vëllezër! A nuk e shihni ylberin dhe urën e "Mbinjeriut?"

Kështu foli Zarathustra.

Për mizat e tregut

Arratisu, o miku im, në vetmi! Unë të shoh të shastisur nga poterja e njerëzve të mëdhenj e të pickuar nga thumbat e të vegjëlve.

Pylli dhe shkëmbi do të dinë të heshtin denjësisht për ty. Ji i ngjashëm me atë pemë që aq shumë e do, atë pemë të hijes së gjerë, që e varur rri mbi det dhe rri e dëgjon në heshtje.

Ku mbaron vetmia, fillon tregu e, ku fillon tregu, fillon edhe poterja e aktorëve të mëdhenj dramatikë dhe zhuzhitja e mizave të helmëta.

Në botë gjërat më të mira nuk nevojiten për asgjë, po që se nuk i përfaqëson dikush. Populli njerëzit e mëdhenj i quan komedianë.

Populli kupton pak nga madhështia, domethënë nga krijimi. Mirëpo është i ndjeshëm t'i njohë gjithë komedianët dhe aktorët dramatikë të gjërave të mëdha.

Bota u vjen rrotull zbuluesve të vlerave të reja, u vjen qark në mënyrë të padukshme, se populli dhe fama qarkojnë veç aktorët dramatikë. Kështu shkon kjo botë!

Aktori dramatik ka shpirt, por ka pak ndërgjegje të këtij shpirti. Beson gjithmonë në atë gjë, me anë të së cilës i bën të tjerët të besojnë fortësisht; pra, të besojnë në atë vetë.

Nesër ka një besim tjetër, e pasnesër një tjetër. Ka ndjesi zemërake, si populli, dhe humor të luhatshëm.

Shkatërrimin e quan 'demonstrim' dhe 'bindjen' të shkuarit çmendi. Për të gjaku është arsyeja më e mirë.

Një të vërtetë, që depërton veç nëpër veshët e mprehtë, e quan gënjeshtër dhe hiçgjë. Se, në realitet, ai beson vetëm zotat që bëjnë më shumë zhurmë nëpër botë.

Tregu është plot e përplot me tallës e shakatarë të ligj. Populli lëvdohet me njerëzit e tij të mëdhenj, ata janë zotërinjtë e kohës së sotme.

Mirëpo, koha tash po i shtyn e ata, nga ana e tyre, i shtyjnë të tjerët duke kërkuar një po ose jo edhe nga ty. Medet, mos ndoshta ti do të ulesh në një karrige të vendosur në mes po-së dhe jo-së?

Mos ji aspak xheloz me këta të dhunshmit e absolutistët ti, o dashnor i së vërtetës!

Kurrë nuk u var ndonjëherë e vërteta në krahët e një absolutisti. Përvidhu shpotitësve e kthehu prapa kah sigurisë

tënde, se vetëm në treg mund të të kërcënojnë me një po a me një jo.

I avashtë është procesi i eksperiencës në të gjitha pusët e thella; duhet të presësh gjatë, për të kuptuar se ç'ka ndodhur në thellësi të tyre.

Të gjitha gjërat e mëdha ndodhin jashtë tregut dhe famës; zbuluesit e vlerave të reja kanë rrojtur gjithmonë larg tregut dhe famës.

Arratisu, o miku im, në vetminë tënde! Unë të shoh të pickuar nga miza të helmëta.

Arratisu, atje lart, ku ka një atmosferë të fortë e të ashpër!

Arratisu në vetminë tënde! Ke rrojtur kaq gjatë afër të vegjëlve dhe meskinëve.

Arratisu nga hakmarrja e tyre e padukshme, se me ty ata mund veçse të hakmerren! Mos e ngri kurrë dorën kundra tyre! Ata janë të panumërt, por s'është detyra jote të bësh mizë-shpërndarësin.

Të panumërt janë të vegjlit dhe meskinët. Më shumë se një ndërtesë e madhërishtme është rrëzuar, për shkak të pikëzave të shiut e barërave të këqija që rriteshin përreth tyre.

Ti nuk je një shkëmb, por tashmë shumë pikëza të kanë gërryer. Këto pikëza mund të të copëtojnë e të të bëjnë thërrime.

Unë të shoh të lodhur nga këto miza të helmëta, të shoh gjithë gjak në njëqind vende, por krenaria jote nuk do as edhe të nxehesh.

Me gjithë pafajësinë e tyre e dëshirojnë gjakun tënd, u digjet flakë e gjak shpirti i tyre anemik. Kështu të pickojnë me gjithë pafajësinë që kanë.

Por ti, o i thellë, aq thellësisht vuan edhe nga plagët më të vockla. Më parë se të shërohesh, po i njëjti krimb helmues nis të zvarritet nëpër dorë.

Je shumë krenar për t'i vrrarë këta lakmitarë. Por ki kujdes, të mos durosh paskëtaj fatin e padrejtësisë së tyre helmuese!

Gumëzhijnë përreth teje edhe me lavdet e tyre, mirëpo lavdi i tyre nuk është veçse përgatitje për sulm. Duan afrinë me lëkurën tënde e me gjakun tënd.

Të miklojnë si një zot a një demon; ofshajnë përpara teje si përpara një zoti a një djalli. Ç'ëndësi ka? Nuk janë veçse lajkatarë dhe qaramanë.

Shpesh vishen edhe me një petk dashamirës. Kjo ka qenë gjithmonë matura e burracakëve, sepse burracakët janë të matur.

Në shpirtat e tyre të mjerë mendojnë shumë gjëra për ty, sepse ti i gjallon dyshimet e tyre. Të menduarit shumë shkakton dyshime.

Të ndëshkojnë për të gjitha virtytet e tua. Të falin me zemër vetëm gabimet, sepse ti je i butë e i drejtë, e thua: "Janë të pafajshëm në ekzistencën e tyre të vockël". Mirëpo, shpirti i tyre i mjerë mendon: "Faj është gjithë ekzistenca e njerëzve të mëdhenj".

Edhe kur i butë je me ta, të përçmuar ata ndihen, gjithsesi, dhe t'i shkëmbejnë mirësitë e tua me ligësi të fshehta.

Krenaria jote e heshtur shkon gjithmonë kundër shijes së tyre; janë të lumtur, kur ti shfaqesh ndonjëherë aq shumë modest sa të tregohesh mendjemadh.

Atë ç'ka ne njohim te një njeri, ia përflakim edhe në shpirt. Ndaj, ruhuni nga të vegjlit!

Përpara teje ata ndihen të vegjël, inferioriteti i tyre rri i fshehur nën thëngjij e digjet, duke të të përgatitur një hakmarrje të padukshme.

A nuk e ke vënë re se sa shpesh bëhen memecë, kur u afroresh pranë, humbasin çdo fuqi, si tymi i një zjarri që po shuhet?

Po, miku im, ti je ndërgjegjja e keqe për fqinjët e tu, sepse ata të padenjë janë për ty. Ndaj të urrejnë e duan të ta pinë gjakun.

Fqinjët e tu do të jenë gjithmonë miza të helmëta; çka e madhe është te ty, është ajo që i bën helmues e të përngjasojnë me mizat.

Arratisu, o miku im, në vetminë tënde, aty ku fryn një erë e ashpër dhe e fortë! Nuk është detyra jote të bësh miza-shpërndarësin.”

Kështu foli Zarathustra.

Për dëlirësinë morale

“Unë e dua pyllin. Në qytet rrohet keq, ka shumë epsharakë. Nuk është vallë më mirë të biem në duart e një vrasësi sesa në ëndrrat e një gruaje epsharake?

Shikojini ata njerëz: shikimi i tyre thotë se mbi tokë nuk ka gjë më të mirë se sa të shkosh me një grua.

Njelmësi është thellësia e shpitrave të tyre; mjerë, nëse në këtë njelmësi gjendet rastësisht ndonjë shpirt!

Sikur të ishin tërësisht bisha! Se bisha ka dhe pafajësi brenda vetes.

A mos vallë po ju këshilloj që t’i vrisni ndjesitë tuaja?

Ju këshilloj vetëm pafajësinë e ndjenjave.

A mos vallë ju këshilloj dëlirësinë morale? Dëlirësia te disa është një virtyt, por te të tjerë gati një ves.

Disa përmbahen, por bushtra e sensualitetit lakmon me mllef gjithçka që ata bëjnë.

Madje, gjer në thellësitë e virtyteve e në ftohtësitë e shpitrave, i ndjek kjo bishë me shqetësimet e veta.

E sa mirë di t’ia dalë mbanë bushtra e sensualitetit në lypjen e një copëze të shpirtit, kur i refuzohet një copëz mishi.

Ju dashuronit tragjeditë e gjithçka që ju thyen zemrën? Por unë ushqej shumë dyshime, në lidhje me bushtrën tuaj.

Jukenisogoxhatëtmerrshëmelakmitarëishihnitëpërvuajturit. Mos vallë epshmëria juaj është transformuar e tash quhet mëshirë? Unë po ju kushtoj edhe këtë alegori: jo pak nga ata që deshën ta përzinin djallin e tyre përfunduan vetë mes derrave.

Atij që dëlirësia i duket e rëndë, ajo s'i duhet këshilluar derisa të mos i kthehet në rrugën drejt ferrit, drejt njelmësisë dhe epshërimit të shpirtit.

Mos flas vallë për gjëra të ndyra? S'është kjo gjëja më e rëndë.

Jo kur e vërteta është e ndyrë, por kur ajo është sipërfaqësore, kush e njeh zbret pa dëshirë në ujërat e saj.

Në realitet, ka disa që janë të dëlirë në intimitet; po ata janë më të butë në zemër, qeshin më shpesh e me kënaqësi me ju.

Ata qeshin edhe me dëlirësinë e pyesin: "Ç'është vallë dëlirësia? S'është një marrëzi? Mirëpo, kjo marrëzi erdhi të na vizitojë, nuk qemë ne që e kërkuam.

I dhamë mirëseardhjen dhe zemrën tonë: tash ajo banon me ne, e mund të qëndrojë sa të dojë!"

Kështu foli Zarathustra.

Për mikun

"Një është gjithmonë përreth meje, - mendon eremiti.- Gjithmonë një e nga një e, më në fund, do të bëhen dy! Uni dhe Mua jemi gjithmonë në një bashkëkuvendim të njerëzishëm. Si mund të durohet e gjitha kjo, pa një mik?"

Miku për eremitin është gjithmonë një i tretë. I treti është shtupa që pengon që bashkëkuvendimi të bjerë në fund.

Medet, të gjithë eremitët kanë goxha thellësi. Ndaj digjen aq shumë për një mik e për majën e tij.

Besimi ynë te të tjerët e tradhton atë, në të cilën ne duam të besojmë. Është dëshirimi ynë i zjarrtë për një mik ai që na tradhton.

Shpesh, me dashuri kërkohet të kapërcehet zilia. Shpesh, përfundojmë në grindje e krijojmë armiq, veç për të fshehur luhatshmërinë tonë.

“Ji të paktën armiku im!” Kështu flet respekti i vërtetë, që nuk guxon të kërkojë miqësi. Nëse dëshirohet vërtet një mik, duhet edhe të kesh kurajën të zbresësh në luftë për të, por për të udhëhequr një luftë, duhet të dish të jesh armik.

Duhet ta nderosh mikun tënd edhe tek armiku!

A mund t’i afrohesh vallë mikut, pa kaluar në anën e tij?

Te miku yt duhet të kesh edhe armikun tënd më të mirë.

Duhet të jesh më afër se kurrë me zemrën e tij, sa herë që e kundërshton.

A do t’i paraqitesh mikut tënd lakuriq, e t’i bësh atij nder, që i paraqitesh kështu siç je? Kështu ai do të të çojë në djall.

Kush nuk di të fshehë, të zemëron; aq të shumta janë arsyet për të fshehur lakuriqësinë tuaj. Vetëm po të ishit zotër do të kishit të drejtën për t’u turpëruar me veshjet tuaja.

Ti nuk mund të stolisesh kurrë mjaftueshëm për mikun tënd se, në të vërtetë, ti duhet të jesh përjetë një shigjetë dhe një dëshirim i zjarrtë kah Mbinjeriut.

A e ke parë vallë mikun tënd të flejë, për të kuptuar se ç’brumë ka? Ç’gjë vallë është e zakonshme në fytyrën e mikut tënd? Është vetë fytyra jote e shëmbëllyer në një pasqyrë të palatuar e të papërsosur.

A e ke parë vallë mikun tënd të flejë e nuk je frikësuar nga çehrja e tij? Oh, miku im, njeriu është diçka që duhet tejkaluar!

Miku duhet të jetë mjeshtër në zbulimin e gjërave dhe, në heshtjen ndaj këtyre zbulimeve, ti nuk duhet të shohësh çdo gjë. Ëndrra jote le të zhvillojë atë që miku yt bën zgjuar.

Zbulimi i saj, qoftë mëshira jote, derisa ti ta dish që më parë, nëse miku yt e do vërtet këtë mëshirë. Ndoshta ai dashuron te ty syrin e kulluar dhe shikimin e përjetësisë.

Mëshira për mikun duhet të fshihet nën një lëvozhgë të ashpër; tek ai duhet të gësh gur për dhëmbët e tu. Kështu gjërat do të duken më të ëmbla e më fine. A je ti vallë ajër i kulluar e vetmi, bukë e melhem për mikun?

Dikush mund të mos arrijë t'i thyejë zinxhirët e vet, por, megjithatë, është një shpëtimtar për mikun e vet.

A je vallë një skllav? Në një rast të tillë s'mund të jesh mik.

A je vallë një tiran? Në këtë rast s'mund të kesh miq.

Te një grua fshihet gjatë skllavi dhe tirani. Ndaj, gruaja s'është ende e aftë për miqësi; ajo njeh vetëm dashurinë.

Në dashurinë e gruas gjendet padrejtësia dhe verbëria për gjithçka që ajo dashuron.

Madje, edhe në dashurinë e ndërgjegjshme të gruas ka gjithmonë, bashkë me dritën, edhe agresion, vetëtima dhe natë.

Gruaja nuk është ende e aftë për miqësi: gratë janë gjithnjë mace dhe zogj. Ose, në rastin më të mirë, lopë.

Gruaja nuk është ende e aftë për miqësi. Por edhe nga ju, o burra, thomëni, kush është i aftë për miqësi?

Oh sa mizerie te ju, o njerëz, e sa kurnacëri në shpirt! Atë ç'ka ju i jepni një miku, unë do t'ia jepja edhe armikut, e s'kisha për t'u bërë aspak më i varfër. Ekziston shoqëria (në mes shokëve të shkollës, të ushtrisë). Oh, sikur të ekzistonte edhe miqësia!"

Kështu foli Zarathustra.

Për një mijë e një objektivat

"Shumë vende e popuj pa Zarathustra. Zbuloi kështu të mirën dhe të keqen e shumicës prej tyre, por s'gjeti fuqi më të madhe mbi tokë sesa e mira dhe e keqja.

Asnjë popull nuk do të mund të jetonte, nëse nuk do të dinte të gjykonte të mirën dhe të keqen. Nëse do të mbijetojë, nuk do t'i duhet të gjykojë po njëlloj si fqinji.

Shumë gjëra, që nga një popull besohen si të mira, nga një tjetër quhen turp dhe shpoti: kështu vërejta. Kishte këtu shumë gjëra të vlerësuara si të këqija, që diku gjetkë rrethoheshin nga nderimet më të mëdha.

Kurrë ndonjëherë fqinjët s'e kuptojnë njëri-tjetrin. Ata gjithmonë habiten në shpirt për marrëzinë dhe ligësinë e fqinjët.

Një tabelë vlerash rri pezull mbi çdo popull. Kjo është tabela e fitoreve mbi vetveten; ky është zëri i vullnetit të tij për pushtet.

Është gjithashtu e denjë për lavde ajo që atij i duket e guximshme, sepse ai quan të mirë atë që është e ndaluar dhe e vështirë, atë që e çliron nga ankthi më i madh, të rrallën, tej mase të vështirën. Ja, ç'është e shenjtë për të!

Ajo që e bën të sundojë, të mbretërojë, të fitojë e të shkëlqejë, për tmerrin dhe zilinë e fqinjët; kjo është për të supremja, gjëja parësore, masa, kuptimi i të gjitha gjërave.

Në realitet, o vëlla, nëse do t'ia njihje ankthin një populli, bashkë me tokën, qiellin dhe fqinjin do të zbuloje, me siguri, ligjin e vlerave të tij, si dhe përse ai vallë e ngjit këtë shkallë drejt shpresave të veta.

"Ti duhet të jesh gjithmonë i pari, ti duhet t'i mposhtësh të tjerët; shpirti yt xheloz nuk duhet të dojë askënd, përveçse "mikut"! Kjo shprehje e drithëronte shpirtin e një greku; kështu ai marshonte në shtegun drejt madhësisë.

"Të thuash të vërtetën e të stërvitesh fort me harkun dhe shigjetën!" Kjo iu duk njëherësh e shtrenjtë dhe e guximshme atij populli [persian - shpjegim i përkthyesit], prej të cilit e ka prejardhjen emri im; një emër që më është sa i dashur aq dhe i rëndë.

"Nderojë nënën dhe babanë e qofsh i gatshëm ta përmbushësh vullnetin e tyre deri në rrënjë të shpirtit!" Këtë tabelë të fitores mbi vetveten diktoi një tjetër popull [hebre - shpjegim i përkthyesit] e me të u bë i fuqishëm e i përjetshëm.

"Dëshiro besnikërinë dhe, për dashuri të besnikërisë, vendose nderin dhe gjakun edhe në gjëra të këqija e të rrezikshme!" Me këtë doktrinë, një tjetër popull e mposhti vetveten. Duke bërë kështu u shndërrua i mbarsur e i fortë në shpresa të mëdha [i referohet popullit gjerman - shpjegim i përkthyesit].

Në realitet, njerëzit ia afruan vetvetes gjithë të mirën e të keqen. Në realitet, ata nuk e morën atë lehtësisht mbi vete, nuk e gjetën, as nuk u ra ajo si një zë nga qielli. Ishte njeriu ai që vendoi një masë mbi gjërat, për të mbijetuar.

Së pari, iu dha këtyre një kuptim, një kuptim njerëzor. Ndaj, ai quhet "njeri", d.m.th. vlerësuesi.

Të masësh, të vlerësosh është krijim. Dëgjojeni, o krijues! Të vlerësosh është në vetvete thesari e xhevahiri i të gjitha gjërave të vlerësuara se, përmes vlerësimit, ekziston vlera. Pa vlerë, thelbi i ekzistencës do të ishte bosh. Dëgjojeni, o krijues! Përkëmbja e vlerave do të thotë përkëmbim i krijimit.

Shkatërron gjithmonë ai që do të jetë krijues.

Krijues, për së pari, qenë popujt, pastaj individët. Në të vërtetë, vetë individi është më i mbrami i krijimeve. Një kohë, popujt vendosën mbi vete tabelën e së mirës. Dashuria që do të sundojë dhe dashuria që do të bindet i krijoi së bashku këto tabela. Më antik është entuziazmi, për masën e popullit, sesa kënaqësia e Unit. Përderisa ndërgjegjja e drejtë quhet masë popullore, vetëm ndërgjegjja e keqe thotë Unë.

Në realitet, Uni i çalltisur, pa dashuri, që kërkon përfitimin e vet në përfitimin e të tjerëve, nuk është zanafilla e masave popullore, por, përkundrazi, perëndimi i tyre.

Të dashuruarit dhe krijuesit ishin ata që krijuan të mirën e të keqen. Zjarri i dashurisë dhe zjarri i zemërimit digjet në të gjitha emrat e virtyteve.

Zarathustra pa shumë vende dhe popuj, por s'gjeti asnjë fuqi më të madhe mbi tokë sesa në veprat e të dashuruarve; emri i tyre është "e mirë" dhe "e keqe".

Në realitet, një monstruoze është fuqia e lavdit dhe qortimit. Thomëni, o vëllezër, kush vallë do ta vërë nën zgjedhë? Thomëni, kush do ta flakë tej zgjedhën e kësaj bishe me një mijë kokë? Një mijë objektiva qenë deri tash, se një mijë popuj qenë gjithsej. Mungon vetëm zgjedha e një mijë

kokave, mungon një objektiv i vetëm. Njerëzimi është ende pa objektiv.

Ndaj, thomëni, atëherë, o vëllezër: nëse njerëzimit i mungon ende qëllimi, a nuk mungon vallë edhe vetë ekzistenca e tij?"

Kështu foli Zarathustra.

Për dashurinë ndaj të afërmit

Ju bëheni turmë përreth të afërmit tuaj e, si shkëmbim, merrni fjalë të bukura. Por unë ju them: dashuria juaj për të afërmin nuk është veçse një dashuri e keqe për vetveten.

Ju strehoheni tek i afërmi duke iu arratisur vetvetes, e dëshironi madje ta bëni këtë gjë një virtyt, por unë e kuptoj me intuitë "altruizmin" tuaj.

Ti është më e vjetër se Unë. Ti, tashmë është shpallur e shenjtë, kurse Unë ende jo, ndaj njeriu bëhet turmë përreth të afërmit.

Mos vallë po ju këshilloj dashurinë për të afërmit? Më mirë po ju këshilloj arratinë nga i afërmi dhe dashurinë për më të largët.

Më lart dashurisë për të afërmin është dashuria për më të largëtën dhe për të ardhmen. Më lart dashurisë për njerëzit, unë çmoj dashurinë për gjërat dhe fantazmat.

Kjo fantazmë që të paraprin, o vëlla, është më e bukur se ty. Pse si dhuron vallë mishin dhe kockat e tua? Mirëpo, ke frikë nga ajo dhe vrapon për tek i afërmi yt.

Ju nuk e duroni dhe as e dashuroni aq shumë veten. Ja tek dëshironi ta ngjallni të afërmin tuaj me dashuri e të stoliseni me gabimin e tij. Unë do të doja që ju të mos ishit dakord me të afërmit dhe fqinjët; kështu do të detyroheshit ta krijonit nga vetja mikun tuaj dhe zemrën e tij grafulluese.

Kur doni të flisni mirë për veten, ftoni një dëshmitar. Vetëm kur ta keni shtyrë të mendojë mirë për ju, vetëm atëherë edhe ju do të mendoni mirë për të.

Nuk gënjen vetëm ai që flet kundra ndërgjegjes së tij, por akoma dhe me më shumë arsye ai që flet kundra jo ndërgjegjes së tij.

Ja, kështu ju flisni në marrëdhëniet tuaja. Bashkë me veten, mashtroni dhe fqinjin.

Kështu flet i marrosuri: "Raporti me njerëzit ta korrupton karakterin, mbi të gjitha, kur nuk e ke një të tillë".

Dikush shkon kah të afërmit, sepse kërkon vetveten; një tjetër, sepse kërkon të humbasë në vetvete. Dashuria juaj e keqe për veten e bën vetminë tuaj burg.

Më të largëtit janë ata që e paguajnë haraçin e dashurisë suaj për të afërmin; sa bëheni pesë, i gjashti duhet gjithmonë të vdesë.

Unë nuk i dua as festat tuaja: vërej shumë aktorë; edhe spektatorët ngandonjëherë marrin pamjen e aktorit.

Unë nuk ju mësoj të gjeni të afërmin, por mikun. Miku qoftë për ju festa e tokës dhe parandjenja e Mbinjeriut.

Unë ju mësoj të gjeni mikun dhe zemrën e tij grafullonjëse. Por duhet të jesh i gatshëm të bëhesh sfungjer, nëse do të dashurohesh nga një zemër grafullonjëse.

Ju mësoj të gjeni mikun, tek i cili gjendet një botë e fundme, një guaskë e së mirës; të gjeni mikun krijues, që ka gjithmonë një botë të përfunduar për të ta dhuruar.

Ashtu si bota që për të rrotullohet pjesë-pjesë, po ashtu ajo riformësohet në mënyra të reja, njëlloj siç shndërrohet e mira nga e keqja, qëllimi nga shkaku.

E ardhmja dhe e largëta qofshin për ty arsyeja e së sotmes: te miku yt duhet të duash Mbinjeriun, si origjinën e vetvetes.

Vëllezër, unë nuk ju këshilloj dashurinë për të afërmin: unë ju këshilloj dashurinë për më të largëtin!"

Kështu foli Zarathustra.

Për udhën e krijuesit

A do vallë, o vëlla, të tërhiqesh në vetmi? A do vallë ta kërkoesh udhën për te vetvetja? Duro edhe pak e dëgjomë!

“Kush kërkon, e humbet veten lehtësisht.” Çdo izolim është faj: kështu flet turma. E ti ke kohë që i përket turmës.

Zëri i turmës do të kumbojë akoma te ty, derisa ti të thuash: “Unë nuk kam të njëjtën ndërgjegje me ju”. Fjalët e tua do të kumbojnë si një vajtim e dhimbje.

Shiko, se këtë dhimbje e krijoi ndërgjegjja e përbashkët, ndërkohë që e fundmja dritëz e kësaj ndërgjegjeje shkëlqen akoma në melankolinë tënde.

Po ti vallë, a do të kalosh nëpër udhën e melankolisë, që është udha drejt vetvetes?

Dëshmomë, pra, të drejtën dhe fuqinë tënde.

A je vallë një fuqi dhe një e drejtë e re? Një lëvizje parësore? Një rrotë që rrotullohet vetë? A mund t’i detyrosh vallë edhe yjet të sillen për qark teje?

Ah, sa i madh është epshi i lartësive të tua! Po kaq e madhe spazma e ambiciozëve. Dëshmomë se nuk je epsharak dhe ambicioz!

Ah, ka aq shumë mendime të tjera, që nuk janë gjë tjetër, veçse kacekë ajri; ata fryjnë e të lënë gjithnjë e më bosh.

Ti e quan veten i lirë? Dua të dëgjoj nga ty mendimin mbizotërues, e jo se ti i ke shpëtuar një zgjedhe.

Po a je vallë i tillë, sa të kesh të drejtën t’i shpëtosh zgjedhës?

Se ka nga ata që e flakin tej edhe veprën e tyre të mbrame e, bashkë me të edhe nënshtrimin.

I lirë nga ç’gjë vallë? Ç’rëndësi ka kjo për Zarathustrën! Qartësisht, duhet të ma thotë syri yt: i lirë, për ç’qëllim?

A mund t’ia diktosh vetes të mirën e të keqen e të varësh sipër saj vullnetin tënd, si një ligj? A mund të jesh gjykatës i vetvetes e ndëshkues i ligjit tënd?

Është e tmerrshme të jesh vetëm me gjykatësin dhe ndëshkuesin e ligjit tënd. Kështu lëshohet një yll në hapësirën e shkretuar e në gulçimin e akullt të vetmisë.

Sot ti vuan akoma për shkak të shumë të tjerëve. Ti, i vetmi që i ke akoma gjithë kurajën dhe shpresat e tua.

Mirëpo, një ditë izolimi do t'ju lodhë, një ditë krenaria do të të përkulë e kuraja jote do të thërrmohet. Atëherë, do të ulërish: "Jam vetëm!".

Një ditë, ti nuk do ta shohësh më lartësinë tënde e do ta ndjesh shumë afër atë që për ty është aq poshtë; vetë sublimiteti yt do të ngjallë frikë, si një fantazmë. Atëherë do të bërtasësh: "Gjithçka është false!".

Ka sentimente që kërkojnë ta vrasin vetmitarin; nëse nuk ia arrijnë, atëherë janë të detyruar të vdesin. Po ti, a do të dije të bëheshe vrasës?

Ti e njeh mirë, vëlla, fjalën 'përçmim'. Po ankthin e drejtësisë, detyrën e të qenit të drejtë ndaj atyre që të përçmojnë? Ti i detyron shumë të tjerë ta ndryshojnë opinionin ndaj teje. Për këtë, të ngarkojnë me shumë përgjegjësi. Ti mbërrite si fqinj i tyre, por kalove përtej, ndaj s'kanë për të ta falur kurrë.

Kalove përtej, por, sa më lart ngjitesh aq më të vogël të sheh syri i zilisë. Ai që ngjitet fluturimthi është më i urryeri nga të gjithë.

"Si do të donit të ishit të drejtë me mua? - duhet t'u thuash. - Unë zgjedh padrejtësinë tuaj, si hisen që më përket!"

Padrejtësi dhe ndyrësi ata vjellin mbi vetmitarin, por, vëlla, nëse do të jesh një yll, nuk duhet t'i ndriçosh më pak për këtë gjë!

Dhe kujdes, ruaju nga të mirët e të drejtët! Me shumë dëshirë i kryqëzojnë ata njerëzit që virtytet e tyre i gjejnë te vetvetja; e urrejnë vetmitarin.

Ruaju edhe nga dëlirësia e shenjtë! Gjithçka që nuk është e pafajshme, i duket profane; luan me dëshirë me zjarrin, me turrën e druve.

Ruaju gjithashtu nga sulmet e dashurisë! Goxha shpejt ia shtrin dorën vetmitari atij që takon.

Disa njerëzve s'duhet t'ua japësh dorën, por vetëm putrën; e unë dua që putra jote të ketë thonj.

Mirëpo, armiku më i keq që ti mund të ndeshësh, je gjithmonë ti vetë; je ti vetë që zë prita nëpër shpella e pyje.

Vetmitar, ti përshkon rrugën drejt vetvetes. Kjo rrugë kalon para teje e para shtatë demonëve të tu.

Vetvetes do t'i dukesh heretik, hamendësoj edhe i marrë, skeptik, profan e i lig.

Ti duhet të jesh gati të digjesh në flakën e zjarrit tënd. Si mund të rilindësh, nëse më parë nuk bëhesh hi?

Vetmitar, ti përshkon udhën e krijuesit: një zot do të krijosh prej shtatë demonëve të tu.

Vetmitar, ti përshkon udhën e të dashuruarit: e dashuron vetveten, ndaj dhe e përçmon atë, ashtu siç dinë të përçmojnë të dashuruarit.

I dashuruari kërkon të krijojë, sepse përçmon. Ç'mund të dijë për dashurinë ai, që nuk i është dashur kurrë të përçmojë atë që dashuronte?

Me dashurinë dhe me krijimin tënd shko drejt izolimit, o vëlla! Drejtësia, më vonë, do të të vijë pas, duke çaluar.

Me lotët e tu shko drejt izolimit, o vëlla! Unë e dua atë që do të krijojë përtej vetvetes, madje të vdesë për një gjë të tillë.”

Kështu foli Zarathustra.

Për gratë plaka dhe të reja

“Përse shkon duke u përvjedhur kaq i ndrojtur, nëpër muzg, o Zarathustra? Ç'fsheh vallë me aq shumë kujdes nën mantelin tënd?

Mos është vallë një thesar që ta patën dhuruar, apo një fëmijë të sapolindur? A mos ndoshta ti vetë po shkon në udhën e hajdutëve, ti o mik i të ligjve?”

“Në realitet, o vëlla, - tha Zarathustra, - ekziston një thesar që m'u pat dhurua; është një e vërtetë e vogël, ajo që unë sjell.

Por ajo është rebele si një vogëlush e, nëse nuk ia kyç gojën, do të bërtiste me piskama.

Sot, teksa po ecja krejt i vetëm në rrugën time, në atë kohë kur sapo perëndon dielli, u takova me një grua plakë që i foli kështu shpirtit tim: “Shumë gjëra ka thënë Zarathustra edhe për ne gratë, por nuk foli kurrë për gruan”.

E unë iu përgjigja: “Për gruan duhet të flasësh vetëm me burrat”.

“Fol edhe me mua për gruan, - ia ktheu ajo. - Unë jam mjaft plakë e do ta harroj shpejt atë që do më thuash.”

E kënaqa gruan plakë, duke i folur kështu:

“Te gruaja gjithçka është enigmë; gjithçka te gruaja ka një zgjidhje: ajo quhet shtatzëni.

Njeriu për gruan është një mjet: qëllimi është gjithmonë fëmija. Mirëpo, ç'është vallë gruaja për burrin?

Njeriu i vërtetë do dy gjëra: rrezikun dhe lojën.

Ndaj ai e do gruan, që është lodra më e rrezikshme.

Njeriu duhet të jetë i stërvitur për luftën, kurse gruaja për çlodhjen e luftëtarit: çdo gjë tjetër është marrëzi.

Frutat shumë të ëmbla luftëtari nuk i do, andaj ai do gruan; është gjithmonë e hidhur, qoftë edhe gruaja më e ëmbël.

Gruaja i kupton fëmijët më mirë se një burrë, ndërkohë që burri është më foshnjor se gruaja.

Te burri i vërtetë fshihet një fëmijë që do të luajë. Përpara, o gra, zbulomëni pra fëmijën te burri!

Qoftë gruaja një lodër e thjeshtë dhe fine, e ngjashme me një xhevahir, e ndriçuar nga virtyti i një bote që akoma nuk ka lindur!

Rrezja e një ylli shkëlqeftë në dashurinë tënde! Qoftë ajo shpresa juaj! Ah, sikur ta lindja unë Mbinjeriun!

Në dashurinë tuaj qoftë heroizmi! Me dashurinë tuaj lëshohuni mbi atë që ju ngjall frikë!

Në dashurinë tuaj qoftë nderi, se gruaja pak kupton nga nderi. Ky qoftë nderi juaj: të dëshironi më shumë se sa jeni i dashuruar e mos qofshi kurrë të dytët!

Burri i druhet gruas kur ajo dëshiron, sepse ajo bën çfarëdolloj sakrifice; për të asgjë tjetër nuk ka më vlerë.

Burri i druhet gruas, kur ajo urren, sepse burri, në thellësi të shpirtit nuk është i keq, ndërkohë që gruaja është e ligë.

Po kë urren gruaja më shumë se gjithçka? Kështu i tha hekuri magnetit: “Unë të urrej ty më shumë se çdo gjë, sepse ti tërheq pas vetes, por nuk je aq i fortë sa të mbash ngjitur”.

Lumturia e burrit quhet ‘unë dua’, lumturia e gruas quhet ‘ai do’. Shiko, vetëm tani bota u bë e përsosur. Kështu mendon çdo grua, kur bindet me gjithë dashurinë e saj.

Gruaja duhet të bindet e të gjejë një thellësi për sipërfaqen e saj. Sipërfaqja është shpirti i gruas, një lëkurë e butë dhe e stuhishme sipër një uji të cekët.

Kurse shpirti i burrit është i thellë, rrjedha e tij shkumëzon në shpellat e nëndheshme; gruaja ia ndjen fuqinë, por nuk ia kupton.

Gruaja plakë m’u përgjigj: “Shumë gjëra të bukura tha Zarathustra, veçanërisht për ato që janë ende mjaft të reja.

Është e çuditshme, Zarathustra i njeh pak gratë, por megjithatë ka të drejtë në ato që thotë për to. Kjo ndodh, ndoshta ngaqë për gruan asgjë s’është e pamundur.

E tani, si falënderim, po të tregoj një të vërtetë të vogël.

Unë jam goxha e vjetër, për të ta dhuruar.

“Mbështille mirë dhe taposja gojën, përndryshe, do të bërtasë me piskamë, e vogla vërtetësi.”

“Jepma, o grua plakë, të vërtetën tënde të vogël!” - ulërita. E kështu shtoi gruaja plakë: “Ti po shkon te gratë? Mos harro kamxhikun!”.

Kështu foli Zarathustra.

Për kafshimin e nepërkës

Një ditë Zarathustra po flinte nën një pemë fiku; bënte vapë e duart i kish të palosura mbi fytyrë. Kaloj një nepërkë dhe e kafshoi në qafë, aq sa Zarathustra briti nga dhimbja. Pasi hoqi duart nga fytyra, pa reptilin. Por, sapo njohu sytë e Zarathustrës, ai u përdrodh i ngathtësuar e donte të merrte arratinë.

“Jo, - tha Zarathustra, - nuk të kam falënderuar ende. Ti më zgjove në kohë, rruga ime është akoma e gjatë.”

“Rruga jote tash është e shkurtër, - i tha me të keq nepërka. - Helmi im vret!”

Zarathustra buzëqeshi. Kur vallë një dragua ngordhi nga helmi i një reptili? Tha: “Merre, pra, helmin tënd! Ti nuk je kaq e pasur sa të ma dhurosh!”. Atëherë, nepërka iu vërsul sërish mbi qafë dhe i lëpiu plagën.

Kur Zarathustra ua tregoi njëherë këtë gjë dishepujve të vet, ata e pyetën: “Cili është vallë, o Zarathustra, morali i një rrëfimi të tillë?”

Zarathustra u përgjigj kështu: “Të mirët dhe të drejtët më quajnë shkatërruesi i moralit: doktrina ime është imorale. Ndaj, nëse keni një armik, mos ia merrni të mirën për të keqe. Kjo do ta turpëronte!”

Përkundrazi, dëshmojini se ju ka bërë diçka të mirë. Grinduni më mirë me dikë se sa ta turpëroni! Nëse dikush ju shan e ju mallkon, mua nuk më pëlqen aspak që ju doni ta bekoni. Shajeni e mallkojeni nga pak edhe ju!

Nëse ju kanë bërë një padrejtësi të madhe, shpërblejani menjëherë me pesë të vogla! Është i tmerrshëm spektakli i atij që, krejt i vetëm shtypet nga padrejtësia.

A e dinit tashmë gjithë këtë? Një padrejtësi e ndarë është si një gjysmë drejtësi. Le ta marrë mbi vete padrejtësinë ai që mund ta durojë!

Një hakmarrje e vogël është më e durueshme se asnjë hakmarrje. Nëse ndëshkimi nuk është një nder dhe një e drejtë për ligjshkelësin, unë nuk di se çfarë të bëj me ndëshkimet tuaja.

Është më fisnike ta gjesh veten në gabim sesa në të drejtë, veçanërisht kur ke të drejtë. Megjithatë, për ta bërë këtë gjë, duhet të jesh i pasur.

Unë nuk e dua drejtësinë tuaj të akullt; pas syve të gjykatësve tuaj unë tejshoh gjithmonë xhelatin dhe satërin e tij të ftohtë.

Thomëni, ku gjendet drejtësia, që është dashuri me sy hapur? Shpikmëni, pra, dashurinë që duron jo vetëm çdo dënim, por edhe çdo faj!

Shpikmëni, pra, drejtësinë që shfajëson të gjithë, përveç gjykatësit!

A doni ta dëgjoni edhe këtë? Tek ai që do të jetë i drejtë deri në thellësi të vet, edhe gënjeshtër bëhet simpati kundrejt njerëzve.

Po si mundem unë të jem i drejtë deri në thellësi?

Si mund t'ia jap hakun secilit? Më mjafton kjo: unë i jap çdokujt hisen time.

Së fundi, o vëllezër, kujdesuni që të mos u bini në qafë eremitëve. Si mund të harrojë vallë një eremit? Si mundet vallë të ta shpërblejë ai po njëlloj?

Një eremit është si një pus i thellë. Është e lehtë t'i hedhësh brenda një gur, por kur ai arrin fundin, thomëni, kush mund ta nxjerrë jashtë?

Ruajuni nga sharja e një eremiti! Por, nëse e bëni, atëherë kini kurajën edhe ta vrisni !”

Kështu foli Zarathustra.

Për fëmijët dhe martesën

“Kam një pyetje të ruajtur veç për ty, o vëlla; si një thellësi matës, unë po e lëshoj këtë pyetje në shpirtin tënd, për të kuptuar se sa i thellë është.

Ti je i ri e dëshiron fëmijë dhe martesë. Mirëpo unë po të pyes: a je vallë një njeri që ka të drejtën të dëshirosh një fëmijë?

"A je ti fitimtari, kapërcyesi i vetvetes, sunduesi i ndjenjave, zotëria i virtyteve të tua? Ja, këtë po të pyes.

Apo mos vallë në dëshirimin tënd flet bisha dhe nevoja? Apo izolimi? Apo mos vallë papajtueshmëria me vetveten? Unë dua që fitorja dhe liria jote të kenë për qëllim një fëmijë. Ti duhet t'i ngresh monumente të gjallë fitores dhe çlirimit tënd.

Duhet të ndërtosh mbi vetveten. Por, së pari, duhet ta kesh ndërtuar veten që nga trupi deri në shpirt.

Ti nuk duhet vetëm të transplantohesh, por të transplantohesh për së larti! Për këtë gjë ndihmon kopshti i martesës.

Ti duhet të ndërtosh një trup superior, një lëvizje parësore, një rrotë që rrotullohet rreth vete; ti duhet të krijosh një krijues.

Martesë: kështu unë quaj dëshirimin e dy njerëzve, për të krijuar atë bashkim që është më i epërm se sa ata që e krijuan. Unë quaj martesë respektin reciprok të dy njerëzve që e dëshirojnë këtë vullnet. Ky qoftë kuptimi dhe realiteti i martesës tënde!

Po atë, që shumica e të tepërtve e quan martesë, medet, si mund ta quajnë?

Medet, meskinitet i dy shpirtave të çiftëzuar! Medet, fëlliqësia e shpirtave të çiftëzuar! Medet, qejfbërje e trishtë e dy qenieve!

Të gjitha këto i quajnë martesë; thonë se martesat e tyre lidhen në qiell.

Po mua nuk më intereson fare ky qiell i të tepërtve! Jo, asgjë s'më intereson për ato bisha të zëna në rrjetën e qiellit.

Mbettë larg meje edhe ai zot që avitet këmbëçalë për të bekuar atë që nuk ka bashkuar!

Mos qeshni me këto martesë! Cili fëmijë vallë nuk ka një motiv për të qarë për prindërit e vet.

Mua, për shembull një burrë m'u duk i denjë e i pjekur për kuptimin e tokës, por kur pashë gruan e tij, toka më ngjau me një shtëpi të çmendurish.

Po, do të doja që toka të tundej e tëra, kur një shenjt të lidhej me një patë.

Dikush u nis si një hero në kërkim të së vërtetës e, në fund solli vetëm një gënjeshtër të vogël e të mirë sajuar. Dhe këtë e quan martesën e tij.

Një tjetër ishte shpifarak në zgjedhje e në raport me të tjerët, por e rrënoi njëherë e përgjithmonë miqësinë e vet. E kjo ishte martesë e tij.

Një tjetër kërkonte një shërbëtores me virtytet e një engjëlli, por, papritmas u bë shërbëtor i një gruaje. Tani do të ishte më e nevojshme të gjente një mënyrë për t'u bërë engjell.

Unë i kam njohur blerësit gjithmonë si tipa të shkathët e që të gjithë me sy dinakë. Mirëpo, edhe më i zoti prej tyre gruan do ta blinte në thes.

Shumë marrëzira të vogla. Ja çfarë ju quani dashuri! Martesa u jep fund këtyre marrëzive të vogla, duke i transformuar në një budallallëk të gjatë.

Dashuria juaj për gruan dhe dashuria e gruas për burrin. Ah, sikur të kish dhembshuri ndaj vajtimtarëve dhe zotave të fshehur!

Kur zakonisht nuk bëhet fjalë, veçse për takimin e dy bishave.

Edhe dashuria juaj më e mirë s'është veçse një alegori entuziaste dhe një pasion i dhimbshëm. S'është vetëm një pishtar, që duhet t'ju ndriçojë kah rrugëve më të larta.

Një ditë ju duhet të dashuroni vetveten. Pra, është e nevojshme që, së pari, të mësoni të dashuroni. Ndaj, duhet të pini kupën e hidhur të dashurisë suaj.

Se hidhërimi është edhe në kupën e dashurisë më të mirë: kështu ajo bëhet gulçim kah Mbinjeriut; kështu ajo bëhet etja jote, o krijues.

Etje e krijuesit, shigjetë e gulçim kah Mbinjeriut. Fol, o vëlla, është ky vullneti yt për martesën?

Unë e besoj të shenjtë një vullnet të tillë, si dhe të shenjtë këtë lloj martesë."

Kështu foli Zarathustra.

Për vdekjen e lirë

“Shumë vdesin tepër vonë, ndërsa disa të tjerë tepër shpejt.” Ende kumbon i çuditshëm mësimi: “Vdis në momentin e duhur!”.

Vdis në momentin e duhur: kështu mëson Zarathustra. Sigurisht, ata që nuk jetuan në kohën e duhur, si mund të vdesin në çastin e duhur? Ah, të mos kishin lindur fare! Kështu i këshilloj të tepërtit.

Mirëpo, edhe këta të tepërt krekosen për vdekjen e tyre, ashtu siç kërkon të thyhet edhe lëvozhga boshe.

Të gjithë e marrin vdekjen seriozisht, mirëpo vdekja nuk është akoma festë. Njerëzit s’kanë mësuar akoma si kremtohen festat më të bukura. Unë po ju tregoj vdekjen që zgjidh dhe përmbush, që është stimul dhe një premtim solemn për gjithë të gjallët.

Vdes fitimtar ai që realizon vdekjen e tij të vërtetë, i rrethuar nga ata që shpresojnë dhe nga ata që betohen.

Duhet të mësohesh të vdesësh kështu. Nuk duhet të ketë festë aty ku, ai që vdes si i tillë të mos ketë shuguruar betimet e gjithë të gjallëve.

Të vdesësh kështu është mënyra më e mirë; e dyta, është të vdesësh në fushë të betejës e të bësh të shuhet një shpirt i madh.

E urryer, si për luftëtarin ashtu dhe për fituesin, është vdekja juaj e zgërdheshur, që avitet duke u zvarritur si një hajdute, për t’ia behur pastaj si një padrone. Unë lëvdoj edhe vdekjen time, vdekjen e lirë, që vjen kur dhe pse e dua unë.

Po kur vallë do ta dua? Kush ka një qëllim dhe një trashëgimtar e do vdekjen në momentin më të drejtë, për qëllimin dhe trashëgimtarin e tij.

Për respekt të këtij qëllimi dhe këtij trashëgimtari, ai nuk do të varë më kurora të vyshkura lulësh në faltoren e jetës.

Në të vërtetë, unë nuk dua t’u ngaj tërheqësve të litarit; ata e shtrëngojnë litarin për një kohë të gjatë, por, prapëseprapë, zmbropsen gjithmonë.

Disa bëhen shumë të vjetër për vetë të vërtetën dhe fitoret e tyre; një gojë pa dhëmbë nuk ka më të drejtën t'i zotërojë të gjitha të vërtetat.

Po kush do të fitojë famë duhet të tërhiqet dalëngadalë nga nderimet e të praktikojë një art më të vështirë: të ikë në momentin e duhur.

Duhet ta ndalësh të ngrënin, kur të shijon më shumë; këtë dinë ata që duan të dashurohen gjatë.

Sigurisht, ka edhe mollë të tharta, fati i të cilave është të presin deri në ditën e fundit të vjeshtës e të bëhen njëherësh të pjekura, të verdha e të fishkura.

Disave u plaket më parë zemra e të tjerëve shpirti. Disa të tjerë janë plakur që në rini, mirëpo ai që rinohet vonë mbetet gjatë i ri.

Jeta për ndonjë ka një fat të palumtur: një krimb helmues ia gërryen zemrën. Kështu, ai mund të shohë se sa më e lehtë është të vdesësh.

Dikush nuk bëhet kurrë i ëmbël; kalbet që gjatë verës. Është vetëm burracakëria që e mban të lidhur pas degës së vet.

Shumë njerëz jetojnë e shumë gjatë ata mbahen lidhur pas degës së vet. Arriftë një furtunë që t'i shkundë nga pema të gjithë frutat e kalbura e të gërryera nga krimbat!

Ardhshin, të paktën predikuesit e vdekjes së rrëmbimtë! Ata do të ishin për mua furtuna e vërtetë dhe shkundësit e pemëve të jetës. Por e keqja është se dëgjoj të predikohet vetëm vdekja e ngadaltë dhe durimi përkundrajt të gjitha gjërave "tokësore".

Medet, ju predikoni durimin ndaj të gjitha gjërave tokësore, por janë vetë gjërat tokësore që kanë shumë durim me ju, o njerëz të sakrilegjeve!

Shumë shpejt vdiq ai hebre që predikojnë predikuesit e vdekjes: shumë njerëzve u ishte fatale vdekja e tij shumë e shpejtë.

Njihite veç lotët dhe melankolinë e hebrenjve, bashkë me urrejtjen e të mirëve dhe të drejtëve hebreu Jezus, ndaj dhe iu vërsul dëshirimi i zjarrtë i vdekjes.

Sikur të kish ngelur në shkretëtirë e larg nga të mirët e të drejtët, ndoshta do të kish mësuar të jetonte, do të kish mësuar të dashuronte tokën, por edhe buzëqeshjen.

Besomëni, o vëllezër! Ai vdiq shumë shpejt, sepse ai vetë do t'i kish tërhequr mbrapsht mësimet e tij, po të kish mbërritur në moshën time. Ishte goxha fisnik për të pasur kurajën e tërheqjes.

Aq më tepër, që ish i papjekur. I riu dashuron në mënyrë të papjekur e po në mënyrë të papjekur urren njeriun dhe tokën. Të rënda e të lidhura janë ende në të shpirti dhe krahët e shpirtit.

Ndërkohë që njeriu i rritur është më foshnjarak se i riu dhe ka më pak melankoli, e kupton me mirë jetën dhe vdekjen.

Vdekja juaj mos qoftë kurrë mallkimi i njerëzve dhe i tokës, o vëllezër! Këtë kërkoj, duke u lutur për mjaltin e shpirtit tuaj.

Në zemrën tuaj u djegtë akoma shpirti dhe virtyti juaj, si një perëndim i kuq që zbret mbi tokë ose, përndryshe, vdekja juaj s'ka për t'u përmbushur. Kështu dua të vdes edhe unë, derisa ju, o miqtë e mi, për hir të dashurisë sime, të dashuroni më shumë tokën, se tokë dua të kthehem, për të gjetur paqe tek ajo që më lindi!

Në realitet, Zarathustra e pati një qëllim, që ish ai i lëshimit të mesazhit të tij, Ju, o miq, jeni trashëgimtarët e qëllimit tim! Te ju unë po e lëshoj këtë mesazh të praruar.

S'kam gjë më të shtrenjtë, o miq, se sa t'ju shoh të lëshoni edhe ju mesazhin e praruar! Atëherë po qëndroj ende edhe pak kohë në tokë. Më falni!"

Kështu foli Zarathustra.

Për virtytin e dhurimit

1.

Kur Zarathustra u largua nga qyteti, aq shumë i shtrenjtë për të, një qytet me emrin "lopa laroshe", nisi të ndiqej e të përcillej nga shumë njerëz që e quanin veten dishepuj të tij.

Të gjithë se bashku arritën kështu në një udhëkryq; aty Zarathustra u tha se tashmë donte të shkonte vetëm, sepse ish mik i udhëtimeve vetmitare. Mirëpo, dishepujt e vet i ofruan përgjatë ndarjes një bastun, në dorezën e artë të të cilit figurohej një gjarpër i përdredhur përreth diellit. Zarathustra u gëzua, madje u mbështet mbi bastun; pastaj u foli kështu dishepujve të tij:

“Pa më thoni, si ia mbërriti ari të jetë vlera e epërme e çdo gjëje? Sepse është i jashtëzakonshëm, i padobishëm dhe i butë në shkëlqimin e tij e gjithnjë dhurohet.

Vetëm si simbol i këtij virtyti të epërm, ai arriti në vlerën e tij të epërme.

Si i praruar shkëlqen vështrimi i dhuruesit. Shkëlqimi i arit lidh miqësi mes hënës dhe diellit.

Virtyti i epërm është i jashtëzakonshëm, i padobishëm, i shndritshëm e i lartë në shndritjen e vet. Një virtyt që dhurohet pa u kursyer është virtyti më i epërm.

Në të vërtetë, unë ju kuptoj mirë, o dishepuj të mi. Ju synoni, ashtu si unë, virtytin e dhurimit. Ç’gjë vallë do të kishit të përbashkët me macet dhe ujqërit?

Kjo është etja juaj: të bëheni ju vetë dhurata dhe viktima. Ja pse keni etje të grumbulloni çdo pasuri në shpirtin tuaj.

Shpirti juaj i panginjur synon thesaret e xhevahiret, sepse virtyti juaj nuk nginjet kurrë nga dëshira e të dhuararit.

I detyroni të gjitha gjërat të vijnë kah jush dhe te ju, që ato të vërshojnë nga burimi juaj, si dhurata të zemrës suaj.

Në të vërtetë, kjo dashuri dhuruese duhet të shndërrohet në grabitësen e të gjitha vlerave. Por unë këtë e quaj egoizëm të shenjtë e të pamohueshëm.

Kaedhe një egoizëm tjetër, të mizershëm, të uritur, që do gjithmonë të grabisë: egoizmi i të sëmurit dhe i të dëgjuarit për vdekje.

Në syrin e hajdutit sheh gjithçka që shkëlqen; me lakminë e urisë mat me sy atë që ka për të ngrënë me bollëk; e zvarritet gjithmonë rreth tavolinës së dhuruesit.

Një sëmundje, një patretshmëri ushqimi fshihet pas kësaj lakmie; nuk është veçse shprehje e një trupi të sëmurë lakmia tinëzare e këtij egoizmi.

Thomëni, pra vëllezër, ç'gjë është më e keqja për ne? S'është degjenerimi? Se gjithmonë ndeshemi në fund me një degjenerim, të cilit i mungon shpirti i dhurimit.

Rruga jonë shkon për së larti, nga specia te superspecia. Por na kall tmerr kuptimi degjenerues që thotë "gjithçka për mua".

Kuptimi ynë fluturon për së larti, kështu ai bëhet simbol i trupit tonë, simbol i një lartësimi. Të tilla simbole lartësimi janë emrat e virtyteve.

Kështu kalon trupi nëpërmes historisë, duke u shndërruar e duke u bërë luftarak. Po shpirti, ç'është vallë për të? Është stema e luftërave dhe fitoreve të tij, një mik dhe një jehonë.

Simbole janë edhe të gjitha emrat e së mirës dhe së keqes; ata nuk flasin, vetëm bëjnë shenja. Budalla qoftë ai që do të zbulojë llojin e dijes së tyre. Kujdes, o vëllezër, sa herë që shpirti juaj do të flasë me simbole, në të gjendet origjina e virtytit tuaj.

Atëherë trupi ynë ndihet i lehtësuar e si i ringjallur; me gëzimin e tij të madh vital, ai entuziazmon shpirtin për t'u shndërruar në krijues, vlerësues, dashurues dhe mirëbërës i të gjitha gjërave.

Kur zemra drithërohet, valëzohet fort e fryhet si një lumë, një bekim dhe një kanosje për atë që rron ndanë brigjeve të tij; aty është origjina e virtytit tuaj.

Kur ndiheni superiorë mbi lëvdimin dhe ankimet, vullneti juaj do të diktohet mbi çdo gjë, si vullneti i të dashuruarit: aty është origjina e virtytit tuaj.

Kur përçmoni zbavitjet dhe shtratin e ngrohtë e kur nuk ju duket të shtrihen kurrë aq larg nga të zhburrëruarit, aty është origjina e virtytit tuaj.

Kur vullneti juaj është një vullnet i vetëm dhe ky ndryshim i çdo dënimi dhe nevoje merr emrin e domosdoshmërisë, aty është origjina e virtytit tuaj.

Në realitet, ajo është një e mirë dhe një e keqe e re. Është vërtetë një rrëqethje e re dhe e thellë, është zëri i një burimi të ri.

Fuqi është ky virtyti i ri; është një mendim gjithëkundues i qarkuar nga një shpirt i mençur, një diell i praruar e përreth tij gjarpri i njohjes.”

2.

Këtu, Zarathustra heshti pak e i pa me dashuri dishepujt e vet. Pastaj vazhdoi, duke thënë kështu; edhe zëri i tij ndryshoi:

“Qëndroni besnik tokës, o vëllezër, me forcën e virtytit tuaj! Dashuria dhuruese dhe njohja juaj le ta zbulojmë kuptimin e tokës! Kështu unë ju lutem e ju përgjërohem.

Bëni që ata të mos dëshirojnë të ikin tej gjërave tokësore, për t'i përplasur krahët kundër mureve të së përjetshmes!

Medet, sa shumë virtyt fluturoi drejt tyre, duke u shprishur!

Risilleni në tokë virtytin e fluturuar jashtë saj, siç bëra unë. Po, risilleni mbrapsht te trupi dhe te jeta! Jepini kështu tokës kuptimin e vet, kuptimin njerëzor!

Në njëqind mënyra janë davaritur deri më sot shpirti dhe virtyti.

Medet, në trupin tonë strehohet akoma ajo marrëzi dhe ai gabim: janë bërë ata vetë trup dhe vullnet.

Në njëqind mënyra deri më sot, si shpirti ashtu dhe virtyti u orvatën dhe humbën. Po, njeriu ka qenë gjithmonë një orvatje. Medet, sa padituri e sa shumë gabime u bënë trupi ynë!

Jo vetëm arsyeja e mijëvjeçarëve, por edhe marrëzitë e tyre, vërshuan sipër nesh duke na shtypur. Është e rrezikshme të jesh trashëgimtar.

Akoma dhe sot ne luftojmë me gjigantin që quhet Rast. Rëndon aq shumë mbi gjithë njerëzimin deri më sot Irracionalja, pakuptimi.

Shpirti dhe virtyti juaj u shërbefshin kuptimit të tokës, o vëllezër, dhe vlera e të gjitha gjërave qoftë sërish e përcaktuar nga ju! Ja përse duhet të jeni luftëtarë! Ja përse duhet të jeni krijues!

Dija e pastron trupin; me kërkimin e dijes çohesh lart; atij që di i shenjtërohet çdo instinkt; edhe shpirti i të lartësuarit bëhet i qetë e i gëzuar.

Mjek, shëro vetveten! Kështu do të shërosh edhe të sëmurin tënd. Do të jetë kura më me mirë të shohësh me sytë e tu atë që diti të shëroje vetveten.

Ka me mijëra shtigje që nuk janë shkelur ende, mijëra rrugë shpëtimi dhe toka të premtuara jetësh të fshehura. Njeriu dhe toka njerëzore janë gjithmonë të pashterueshëm e gati për t'u zbuluar.

Vigjiloni e dëgjoni, o vetmitarë! Nga e ardhmja mbërrijnë erëra me një rrahje misterioze krahësh e për veshët e mprehtë po arrin një lajm i mirë.

Ju vetmitarët e sotëm, ju të shkëputurit nga jeta, një ditë do të bëheni një popull. Nga ju, që dini ta lartoni vetveten, do të lindë një popull i zgjedhur e prej tij Mbinjeriu. Se, në të vërtetë, toka duhet të bëhet akoma një vend shërimi. Një aromë e re po e qarkon, një paralajmërim shpëtimi dhe një shpresë e re!”

3.

Kur tha këto fjalë, Zarathustra heshti, si një njeri që nuk e ka thënë ende fjalën e fundit; e lëkundti gjatë dhe në mënyrë të pasigurt bastunin në dorën e tij. E në fund foli kështu; më një zë që tashmë e kish ndryshuar.

“Tani, unë po shkoj i vetëm, o dishepuj! Edhe ju do të shkoni të vetëm! Ja, kështu dua!

Në të vërtetë, po ju këshilloj: ikni sa më larg prej meje e ruhuni nga Zarathustra! Ose, më mirë akoma, turpërohuni për të! Ndoshta ai ju ka gënjyer.

Njeriu i dijes duhet jo vetëm t'i dashurojë armiqtë e tij, por edhe t'i urrejë ata.

Shpërblehet keq një mësues, nëse mbetesh gjithmonë vetëm nxënës. Pse vallë nuk doni t'i krasisni gjethet e kurorës sime?

Ju më nderoni dhe respektoni, por ç'do të ndodhte, nëse ky nderimi juaj do të shembej? Kujdes, se mos ju shtyp kjo statujë! Ju thoni që besoni te Zarathustra? Po ç'ju intereson vallë Zarathustra? Ju jeni të besuarit e mi, po ç'më duhen gjithë këta besimtarë?

Ju nuk e keni gjetur ende vetveten; kur ja tek më gjetët mua. Kështu bëjnë të gjithë besimtarët, prandaj çdo besim është kaq pak i rëndësishëm.

Tani po ju urdhëroj të më harroni mua e të gjeni vetveten, pasi vetëm kur të më keni mohuar do të kthehem te ju.

Se vërtet, me të tjerë sy, o vëllezër, unë do t'i kërkoj të humburit e mi; me tjetër dashuri unë atëherë do t'ju dua.

Paskëtaj, do të bëheni miqtë e mi dhe bijtë e një shprese. Atëherë, për të tretën herë, unë do të jem me ju, për të festuar së bashku mesditën e madhe.

Do të jetë në mesditën e madhe, kur njeriu do të gjendet në mes të rrugës, midis bishës dhe Mbinjeriut, që do të kremtojë udhëtimin e vet drejt mbrëmjes, si shpresa e epërme. Kjo, në fakt, është udha për një agim të ri.

Atëherë perënduesi do të bekojë vetveten, sepse ai është personi që kalon përtej. Kështu dielli i dijes së tij do të arrijë të jetë në Zenit.

Te gjithë zotat kanë vdekur: tani duam të rrojë Mbinjeriu; kjo qoftë në mesditën e madhe dëshira jonë e mbrame.”

Kështu foli Zarathustra.

PJESA E DYTE

*“... pasi vetëm kur të më keni mohuar
do të kthehem te ju. Se vërtet, me të tjerë sy,
o vëllezër, unë do t’i kërkoj të humburit e mi.
Me tjetër dashuri unë atëherë do t’ju dua.”*

“PËR VIRTYTIN E DHURIMIT”

Djali me pasqyrë

Pas gjithë kësaj, Zarathustra u kthye në mal dhe, në vetminë e shpellës së tij, u tërhoq nga njerëzit, duke pritur si ai mbjellësi që tashmë e kish hedhur farën e tij. Mirëpo, shpirtin e kish plot padurim dhe dëshirë për ata që dashuronte, se kish akoma shumë për t'u dhënë. Kjo është në të vërtetë gjëja më e guximshme: për dashurinë të mbyllësh dorën e hapur e të kesh turp të dhurosh.

Kaluan, kështu, për vetmitarin, muaj e vite, mirëpo mençuria e tij rritej dhe bollëku i saj e bënte të trishtë.

Veçse një mëngjes ai u zgjua që pa gdhirë, meditoi gjatë, ashtu i shtrirë në shtrojën e vet, e së fundi i foli zemrës:

“Ç'më trembi vallë në gjumë, që u zgjova kaq befas? A s'erdhi vallë drejt meje një fëmijë që më solli një pasqyrë?”

“O Zarathustra! - më tha fëmija, - pa shikohu në pasqyrë!”

Teksa e pashë veten në fytyrë, lëshova një piskamë, e zemra ime u emocionua. Nuk qe vetvetja ajo që po shihja, por ngërdheshja e nënqeshja e një demoni.

E kuptoj, vërtet, domethënien dhe paralajmërimin ndëshkues të ëndrrës: mësimi im është në rrezik, bari i keq pretendon të quhet grurë. Armiqtë e mi janë bërë të fuqishëm e kanë përkëmbyer imazhin e mësimit tim, kështu që të përzgjedhurit e mi duhet të turpërohen për dhuratat që u dhashë.

Kam humbur miqtë e mi; ka mbërritur ora të kërkoj të humburit e mi.

Pasi tha këto fjalë, Zarathustra brofi përpjetë, jo si një i ankthshëm që kërkon ajër, por si një profet dhe këngëtar që është mbërthyer nga shpirti. Shqiponja dhe gjarpri i tij e vështruan të

mrekulluar. Përderisa, si një aurorë, një lumturi e sapobehur iu shpërhap në fytyrë.

“Ç’më ndodhi vallë, o kafshët e mia? - tha Zarathustra. - Nuk kam ndryshuar vallë? Ndoshta bekimi s’ka mbërritur ende tek unë si, një erë e furishme? Lumturia ime është budallaqe e do të thotë absurditete: ajo është shumë e re, kini durim me të!

Unë jam plaguar nga lumturia ime: gjithë vuajtësit qofshin mjekët e mi!

Unë mund të rizbres te miqtë, por edhe tek armiqtë.

Zarathustra mund të flasë e të dhurojë përsëri, t’ju bëjë mirë të përzgjedhurve të tij.

Dashuria ime e paduruar rrjedh me rrëke drejt lindjes dhe perëndimit. Prej maleve heshtjeshumë e prej stuhive të dhimbjes shpirti im zhaurin lugoreve.

Goxha gjatë unë lëngova e vështrova në largësi, goxha gjatë qeshë pre e vetmisë; kështu harrova të hesht.

Jam bërë i gjithi gojë, shkumëzim i një përroi teposhtë shkëmbinjtë të lartë. Unë dua që fjala ime të zbresë e të qëndrojë luginave.

Edhe rrëkeja ime e furishme e dashurisë le të zbresë e të qëndrojë nëpër vende të paarritshme. Si mundet vallë një rrëke të mos e gjejë më në fund rrugën për në det?

Sigurisht që gjendet brenda meje një liqen vetmitar, i kënaqur me veten. Mirëpo, rrëkeja ime e furishme e dashurisë do ta shpjerë edhe atë në det.

Unë do të shkoj nëpër udhë të reja, një fjalë e re gjendet tek unë; i lodhur jam, si gjithë krijuesit, prej gjuhëve antike. Shpirti im nuk do të ecë më shtigjeve të shkelura.

Çdo fjalë më duket shumë e ngadaltë: në qerren tënde unë brof, o stuhi! Dua të të fshikulloj edhe ty me ligësinë time.

Dua të kaloj mbi detet e largëta, si një britmë ngazëllimi, derisa të mbërrij në ishujt e bekuar, aty ku jetojnë miqtë e mi.

Mes tyre, edhe armiqtë e mi. Oh, sa fort i dua ata, me të cilët mund të flas! Edhe armiqtë i përkasin lumturisë sime.

Kur dua të shaloj mbi kalin tim më të tërbuar, atëherë më nevojitet më shumë se kurrë heshta ime. Ajo është një shërbëtore gjithmonë e gatshme për këmbën time.

Heshta, që unë vërvit ndaj armiqve. Sa i falënderoj ata armiq që, më në fund mund t'ua vërvit heshtën time!

Shumë e madhe ishte rëndesa e resë sime: unë një breshër dua të lëshoj gjer në thellësi, mes të qeshurave të vetëtimave.

Vrullshëm do të gufohet atëherë gjoksi im, i vrullshëm do të fryjë nëpër male stuhia e tij; kështu do të nisë të lehtësohet.

Në të vërtetë, gëzimi dhe liria ime arrijnë si një stuhi. Mirëpo, armiqtë duhet të besojnë që ligësia shpërthen furishëm mbi kryet e tyre.

Po, edhe ju do të frikësoheni, o miqtë e mi, nga mençuria ime e egër. Ndoshta edhe ju do të merrni arratinë bashkë me armiqtë.

Oh, sikur me fyejt e barinjve t'ju grishja të ktheheshit mbrapsht!

Oh, sikur të mësonte të ulërinte me delikatesë luanesha e mençurisë sime! Të dy bashkë kemi mësuar shumë gjëra. Mençuria ime e egër është mbarsur maleve vetmitare.

Gurëve të ashpër ajo lindi vogëlushin e saj, vogëlushin e saj të fundit.

Tashmë, e marrosur, vrapon shkretëtirës së rreshkët, duke kërkuar e kërkuar një lëndinë të qetë. Oh, mençuria ime e vjetër dhe e egër!

Në lëndinën e butë e të qetë të zemrës suaj, o miqtë e mi, në dashurinë tuaj, ajo do të donte të prehet i përzgjedhuri i vet!"

Kështu foli Zarathustra.

Në ishujt e bekuar

"Fiqtë që bien nga pema janë të ëmbël e të shijshëm, por, teksa bien, u çahet ajo lëkura e tyre e trëndafiltë. Unë, një erë e Veriut jam për fiqtë e pjekur.

Kështu, njësoj si fiqtë bien mbi ju këto mësimë, o miqtë e mi. Andaj, piheni lëngun dhe hajeni tulin e tyre të ëmbël! Përreth është vjeshtë e qielli mbrëmjeve është i pastër.

Shikoni se ç'plotësi ka qark jush! Mes këtij bollëku është aq bukur të shohësh kah deteve të largët.

Një kohë thuhej Zot, kur shihej kah një deti të madh, po tash unë ju mësova të thoni Mbinjeri.

Zoti është një supozim, por unë dua që supozimi juaj të mos shtrihet më larg se vullneti juaj krijues.

A mundeni vallë të krijoni një zot? Atëherë, mos më flisni për asnjë zot, ndërkohë që Mbinjeriun ju mund ta krijoni.

Ndoshta jo pikërisht ju, o vëllezër! Por mund të transformoheni në etërit dhe stërgjyshërit e Mbinjeriut. Ja, ky do të jetë krijimi juaj më i mirë!

Zoti është një supozim, por unë dua që supozimi juaj të mbetet në caqet e aftësisë së mendimit.

A mundeni vallë ta mendoni një zot? Se kjo nënkupton pikërisht vullnetin për të vërtetën, për atë përkëmbim të çdo gjëje në diçka njerëzisht të mendueshme, njerëzisht të ndjeshme. Ju duhet t'i mendoni deri në fund ndjenjat tuaja.

Atë që ju e quani botë, më parë duhet ta krijoni; ajo bëhet për ju arsyeja, imazhi, vullneti, dashuria. Realisht, lumturia juaj, o kërkimtarë të dijes!

Po si mund ta toleroni jetën pa këtë shpresë, o kërkimtarë?!¹⁰ Nuk mund të rrënjoseni as tek e pakuptueshmja as tek e paarsyeshmja.

Ndaj, unë dua t'ju njoh me gjithë zemrën time, o miq. Nëse do të ekzistonin zotat, si mund të duroja vallë pa qenë një zot?! Kësisoj, zotat nuk ekzistojnë.

Nxora një përfundim: tash është ai që po më tërheq pas vetes.

Zoti është një supozim; po kush mund ta duronte vallë gjithë tmerrin e këtij supozimi, pa vdekur? Mos duhet t'ia heqim vallë krijuesit besimin e tij dhe shqiponjës çlirimin nëpër hapësira të denja për shqiponjat?

Zoti është një mendim që e bën të shtrembër çdo të drejtë e që lëviz gjithçka që është e fiksuar. Po si? Mos koha duhet të ndalet e gjithçka jetëshkurtër të jetë një gënjeshtër?

Një mendim i tillë është vorbull e marramendje për kockat njerëzore, madje dhe volitje. Në të vërtetë, këtë supozim unë e quaj sëmundja e marramendjes.

Për mua është i keq dhe çnjerëzor ky mësim i Njëshit të mjaftueshëm, të palëvizshëm, të nginjur e të pandryshueshëm në amshim.

Gjithçka e pandryshueshme s'është veçse një simbol. [Aluzion ndaj vargjeve finale të "Faustit" të Gëtes: "Ales Vergängliche ist nur ein Gleichnis". (Gjithçka jetëshkurtër s'është veçse simbol)].

Poetët gënejnë shumë! Simbolet më të mira duhet të evokojnë kohën dhe Bërgen; duhet të jenë një lavd dhe një justifikim i të gjitha gjërave kalimtare.

Të krijosh: ky është çlirimi i madh nga dhimbja që e bën të shpenguar jetën. Por, që të ekzistojë krijuesi, janë të nevojshme shumë dhimbje dhe metamorfoza.

Shumë vdekje të hidhura duhet të ketë në jetën tuaj, o krijues! Qofshi kështu mbrojtësit dhe justifikuesit e të gjitha gjërave kalimtare!

Nëse krijuesi do të jetë edhe një vogëlush i porsalindur, ai duhet të jetë njëherësh i lindur dhe vuajtës i dhimbjeve të lindjes.

Në të vërtetë, unë e zgjodha rrugën time përmes njëqind shpirtrash e përmes njëqind djepesh e dhimbjesh të lindjes. Më shumë se sa një ndarje kam përjetuar; i njoha orët supreme që thyejnë një zemër.

Mirëpo, kështu duhej të jetë vullneti im krijues, fati im. Ose, për t'ju folur më qartë, është pikërisht ky fat ai që do vullnetin tim. Të gjitha ndjenjat e mia vuajnë tek unë e janë si në një burg. Mirëpo, është vullneti im ai që më mbërrin gjithmonë si çlirues e si gëzimsjellës.

Dëshirimi i lirë: ky është mësimi i vërtetë mbi vullnetin dhe lirinë. Kështu ju mëson Zarathustra.

Jo-më-dëshirim, jo-më-vlerësim dhe jo-më-krijim! Oh, qëndroftë larg meje gjithë kjo lodhje e mundim!

Edhe te njohja unë nuk paralajmëroj në vullnetin tim, veçse gëzimin e të krijuarit dhe të të bërit. Nëse në hijen time ka pafajësi, ndodh kështu, sepse në të ka vullnet për të ndryshuar.

Ky vullnet më largoi nga Zoti dhe nga zotat. Po ç'gjë vallë do të kish për të krijuar, nëse do të kishin ekzistuar zotat.

Në të kundërt, ky vullneti im i zjarrtë për të krijuar më shtyn gjithmonë e sërish kah njerëzve; ashtu siç shkon çekiçi gjithmonë kah gurit.

Medet, o njerëz, një imazh për mua fle i mbyllur në gur, imazhi i imazheve të mia! Medet, fati e thotë se ai duhet të flejë në gurin më të ashpër e më të pagdhendur!

Tash, çekiçi im do të tërbohet tmerrshëm kundër burgosjes së vet. Nga guri fluturojnë copëra e cifla; po mua kjo s'më duhet hiç?

Unë dua të mbaroj, sepse një hije erdhi tek unë; erdhi një ditë tek unë më e heshtura dhe më e lehta e të gjitha gjërave.

Bukuria e Mbinjeriut erdhi tek unë si një hije. Medet, o vëllezër! Mos më intereson ajo tash dhe më shumë se zotat?"

Kështu foli Zarathustra.

Për të mëshirshmit

"O miq, një ligjërim përqeshës i mbërriti mikut tuaj: Pa shikoni pak, Zarathustrën! Nuk ecën ai mes nesh sikur të ecte mes bishash?"

Ndërkohë që është më mirë të thuhet kështu: "I mençuri ecën mes njerëzve, si mes bishave".

Vetë njeriu është quajtur nga i mençuri "bisha me mollëza të kuqe".

Po si i ndodhi kjo gjë? Mos vallë, pse atij shumë shpesh iu desh të turpërohej?

O miqtë e mi! I mençuri flet kështu: turp, turp, turp! Kjo është historia e njeriut.

Prandaj, fisniku i dikton vetes mosposhtërimin; i dikton vetes turpin përpara gjithë vuajtësve.

Në të vërtetë, mua nuk më pëlqejnë mëshirëmëdhenjtë, që janë të bekuar nga mëshira e tyre: u mungon shumë turpi.

Unë duhet të jem i mëshirshëm, por nuk dua të quhem i tillë. Nëse jam, më mirë atëherë të shfaqem për së largu.

E fsheh kokën me dëshirë e marr arratinë, përpara se të më njohin, por ju urdhëroj edhe juve të bëni kështu, o miqtë e mi!

Qoftë fati im i tillë, që të udhëheqë në rrugën time gjithmonë persona pa dhimbje, të ngjashëm me ju dhe ata, me të cilët unë mund të kem të përbashkët shpresën, bukën dhe mjaltin.

Në të vërtetë, kam bërë gjithçka për vuajtësit, por mendoj se kam bërë gjithmonë më të mirën, kur mësova ta shijoj më mirë vetveten.

Që kur ekzistojnë njerëzit, njeriu e ka shijuar shumë pak veten. Ja, o vëllezër, ky është mëkati ynë origjinal!

E kur të mësohemi ta shijojmë veten më mirë, atëherë do të çmësohemi më mirë se kurrë ndonjëherë të mos u bëjmë keq të tjerëve e të mos sajojmë gjëra të këqija.

Ndaj unë po i laj duart, që ndihmova vuajtësit; ndaj unë po pastroj edhe shpirtin.

Kësisoj, kur shoh vuajtësin të lëngojë, turpërohem për turpin e tij se, kur e ndihmova, padyshim që e fyeva krenarinë e tij.

Mirësjelljet e mëdha nuk frymëzojnë mirënjohjen, por dëshirimin e zjarrtë të hakmarrjes; mirëbërjet e vogla, nëse nuk harrohen, bëhen krimba brejtës.

“Qofshi ngurrues në praninë! Kështu e tregoni qartë se pranoni!” Kështu i këshilloj ata që nuk kanë asgjë për të dhuruar se, ndryshe nga ata, unë jam një dhurues: e dhuroj me dëshirë, si një mik miqve të vet. Të huajt dhe të varfrit mund ta këpusin

vetë frutën e pemës sime, kështu që do të turpërohen më pak.

Paskëtaj, duhet t'i ndalohen gjithë lypësit. Të acaron t'u japësh, të acaron dhe të mos u japësh.

E njëjta gjë vlen edhe për mëkatarët dhe shpirtrat e ligj. Besomëni, o miq, sëmbimet e ndërgjegjes të edukojnë të kafshosh.

Por gjëja më e rëndë janë mendimet e vogla. Më mirë të veprosh keq sesa të mendosh për gjëra të vogla.

Kur, në të vërtetë, ju thoni: "Gëzimi i disa ligësive të vockla na kursen nga shumë veprime të këqija"? Mirëpo, shikoni se nuk duhet të kërkon kurrë të kurseheni.

Veprimi i keq është si një ulcerë: pickon, gërryen e shpërthen; manifestohet ndershmërisht. "Shihmëni, unë jam një sëmundje!" Kështu thotë veprimi i keq; kjo është ndershmëria e tij.

Ndërkohë që mendimi i vogël është si një kërpudhë; degëzon e sheshohet e nuk do të jetë në asnjë vend derisa i gjithë trupi t'i kalbet e t'i mbartet me kërpudha të vogla.

Ndërsa atij, që është pllakosur nga demoni, po i them këtë fjalë në vesh: "Do të ishte më mirë ta edukoje demonin tënd të madh! Ka edhe për ty një rrugë shpëtimi!".

Medet, o vëllezër! Flitet shumë për secilin prej jush! Më shumë se një bëhet për ne i nëpërdukshëm. Pikërisht për këtë gjë ne nuk mund të depërtojmë dot në të.

Është e rrezikshme, kërkon guxim të jetosh me njerëzit, sepse do aq guxim të heshtësh.

E jo kundra atij që na përbuz ne jemi më të padrejtë, por ndaj atij për të cilin s'na intereson asgjë.

Ndaj, nëse ke një mik që lëngon, bëhu vendi i prehjes dhe pushimit të vuajtjeve të tij. Në të njëjtën kohë, një shtrat i fortë, një shtrat i paretshëm fushimi, se kështu do ta ndihmosh atë në mënyrën më të mirë. E nëse një mik të bën keq, foli kështu: "Unë po ta fal këtë që më bëre, por atë që i bëre vetes, si mund të ta fal?".

Kështu flet çdo dashuri e madhe: tejkalon edhe faljen e mëshirimin.

Duhet ta mbash gjithnjë afër zemrën; nëse të ikën, duhet ta ndjekë menjëherë mendja!

Medet, kush vallë në botë bëri marrëzira më të mëdha se sa ato të mëshirimit? E ç'gjë në botë solli më shumë dëm sesa marrëzitë e mëshirimit?

Mjerë të dashuruarit që nuk kanë një majë, që të ngrihet mbi mëshirimin e tyre!

Kështu më tha një ditë djalli: “Edhe Zoti e ka ferrin e tij, domethënë dashurinë e vet për njerëzit”.

E kam dëgjuar rishtazi shqiptimin e këtyre fjalëve: “Zoti vdiq; e vrau mëshirimi i tij për njerëzit”.

Ruhuni, pra, nga mëshirimi! Prej saj zbret mbi njerëzit një re e zezë dhe e rëndë! Kujdes, se unë i kuptoj shenjat paralajmëruese të furtunës! Po kujtomani këtë fjalë: çdo dashuri e madhe është gjithnjë më e epërme se mishërimi i vet, sepse ajo, në të kundërt, do ta krijojë të përzgjedhurin e vet. Zemrës sime unë i sakrifikoj vetveten, e ashtu si unë edhe i afërmi im. Kështu shkon historia për gjithë krijuesit.

Por të gjithë krijuesit janë të fortë.”

Kështu foli Zarathustra.

Për priftërinjtë

Një herë, Zarathustra u tregoi dishepujve të vet një shenjë, duke u thënë këto fjalë: “Këtu janë priftërinjtë por, edhe pse ata janë miqtë e mi, ju afrojuni në heshtje e me shpatën në mhill”.

Edhe mes tyre ka heronj: plot nga ata kanë vuajtur shumë; ndaj duan t'i bëjnë të vuajnë edhe të tjerët.

Janë armiq të këqij: asgjë s'është më hakmarrëse se sa thjeshtësia e tyre e molepset lehtësisht kushdo që i prek.

Aq më tepër, që unë jam në lidhje gjaku me ta. E dua ta shoh të nderuar këtë lidhje gjaku.”.

Por edhe pse ata u larguan, Zarathustra u përfshi i tëri nga dhimbja, por nuk kaloi shumë kohë derisa ai nisi të flasë: “Më dhimbsen, këta priftërinj. Nuk më pëlqejnë hiç, por kjo s’ka rëndësi, përderisa gjenden në mes të njerëzve. Aq më tepër, që unë kam vuajtur e vuaj me ta. Për mua ata janë të burgosur e të shënuar. Ai që e quajnë Shpëtimtari, ka ngucur në zinxhirë.

I ka zinxhirëzuar në vlera të gënjeshtërtë e në fjalë të marrëzishme. Medet, sikur dikush t’i shpëtonte nga shpëtimtari tyre!

Besuan të qenë zbarkuar në një ishull, kur i përplasi stuhia e detit; një det që ish një përbindësh i fjetur.

Vlera të gënjeshtërtë dhe fjalë të marrëzishme: këta janë përbindëshat më të këqij për mortorët; fati në ta fle gjatë e pret.

Po në fund ai mbërrin, zgjohet, i gëlltit dhe i kollofit njëherësh të gjithë ata që patën besuar të ndërtonin një strehë sipër tij.

Oh, shikojini strehimet që patën ndërtuar priftërinjtë! Kisha i quajnë ato strofulla të temjanisura.

Oh, ç’dritë e gënjeshtërtë! Ç’ajër i mykur, ku shpirti nuk arrin dot të lartohet në kulmin e vet!

Besimi i tyre dikton: “Në gjunjë ngjitini shkallët, o mëkatarë!”. [Bëhet aluzion për shkallën e shenjtë në Romë - shënim i përkthyesit]

Në të vërtetë, më duken më simpatikë njerëzit e pacipë sesa sytë e vëngërt të drojës dhe përkushtimit të tyre.

Kush janë vallë këta që ndërtuan të tilla shpella dhe shkallë pendesash? Nuk qenë ndoshta ata që u fshehën e u turpëruan nga qielli i kulluar?

Vetëm kur qielli i kulluar do të shkëlqejë përsëri përmes tavaneve të çara dhe mureve të plasaritura mes gramishtave dhe lulëkuqeve petale-purpurta, vetëm atëherë do ndjej ta kthej zemrën përkrah shtëpisë së atij zoti.

E quajtën Zot atë që i kundërshtonte dhe i bënte të vuanin; ka vërtet shumë theks heroik në adhurimin e tyre.

Nuk ditën ta dashuronin ndryshe zotin e vet, përveçse duke kryqëzuar njeriun.

Menduan të jetonin si kufoma, duke i veshur me të zeza kufomat e tyre, por edhe nëpër ligjërata unë ua ndjej erën e qelbur të dhomave mortore.

Kush rron pranë tyre, pranë moçaleve të zinj rron, në të cilët thithëlopa piskat këngën e saj me një melankoli të ëmbël. Duhet të më këndojnë këngë më të bukura, që të mësoj të besoj në shpëtimtarin e tyre. Më të çliruar duhet të më shfaqen dishepujt e tij.

Do të doja t'i shihja lakuriq, sepse vetëm bukuria mund t'ia lejojë vetes predikimin e pendesës. Kush vallë do ta lërë veten të bindet nga ky trishtim i veshur me rroba?

E vërteta është se edhe vetë shpëtimtarët e tyre nuk vijnë nga liria dhe nga qielli i shtatë i lirisë. Ata vetë nuk kanë ecur kurrë nëpër tapetet e njohjes. Shpirti i këtyre shpëtimtarëve kishte shumë boshllëqe, aq me tepër, që secilën prej tyre ata e mbushën me marrëzinë e vet, një lloj mbushjeje që e quajtën Zot.

Në mëshirim u është mbytur shpirti, por, meqë janë të mbushur e stërmbytur me mëshirë, në sipërfaqe u del gjithmonë një masë e madhe budallallëku. Me britma të ethshme e nxisin kopenë e vet të ngjitet në urën e tyre, si të ishte e vetmja urë kah së ardhmes. Në të vërtetë, edhe ata barinj nuk janë veçse dele.

Ata kanë qenë gjithmonë mendjevegjël e shpirtmëdhenj, por, vëllezër, ç'toka të vockla kanë qenë deri më sot edhe më të mëdhenjtë e shpitrave të tyre?

E kanë shënjuar me gjak rrugën ku kalonin; marrëzia e tyre na mësoi se me gjak dëshmohet e vërteta.

Mirëpo, gjaku është dëshmitari më i keq i së vërtetës; gjaku helmon edhe doktrinën më të kulluar dhe e transformon në marrëzi e urrejtje zemrash.

Nëse dikush shkon në turrën e druve për doktrinën e tij, ç'do të provonte vallë ai? Se, në të vërtetë, është më mirë që doktrina të lindë nga zjarri i vet!

Një zemër ndrydhëse dhe një mendje e ftohtë: aty ku puqen këto dy gjëra, aty shpërthen furtuna "Shpëtimtari".

Në të vërtetë, ka pasur njerëz më të mëdhenj e më të ngritur nga këto furtuna trallitëse, që populli i quan shpëtimtarë.

Nga njerëz më të mëdhenj se gjithë shpëtimtarët, o vëllezër, duhet të çliroheni; nëse do të donit të gjenit rrugën drejt lirisë!

Mbinjeriu nuk është shfaqur ende. Lakuriq unë i kam parë të dy, njeriun më të madh e atë më të vogël.

Ngjajnë ende shumë në mes tyre. Se, në fakt, edhe më të madhin e kam gjetur shumë njeri."

Kështu foli Zarathustra.

Për të virtytshmit

"Me bubullima dhe fishekzjarrë qiellore duhet t'u flitet ndjenjave të fjetura dhe të preha.

Mirëpo, zëri i bukurisë flet me ton të ulët: ai hyn ngadalë dhe veç nëpër shpirtra që rrinë zgjuar.

Sot mburoja ime vibroi lehtazi e më buzëqeshi; kjo është një e qeshur e shenjtë dhe një drithërimë e bukurisë.

Por edhe për ju, o të virtytshëm, qeshi sot bukuria ime. E zëri i saj më mbërriti kështu: "Ata duan edhe të paguhen!"

"Ju doni edhe të paguheni, o të virtytshëm! Po mos doni një shpërblim për virtytin, mos doni qiellin në këmbim të tokës dhe përjetësinë në këmbim të së sotmes?

Vallë jeni të zemëruar me mua, se unë mësoj se nuk ekziston shpërblimi dhe thesambajtësi? Po, në të vërtetë, unë nuk mësoj as edhe që virtyti shpërblehet në vetvete. Medet, ky është trishtimi im: në thellësi të të gjitha gjërave është imagjinuar një dënim dhe një shpërblim, e po kështu edhe në thellësi të shpirtrave tuaj, o të virtytshëm!

Si turiri i derrit të egër, fjala ime do të shpojë thellësinë e shpirtrave tuaj; unë, si plugu i parmendës, dua të jem për ju.

Të gjitha sekretet e shpirtit do t'ju dalin në dritë; kur të shtrirë nën diell do të qëndroni të tronditur e të copëtuar, edhe gënjeshtria do të arrijë të ndahet nga e vërteta juaj.

Sepse kjo për ju është e vërteta: ju jeni shumë të pastër për fëlliqësinë e fjalëve tuaja të hakmarrjes, dënimit, shpërblimit dhe pagimit.

Ju e dashuroni virtytin tuaj si nëna fëmijën e saj. Po ku është dëgjuar vallë që një nënë të paguhet për dashurinë e saj?

Virtyti është gjëja juaj më e shtrenjtë. Dëshirimi i zjarrtë i unazës [Aluzion për "Unazën e Nibelungëve" të Vagnerit, dëshirimi i zjarrtë, ndaj së cilës është shkak i çdo të keqeje] gjendet te ju. Çdo unazë synon të kthehet në vetvete, sepse çdo unazë kthehet në vetvete. E ngjashme me një yll të shuar është çdo vepër e virtytit tuaj; drita e tij është gjithnjë në udhëtim. Por kur vallë nuk do të jetë më në udhëtim?

Po kështu, akoma në udhëtim, është edhe drita e virtytit tuaj, qoftë edhe kur vepra është përmbushur. Qoftë e harruar dhe e shuar: rrezja e dritës së saj rron akoma e udhëton.

Që virtyti ynë qofshi vetë ju, e jo diçka e huaj, një lëkurë a një mantel. Kjo le të jetë e vërteta që buroftë prej thellësisë së shpirtit tuaj, o të virtytshëm!

Ka disa që e quajnë virtyt grahamën therëse nën fshikullimin e kamxhikut. Ju i keni dëgjuar për një kohë të gjatë këto thirrje.

Ka të tjerë që e quajnë virtyt kalbëzimin e fytyrave të tyre e, kur urrejtja dhe xhelozia u shtrihen, "drejtësia" e tyre zgjohet e fërkon sytë e dremitur.

Ka edhe të tjerë që tërhiqen për poshtë: i tërheqin pas vetes demonët e tyre. Po sa më thellë fundosen, aq më i zjarrtë shkëlqen syri i tyre për të dëshiruar Zotin.

Medet, edhe britma e tyre mbërriti në veshët tuaj, o të virtytshëm! Ajo ç'ka unë s'jam, ajo, ajo është për mua zoti dhe virtyti.

Ka edhe të tjerë që vijnë rëndë-rëndë e duke kërkëllitur si qerre të mbushura plot me gurë: flasin shumë për dinjitetin dhe virtytin dhe virtyt quajnë frenimet.

Ka edhe të tjerë që u ngjajnë sahatëve me kurdisje: bëjnë tik-tak dhe këtë tik-tak e quajnë virtyt.

Për të thënë të vërtetën, ata më duken simpatikë: aty kundeshem me të tilla sahatë, i kurdis me shpatën time e zbavitem teksa dëgjoj zhurmërimën e tyre.

Ka të tjerë që ndihen krenarë për një grusht drejtësie që kanë. Dhe, për hir të dashurisë ndaj saj, kryejnë krime ndaj gjithçkaje: aq sa dhe llumi përfundon i mbytur në padrejtësinë e tyre.

Medet, sa keq kumbon fjala "virtyt" në buzët e tyre. Ndaj, kur thonë: "Unë jam i drejtë", është gjithmonë njëlloj sikur të thonë: "U hakmora!".

Me virtytin e tyre do të donin t'u nxirrnin sytë armiqve; lartësohen veç për të poshtëruar të tjerët.

Së fundi, ka edhe nga ata që rrinë ulur mbi moçalishtet e tyre dhe përmes kallamave kënetorë thonë: "Virtyt është të rrish ulur, në heshtje, mbi llum".

Ne nuk kafshojmë askënd dhe u shmangemi atyre që duan të kafshojnë; mbi gjithçka kemi opinionin që na ofrohet.

Gjunjët e tyre adhurojnë gjithmonë e duart e lartojnë virtytin sa më lart, por zemra gjithsesi nuk u nxë asgjë.

Ka dhe nga ata që e vlerësojnë si virtyt thënien "Virtyti është i nevojshëm", por që thellë-thellë mendojnë se duhet thirrur vetëm policia.

Dikush që nuk mund ta kuptojë dot lartësimin që gjendet te njeriu, quan virtyt shfaqjen e inferioritetit njerëzor: për ta quajtur kështu virtyt syrin e tij të keq.

Disa duan të ndërtohen e të lartohen, duke e quajtur virtyt një gjë të tillë; të tjerë duan të jenë të shkatërruar, madje e quajnë edhe këtë virtyt.

Ka pastaj nga ata që i dashurojnë gjestet dhe mendojnë se virtyti është një lloj gjesti.

Gati të gjithë besojnë se kanë pjesë te virtyti; të paktën secili imagjiron të jetë një njohës i së mirës dhe së keqes.

Mirëpo, Zarathustra nuk erdhi vallë për t'u thënë gjithë këtyre të marrosurve dhe gënjeshtarëve: "Po ç'dini ju vallë për virtytin? Ç'mund të dinit vallë për të?".

Erdhi sepse, ju o miqtë e mi ndiheni të lodhur e të mërzhitur nga mësimet antike të mësuara nga të marrosurit dhe gënjeshtarët.

Të lodhur nga fjalët "shpërblim", "pagim", "dënim", "hakmarrje me drejtësi". Të lodhur të thoni se një veprim është i mirë, sepse është pa interes. Medet, o miqtë e mi! Qoftë qenia juaj te veprimi, si nëna te biri; kjo le të jetë fjala juaj për virtytin.

Në fakt, unë ju hoqa më shumë se njëqind fjalë, bashkë me lodrën më të shenjtë të virtytit juaj. Tash jeni të zemëruar me mua, siç varin buzët fëmijët.

Ata lodronin në breg të detit; erdhi vala e ua mori tej lodrat e tani qajnë. Mirëpo, e njëjta valë do t'u sjellë atyre lodra të reja e do t'u shpërndajë guaska shumëngjyrëshe.

Kështu, ata do të ngushëllohen. Por si ata, edhe ju, o miqtë e mi, duhet të keni ngushëllimet tuaja, guaskat tuaja shumëngjyrëshe!"

Kështu foli Zarathustra.

Për horrat

"Jeta është burim gëzimi, por aty ku horrat pinë me të tjerët, aty të gjitha burimet janë të helmuara.

Unë jam në favor të gjithë asaj që është e kulluar, por nuk mund të shoh dot fytyra të ngërdheshura dhe etjen e të papastërve.

Me sytë e tyre ata kanë vështruar edhe fundin e burimeve. Tani shoh shëmbëllimin e buzëqeshjes së tyre përçmuese, që poshtë fundit kanë helmuar me epshmërinë e vet ujin e shenjtë. Kur quajtën gëzim shenjat e tyre të ndyra, helmuan edhe fjalët.

Flaka tërhiqet, kur ata vënë pranë zjarrit zemrat e tyre veshtullake; edhe vetë shpirti zien dhe tymon, kur horrat vijnë afër zjarrit.

Fruta në duart e tyre kalbet e stërpiqet: shikimi i tyre e bën pemën frutë-rënë e frutë-tharë.

Shumë njerëz e braktisën jetën për t'u arratisur nga horrat: nuk deshën të bëheshin me ta pemë, zjarr dhe frutë.

Shumë nga ata që shkuan nëpër shkretëtira e vuajtën zhuritjen bashkë me bishat dhe e bënë këtë gjë vetëm se nuk donin të rrinin rreth cisternës me devetçinjte e pistë.

Shumë të tjerë, që erdhën këtu si shkatërrimtarë e si një breshër i rënë mbi fushat pjellore, deshën vetëm t'ua vinin këmbën në fyt e t'ua shtypnin gojën.

Nuk është kjo ajo "kafshata" që duhet, të paktën ta copëtojmë që të mos na mbysë, për të kuptuar që vetë jeta ka nevojë për armiqësinë, vdekjen dhe kryqet e martirëve.

Mirëpo, një ditë unë pyeta e gati sa s'm'u zu fryma nga pyetja: Po si vallë? Jeta ka nevojë edhe për horra?

A janë të nevojshëm burimet e helmuara dhe zjarret tymuese, ëndrrat e ndyra dhe krimbat mbi bukën e jetës?

Jo urrejta, por përçmimi im më bëri të uritur për jetën.

Medet, unë u lodha dhe me shpirtin, kur zbulova se edhe horrat ishin gjithë shpirt!

Kështu ua ktheva shpinën edhe sunduesve, kur pashë se çfarë ata sot quajnë sundues: njerëz që trafikojnë e bëjnë pazarllëqe me këta horra, veç për pushtet.

Me hundë të taposur, kalova përçmues përmes të gjitha të djeshmëve dhe të sotmëve. Në të vërtetë, ndjeva aromë të keqe, si tek e djeshmja ashtu dhe tek e sotmja. Në të vërtetë, sa e shkuara aq edhe e tashmja kutërbojnë erën e atyre horrave që shkruajnë.

I ngjashëm me një invalid të bërë i verbër, i shurdhër dhe memec: rrojta gjatë, veç që të mos kisha asgjë për të ndarë me horrat që komandojnë, shkruajnë dhe dëfrenjë.

Me droje, me kujdes e plot dhimbje i ngjiti shkallët shpirti im; lëmoshat e kënaqësisë qenë ngushëllimi i tij. Ndërkaq, jeta rrihte ngadalë për të verbrin e mbështetur mbi bastun.

Po ç'më ngjau më pas? Si u çlirova nga përçmimi? Kush i rigëzoi sytë e mi? Si arrita n'ato lartësi, ku horrat nuk ulen më përreth burimeve? Mos vallë po i njëjti përçmim më dha krahët dhe fuqinë ogurmbarë për të gjetur burimet e reja? Në të vërtetë, m'u desh të fluturoja shumë lart, për të gjetur burimin e gëzimit.

Oh, po unë e gjeta, o vëllezër! Këtu, në lartësitë e epërme, buron për mua gurra e gëzimit. Ka një jetë që s'do t'u japë kurrë të pijë horrave.

Por, edhe shumë i vrullshëm, ti rrjedh për mua, o burim i gëzimit! E shpesh e zbraz kupën, sepse do ta rimbushësh përsëri.

Ndaj, më duhet akoma të mësoj të të afrohem me kujdes; zemra ime të vjen përballë me shumë vrull e fuqi; zemra ime, në të cilën djeg vera ime, e shkurtra, e nxehta, melankolikja, e bekuara verë. Oh, sa shumë zemra ime verore e dëshiron freskinë tënde!

Mbaroi melankolia ngurruese e pranverës sime. Shkoi ligësia e flokëve të mi të dëborës në qershor. Unë jam bërë i gjithi verë e mesditë vere. Një verë mbi lartësitë me burime të ftohta e heshtje të bekuara. Ejani, o miqtë e mi, që heshtja të bëhet akoma dhe më e bekuar!

Kjo është lartësia dhe atdheu ynë: shumë lart e në një vend të thepisur ne banojmë për të papastërit dhe etjen e tyre.

Hidhini shikimet tuaja të kulluara në burimin e gëzimit, o miq! Si mundet ajo të turbullohet? Duhet të buzëqeshë përkundrajt jush me qashtërsinë e saj!

Ne do ta ngremë folenë tonë në pemën e së ardhmes; shqiponjat duhet të sjellin për ne, vetmitarët, ushqim me sqepat e tyre.

Në të vërtetë, nuk është ushqim nga ai, me të cilin mund të ushqehen të papastërit. Do t'u dukej të hanin zjarr e do t'u digjeshin turinjtë.

Ne nuk mbajmë këtu lart banesa për të papastërit. Gëzimi ynë do t'u dukej si një shpellë e akullt trupave dhe shpitrave të tyre.

Si një erë e fortë, duam të jetojmë sipër tyre, në afërsi me shqiponjat, në afërsi me borën, në afërsi me diellin. Kështu rrojnë erërat e forta.

Si një erë, unë dua të fryj një ditë mbi ta e me shpirtin tim ta shuaj frymimin e shpitrave të tyre. Kështu do e ardhmja ime.

Në realitet, Zarathustra është një erë e fortë për të gjitha ultësitat. Këtë këshillë u jep miqve të vet, ashtu si dhe atyre që vjellin e pështyjnë: "Ruhuni nga pështymat kundra erës!". Është njëri nga pasazhet që shpreh më mirë sensin ditirambik të predikuesit dionizak. (Shënim i përkthyesit)

Kështu foli Zarathustra.

Për merimangat

"Shikoje, kjo është strofulla e merimangës! A do ta kundrosh? Këtu varet cerga e saj: preke, që ajo të drithërohet e tëra.

Ja, tek po mbërrin spontanisht vetë merimanga. Mirë se vjen, o merimangë! I zi është trekëndëshi mbi shpinën tënde, shenja jote; po unë di edhe se ç'ka në shpirtin tënd. Hakmarrje ka në shpirtin tënd: aty ku ti kafshon, aty rritet një kore e zezë. Me hakmarrje, helmi yt bën që shpirti të bëhet furkë.

Unë po ju flas me metaforë juve, që e bëni shpirtin të përdridhet juve, o predikatorë të barazisë. Ju për mua jeni merimanga dhe shpirta të zymtë hakmarrës.

Por unë dua të sjell dritë nëpër skutat tuaja sekrete, ndaj ju qesh në fytyrë me buzëqeshjen time të lartësisë.

Ndaj dhe po ua shtur cergën tuaj derisa zemërimi t'ju tërheqë jashtë strofullës së gënjeshtërt e hakmarrja t'ju brofë jashtë fjalës "drejtësi".

Që njeriu të ringjallet nga hakmarrja; kjo është për mua ura, kah shpresave më të larta dhe një ylber pas aq shumë shtrëngatash.

Por ata, në të kundërt, duan merimangat. “Pikërisht këtë quajnë drejtësi, që bota të jetë plot me shtrëngatat e hakmarrjeve tona.” Kështu i thonë njëri-tjetrit.

“Ne duam ta përdorim fyerjen dhe hakmarrjen ndaj atyre që nuk janë si ne: kështu premtojnë solemnisht në zemrën e tyre merimangat.

Vullnet për barazi. Ky qoftë në të ardhmen emri i virtytit e, kundër gjithçkaje që ka fuqi, ne duam ta ngremë britmën tonë.

O predikues të barazisë, marrëzia tiranike e pafuqisë ulërin kështu te ju, duke lutur “barazi”! Dëshirat tuaja më të fshehura tiranike maskohen kësisoj nëpër fjalë të virtytshme.

Fodullëk i brengosur, zili e ndrydhur, ndoshta fodullëk dhe zili e prejardhur prej baballarëve tuaj. E gjitha kjo shpërthen te ju si flakë dhe marrëzi hakmarrjeje.

Ajo për çka heshtën baballarët, tash del nga goja e të bijve. Kam parë shpesh bij të nxjerrin në shesh sekretet e baballarëve.

U ngjajnë të frymëzuarve: s’është zemra që i frymëzon, por hakmarrja. Kur bëhen të ftohtë e dinakë, nuk është shpirti që i bën të ftohtë dhe dinakë, por hakmarrja. Xhelozia i udhëheq të shkelin edhe shtigjet e mendimtarëve; ky është dëftuesi i xhelozisë së tyre, se ata shkojnë gjithmonë përtej caqeve të veta. Andaj lodhja, më në fund, i shtrëngon t’i zërë gjumi në dëborë.

Nga çdo ankim i tyre kumbon zilia, në çdo lëvdatë ka një qëllim të lig; të gjykuarit është për ta gëzimi.

Ndaj unë po ju këshilloj: O miqtë e mi, mos u besoni atyre, te të cilët instinkti i dënimit është i fuqishëm! Janë njerëz të një specie dhe origjine të keqe. Nga fytyra e tyre nëpërshihet xhelati dhe zagari.

Mos u besoni atyre që flasin shumë për drejtësinë e vet! Në të vërtetë, zemrave të tyre u mungon veç mjalti.

E, nëse e quajnë veten “të mirë dhe të drejtë”, atëherë mos harroni që për t’u bërë farizej u mungon vetëm fuqia!

Miqtë e mi, unë nuk dua të ngatërrohem me ta.

Ka ndonjë që predikon doktrinën time për jetën, por, në të njëjtën kohë, ai është edhe predikues i barazisë dhe merimangave.

Këta njerëz flasin duke lëvduar jetën kur, në të vërtetë, veç rrinë strukur në strofkën e tyre; po ashtu si ato merimanga të helmëta, larg jetës se, në fakt, ato duan të bëjnë vetëm keq.

Duan t'u bëjnë keq atyre që tash kanë pushtetin; përderisa predikimi i vdekjes është gjithmonë për ta zgjedhja më e mirë. Nëse do të ishte ndryshe, merimangat do të mësonin diçka tjetër, sepse një kohë qenë pikërisht ata shpifësit më të mirë të botës dhe djegësit e heretikëve.

Me këta predikues të barazisë unë nuk dua të jem as i përzier, as i ngatërruar, se edhe drejtësia na mëson që "njerëzit nuk janë të barabartë".

E as duhet të bëhen! Ç'gjë do të ishte dashuria ime për Mbinjeriun, nëse unë do të flisja ndryshe?

Nëpër mijëra ura e shtigje duhet të vërviteni drejt së ardhmes; gjithnjë e më shumë lufta dhe pabarazia duhet të gjejnë vend mes njerëzve. Kështu më mëson dashuria ime e madhe!

Në luftën e tyre ata duhet të bëhen sajuesit e simboleve dhe fantazmave, e me këto simbole e fantazma duhet të përleshën midis tyre për betejën supreme.

I mirë dhe i keq, i pasur dhe i varfër, i ulët dhe i lartë, bashkë me të gjitha emrat e virtyteve, duhet të bëhen armë dhe shenja kumbuese, që jeta ta kapërcejë gjithmonë vetveten.

Vetë jeta do të ndërtojë me shtylla dhe shkallë: do të shikojë nëpër largësira të mëdha e kah bukurive të qashtra, ndaj ka nevojë për lartësira.

Meqenëse ka nevojë për lartësira, ka nevojë për shkallë, për kundërshtitë mes shkallëve dhe atyre që i ngjisin. Jeta do të ngjitet e duke u ngjitur të kapërcejë vetveten.

Shikoni, pra, miqtë e mi! Këtu ku është strofka e merimangës, lartohen gërmadhat e një tempulli antik; shikojeni me sy të ndriçuar!

Në të vërtetë, ai që një ditë i ngriti për së larti mendimet e tij me gurrë, e njohu sekretin e jetës, njësoj si më i mençuri.

Lufta e pabarazia gjenden dhe te bukuria, ashtu si te pushteti dhe sundimi. Këtë ai na e mëson me shenja mjaft të qarta.

Na mëson se si hyjnish shprishen këtu kubetë dhe harqet në një luftë force trup me trup, se si përleshën midis tyre me dritën dhe hijen, luftëtarët hyjnorë.

Bëni që dhe armiqtë tanë të jenë kaq të sinqertë e të bukur, o miqtë e mi! Ne duam të luftojmë hyjnish me njëri-tjetrin.

Medet! Ja tek më pickoi merimanga, mikja ime antike! Ajo ma pickoi gishtin hyjnish e sigurt dhe e bukur.

“Duhet të ketë ndëshkim dhe drejtësi, - mendon ajo. - Askush s'mund të vijë këtu pa motiv e të këndojë këngë për nder të miqësisë!”

“Po, ajo u hakmor! E, mjerë unë! Ajo do të ma rrokullisë tash me hakmarrjen e saj dhe shpirtin tim. Që të mos arrij të rrokullisem, o miqtë e mi, lidhmëni fort, këtu, te kjo kolonë! Më mirë do të dëshiroja të isha një shenjt-kolonë sesa vorbull e hakmarrjes!

Se, në fakt, Zarathustra nuk është një erë e lehtë e luhatshme, as edhe një vorbull ërë. Po, nëse është një valltar, kurrë e më kurrë nuk është një valltar merimangash!” [Ky është njëri nga kapitujt që ka ndikuar më shumë te predikuesit e mëvonshëm të luftës dhe dhunës.]

Kështu foli Zarathustra.

Për të mençurit e shquar

“Shërbëtorë të popullit e të supersticionit të popullit, ishit të gjithë ju, o të mençurit e shquar! Jo, të së vërtetës! Pikërisht kjo ju dhuroi një respekt të thellë.

Për këtë gjë u durua edhe mos religjioziteti juaj, sepse ai u quajt një dinakëri dhe hile për të mbërritur sa më afër popullit.

Po njëlloj si ai padroni që i lë të lirë skllevërit e vet, për t'u dëfryer më pas me kapadaillëkun e tyre.

Por ajo që populli urren më shumë, siç urrejnë qentë ujkun, është shpirti i lirë, armiku i lidhjeve, mos-adhuresi, banori i pyjeve.

Dëbimin nga strehimi i tij i ftohtë: këtë populli e quan gjithmonë "sens të drejtësisë"; kundër tij ai kanos akoma qentë e vet dhëmbëmprehtë.

"Përderisa ekziston e vërteta, ajo nuk është në fakt vetë populli. Mjerë, mjerë, kërkuesit e saj! Kështu është thënë që prej një kohe që s'mbahet mend.

Ju deshët të krijonit për popullin një arsye për nderimin dhe respektimin tuaj. Këtë e quajtet "vullnet të së vërtetës", ju o të mençurit e shquar!

Zemra juaj foli gjithmonë kështu: "Unë vij nga populli: nga ai më vjen edhe zëri i Zotit".

Të matur e kokëfortë, si një gomar, ju qetë gjithmonë mbrojtësit e popullit.

Më shumë se një i pushtetshëm, që donte të kishte marrëdhënie të mira me popullin, mprehu përpara kuajve të tij edhe një kërraç, një të mençur të shquar.

Tash unë do të doja, o të mençurit e shquar, që ju ta zhvishni përfundimisht nga vetja lëkurën e luanit.

Lëkurën shumëngjyrëshe të bishës dhe vellon e eksploratorit, të kërkuesit, të triumfuesit.

Oh, që unë të besoj në "vërtetësinë" tuaj, ju më parë duhet të thyeni përpara meje vullnetin e të adhuruarit.

Të sinqertë unë quaj atë që shkon në shkretëtirë pa Zotin dhe që e ka thyer zemrën e vet që e adhuronte.

Mes rërës së verdhosur, të përzhitur nga dielli, ai picërron sytë i etur për oaze plot me burime, ku veset nginjen e shtriqen nën pemët hijemëdha.

Mirëpo, etja nuk ka për ta bindur të bëhet i ngjashëm me njerëz të tillë, sepse aty ku ka oaze ka dhe idhuj.

Brutal, të uritur, vetmitar, pa zot! Kështu e do veten vullneti i luanit. I lirë nga gëzimi i skllavit, i çliruar nga zotat dhe lutja, i patrembur dhe i tmerrshëm, i madh e vetmitar: i tillë është vullneti i të vërtetit.

Që prej kohësh që s'mbahen mend, njerëzit e vërtetë jetojnë në shkretëtirë; ata shpirtra të lirë, ata padronë të shkretëtirës; nëpër qytete banojnë të mençurit e shquar, të mirë-ushqyerit: kafshë për të tërhequr karrocet. Janë gjithmonë ata që tërheqin si gomarët, qerren e popullit.

Por unë s'jam i zemëruar për këtë gjë. Ata mbeten për mua shërbëtorë dhe të mprehur pas qerreve, edhe pse shkëlqejnë nga takëmet e arta të kuajve.

Qenë shpesh shërbëtorë të mirë e të lavdishëm, se kështu flet virtyti: "Nëse do të jesh shërbëtor, atëherë kërko atë, të cilit shërbimi yt i nevojitet më shumë!

Shpirti dhe virtyti i padronit tënd duhet të rriten, me atë çka i jep si shërbëtori i tij. Kështu, edhe ti vetë do të rritesh bashkë me shpirtin dhe virtytin tënd.

Në fakt, o të mençurit e shquar, o shërbëtorët e popullit, edhe ju jeni rritur me shpirtin dhe virtytin e popullit, por edhe populli përmes jush. E them këtë, për nderin tuaj!

Po përsëri, për mua mbeteni popull, bashkë me virtytet tuaja, popull me vështrim largësi-shkurtër, popull që nuk di se ç'është shpirti.

Shpirti është jeta! Jeta që depërton në vetvete që, prej burimeve të veta ajo e rrit mençurinë e vet. A e dinit?

E ky është gëzimi i shpirtit: të lëtyrë dhe shugurohet me lotët e të sakrifikuarve. A e dinit?

Verbëria e të verbrit, kërkimi dhe ecja e tij nëpër terr, duhet të dëshmojë pushtetin e diellit, tek i cili ai fiksoi shikimin. A e dinit?

Edhe ai që njeh, duhet të mësojë të ndërtojë me malet. Është pak gjë që shpirti të lëvizë malet [Aluzion me shprehjen ungjillore që shpirti lëviz edhe malet]. A e dinit?

Ju njihni veç përshkënditjet e shpirti, por nuk shihni kudhër, atë çka ajo është, si dhe mizorinë e çekiçit të saj.

Në të vërtetë, ju nuk e njihni krenarinë e shpirtit. Akoma e më pak do të dinit të toleronit modestinë e tij, nëse ai do të donte të fliste ndonjëherë.

Se keni ndjerë kurrë nevojën e hedhjes së shpirtit tuaj në një hendek dëbore: nuk jeni ende aq të zjarrtë. Kësisoj, nuk arrini të njihni as ekstazën e akullit të tij.

Megjithatë, ju kuvendoni në mënyrë goxha familjare me shpirtin, duke e bërë shpesh mençurinë strehim për të varfrit dhe spital për poetët e këqij.

Ju nuk jeni shqiponja: nuk e keni kuptuar akoma gëzimin e terrorit të shpirtit. E kush s'është zog, le të mos e ngrejë fushimin e vet thepave.

Të vakët ju jeni për mua, por çdo njohje e thellë e ftohtë rrjedh.

Të ftohta si akujt janë burimet sekrete të shpirtit: të acarta për duart e zjarra e për atë që është gati për të vepruar.

Më rrini pranë, ju o të nderuarit, të rreptët e shpinë-drejtët, të mençurit e shquar! Nuk ju shtyu tej asnjë re e fortë, asnjë vullnet.

Nuk keni parë vallë kurrë një velë të shkojë nëpër det, të shpalosur e të gufuar e vibruese nga fuqia e erës?

E ngjashme me velën, vibruese prej fuqisë së erës, shket mençuria ime nëpër det; mençuria ime e egër.

Ndërkaq, ju, o shërbëtorë të popullit, o të mençurit e shquar, si mund të vini vallë me mua?!"

Kështu foli Zarathustra.

Kënga e natës

"Është natë! Tash më fort flasin gjithë shatërvanët gurgullues. Edhe shpirti im është një shatërvan gurgullues.

Është natë! Veç tani zgjohen të gjitha këngët e të dashuruarve.

Edhe shpirti im është kënga e një të dashuruari.

Diçka të panginjur, të pangishme ka tek unë, që do të dëgjohet.
Ka tek unë një dëshirë dashurie, që flet gjuhën e dashurisë.

Unë jam dritë! Ah, sikur të isha natë! Por kjo është vetmia ime, që unë të jem i brezuar me dritë. Ah, sikur të isha i errët dhe i natës! Sa do të doja t'u ngjitesha gjinjve të dritës!

Edhe ju doja t'ju bekoja, shkëndija të vogla yjore e xixëlluese atje lart. Të jem i bekuar me dhuratat e dritës suaj!

Po unë rroj në dritën time, flakët e mia pi, që shpërthejnë përbrenda meje.

Unë nuk e njoh gëzimin e atij që merr. Madje, shpesh kam ëndërruar se të vjedhurit duhet të jetë më i bekuarit se të marrit.

Kjo është mizeria ime, që dora të mos më lodhet kurrë së dhuruari; kjo është zilia ime, që unë të shoh sy në pritje e net të ndriçuara nga flakë dëshirimi.

O mos-lumturi e gjithë dhuruesve! O errësim i diellit tim! O dëshirë e të dashuruarit! O lakmi e ngimjes!

Ata marrin prej meje! Po unë, ai i prek vallë shpirtrat e tyre?

Një humnerë ka mes dhënies e marrjes; e humnera më e vogël është më e vështira për t'u kapërcyer.

Uri shpërthen prej bukurisë sime; unë do të dëshiroja t'u falja dhimbje atyre që ndriçojnë, do të dëshiroja t'i grabisja përfituesit e shërbimeve të mia. Kaq i uritur me ligësi unë jam!

Tërheq dorën, kur drejt saj shtrihet një dorë tjetër. I ngjashëm me një rrokullimë të ngadaltë që ngurron edhe në rënie. Kaq i uritur jam në ligësi!

Ja, të tillë hakmarrje meriton plotësia ime. E tillë ligësi shpërthen prej vetmisë sime!

Gëzimi im për të dhënë u shua përgjatë dhënies, virtyti im u lodh nga bollëku i tij.

Kush duron, ka gjithmonë rrezik të humbasë turpin; kush shpërndan gjithmonë, i ka duart dhe zemrën me kallo nga shpërndarjet e shumta.

Syri im nuk derdh më lot prej turpit të lutësve; dora ime u bë shumë e ngurtë për drithërimën e duarve të mbushura plot.

Po ku shkoi vallë loti i syrit tim e lëngimi i zemrës sime? O vetmi e gjithë atyre që dhurojnë! O heshtje e tërheqje e gjithë të ndriçuarve!

Shumë diej vijnë qark hapësirave qiellore: gjithçkaje që është e errët ata i flasin me dritën e tyre, kurse me mua heshtin.

Oh, kjo është armiqësia e dritës ndaj gjithçkaje që shkëlqen. E pamëshirshme ajo vazhdon udhën e vet.

I padrejtë në thellësi të zemrës së vet, ndaj gjithçkaje që shkëlqen, e i akullt ndaj diejve. Kështu ecën çdo diell!

Si një stuhi, diejt e përshkojnë udhën e vet, kjo është ecja e tyre.

Ata ndjekin vullnetin e vet të pashtershëm, që është dhe ftohtësia e tyre.

O veç ju, ju të zymtit, ju të natës, jeni ata që prodhoni ngrohtësi, nga trupat shkëlqimtarë! Oh, sikur veç ju të pinit qumësht e rehati nga gjinjtë e dritës!

Medet, akull ka përreth meje, dora ime digjet, duket e prekur me këtë akull. Medet! Etje unë kam, që zjarrmon etjen tuaj!

Është natë! Medet, përse duhet të jem dritë e etje kah natës, por edhe vetmi?

Është natë! Tash dëshira ime shpërthen broftas meje si një dëshirim; dëshirim për fjalë.

Është natë! Tash më fort flasin gjithë shatërvanët gurgullues. Edhe shpirti im është një shatërvan gurgullues.

Është natë! Veç tani zgjohen të gjitha këngët e të dashuruarve.

Edhe shpirti im është kënga e një të dashuruari.”

Kështu foli Zarathustra.

Këngë vallëzimi

Një mbrëmje, Zarathustra po shkonte nëpër pyll bashkë me dishepujt e tij. Pikërisht kur po kërkonte një shatërvan, ja tek mbërriti në një livadh të blertë e të heshtur, të rrethuar nga pemë e gëmusha. Në të, disa vashëza po kërcenin me njëra-tjetrën. Sapo e njohin Zarathustrën, vashëzat e reshtën vallëzimin, mirëpo Zarathustra u afruar me një përshëndetje miqësore, duke u thënë:

“Mos e ndalni vallen, o vashëza të bukura! Nuk po vjen te ju një prishës festash me shikim të lig, as edhe një armik i vashëzave.

Unë jam ndërhyrësi i Zotit kundra demonit. Ai, në të kundërt është shpirti i rëndesës.

Si mund të jem vallë, o të hijshme, armik i vallëzimit hyjnor? Apo i këmbëve të vashëzave me kaviqe të hajthme?

Unë jam, vërtet, një pyll e një natë me pemë të zeza. Kush nuk ka frikë nga errësira ime, gjen buzëkuq nën qiparisat e mi.

Ato i gjen edhe ai zoti i vogël, aq shumë i dashur për vashëzat. Ai rri i shtrirë pranë burimit, i pafjalë e me sytë e mbyllur.

Në të vërtetë, e ka pllakosur gjumi çapkënin, apo mos ndoshta ka vijuar gjatë gjuetinë e fluturave?

Mos jini të zemëruara me mua, o valltare të bukura, nëse e ndëshkoj pakëz këtë zot të vogël! Ai do të qajë e do të bërtasë, por është i hareshëm edhe në vajtim. Me lot në sy do t'ju kërkojë një vallëzim. Edhe unë vetë dua ta përshtat një këngë për vallen e tij: një baladë dhe një këngë satirike për shpirtin e rëndesës, të demonit tim të madh e fort të lartë, që thonë se është padroni i botës.

Kjo është kënga që këndoi Zarathustra, ndërsa Kupidi [Zoti i Dashurisë] dhe vashëzat vallëzonin së bashku:

“Të pashë sërish në sy, o jetë e më ngjau të fundosësia në të papërshkrueshmen.

Por ti më solle përsëri lart me një grip të artë. Qesha ironikisht, kur të quajta të papërshkrueshme.

“Kështu flasin gjithë peshqit,” – the. Ajo çka nuk e depërtojnë, për ta është e papërshkrueshme.

Por unë jam vetëm e egër dhe e luhatshme, e gjitha një femër, për më tepër e virtytshme. Edhe pse nga ju burrat quhem e thellë ose besnike, e përjetshme, misterioze.

“Ju burrat na bëni gjithmonë dhuratë të virtyteve tuaja, o të virtytshëm!”

Kështu qeshi e pabesa, por unë s’kam besim kurrë tek ajo dhe tek e qeshura e saj, kur flet keq për veten.

Se kur foli kokë më kokë me mençurinë time të egër, ajo më tha e zemëruar: “Ti do, ti dëshiron, ti dashuron. Veç për këtë ti e lëvdon jetën!”

Isha gati t’i jepja një përgjigje të keqe e t’i thosha të vërtetën, së zemëruarës, se nuk mund të përgjigjesh më keq se sa “ta quash të vërtetën” mençurinë tënde.

Kështu rrinë gjërat në mes ne të treve. Në thelb, unë dua vetëm jetën; aq më shumë, kur e urrej. Nëse mençuria më është e shenjtë e shpesh shumë e shenjtë, kjo ndodh sepse ajo më kujton shumë jetën.

Ajo ka sytë e saj, buzëqeshjen e saj, madje edhe grepin e saj të artë. Ç’faj kam unë që ato të dyja janë kaq të ngjashme?! Kur një herë jeta më pyeti se cila është vallë kjo, mençuria, atëherë unë i thashë me droje dhe kujdes: “Po, medet! mençuria!”

Ke gjithmonë etje për të e nuk nginjesh kurrë, e sheh si përmes velloshe e kërkon ta zësh me rrjetë.

Është e bukur vallë? Po unë, ku e di! Edhe krapat më të vjetër kapen bashkë me të në grep.

Është e luhatshme dhe kryeneçe. Kam parë shpesh të kafshojë buzët e të krehë flokët.

Ndoshta ajo është e gënjeshtërt dhe e ligë, femër në gjithçka, por kur flet keq për veten, pikërisht atëherë më josh më shumë se kurrë. Sapo i fola kështu jetës, ajo qeshi ligësisht e mbylli sytë: “Për kë po flisje? Për mua, apo jo?”

Po edhe sikur të kishe të drejtë, vallë kështu flitet, në sy të të gjithëve?! Tash na fol pak edhe për mençurinë tënde?

Medet, atëherë ti i hape përsëri sytë, o jeta ime e adhuruar! E mua m'u duk të rrëzohesha sërish në të papërshtueshmëni.

Kështu këndoi Zarathustra.

Po kur vallja mbaroi dhe vashëzat shkuan një nga një, ai u bë i trishtë e tha:

“Dielli ka kohë që ka perënduar, livadhi është i lagësht, nga pylli po vjen freski.

Diçka e panjohur është përreth meje e kuit mendueshëm.

Ç'është vallë? Jeton akoma ti, o Zarathustra? Përse? Përse jeton? Përmes kujt jeton? Drejt e për ku? Për ku? Si? S'është vallë marrëzi të rrosh akoma?

Medet, o miqtë e mi, është mbrëmja ajo që po më pyet kështu! Falmani trishtimin tim! U bë natë. Falmëni, që u bë natë!”

Kështu foli Zarathustra.

Kënga e përzishme

“Atje poshtë është ishulli i heshtur i të vdekurve, atje poshtë janë edhe varret e rinisë sime. Atje unë dua të shpie një kurorë përjetësisht të gjelbër të jetës.

Pasi vendosa kështu në zemër, u drejtova për të kaluar detin.

Po ju, vizione dhe shëmbëlltyra të rinisë sime! Oh, ju, vështrime dashurie, ju çaste hyjnore! Sa shumë shpejt u shuat! Sot po mendoj për ju, si për të vdekurit e mi.

Se prej jush, o të vdekurit e mi të shtrenjtë, më mbërrin një parfum i ëmbël, që ta shkrin zemrën dhe lotët. Në të vërtetë, ai bën të drithërohet e të shkrihet veç zemra e lundërtarit vetmitar.

Unë jam gjithmonë dhe akoma më i pasuri dhe më smirëngjallësi, unë, më vetmitari! Përderisa ju pata e ju më

keni akoma, thomëni, kujt i ranë si mua kaq shumë shegë nga pema?

Unë jam gjithmonë në kujtesën tuaj, trashëgimtari i dashurisë dhe tokës së lulëzuar, si dhe i aq shumë virtyteve të egra e të larmishme, o të adhuruar!

Medet, nuk qemë bërë për të jetuar pranë njëri-tjetrit, o të magjishmet mrekulli të çuditshme! Jo si zogj të ndrojtur ju erdhët tek unë e te dëshirimet e mia, por me besimin e atij që besonte te ju.

Po, të krijuar për besnikërinë, si unë, e për dashamirësinë e përjetshme, duhet t'ju quaj shikime e çaste hyjnore, edhe pas pabesisë suaj. Nuk jam mësuar akoma t'ju gjej një emër tjetër.

Në fakt, goxha shpejt ju m'u shuat, o ikanakë! Nuk më morët arratinë, e as unë s'ua mora arratinë. Jemi reciprokisht të pafajshëm për pabesinë tonë.

Për të më vrarë, jua çanë fytin, o zogj këngëtarë të shpresave të mia! Tamam kështu: kundra jush, o të hijshëm, u vërvit gjithmonë shigjeta e ligësisë, për të goditur zemrën time!

E si më goditi? Përderisa ju më jeni më të dashurit e zemrës, zotërimi im dhe qenia ime e zotëruar, duhet të vdisnit të reja e shumë shpejt.

Shigjeta u drejtua kah asaj që tek unë qe më butë dhe më e pambrojtur. Kundra jush, me atë lëkurë si pendë e atë buzëqeshje që të bën të vdesësh veç me shikim.

Po një fjalë unë dua t'ua them armiqve të mi: ç'është vallë një vrasje krahasuar me atë çka më bëtë ju?

Më keni bërë më shumë keq se sa një vrasës. Më keni zhvatur atë që nuk kthehet më. Kështu po ju them, o armiqtë e mi!

Ju keni vrarë vizionet dhe mrekullitë e hijshme të rinisë sime! Ju më rrëmbyet shokët e lojërave, shpirtrat e shenjtë. Unë po e vendos këtë kurorë e këtë mallkim në emër të kujtimit të tyre.

Këtë mallkim e kam për ju, o armiqtë e mirë. Ju ma shkurtuat përjetësinë, si një kumbim që këputet në një natë të acartë!

Vetëm si rrahje qepallash e një syri hyjnor ajo më mbërriti:
një çast.

Qelibarësia ime më pat thënë një ditë, në një orë mirësie:
“Hyjnore të qoftë çdo qenie!”.

E atëherë ju m'u sulët me fantazma të ndyra. Medet, po ku
më shkoi ajo orë e mbarë?

“Të gjitha ditët më janë të shenjta!” Kështu i foli një ditë
mençuria rinisë sime, por, në të vërtetë, ajo qe një fjalë e një
mençurie të hareshme.

Mirëpo, atëherë ju, o armiq, m'i vodhët netët e m'i
transformuat në pagjumësi të anktshme. Medet, po ku më
shkoi ajo mençuri e hareshme?!

Një herë dëshirova ogure fatmirë; ju më vendosët në rrugën
time një kukuvajkë të fëlliqur e të përbindshme. Medet, po ku
më shkoi ai dëshirimi im dashamirës?!

Një herë u betova të hiqja dorë nga çdo përçmim, por ja,
tekta ju i transformuat në absces të afërmit dhe fqinjët e mi.
Medet, po ku më shkoi më i fismi i betimeve të mi?!

Një ditë përshkova si i verbër rrugë të bekuara, po ju hodhët
plehra në rrugën e të verbrit. Tash ai ka neveri për shtegun antik
të të verbrit.

Kur përmbusha gjënë më të vështirë, e kremtova fitoren e
kapërcimit të vetvetes: atëherë që më donin, ju i bëtë të ulërinin,
sikur unë t'ju shkaktoja aq shumë dhimbje.

Në të vërtetë, kjo pat qenë gjithmonë sjellja juaj: të vrerosnit
mjaltin më të mirë dhe zellin e bletëve të mia më të mira.

Ju i dërguat për të përfituar mëshirën time lypësit më të pacipë;
e shtytë gjithmonë kah dhembshurisë sime të pandreqshmit më
të paturpshëm. Kështu i plaguat virtytet e mia në besim e tyre.

Edhe kur ofroja si kurban gjënë më të shtrenjtë që kisha,
menjëherë mëshira juaj i shtonte asaj dhuratat më të fryra.
Kështu, në temjanin e dhjavit tuaj ju mbytët atë që për mua ish
më e shenjtë.

Një herë dëshirova të vallëzoja, siç nuk kisha vallëzuar kurrë: doja të kërceja në fluturim, sipër të gjitha qiejve. Atëherë ju korruptuat këngëtarin tim më të dashur.

Kësisoj, ai ia mori këngës së një melodie të zymtë e frikë-ndjellëse që më kumboi, medet, në vesh, si zëri i një briri të përzishëm.

Këngëtar vrasës, instrument i ligësisë, më i pafajshmi i të gjithëve. Unë isha gati për vallëzimin tim më të bukur, e ti ma vrave ekstazën time me këngën tënde.

Vetëm në vallëzim unë arrij t'i them me shëmbëllesa gjërat më sublime, por më sublimja e shëmbëllimeve mbeti e pashprehur në gjymtyrët e mia.

E pashprehur dhe e zhgënjyer, më sublimja shpresë. Bashkë me të vdiq edhe çdo vizion e ngushëllim i rinisë sime.

Si munda ta duroja?! Si i mposhta dhe i shërova plagët? Si mundi shpirti im të ringjallej nga varri?

Po, diçka të patundshme, të pavarrosur ka tek unë, që thërrmon shkëmbinjtë. Ai quhet vullneti im.

Përparon i heshtur dhe i pandryshueshëm përgjatë viteve.

Do të marshojë me këmbët e mira, vullneti im plak; i fortë është në zemër dhe i palëkundshëm.

Unë i palëkundshëm jam vetëm në thembra, kurse ti rron gjithmonë aty e je gjithmonë i ngjashëm me vetveten, o i fort-durueshëm! E po gjithmonë ti ai që shkon tutje tëhu, nga varri në varr.

Brenda teje rron akoma ajo pjesë e pashpëtuar e rinisë sime. Si jetë dhe rini ti qëndron këtu, duke shpresuar ende mes gërmadhavë të përzishme e të zverdhura.

Por ti për mua je ende shkatërruesi i çdo varri: përshëndetje, vullneti im. Se vetëm aty ku ka varre, ka ringjallje."

Kështu foli Zarathustra.

Për kapërcimin e vetvetes

Vullnet të së vërtetës, quani ju, o shumë të mençur, atë që ju nxit, ju frymëzon e ju bën kaq besues?

Vullnet të konceptimit të çdo gjëje ekzistuese: kështu unë e quaj vullnetin tuaj.

Çdo gjë që ekziston, ju doni ta bëni të konceptueshme, përderisa dyshoni me masën më të drejtë të mosbesimit, që mund të mendohet. Ajo duhet të nënshtrohet e përkulet përpara jush. Kështu e do vullneti juaj. Duhet t'ju zvarritet e t'ju vendoset poshtë shpirtit, si një pasqyrë dhe imazh i saj i shëmbëlluar.

Ky është tërë vullneti juaj, o shumë të mençur, e është gati një vullnet fuqie! Madje, edhe atëherë kur flisni për të mirën, për të keqen e për çmuarjen e vlerave.

Ju doni të krijoni botën, për t'u gjunjëzuar përpara saj: kjo është shpresa dhe dehja juaj e fundit.

Të pagdhendurit, pra populli, janë si lumi mbi të cilin pluskon një varkë. Në varkë qëndrojnë solemne e të mbuluara rrasat e vlerave. Ju i keni vendosur vlerat dhe vullnetin tuaj në lumin e ribërjes, kurse mua një vullnet i lashtë fuqie më zhvillon atë, që për popullin konsiderohet e mirë ose e keqe.

Qetë ju, o shumë të mençur, që i vendosët të tilla shpirtra në atë varkë e u dhatë një emër fortkumbues e gjithë shkëlqim; ju dhe vullneti juaj i sundimit.

Tashmë lumi e shpie përpara varkën: duhet ta zhvendosë. Pak rëndësi ka, nëse dallga që përplaset mbi shkëmb shkumëzon dhe i kanoset furishëm shkollës.

Nuk gjendet te lumi rreziku dhe fundi i së mirës e së keqes suaj, o shumë të mençur, por te vetë vullneti juaj, te vullneti i fuqisë: të pashtershmit dhe krijuesit vullnet të jetës.

Por meqë ju e kuptoni fjalën time, për të mirën dhe të keqen, unë dua t'ju them edhe fjalën time për jetën dhe për larminë e gjallesave të saj.

Për kapërcimin e vetvetes

Vullnet të së vërtetës, quani ju, o shumë të mençur, atë që ju nxit, ju frymëzon e ju bën kaq besues?

Vullnet të konceptimit të çdo gjëje ekzistuese: kështu unë e quaj vullnetin tuaj.

Çdo gjë që ekziston, ju doni ta bëni të konceptueshme, përderisa dyshoni me masën më të drejtë të mosbesimit, që mund të mendohet. Ajo duhet të nënshtrohet e përkulet përpara jush. Kështu e do vullneti juaj. Duhet t'ju zvarritet e t'ju vendoset poshtë shpirtit, si një pasqyrë dhe imazh i saj i shëmbëlluar.

Ky është tërë vullneti juaj, o shumë të mençur, e është gati një vullnet fuqie! Madje, edhe atëherë kur flisni për të mirën, për të keqen e për çmuarjen e vlerave.

Ju doni të krijoni botën, për t'u gjunjëzuar përpara saj: kjo është shpresa dhe dehja juaj e fundit.

Të pagdhendurit, pra populli, janë si lumi mbi të cilin pluskon një varkë. Në varkë qëndrojnë solemne e të mbuluara rrasat e vlerave. Ju i keni vendosur vlerat dhe vullnetin tuaj në lumin e ribërjes, kurse mua një vullnet i lashtë fuqie më zhvillon atë, që për popullin konsiderohet e mirë ose e keqe.

Qetë ju, o shumë të mençur, që i vendosët të tilla shpirtra në atë varkë e u dhatë një emër fortkumbues e gjithë shkëlqim; ju dhe vullneti juaj i sundimit.

Tashmë lumi e shpie përpara varkën: duhet ta zhvendosë. Pak rëndësi ka, nëse dallga që përplasat mbi shkëmb shkumëzon dhe i kanoset furishëm shkoklës.

Nuk gjendet te lumi rreziku dhe fundi i së mirës e së keqes suaj, o shumë të mençur, por te vetë vullneti juaj, te vullneti i fuqisë: të pashtershmit dhe krijuesit vullnet të jetës.

Por meqë ju e kuptoni fjalën time, për të mirën dhe të keqen, unë dua t'ju them edhe fjalën time për jetën dhe për larminë e gjallesave të saj.

I ndoqa pas të gjitha këto gjallesa në rrugën e tyre më të gjatë e në atë më të shkurtër, për t'ua njohur larminë. Me një pasqyrë qindra herë zmadhuese ua kapa shikimin, nëse goja u rrinte mbyllur, që të më fliste syri i tyre. E syri i tyre më foli.

Kudo ku gjeta gjallesa, aty dëgjova të flitej edhe për bindjen. Çdo njeri i gjallë është i bindur.

Pas kësaj, kjo është gjëja e dytë dalluese: komandohet ai që nuk mund t'i bindet dot vetes. Kështu rrojnë të gjallët.

Ndërsa kjo është gjëja e tretë që dëgjova: të komandosh është më e vështirë se të bindesh. E jo vetëm kaq, por, kush komandon mban mbi vete edhe peshën e atyre që binden, që lehtësisht mund ta shembë të tërin përtokë.

Çdo komandim më ngjau me një ndërmarje e një përvojë të rrezikshme; kur komandon, i gjalli e vendos veten gjithmonë në rrezik.

Po, edhe atëherë kur komandon vetveten, edhe në hije ai duhet ta paguajë shtrenjtë komandimin e vet. I duhet të bëhet gjykatës, hakmarrës dhe viktimë e ligjit të tij.

“Po si mund të ndodhë kjo? – e pyeta veten. - Ç’është shtyn vallë të gjallin të bindet, të komandojë e ta ushtrojë bindjen edhe duke komanduar.

Dëgjoni tash fjalën time, o shumë të mençur! Kontrolloni seriozisht, nëse kam tejshkuar deri në zemrën e jetës e deri në rrënjët e zemrës së saj.

Kudo ku gjeta gjallesa, po aty gjeta edhe vullnetin për pushtet. Madje, dhe në vullnetin e shërbëtorit gjeta vullnetin për të qenë padron.

Që më i dobëti shërben më të fortin, kjo nxitet nga vullneti i tij, vullnet ky që kërkon të jetë padron i të tjerëve më të dobët: ai s'mund të bëjë dot pa këtë kënaqësi.

Ashtu si më i vogli i jep më të madhit, për të pasur akoma, edhe më i vogli kënaqësi dhe pushtet, po kështu edhe më i madhi u jepet të gjithëve e, për dashuri të pushtetit vë në rrezik jetën e vet.

Ky është vetëmohimi i më të madhit, që është rrezik dhe kanosje dhe një lojë me zare përkrah vdekjes.

Edhe aty ku ka sakrifikim, servilizëm e vështrime dashurie, edhe aty ka vullnet për të qenë padron. Nëpër rrugë të fshehta depërton vjedhurazi më i dobëti drejt kështjellës, madje deri në zemër të më të fuqishmit, e i vjedh fuqinë.

Vetë jeta ma ka treguar këtë sekret. "Shiko, - më tha, - unë jam ajo që duhet ta kapërcejë gjithmonë vetveten."

Në fakt, ju e quani vullnet të lindjes, të nxjerrjes në dritë ose të shtytjes përkrah qëllimit, përkrah lartësimit, përkrah largësisë, përkrah shumëfishësisë, por e gjitha kjo është një gjë e vetme dhe një sekret.

Më me kënaqësi do të vdisja sesa ta mohoja këtë Njësh. Në të vërtetë, aty ku ka perëndim dhe gjethe-rënie, aty shikoje jetën të sakrifikohet për pushtetin.

Që unë duhet të jem luftë dhe bërje, qëllim dhe mohim qëllimi. Medet, kush e hamendëson vullnetin tim, hamendëson edhe se cilat rrugë të brendshme atij i duhet të përshkojë. Për atë që unë krijoj e, për aq sa e dua, menjëherë duhet t'i jem armik i saj dhe i dashurisë sime. Kështu do vullneti im.

Edhe ti, o njohës i dijes, nuk je veçse një shteg dhe një hije e vullnetit tim. Në të vërtetë, vullneti im i fuqisë ecën edhe në rrëpirat e vullnetit tënd të së vërtetës.

Nuk e rroku padyshim të vërtetën ai që hodhi pas saj fjalën: vullnet i ekzistencës, se një vullnet i tillë nuk ekziston! [Aluzion për Shopenhauerin, që predikoi mohimin e vullnetit të ekzistencës, egoist e të veçantë, edhe në parimin e kontradiksionit.]

Kësisoj, ajo që nuk ekziston, nuk mund të dëshirojë. Mirëpo, ajo që tashmë ekziston, si mundet të dëshirojë akoma ekzistencë?

Vetëm aty ku ka jetë ka edhe vullnet: jo vullnet të jetës, por, përkundrazi, siç po ta mësoj unë, vullnet të fuqisë.

Shumë gjëra, nga ai që rron, janë vlerësuar si më të larta se vetë jeta, por, pikërisht nga vetë ky vlerësim shfaqet dhe "vullneti për fuqi".

Kështu më mësoi një ditë jeta: me këtë, o shumë të dashur, unë po ju zgjidh enigmën e zemrës suaj.

Në të vërtetë, unë po ju them: e mira dhe e keqja, edhe të përjetshme qofshin, nuk ekzistojnë. Duhet të kapërcehen gjithnjë nga vetvetja. Me vlerat dhe fjalët tuaja të së mirës dhe së keqes, ju ushtroni autoritetin, o çmues të vlerave; kjo është dashuria juaj sekrete dhe vezullimi, drithërima e grafullimi i shpirtit tuaj.

Një autoritet më i madh e një fitore e re ngrihen prej vlerave tuaja: kundra tyre thyhet veza dhe lëvozhga e vezës.

E ai që dëshiron të jetë krijues në të mirë e në të keq; duhet të jetë, në të vërtetë, shkatërrues dhe përthyes i vlerave. Kështu, e keqja e epërme është pjesë e së mirës së epërme: kjo do të thotë të krijosh.

Le të flasim, pra, o shumë të mençur, është sepse është e dhimbshme. Është më e dhimbshme të heshtësh: çdo e vërtetë e fshehur bëhet helmuese.

Le të thyhet gjithçka që e vërteta jonë mund ta thyejë! Ka ende shumë shtëpi për të ndërtuar!”

Kështu foli Zarathustra.

Për sublimët

“I qetë është fundi i detit tim. Po kush mund ta mendonte vallë që do të fshihte përbindësia të çuditshëm? E pa turbulluar është thellësia ime: por rishkëlqen me mistere dhe buzëqeshje pluskuese. Sot unë pashë një sublim, një solemn, një të penduar të shpirtit. Oh, si ka qeshur shpirti im me shëmtinë e tij!

Megjoksin e gufuar, si të atij që merr frymë thellë, kështu qëndronte aty sublimi dhe heshte: i stolisur me të vërteta të tmerrshme, që ishin pretë e tij, i pasur me veshje të rreckosura. Edhe shumë gjemba i qenë ngjitur nga pas, por nuk i pashë asnjë trëndafil.

Ai nuk ka mësuar akoma as të qeshë e as ta njohë bukurinë. Është një gjahtar i kthyer i zymtë nga pylli i mençurisë.

I kthyer nga lufta kundra bishave të egra: por nga serioziteti i tij nëpërduket ende një bishë e egër, e pazbutur.

Ai rri aty gjithmonë si një tigër gati për të brofur; nuk më pëlqejnë këta shpirtra të ndehur, shija ime është armiqësore ndaj gjithë këtyre njerëzve të tërhequr. Po ju thoni, o miq, se nuk mund të diskutohen shijet dhe lezetet?

Mirëpo, e gjithë jeta është një debat për shijet dhe lezetet.

Shija: ajo është njëherësh pësia, peshorja dhe matësja. Mjerë të gjithë ata të gjallë që duan të rrojnë pa debat, pa peshën dhe peshoren!

Vetëm nëse do të lodhej edhe vetë ky sublim, nga sublimiteti i tij, vetëm atëherë do të niste t'i rishkëlqente bukuria; vetëm atëherë do të doja ta shijoja e t'ia ndjeja lezetin.

Vetëm kur të largohet nga vetvetja, mund të kapërcejë përtej hijes së tij, po në të vërtetë, brenda diellit të tij.

Shumë gjatë mbeti në hije, mollëzat i janë zverdhur e venitur penduesit të shpirtit; në pritje gati sa s'vdiq nga uria.

Përçmim ka në syrin e tij; neveria i fshihet në gojë. Është e vërtetë që tash po pushon, po pushimi i tij s'është shtrirë ende në diell.

I duhet të bëjë si një demi gëzimi i tij, duhet të kundërmojë erë toke; jo përçmim të tokës.

Do të doja ta shihja të ngjashëm me demin e bardhë, t'i paraprinte njësoj si ai plorit të parmendës, duke shfryrë e buluruar; bulurima e tij duhet të madhështojë gjithçka tokësore.

Fytyra e tij është akoma e errësuar; hija e dorës i bie përmbi. E fjetur është edhe shqisa e syrit të tij.

Madje, dhe vetë vepra e vet është akoma një hije përmbi të: dora e errëson atë që vepron. Ai nuk e ka kapërcyer ende veprën e vet.

Unë ia dashuroj qafën demore, por tani dua t'i shoh edhe syrin e engjëllit.

Ai duhet të çmësojë edhe vullnetin e tij heroik: duhet të jetë për mua një i lehtësuar e i çliruar, e jo vetëm një sublim; veç eteri duhet ta lartojë atë që është çliruar nga vullneti.

Ka mundur përbindësia, ka zgjidhur enigma, por duhet të çlirojë edhe përbindësat e vet, ashtu si dhe enigmat e veta, për t'i transformuar në vogëlushë qiellorë.

Dija e tij nuk ka mësuar ende të buzëqeshë e të jetojë pa xhelozi; pasioni i saj shpërthyes nuk është fashitur ende te bukuria.

Në të vërtetë, dëshirimi i saj nuk duhet të heshtë e të zhduket te nginja, por te bukuria. Mirësjellja i përket bujarisë së shpirtrave të mëdhenj.

Me krahun e palosur përposh kokës; kështu duhet të pushojë heroi e kështu duhet ta kapërcejë edhe pushimin e tij.

Pikërisht për heroin, e bukura është më e vështira e të gjitha gjërave. Bukuria është e paarritshme nga çdo vullnet i egër.

Ku më pak e ku më shumë, e drejta është ajo më shumë, ajo goxha më shumë.

Të qëndrosh me muskuj të shtendosur e të prehur dhe me vullnet të tërhequr: kjo është gjëja më e vështirë për ju, o sublimë!

Kur fuqia bëhet dashamirëse e zbret tek e ndjeshmja, unë këtë zbritje e quaj bukuri.

E nga askush unë s'e dua këtë bukuri, përveçse prej teje, o i fuqishëm! Mirësia qoftë fitorja juaj më e skajshme mbi vetveten! Unë të konsideroj të aftë për çdo të keqe, ndaj të mirën dua prej teje.

Në të vërtetë, unë kam qeshur shpesh me të dobëtit që e besojnë veten të mirë, vetëm pse kanë putra të paralizuara.

Ti duhet të kërkosh të barazohesh me virtytin e kolonës; sa më shumë lartohet aq më e bukur dhe e zhdërvjellët bëhet, por nga përbrenda më e fortë dhe e përmbajtur.

O sublim, një ditë ti do të duash të jesh edhe i bukur e, përballë bukurisë tënde të vendosësh një pasqyrë!

Atëherë shpirti yt do të shkundet nga një dashuri hyjnore; në kotësinë tënde mburravece do të ketë adhurim.

Ky është, në fakt, sekret i shpirtit. Vetëm kur heroi e braktis, i afrohet në ëndërr, Mbiheroi."

Kështu foli Zarathustra.

Për vendin e kulturës

“Fort thellë hyra tek e ardhmja, ku tmerri më pushtoi të tërin.

E kur hodha sytë përreth, ah medet! Tjetër shok s’kisha, përveç kohën. Atëherë nisa të kthehesha prapa, drejt shtëpisë, gjithnjë e më shpejt. Kështu arrita te ju, o njerëz të sotshëm, në vendin e kulturës.

Për herë të parë solla me vete një sy për ju, bashkë me dëshira të mira: kam ardhur me nostalgjinë në zemër.

Po si mundi të ndodhte kjo gjë? Sado që isha në ankth, m’u desh të qeshja. Nuk kisha parë kurrë gjë më të çuditshme laroshe. Qesha e qesha pa pushim, teksa këmbët dhe zemra më dridheshin akoma.

“Pa shiko, - i thashë vetes, - këtu është tamam atdheu i të gjitha kutive të bojërave!”

Për habinë time, o njerëz të sotshëm, ju qëndronit aty me fytyrën të zhyer në pesëdhjetë njolla bojërash.

Me pesëdhjetë pasqyra përreth jush, që dukeshin të falënderonin dhe lëvdonin lojërat tuaja me ngjyrat.

Nuk mund të zgjidhnit maskë më të mirë, o njerëz të sotshëm, për fytyrën tuaj! Kush do të mund t’ju njihte vallë?

Të gjithë të zhgarravitur me simbole të së shkuarës, por edhe këto simbole të ripikturuar sipër me shenja të reja. Kështu, mes gjithë deshifruesve të enigmave do të jetë i zoti ai që do t’ju kuptojë.

Qoftë edhe më i ushtruar në artin e interpretimeve, si mund ta mendoje vallë se ju i keni ende veshkat?

Ngjani aq shumë të mbujtur veç me ngjyra e gjethëza të ngjitura.

Të gjitha kohët dhe të gjithë popujt shfaqin plot ngjyra nëpër shallet e tyre; të gjitha zakonet dhe fetë flasin me ngjyrën e me gjestet e veta.

Kush prej jush që do të guxonte t'i zhvishte shallet e gjithçka që mbante veshur plot ngjyra e gjeste, do të shfaqte po aq mish sa do të mjaftonte për të bërë një dordolec për zogjtë.

Jam pikërisht unë ai zogu i trembur që ju pa lakuriq e pa ngjyra; e ia mbatha vrapit, kur skeleti ma shkeli syrin me dashuri.

Më mirë të isha një punëtor krahu në ferr e në botën e hijeve të kohës së shkuar!

Banorët e ferrit janë gjithmonë më të shëndoshë se ju! Pikërisht kjo më trishton të tërin, që nuk duroj dot t'ju shoh as lakuriq e as të veshur, ju o njerëzve të sotshëm!

Gjithçka që e ardhmja frikëson e u kall tmerr zogjve të humbur e të hutuar është, në fakt, më e durueshme dhe e pëlqyeshme se "realiteti" juaj. Se ju kështu thoni: "Duam vetëm atë që është e vërtetë, pa fe dhe pa supersticion", e kapardiseni si pallonj me gjoksin përpara, edhe pa pasur gjoks fare!".

Vërtet, po si mund të besoni vallë, nën ato njollat tuaja me ngjyra? Ju nuk jeni veçse piktura të gjithë asaj që u besua njëherë e një kohë! Jeni kontradiksionet shëtitëse të feve, zbutësit e të gjitha mendimeve. A e dini si ju quaj unë, o "realistë"? Të pabesë!

Të gjitha kohët zihen me njëra-tjetrën, duke dërdëllitur për shpirtrat tuaj. Po ëndrrat dhe pallavrat e të gjitha kohërave qenë, të paktat më reale se e gjithë mençuria juaj.

Jeni sterilë, ndaj ju mungon besimi. Ndërkohë që kush krijon ka pasur gjithmonë shenjat e veta largpamëse e simbolet e veta qiellore dhe ka besuar gjithmonë në një fe.

Jeni porta gjysmë të hapura, në të cilat rrinë e presin varrmihësit. Kjo është e vërteta juaj: "Çdo gjë meriton të plagohet".

Ah, ç'pamje keni ju o sterilë, në sytë e mi! Ç'racë brinjësh, që më shfaqni! Madje, ndokush nga ju, e kjo është më e bukura, ishte i ndërgjegjshëm për këtë gjë.

Thoshte kështu: A ishte vallë një zot ai që më hoqi diçka tinëzisht, teksa po flija? Pikërisht kjo gjë mjaftoi për të mburjtur ndonjë zonjëzë!

Është vërtet e çuditshme varfëria e brinjëve të mia! Kështu flet ndonjëri prej këtyre njerëzve të sotshëm.

Po a e dini se më bëni vërtet për të qeshur, ju o njerëz të sotshëm! Është e çuditshme të shohësh se sa shumë mrekulloheni nga vetvetja!

Mjerë unë, po të mos arrija të qeshja me habinë tuaj e të më duhej të pija gjithçka të përçmueshme që gurgullon prej bardhakëve tuaj!

Por unë nuk dua të mërzitem, sepse tjetër gjë të rëndë kam për të duruar. Ç'më duhet se mbi ngarkesën e eshtrave të mia ulen zektha e insekte?

Nuk është kjo ajo që do të më bëjë të rëndë! As nga ju, o njerëz të sotshëm, nuk do të më vijë ligështia e madhe.

Oh, po për ku duhet të ngjitem ende me nostalgjinë time? Nëpër të gjitha malet përreth unë po kërkoj atdheun tim, por se kam gjetur në asnjë vend këtë atdhe.

Ndaj, s'jam i qetë në asnjë qytet dhe marr gjithmonë arratinë drejt të gjitha porteve.

Të huaj më janë një shpoti, këta njerëz të sotshëm, kah të cilëve s'ka shumë kohë që po drejtohem, ndaj në arrati shkoj nga çdo atdhe e mëmëdhe.

Dua akoma vetëm tokën e bijve të mi, atdheun e panjohur, të shtrirë në më të largëtin oqean. Kah tij unë po shpalos velat e mia, që ta kërkojnë pa u lodhur kurrë.

Për bijtë e mi dua ta shlyej fajin e të qenit bir i baballarëve të mi, si dhe për gjithë kohët që do të vijnë, këtë të tashme!”

Kështu foli Zarathustra.

Për ndërgjegjen e panjollë

“Kur dje lindi hëna, ëndërrova të kish lindur një diell: kaq e shtrirë dhe dritë-plotë ajo dukej në horizont.

Po një gënjeshtare ish, sipas meje, me atë barrë që më nëpërduket, teksa më parë më kish bërë t'i besoja anës së saj burrërore se sa asaj femërore.

Sigurisht që është paksa mashkullore ajo mbretëreshë e ndrojtur e natës, ndërgjegje-keqe ecën ajo duke u endur sipër çative.

Aq epsharak e ziliqar është murgu hënor; ziliqar për tokën dhe të gjitha kënaqësitë e të dashuruarve.

Jo, aspak s'më pëlqen ajo mace mbi çati! Të urryer më janë të gjithë ata që zvarriten përreth dritareve gjysmë të mbyllura!

E heshtur dhe e devotshme ajo ecën, duke i përshkruar ngadalë qilimat e yjeve, por unë nuk mund t'i duroj dot të gjithë ata që ecin pa i bërë të dëgjohen hapat e tyre.

Hapi i çdo njeriu të mirë flet, ndërsa macja përbirohet fluturimthi mbi truall. Ja, edhe hëna e pandershme, që rrëshqet si një mace.

Këtë imazh po ua dhuroj juve, o hipokritë të penduar, juve o "njohës të kulluar"! Për mua jeni epsharakë!

Lërmëni tua them: edhe ju e dashuroni tokën dhe gjithçka tokësore. Por në dashurinë tuaj ka një masë turpi dhe ndërgjegje të keqe: i ngjani shumë Hënës.

Shpirti ju është yshtur në përçmimin e gjërave tokësore, por jo rropullitë tuaja: këto janë ato që për ju vlejnë më shumë. Ndaj, tash turpëroheni për shpirtin, që iu bindet të përbrendshmeve dhe i fsheh, duke marrë udhë të fshehta, udhë mashtrimesh.

Ja se si flet, për shembull shpirti juaj i gënjeshtres: "Për mua, gjëja më e lartë do të ishte vështrimi i jetës me një shikim të kulluar, pa zjarrmi, e jo siç bën qeni, llapë jashtë. Do të ishte të qenit i lumtur në kundrimin e kulluar, gjithmonë me vullnet, pa hije egoizmi të zjarrmuar, i ftohtë e i përhimët në të gjithë trupin, por me sy të dehur hënorë!

Këtë do të doja, se është kështu që i mashtruarit mashtron vetveten, "dashuron Tokën siç e dashuron Hëna, e ia admiron bukurinë veç me sy. Kjo është për mua ndërgjegjja e panjollë e

të gjitha gjërave: të mos të të ngjitet asnjë dëshirim për gjërat, të rrish përpara tyre si një pasqyrë me njëqind sy”.

Oh, ju neurotikë, hipokritë dhe epsharakë! Ju mungon pafajësia në dëshirim, ndaj flisni keq për dëshirimin!

Nuk dini ta dashuroni tokën si krijues, si gjenerues, si dashurues të ribërjes!

Ku është pafajësia? Aty ku është vullneti për të gjeneruar. Ai që do të krijojë përtej vetvetes, është për mua ai që zotëron vullnetin më të kulluar. Ku është bukuria? Atje ku unë duhet të dua me gjithë fuqinë e vullnetit, atje ku unë dua të dashuroj e të perëndoj, derisa një imazh të mos mbetet veçse një imazh.

Të dashurosh e të vdesësh: janë dy gjëra të ngjashme që në përjetësi. Vullneti i dashurisë është edhe vullneti i vdekjes. Këtë, po ju them, o qullashë!

Mirëpo, vështrimin e pafuqishëm brenda një kupe të zbrazur ju e quani “shpirt të kundërimit”.

Kurse ajo që shihet me sy të trembur u dashka të quhet “e bukur”. Oh, ju o fëlliqësirat e emrave fisnikë!

Ky është mallkimi juaj, o të panjollosur, o njohësit e kulluar, që nuk prodhoni kurrë asgjë, qoftë edhe sikur të shtriheshit të mëdhenj aq sa jeni përgjatë horizontit!

E mbushni gojën plot me fjalë fisnike e ne na u dashka të besojmë që ju flisni nga thellësia e zemrës suaj, o hipokritë!

Fjalët e mia, në të kundërt, janë të mjerueshme, të përçmuara, fjalë të copëtuara. Ndaj, me dëshirë unë mbledh thërrimet që bien nga tryeza juaj. Me to unë arrij tua them gjithmonë të vërtetën, hipokritëve! Guaskat e mia të lëmuara dhe gjethet e rrushkullit duhet tua ngacmojnë hundën hipokritëve.

Përreth jush e përreth tryezave tuaja ka gjithmonë erë të keqe: mendimet tuaja epsharake, gënjeshtat dhe strehimet e nëndheshme ndihen që në ajër.

Paçi, qoftë edhe njëherë, guximin të besoni te vetvetja, te ju e te brendia juaj! Kush nuk ka besim te vetja, thotë gjithmonë gënjeshtër.

Ju varni larvën e një zoti përreth vetës suaj, o “të kulluar”, sepse krimbi juaj vetmitar shkoi të mbyllet në larvën e një zoti.

Po gaboni vërtet, o “kundrimtarë”! Edhe Zarathustra një kohë qe tellalli i rrëshekëve tuaj hyjnorë, pa e kuptuar se qenë droçka plot me gjarpërinj.

Një kohë besova të shihja një shpirt hyjnor në sytë tuaj, o njohës të kulluar!

Nuk njihja art më të mirë se arti juaj. Largësia më pengonte të ndjeja ndyrësinë dhe erën e fëlliqur të gjarpërinjve dhe dredhinë e një hardhuce që i vinte rrotull ashtu gjithë lyrë.

Por më pas i erdha afër: atëherë mbërriti dita - e do të vijë edhe për ju - që dashurorët e hënës të marrin fund.

Shihni njëherë e mirë se si qëndrojnë punët! A s’ e shihni se si qëndron e zbehtë dhe tinëzare para dritës së kuqërremë të aurorës?!

Sepse tash po arrin aurora e zjarrtë, po vjen edhe dashuria e saj për tokën! Çdo dashuri diellore është pafajësi dhe zjarrmi krijimi.

Shiheni se si ajo po vjen aq e paduruar në det! Nuk e ndjeni etjen dhe gulçimin e ngrohtë të dashurisë së saj?!

Ajo do të thithë gjinjtë e detit e të pijë thellësinë e tyre, duke e frymuar lart; ja teksa dëshirimi i detit po ngrihet me mijëra gjinj përpjetë. Do të puthet e të përthithet nga etja e diellit; do të bëhet ajër, lartësi e shteg i dritës edhe ajo vetë.

Se vërtet, si dielli, unë e dua jetën dhe të gjitha detet e thella. Kjo, për mua, është dituria. Gjithçka që është në thellësi duhet të ngjitet të arrijë lartësinë time!”

Kështu foli Zarathustra.

Për të kulturuarit

Kur po shtrihesha i dremitur, një dele nisi të më ndukë kurorën e dredhëzave mbi kokë e kafshonte lehtë e thoshte: “Zarathustra nuk është më i kulturuar”.

Pasi foli kështu, shkoi e krekosur dhe e ngazëllyer. Ma tregoi një fëmijë, sepse unë gjithë dëshirë rri aty ku lodrojnë fëmijët, ndanë një muri të prishur, mes carangthave dhe lulëkuqeve.

Një i kulturuar unë jam ende për fëmijët, carangthat dhe lulëkuqet.

Ata të pafajshëm janë edhe në ligësinë e tyre.

Kurse për delet nuk jam më: këtë deshi fati im; qoftë i bekuar!

Sepse kjo është e vërteta: u largova nga shtëpia e të kulturuarve dhe përplasa derën pas meje.

Shumë gjatë ndenji shpirti im i uritur në tryezën e tyre; nuk jam si ata, aq i përgatitur të di se si zgjidhen enigmat.

Lirinë unë dashuroj e ajrin sipër tokës së freskët. Më mirë parapëlqej të fle mbi lëkurën e buallit sesa mbi dinjitetin dhe respektin e tyre.

Jam shumë i nxehtë e i përzhitur nga mendimet e mia: shpesh më zihet fryma. E atëherë, më duhet medoemos të dal në ajër të pastër, jashtë prej të gjitha dhomave gjithë pluhur.

Ato sharrojnë së ftohti në hijen e ftohtë: në çdo gjë duan të jenë vetëm kundrues, që përkujdesen aq shumë të mos ulen aty ku dielli djeg shkallaret.

Janë të ngjashëm me ata që rrinë anës rrugës e shikojnë me gojë hapur kalimtarët. Edhe ata presin, e rrinë e vështrojnë mendimet e menduara nga të tjerët.

Nëse i kap me duar, bëjnë një pështjellë pluhuri rreth vetes, si të qenë thasë me miell, edhe pse pa dashur. Po kush do të mendonte, vallë, se pluhuri i tyre vjen nga gruri dhe nga kënaqësia e provuar e fushave verore?!

Nëse japin prova mençurie, thëniat e vockla dhe të vërtetat e tyre më bëjnë të rrëqethem. Shpesh, nga dija e tyre kundërmon një erë që duket sikur vjen nga moçali; më ka ndodhur të dëgjoj vërtet kroatjen e bretkosave.

Janë të aftë, kanë gishtërinj të shkathët. Ç'mund të bëj unë me thjeshtësinë time përballë komplikimeve të tyre? Ata

gishtërinj kuptojnë çdo nyje e ind endjeje të çdo cohe: e dinë mirë se si enden çorapet e shpirtit.

Edhe orë të sakta ato janë: mjaft që t'i kurdisësh mirë. Atëherë s'gabojnë në tregimin e kohës, duke bërë një tik-tak të lehtë.

Si shumë të tjerë punojnë e bluajnë: mjaft që t'u vesh brenda farërat. E dinë vetë si t'i kthejnë në pluhur të bardhë.

E shohin me kujdes njëri-tjetrin në duar e s'kanë besim. Dinakë në sajimin e dredhive të vogla, mezi i presin ata që çalojnë nga dituria; i presin ashtu siç bëjnë merimangat.

I kam parë t'i përgatisin gjithmonë me kujdes helmet e tyre, me doreza të xhamta.

Edhe me zare hileqare dinë të luajnë; i kam parë të luajnë me aq shpejtësi sa të djersinin.

E vërteta është se ne jemi të huaj me njëri-tjetrin e virtytet e tyre më ngjallin neveri, akoma edhe më shumë se hipokrizia dhe zaret hileqare.

Ndaj, kur banoja pranë tyre, në fakt, unë banoja sipër tyre. Për këtë gjë tërboheshin nga zemërimi.

Nuk donin të dëgjonin asgjë që t'i mëshonte diçkaje që qëndronte sipër kreve të tyre. Kështu grumbullonin dërrasa dhe mbeturina mes meje e mendjeve të tyre.

E shuan në këtë mënyrë zhurmën e hapave të mija, se ata që s'më kanë dëgjuar fare deri tani kanë qenë më të kulturuarit. Mes meje e tyre vendosën cenet dhe mangësitë e gjithë njerëzve; "terren izolues", e quanin në shtëpitë e tyre.

Por, megjithatë, unë endem sipër kokave të tyre me mendimet e mia; madje, edhe po të hallakatesha sipër gabimeve të mia, nuk do të isha më pak sipër tyre dhe mendjeve të tyre.

Sepse njerëzit nuk janë të barabartë: kështu flet drejtësia. E atë që unë dua, ata nuk mund ta shohin!"

Kështu foli Zarathustra.

Për poetët

“Meqë njoh më mirë trupin, - i tha Zarathustra njërit prej dishepujve të tij, - shpirti për mua është ende sa për të thënë një shpirt e, “gjithçka e pandryshueshme” është edhe ajo veçse një simbol.” [Aluzion me vargjet përfundimtare të “Faustit” të Gëtes: “Gjithçka jetëshkurtër nuk është veçse një simbol”]

“Të kam dëgjuar edhe herë tjetër të thuash kështu,” - u përgjigj dishepulli. Atëherë shtove: “Mirëpo, poetët gënjejnë shumë”.

Përse the vallë se poetët gënjejnë shumë?”

“Përse? - tha Zarathustra. Ti pyet përse? Unë nuk u përkas atyre që mund të pyeten përse.

“Mos vallë për gjëra të së djeshmes? Shumë kohë më parë unë i njihja arsyet e mendimeve të mia. Po duhet të isha një vazo e kujtesës, nëse do të doja të mbaja brenda vetes edhe arsyet.

Është diçka e madhe për mua që t’i ruaj mendimet, se, hera-herës ndonjë zog fluturon tej.

Por hera-herës edhe në pëllumboren time vjen ndonjë zog i ri, që m’është i huaj e që drithëron, nëse ia vë dorën sipër.

Ç’të tha vallë një ditë Zarathustra? Që poetët gënjejnë shumë? Mirëpo, edhe Zarathustra është poet.

A beson pra, se unë po them të vërtetën? E përse e beson?”

Dishepulli u përgjigj: “Unë besoj te Zarathustra”. Por Zarathustra tundi kokën dhe buzëqeshi. “Besimi nuk më bën të lumtur,” - tha. - Të paktën, besimi brenda meje.

Nëse e pranojmë se dikush ka folur më me seriozitet, kur ka thënë “se poetët gënjejnë shumë”, ai ka të drejtë; ne gënjejnë shumë.

Dimë shumë pak gjëra dhe jemi studiues të këqij, andaj duhet edhe vetëm për këtë gjë të gënjejnë.

Kush nga ne poetët nuk do ta përziante verën e vet? Nëpër kantinat tona janë bërë përzierje të helmëta e kanë ndodhur gjëra të papërshkrueshme.

Përderisa dimë pak, na pëlqejnë me gjithë zemër të varfrit në shpirt, veçanërisht kur bëhet fjalë për vashëza të reja.

Por edhe për ato gjëra, që plakat rrëfejnë mbrëmjeve, ne jemi kureshtarë, zjarmues. I quajmë Fëmijëria e Përjetshme.

Njëlloj si të ekzistonte një qasje sekrete, e veçantë ndaj dijes, që humbet për ata që mësojnë diçka, kështu ne besojmë te populli dhe te mençuria e tij.

Veçse këtë e besojnë gjithë poetët; kush nëpër lëndina e kush nëpër rrëpira vetmitare, prehet e shtrin veshët për të kuptuar diçka për gjërat që rrinë midis qiellit dhe tokës.

Kur u mbërrijnë ato të ëmblat e të hijshmet vrulle të brendshme, poetët mendojnë gjithmonë se është vetë natyra ajo që është dashuruar me ta, së ajo hyn fshehurazi në veshët e tyre, për të thënë diçka sekrete e disa fjalë të këndshme dashurie, me të cilat ata lëvdohen dhe fitojnë lavdi përpara gjithë mortorëve.

Oh, medet, ka gjëra midis qiellit dhe tokës, për të cilat kanë ditur të ëndërrojnë vetëm poetët! Madje, edhe sipër qiellit, sepse gjithë zotat janë simbole të poezisë, këshillime poetike.

Vërtet, shtyhemi gjithmonë për së larti [Referimi ndaj dy vargjeve të fundit të "Faustit" të Gëtes], përkrah mbretërisë së reve; mbi to vendosim tullumbacet tona laramane, për t'i quajtur pastaj Zota e Mbinjerëz, sepse aq të lehtë janë për frone të këtij lloji, gjithë këta Zota e Mbinjerëz.

Ah, sa i lodhur jam nga gjithçka e papërfunduar e që, në të vërtetë duhet të bëhet fakt tërësisht konkret. Ah, sa i lodhur jam prej poetëve!

Kur Zarathustra tha këto fjalë, dishepulli provoi zemërim kundra tij, por mbeti i heshtur. Edhe Zarathustra heshti e syri iu kthye drejt brendësisë së vet, njëlloj sikur të shikonte largësi të shtrira. Pastaj psherëti, duke mbajtur frymën.

"Unë jam sot e përgjithmonë," - tha më pas, - por ka diçka tek unë që është e së nesërmes, e së pasnesërmes dhe e çdo kohe të së ardhmes.

U lodha nga poetët, si nga antikët ashtu edhe nga të rinjtë: të gjithë janë për mua sipërfaqësorë e dete të cekëta.

Nuk mendojnë tepër në thellësi: ndaj ndjesia e tyre nuk e arrin kurrë fundin.

Njëlloj kënaqësie e njëlloj mërzie; ja se ç'është mendimi i tyre më i mirë.

E gjithë muzika e harpës së tyre për mua është një puhi dhe vallëzim tinëzar fantazmash. Ç'kanë mundur vallë ata të dinë për ngrohtësinë e vërtetë të tingujve?

Për më tepër, që për mua nuk janë ende botë: i turbullojnë të gjitha ujërat, për t'i bërë të duken të thella.

Me dëshirë hiqen e krekosen si të jenë pajtues, por për mua mbeten ndërmjetës dhe përzierës, persona përgjysmë e pakëz të pastër.

Medet, hodha rrjetat e mia në detet e tyre, duke dashur të bëj ndonjë peshkim të mbarë, por në breg nxora gjithmonë kokën e një hyjnie të vjetër.

Kështu, të uriturit, deti i dha një gur. Pra, edhe ata vetë në fund të detit mund të dalin prej tij.

Ka padyshim në mes tyre edhe perla, por shumica i ngjan stridheve guaskë-forta. Ndërsa për shpirtin, te ta gjeta shpesh veçse mukus kripe.

Kanë mësuar prej detit edhe burracakërinë e tij. Pse vallë, s'është deti më i krekosuri i gjithë të krekosurve.

Edhe përpara me të shëmtuarit të gjithë buajve, ai rrokullis shestimin e vet e s'lodhet kurrë nga ato freskoret e tij prej dantellash të mëndafshta e argjendore.

Mirëpo, bualli e sheh i padenjë, i afërt me rërën në shpirtin e vet, akoma më i afërt me pyllishtat e dendura, e akoma më shumë me moçalishtet.

Ç'janë për të bukuria, deti dhe stolitë e palloit? Ja, një krahasim që unë po jua mësoj poetëve.

Se vërtet vetë shpirti i tyre është si më palloi i pallonjve e një det i tërë mburracakërie!

Shpirti i poetit do spektatorë: qofshin ata edhe veç buaj.
Me këtë lloj shpirti jam tashmë i lodhur, të afërt e shoh
çastin kur edhe ai do ta lodhet nga vetvetja.

Madje, i shoh tash poetët të shndërrohen në të tjerë, duke i
kthyer shikimet nga vetja.

Si pendimtarët e shpirtit i shoh të vijnë e të dalin jashtë prej
saj.”

Kështu foli Zarathustra.

Për ngjarjet e mëdha

Ka një ishull në mes të detit, jo larg nga Ishujt e Lumtur
të Zarathustrës, mbi të cilin tymon vazhdimisht një vullkan.
Populli, por, veçanërisht plakat, thonë për të se është vendosur si
një shkrep përpara portës së ferrit.

Në kohën kur Zarathustra banonte në Ishujt e Lumtur,
ndodhi që një anije të ankorohej përpara ishullit, në të cilin
gjendej mali tymues. I gjithë ekuipazhi zbriti në tokë për
të gjuajtur lepuj. Aty nga ora e mesditës, kur kapiteni dhe
ushtarët sapo mblidheshin, papritmas panë një njeri që vinte
drejt tyre përmes ajrit e dëgjuan një zë që fliste qartësisht:
“Është ora! Mbërriti ora!”. Kur figura po vinte gjithmonë e
më afër, teksa kaloi me shpejtësi si një hije, në drejtimin ku
ngrihej vullkani, ata kuptuan me një habi të përgjithshme se
ai ishte Zarathustra. E njihnin që të gjithë, përveç kapitenit,
dhe e dashuronin ashtu siç di të dashurojë vetëm populli:
duke bashkuar në masë të barabartë dashurinë dhe drojën.
“Shikoni, - tha timonieri i vjetër. - Ja Zarathustra që po shkon
drejt ferrit!”

Gjatë kohës që marinarët qëndruan në Ishullin e Zjarrit, u
hap lajmi se Zarathustra qe zhdukur. Kur pyetën miqtë e tij, ata i
treguan se ishte nisur gjatë natës me një anije, pa thënë për ku.

Përreth nisi të përhapej shqetësimi; pas tri ditësh, këtij ankthi iu shtua edhe rrëfimi i marinarëve; i gjithë populli nisi të thoshte se Zarathustrën e kish rrëmbyer djalli. Dishepujt e tij qeshnin me të tilla thënie; madje, njëri prej tyre arriti deri aty sa të thoshte: "Unë do të besoja më tepër se ka qenë Zarathustra ai që ka shkuar të kapë djallin". Megjithatë, thellë në shpirt ishin plot ankth e shqetësim. Ndaj, e madhe qe lumturia e tyre, kur ditën e pestë Zarathustra u shfaq në mes tyre. Ky ishte rrëfimi i kuvendimit të Zarathustrës me qenin e ferrit.

"Toka, - tha ai, - ka një lëkurë e kjo lëkurë ka sëmundje. Për shembull, njëra prej tyre quhet "Njeri".

Një tjetër quhet "qeni i ferrit", për të cilën njerëzit kanë gënjyer shumë dhe kanë lejuar të gënjehet.

Unë kalova detin për të zbuluar këtë mister; e pashë të vërtetën lakuriq, ashtu si ajo është, nga koka te këmbët.

Se si janë punët me qenin skëterror, tashmë unë e di; e njëjta gjë ndodh me gjithë demonët e dëbuar e të precipituar, prej të cilëve nuk frikësohen vetëm plakushët.

"Forca, dil jashtë, o qen i ferrit, nga thellësia jote, - i bërtita, - e na trego se sa e thellë është ajo! Nga vjen gjithçka që ti shfryn jashtë?

Ti pi me bollëk ujë nga deti; e dëshmon rrjedhshmëria jote e kripur. Në të vërtetë, për një qen të humnerave ti e merr ushqimin shumë në sipërfaqe!

Unë të vlerësoj po aq sa një palaço të tokës që flet me bark. Gjithmonë, sa herë dëgjoja të flisnin për demonë të dëbuar e të precipituar, ata më janë dukur si ty: të kripur, gënjeshtarë e sipërfaqësorë.

Ju dini të bulurini e të përziheni me hirin.

Ju jeni mburravecët më të mirë fjalëmëdhenj të botës dhe e keni mësuar aq mirë artin e gëlimit të fjalës. Kudo ku ju rrini, duhet të ketë përreth gjithmonë baltë dhe gjëra të flashkëta, të zgavërta, të ndrydhura, që gulçojnë për liri.

Liri, bërtisni të gjithë me aq shumë kënaqësi. Po unë e kam humbur besimin te ngjarjet e mëdha, kur ato shoqërohen nga kaq shumë britma e tym.

Besomë, o mik i zhurmshëm skëterror! Ngjarjet më të mëdha nuk janë orët tona më të zhurmshme, por ato më të heshtura.

Bota nuk rrotullohet përreth zbuluesve të britmave të reja, por përreth zbuluesve të vlerave të reja; e rrotullohet në heshtje.

Rrëfeje pra! Është parë gjithmonë se shumë pak gjëra kanë ndodhur, kur janë davaritur britmat dhe tymrat. Ç'rëndësi ka atëherë që një qytet të transformohet në një mumie dhe një monument të dergjet në baltë?!

Po u them edhe këtë fjalë përmbysësve të monumenteve. Është marrëzia më e madhe të hedhësh kripë në det dhe monumente në baltë. Në baltën e përçmimit tuaj dergjet monumenti, por ky është ligji i tij që, nga përçmimi juaj, tek ai të lindë sërish jeta dhe një bukuri e gjallë.

Ja, teksa me një vrull hyjnor brof përpjetë, i bërë joshës nga vuajtja. Vërtet! Ai do t'ju thotë edhe faleminderit që e përmbysët, o shkatërrimtarë!

Edhe këtë këshillë po ua jap mbretërve, kishave dhe çdo gjëje të vjetruar e të mangët nga virtytet. Lëreni veten që të përmbyseni! Kështu do të ktheheni përsëri në jetë e te ju do të kthehet virtyti".

Kështu i fola qenit të skëterrës; atëherë ai më ndërpreu e më pyeti: "Kisha? Po ç'është vallë?".

"Kisha, - iu përgjigja, - është një lloj shteti, por, në të vërtetë, më i gënjeshtërti. Ndaj hesht, pra, o qen hipokrit! Ti e njeh më mirë se të gjithë llojin tënd!

Si ti, edhe shteti është qen hipokrit; flet me dëshirë, si ti, me tym e me të bërtitura, për të na bërë të besojmë se po flet nga barku i gjërave.

Se shteti do të jetë absolutisht bisha më e rëndësishme e tokës, e kështu ndodh që ka shumë që e besojnë!"

Kur po i shqiptoja këto fjalë, qeni i ferrit bëri ca gjeste, si i marrosur prej tërbimit.

“Si? - ulëriti bisha më e fuqishme e tokës. – A ndodh shumë që e besojnë? Nga gryka i shpërtheu aq shumë avull e një zë aq monstruoz, sa që unë mendova se do t’i zihej fryma nga përçmimi dhe zemërimi. Më në fund, heshti. Edhe gulçimi i tij i ankthshëm s’u ndje më; por sapo ai heshti, unë i thashë duke qeshur:

“Ti inatosesh, o qen i ferrit! Atëherë, unë paskam të drejtë për ty!

Derisa të kem të drejtë, dëgjo me kujdes se ç’po të them edhe për një tjetër qen të ferrit, i cili flet realisht nga zemra e tokës.

Nga frymëzimi i shpërndahequr aq ar e aq shi i pruar: kështu do zemra e tij. Ç’gjë vallë është për të hiri, tymi e kremi i vluar?

E qeshura shpërthen prej tij si një re shumëgjyreshe; ai është i mbushur plot me dashamirësi për grafullimat, vomitjet e prerjet e tua të barkut.

Kurse arin dhe të qeshurën ai e merr nga zemra e tokës, se duhet ta dish se zemra e tokës është e artë.”

Kur qeni skëterror i dëgjoji këto fjalë, nuk deshi të dëgjonte më asgjë tjetër. I hidhëruar nga poshtërimi, tërhoqi bishtin, lëshoi britmën zemërlëshuar “Bau! Bau!”, e u fut në strofullin e tij.

Kështu rrëfeu Zarathustra. Por dishepujt e tij mezi i mbante vendi. Aq e madhe ishte dëshira për t’ua treguar historinë marinarëve të lepujve dhe njeriut fluturues.

“E ç’mund të mendoj unë vallë?, - tha Zarathustra, - që jam një fantazmë?”

Duhet të ketë qenë ndoshta hija ime. A keni dëgjuar ndonjëherë për shtegtarin dhe hijen e tij.

Një gjë është e sigurt: që unë duhet ta mbaj në fre, përndryshe, do të ma humbasë reputacionin.

E Zarathustra tundi sërish kokën dhe u mrekullua: “Ç’duhet të mendoj vallë?”, - përsëriti prapë.

Fantazma bërtiti: "Erdhi ora! Mbërriti momenti!"
 Për ç'gjë vallë mbërriti momenti?"
 Kështu foli Zarathustra.

Profeti

"E unë një trishtim të madh pashë të mbërrinte te njerëzit. Më të mirët nisën të lodheshin me veprat e tyre.

U shfaq një doktrinë dhe u shoqërua me një besim: Gjithçka është bosh, gjithçka është njësoj, gjithçka ka qenë njësoj!

E nga të gjitha kodrinat nisën të kumbonin po të njëjtat fjalë: Gjithçka është bosh, gjithçka është njësoj, gjithçka ka qenë njësoj!

Është e vërtetë se të vjelat qenë të mbara: po përse vallë të gjithë frutat na u nxinë e na u kalbën? Ç'ndodhi vallë natën e mbrame të hënës së keqe?

Gjithë puna dëm, u helmua vera jonë, syri i keq bëri të zverdhen fushat dhe zemrat tona.

Jemi të gjithë të zhvokshur e të përtharë; e nëse na bie zjarr, bëhemi pluhur si hiri: e lodhëm madje dhe zjarrin.

Të gjithë shatërvanet u thanë, edhe deti u tërhoq. Po hapet çdo humnerë, por thëpëra nuk do ta përpijë!

"Ah, po ku ka vallë akoma një det, një det ku mund të mbytemi", kumbon vajtimi ynë; e përshkron suprinat e moçaleve.

Se në të vërtetë shumë të lodhur jemi tash për vdekjen; e kështu vijojmë të rrimë zgjuar netëve e të rrojmë nëpër varreza?"

Kështu dëgjoji Zarathustra të fliste një profet; e provania e tij i zbriti deri në zemër dhe e transformoi. Nisi të endej i trishtë dhe i lodhur; u bë i ngjashëm me atë për të cilin fliste profeti. "Vërtet", - u tha dishepujve të vet, edhe për pak vjen perëndimi i gjatë. Medet, si mund ta shpëtoj dritën time?

Vetëm nëse nuk do gjendem i përfshirë në gjithë këtë trishtim! Në botë më të largëta duhet të shkëlqejë drita, e në netë më të gjata!”

Kështu i shqetësuar në shpirt vazhdonte të endej Zarathustra; e për tre ditë nuk vuri gjë në gojë, as gjeti paqe e s'foli asnjë fjalë. Më në fund ra në një gjumë të thellë. Dishepujt e tij i rrinin zgjuar përreth, netëve të gjata, duke pritur të ankthshëm që ai të zgjohej e të fliste përsëri, e të shërohej nga ai turbullim që e mundonte.

Ky pastaj është ligjërimi i Zarathustrës kur u zgjua; veçse zëri i tij, dishepujve u dukej se u arrinte nga një distancë e largët.

“Dëgjoni t'u tregoj ëndrrën që pashë, o miq, e ndihmomëni t'ia gjej kuptimin!

Një enigmë është për mua kjo ëndërr; kuptimi i saj është i mbyllur në të, e nuk po del ende jashtë duke shpalosur krahët.

Ëndërrova të kisha hequr dorë nga çdo lloj jete. Isha bërë roja e natës së varrezave, atje tej në kështjellën vetmitare malore të vdekjes.

Aty lart unë kundroja qivuret: galeritë e zymta ishin të mbushura plot me simbole fitoreje. Njëlloj sikur prej qivureve të qelqta të më shikonte një jetë tashmë e shkuar.

Frymoja erën e përjetësive të pluhurta: i afshuar dhe gjithë pluhur ishte shpirti im. E kush vallë mund t'i frynte në atë vend shpirtit tim?

Një kthjelltësi mesnate rrinte gjithmonë përreth meje, vetmia i kruspullohej aty pranë, e si e tretë, palëvizshmëria grahmonjëse mortore ish më e keqja e mikeshave të mia.

Mbaja çelësa nëpër duar, më të ndryshkurit e të gjithë çelësave; e me ta dija të hapja më të zhurmshmet e portave.

I ngjashëm me një kroatje të ligë kumbonte tingulli korridoreve të gjatë, sa herë që hapja kanatet e një porte: zogu klithte ogurkeq, sepse nuk donte të shqetësohej.

Po akoma më i kobshëm e tmerrndjellës ai ishte kur heshte, e përreth heshtja bëhej akoma dhe më e madhe, teksa unë qendroja i vetëm në atë qetësi të mbrapshtë.

Kështu kalonte e rridhte koha, për aq sa mund të kishte akoma një kohë. Ku ta di unë? Por së fundi ndodhi diçka që më zgjoi.

Tri herë u dëgjuan të trokitura te porta, të ngjashme me bubullima, e çatitë e galerive kumbuan duke uluritur tri herë: atëherë u drejtova për tek porta.

“Shejtan”, - brita, “kush e çon hirin e tij në mal? Alpa! Shejtan! kush e çon hirin e tij në mal?”

Futa çelësin në bravë, e u përpoqa ta hapja, duke u sforcuar. Por ajo s’qe hapur as edhe një gisht, kur një erë e furishme ia shkallmoi kanatat. E duke fishkëlluar e uturuar më vërviti sipër vetes një qivur të zi; e në pështjellimin, fishkëllimin e uturimin e erës qivuri u hap duke pështyrë jashtë mijëra të qeshura mijëra-formëshe.

Prej mijëra maska fëmijësh, engjëjsh, të marosurish, ojnatorësh e fluturash të mëdha sa një fëmijë, shpërthenin të qeshura, shpoti e mallkime kundra meje.

Pëshpërita i frikësuar: e u plandosa përtokë. Ulërita nga tmerri, siç nuk kisha uluritur kurrë. Po qe pikërisht kjo ulërimë ajo që më zgjoi e më solli në vete.

Kështu tregoi Zarathustra për ëndrrën e tij dhe heshti: përderisa nuk dinte akoma si ta interpretonte.

Por dishepulli, ai që e donte më shumë, u ngrit reëmbimthi, rroku dorën e Zarathustrës e i tha:

“Është vetë jeta jote ajo që e shpjegon këtë ëndërr, o Zarathustra!

Nuk je ti vallë era që fërshëllen duke fishkëlluar e duke hapur tej e tej portat e kështjellave të vdekjes?

Nuk je ti vallë qivuri plot ligësi shumëngjyrëshe e maskash ëngjëllore të jetës?

Në të vërtetë, i ngjashëm me mijëra të qeshura fëmijësh mbrin Zarathustra në të gjitha dhomat mortore, duke qeshur me rojtarët e natës së varrezave, e me ata që bëjnë zallamahi me çelësat e tyre makabër. Ti do t’i frikësosh dhe do t’i rrezosh përtokë me ngërdheshjen tënde; Zvenitja dhe rizgjimi i tyre do të dëshmojë fuqinë tënde mbi ta.

Po edhe nëse do të mbrijë perëndimi i gjatë dhe lodhja mortore, ti nuk do të vdesësh nën qiellin tonë, ti që je lëvduesi dhe lartnjësi i jetës!

Yje të rinj na tregove dhe mrekulli të reja mbrëmjesore; në të vërtetë, madje edhe të qeshurën ti e shtrive sipër nesh si një tendë të madhe shumë-ngjyrëshe.

Tani do të ketë gjithmonë një qeshje vogëlushësh që do të gurgullojë nga qivuret, se tashmë gjithmonë fitimtare do të vijë një erë e fortë për të pastruar çdo lloj lodhje mortore; për këtë, ti je vetë dëshmitari dhe paralajmëruesi!

Vërtet, je ti vetë ai që i ke ëndërruar armiqtë e tu: e kjo ka qenë ëndrra jote më e zymtë.

Po ashtu siç ti arrite më në fund të zgjoheshe e të vije në vete, po kështu dhe ata duhet të zgjohen e të vijnë në vete!”

Kështu foli dishepulli; e të gjithë të tjerët u mblodhën rreth Zarathustrës, e morën për dore e donin ta bindnin të linte shtratin dhe trishtimin e të kthehej tek ta.

Mirëpo Zarathustra qëndronte ulur mbi shtrat, me një shikim të tjetërsuar. I ngjashëm me atë që kthehet pas një pushimi të gjatë në një vend të huaj, ai shikonte dishepujt e tij dhe u tejkqyrte fytyrat; po akoma nuk i njihte. Kur më pas ata e ngritën dhe e mbajtën në këmbë, ja teksa syri i tij ndryshoi bafasisht, kuptoi gjithçka që kish ndodhur, përkëdheli mjekrën dhe tha me zë të fortë:

“Mirë pra, kjo gjë mori fund; ju ndërkaq mendoni, o dishepujt e mi, të përgatisni një drekë të mirë e në pak kohë! Kështu dua të bëj pendesë për ëndrrat e këqija!

Edhe profeti, duhet të hajë e të pijë në krahun tim: se vërtet, dua t'i tregoj akoma një det ku të mund të mbytet!”

Kështu foli Zarathustra. Shikoi dishepullin, që i kishte interpretuar ëndërrën, duke e kundruar gjatë në fytyrë, e tundi kokën.

Për shpëtimin

Një ditë, ndërsa Zarathustra po kalonte mbi një urë të madhe, u rrethua nga lypsa e sakatë, dhe një gungaç i foli kështu:

“Shiko, Zarathustra! Edhe populli mëson nga ty e fiton besim në doktrinën tënde; por që unë të të besoj deri në fund, më duhet akoma një gjë: ti para së gjithash duhet të bindësh sakatët! Këtu ti ke një motiv të bukur, e në realitet, një rast me aq shumë mundësi.

Mund t’i shërosh të verbërit dhe t’i bësh të ecin sakatët; e atij që ka një goxha xhungë në kurriz mund t’i heqësh një pjesë: kjo, sipas meje, është mënyra më e drejtë për të bërë që edhe sakatët t’i besojnë Zarathustrës!”

Mirëpo Zarathustra iu përgjigj kështu atij që i kishte folur: “Nëse i heq një gungaçi gungën e tij, i heq shpirtin: kështu na mëson populli. E nëse i jep shikimin të verbërit, ai do të shohë gjëra shumë të shëmtuara mbi tokë: aq sa do ta mallkojë atë që e ka shëruar. Kurse ai që bën sakatin të ecë, i bën dëmin më të madh: përderisa kur të nisë të ecë ai do të mbartë mbi vete edhe të gjitha veset e tij: kështu na mëson populli për sakatët. Ndaj përse vallë Zarathustra nuk duhet të mësojë nga populli, nëse vetë populli mëson nga ai?

Që kur jam në mes të njerëzve, ata për mua janë e keqja më e vogël që shoh: që dikujt i mungon një sy, një tjetri një vesh a një të treti një këmbë, ndërkohë që të tjerët kanë humbur gjuhën, hundën apo kokën”.

Shoh dhe kam parë gjëra më të këqija, e ca të tjera rrëqethëse, për të cilat nuk do të doja aspak të flisja, por megjithatë për ndonjërin prej tyre nuk mund të hesht; si p.sh. për ata njerëz të cilëve u mungon gjithçka, përveç asaj gjëje që e kanë të tepërt; njerëz që nuk janë asgjë tjetër veçse një sy i madh ose një gojë e madhe a një plënc i madh apo diçka gjithësesi e madhe; unë ata i quaj sakatë të përkëmbyer.

Kur dola jashtë nga vetmia ime e kalova për herë të parë mbi këtë urë, nuk u besova syve; shqyrtoja e vazhdoja të shqyrtoja, e së fundmi thashë: “Ky është një vesh!një vesh i madh sa një njeri!Pashë akoma edhe më mirë; e në të vërtetë pas veshit lëvizte diçka që ishte kaq e vockël, meskine dhe e brishtë sa të ngjallte mëshirë. Për fjalë të nderit, ai vesh monstruoz rrinte mbi një kërcell të vogël dhe të hollë; mirëpo ky kërcell ish një njeri! Nëse dikush do të vinte lente mbi sy, do të mund të shihte një fytyrë të vockël ziliqare dhe se një shpirtëzë e gufuar valonte mbi kërcell. Populli më tha se ai vesh i madh jo vetëm që ishte një njeri, por një njeri i madh, një gjeni. Nuk i besoj kurrë popullit, kur flet për njerëzit e mëdhenj: e kështu mbeta në opinionin tim, që ai ishte një sakat i përkëmbyer, që kishte shumë pak nga të gjitha, e shumë nga një gjë e vetme.”

Kur Zarathustra i foli kështu gungaçit dhe ayre të cilëve u ishte zëri dhe mbrojtja, iu kthye krejt i pakënaqur dishepujve të tij dhe tha:

Në të vërtetë, o miqtë e mi, unë eci mes njerëzve si mes fragmenteve dhe grumbujve të gjymtyrëve njerëzore!

Për sytë e mi kjo është gjëja më e tmershme, që unë ta shoh njeriun të copëtuar e të hallakatur si në një fushë beteje e në një thertore.

E nëse syri im do të përshkronte me të shpejtë kohën që nga e tashmja deri në të shkuarën, do të gjente gjithmonë të njëjtën gjë: fragmente e grumbuj gjymtyrësh, raste nga më të tmershmit; por jo njerëz!

E tashmja dhe e shkuara e tokës – medet! O miqtë e mi – kjo është gjëja më e padurueshme për mua; e nuk do të dija si të jetoja, po të mos isha profet i asaj që duhet të ndodhë.

Një profet, një njeri që dëshiron, një krijues, një e ardhme unë vetë dhe një urë për të ardhmen; e medet, si të thuash, edhe një sakat mbi këtë urë: e gjitha kjo është Zarathustra.

Edhe ju e keni pyetur veten shpesh: cili është vallë Zarathustra për ne? Si duhet ta quajmë atë? E ashtu si unë, ju dhatë pyetje

për përgjigje. Është një paraljmërues? Një rregullmbajtës? Një fitimtar? Apo një trashëgimtar? Një vjeshtë? Apo një vomitje? Një mjek? Apo një i shëruar?

Është poet? Apo një njeri që thotë të vërtetën? Një çlirues? Një njeri i mençur? Një njeri i mirë? Apo i lig?

Lëviz mes njerëzve si mes fragmenteve të së ardhmes: kjo është e ardhmja që unë shoh.

E ky është gjithë poetizimi im dhe prirja ndaj tij: që unë ta reduktoj poetikisht në një njësi dhe të lidh atë që është një fragment, enigmë dhe rast i turbullt.

E si mund të duroj të jem njeri, nëse njeriu nuk do të ishte edhe poet, edhe zgjidhës i enigmave, edhe shpëtimtar i fatit!

Shpëtimi i të ndjerëve dhe transformimi i çdo "qe" me një "kështu deshi"! kjo për mua do të ishte shpëtimi!

Vullnet, kështu quhet çliruesi dhe mbartësi i lumturisë: kështu unë ju mësova, o miqtë e mi! Po tash mësoni edhe këtë gjë: vetë vullneti është një i burgosur.

Vullneti i lirë: po si quhet ajo që vë në pranga edhe çliruesin?

"Qe": kështu quhet mprehësja e dhëmbëve të dëshirimit dhe dhimbja më vetmitare. E pafuqishme kundra asaj që është në fakt, spektator i keq i gjithë së shkuarës.

Vullneti nuk mund të kthehet mbrapsht; fakti që ai nuk mund ta thyejë kohën dhe dëshirat e kohës: ky është pezmatimi më vetmitar i vullnetit.

Vullneti i lirë: po ç'gjë vallë do të sajojë vullneti, për t'u çliruar nga pezmatimi e për ta bërë lojë të burgosjes së vet?

Medet! Çdo i burgosur bëhet një i marrosur! E përmes marrëzisë çlirohet edhe vullneti i burgosur.

Që koha të mos kthehet mbrapsht, kjo është brenga e tij; "ajo që qe", kështu quhet guri që ai nuk mund të hedhë.

E kështu i hedh gurët e tjerë me inat e zemërim, duke u hakmarrë me atë që nuk ndjen si ai, brengë dhe zemërim.

Kështu vullneti, çlironjësi, kthehet në diçka që bën keq; e për gjithçka që vuan, hakmerret duke mos e lënë të kthehet mbrapsht.

Kjo, kjo është hakmarrja në vetvete: urrejtja e vullnetit kundër kohës dhe “qe” të saj.

Se vërtet, një marrëzi e madhe banon në vullnetin tuaj, e është një mallkim për gjithë njerëzimin që kjo marrëzi është bërë shpirt!

Shpirti i hakmarrjes: kjo o miqtë e mi, ka qenë deri më sot mënyra më e mirë për të reflektuar; se aty ku gjendej e keqja, duhet të gjendej gjithmonë edhe dënimi.

Pikërisht “dënim” quhet hakmarrja në vetvete: gjithë fallsitet ajo stimulon një ndërgjegjje të mirë.

E përderisa në atë që dëshiron, në atë vetë gjendet dhe e keqja, për faktin se ai nuk mund të kthehet mbrapsht në dëshirimin e tij, po kështu, vetë vullneti dhe çdo jetë kthehet në një dënim!

Kësisoj ka ndodhur që re pas reje të jenë grumbulluar lart mbi shpirtin; deri kur marrëzia ulëriti: “Gjithçka kalon, gjithçka meriton të nëpërkalojë e të shuhet!”

“Drejtësi në vetvete është ai ligj i kohës, sipas të cilit ai duhet të hajë famijët e vet”: kështu ulëriti marrëzia.

“Në bazë të zakonit, gjërat rregullohen sipas asaj ç’ka na mëson e drejta dhe dënimi. Oh, po ku është çlirimi nga rrjedha e gjërave dhe nga dënimi i ekzistencës?": kështu ulëriti marrëzia.

“Ndoshta s’do të ketë kurrë vallë çlirim, nëse ekziston një jetë e përjetshme? Medet, i palëvizshëm është guri i “qe”, të përjetshme duhet të jenë të gjitha dënimet”: kështu ulëriti marrëzia.

“Asnjë veprim nuk mund të anulohet: e si mundet ajo vallë të shndërohet në virtytin e dënimit? Ky, është elementi i përjetshëm i dënimit të ekzistencës, që ekzistenca të jetë nga ana e saj edhe veprim edhe faj!

Qoftë edhe sikur vullneti ta çlironte vetveten, dhe dëshirimi të bëhej një mosdëshirim: po ju e njihni mirë, o vëllezër, këtë këngë të vjetër të marrëzisë.

Nga këto histori unë ju nxorra jashtë kur ju mësova: “vullneti është krijues”.

Çdo “qe” është një fragment, një enigmë, një fat i trishtë, deri kur vullneti krijues të shtojë: “Kështu desha unë!

Deri kur vullneti krijues të shtojë: “Kështu desha unë! E kështu do të vazhdoj të dua!”

Po a ka folur ai ndonjëherë kështu? E kur vallë ndodhi një gjë e tillë? A mos ndoshta vullneti e ka hequr qafe marrëzinë e tij?

Vullneti ndoshta qe çlironjësi dhe mbartësi i gëzimit të vet? A e harroi shpirtin e hakmarrjes e të gjithë atë skërmitje të dhëmbëve?

E kush e mësoi vallë që të ripaqëzohet me kohën, e me diçka më të lartë se çdo pajtim?

Diçka më të lartë se çdo pajtim duhet të dëshirojë një vullnet që të jetë vullnet i vërtetë fuqie: po si mund të ndodhë kjo gjë? Kush do t’ja ketë mësuar vallë mundësinë e kthimit prapa në veprimet e dikurshme?”

Në këtë pikë të ligjërimit të tij, ndodhi që befas Zarathustra heshti; ngjante me dikë që ishte shumë i friksuar. I vështroi dishepujt e vet me sy të terrorizuar; shikimi i tij i nëpërkalonte si shigjetë mendimet dhe prapamendimet e tyre. Por pas një ndalesë të vogël nisi të qeshë e të thotë me dashamirësi:

“Është e vështirë të rrosh me njerëzit, sepse është kaq e vështirë të heshtësh.

E çudishme kjo për dikë që flet shpesh”.

Kështu foli Zarathustra. Por gungaçi pasi kish dëgjuar ligjërimet e tij kish mbuluar fytyrën me duar; veç kur dëgjoji Zarathustrën të qeshte, vështroi gjithë kuriozitet dhe e pyeti:

“Po përse, o Zarathustra, neve na flet në mënyrë të ndryshme nga dishepujt?”

Zarathustra iu përgjigj: “Pse është kaq për t’u çuditur? Me gungaçët duhet të flasish gungaçse!”

“Epo mirë”, - ia ktheu gungaçi; “po njëlloj, me studiuesit duhet të shprehesh në mënyrën e studiuesve. Po përse atëherë Zarathustra flet ndryshe me studiuesit e ndryshe me vetveten?”

Për maturinë njerëzore

Jo lartësia, por përkulja është e rrezikshme!

Përkulja ku shikimi humbet përposh dhe dora shtrihet për lart. Atëherë zemra duket sikur resht për shkak të vullnetit të saj të dyfishtë.

Medet, o miq, a e zbuloni dot vallë gjithë vullnetin e dyfishtë të zemrës sime?

Kjo, kjo është përkulja dhe reziku im, kur shikimi më humbet kah lartësisë dhe dora ime dëshiron të mbahet e të humbasë në humnerë! Vullneti im kapet fort pas njeriut, unë zinxhizohem me njerëzit, sepse ndihem i frymëzuar për së larti drejt Mbinjeriut: tek ai priret vullneti im i dytë.

Ndaj si një i verbër unë rroj mes njerëzve: sikur të mos njihja; derisa dora ime të mos e humbasë krejtësisht besimin tek e përjetshmja.

Unë nuk ju njoh o njerëz: ky ngushëllim e kjo errësirë shpesh më mbështjellin të tërin.

Rri ulur nën këtë portik, i gatshëm për mbërritjen e çdo lloj kopuku e pyes: kush do të më mashtrojë vallë?

Kjo është maturia ime e parë njerëzore: që ta lë veten të mashtrohem, për të mos qenë i shtrenguar të ruhem nga njerëzit; si mundet vallë njeriu të ndërtojë një spirancë për topin tim? Lehtësisht do të ngjitesha lart, shumë lart, nëpër qiell!

Kjo është provania që rri mbi fatin tim, që unë duhet të rroj pa përkujdesje.

E kush mes njerëzve nuk do të vdesë nga etja, duhet të mësojë të pijë në të gjitha kupat; e kush mes njerëzve do të

qëndrojë i dliërë, duhet të përshtatet të lahet edhe me ujë të papastër.

Shpesh i kam thënë vetes për ngushëllim: "Forca, përpara, o zemër e vjetër! Një fatkeqësia jote pati një fund jo të lumtur: po ti gëzoje si të qe një fat!"

Kjo është maturia ime tjetër njerëzore: që unë të respektoj me shumë sedërlijtë se krenarët.

Sedra e plagosur s'është vallë nëna e gjitha tragjedive? Përkundrazi aty ku plagoset krenaria, aty lind diçka më e mirë se sa dhe vetë krenaria.

Që jeta të jetë e denjë të kundrohët, duhet të luhet e të recitohet mjaft mirë: për këtë lipsen aktorë të zotë.

E zbulova se të gjithë sedërlijtë janë aktorë të zotë: recitojnë e dëshirojnë që t'i shohin; i gjithë shpirti i tyre është i vendosur në këtë vullnet! Përfaqësojnë vetveten, shpikin vetveten. I respektoj sedërlijtë sepse janë mjekët e melankolisë sime dhe më mbajnë të zinxhirzuar te njeriu si te një spektakël.

E paskësaj: kush mund të gjykojë vallë tek sedërliu, gjithë thellësinë e thjeshtësisë së tij? Unë jam i mirë e i dhembshur me të, mos vallë për hir të kësaj thjeshtësie? Pret ta mësojë nga ju besimin në vetevete; ushqehet me shikimet tuaja, për lan lavdërimet e duarve tuaja.

Madje, ua beson dhe gënjeshttrat, nëse do të dinit të gënjenit mirë për të; sepse në thellësi të zemrës ai psherëtin: "po ç'jam unë vallë"? E nëse virtyti i vërtetë është ai që nuk e njeh vetveten, sedërliu nuk e njeh thjeshtësinë e vet!

Kjo, është më pas, maturia ime e tretë njerëzore: nuk e lë veten të shprishem nga frika e tyre, kënaqësia e syve të njerëzve të ligj. Jam i bekuar kur shoh mrekullitë që fsheh dielli përvëlues: tigrë, palma e gjarpërinj me zile. Edhe mes njerëzve ka mjaft gjëra të fshehura nën diellin përvëlues, e mjaft gjëra të mrekullueshme mes të ligjve. Se vërtet, ashtu siç të mençurit tuaj nuk më duken kaq të mençur, po kështu edhe ligësia e njerëzve m'u duk përposh

famës së saj. Ndaj kam pyetur shpesh, duke tundur kokën: përse e kumboni akoma zilen, o gjarpërinj me zile? Në të vërtetë, ka të ardhme edhe për të ligun!

E jugu më përvëlues, për njeriun nuk është zbuluar akoma. Sa shumë gjëra vallë quhen ligësi të tmerrshme, që nuk zgjaten më shumë se 12 këmbë dhe nuk shtrihen më shumë se në 3 muaj kohë!

Po një ditë dragonj shumë më të mëdhenj do të vijnë. E që mbinjeriut të mos i mungojë dragoi i tij, mbidragoi i denjë për të, një diell akoma më i nxehtë duhet të përvëlojë më të virgjërit pyje të lagësht!

Nga macet tuaja të egra duhet të zhvillohen tigrat, e nga thithlopat e helmëta krokodilët, sepse një gjahtar i zot duhet të ketë një gjah më të majmë! Se në të vërtetë, o të mirë e të këqinj, shumë gjëra në ju ia vlejné të qeshen, e mbi të gjitha frika juaj ndaj atij që deri më sot është quajtur "djall"! Kaq të huaj, ju dhe shpirtrat tuaj, jeni ndaj gjërave të mëdha, saqë Mbinjeriu, në gjithë mirësinë e vet, iu duket i frikshëm! E ju të urtë e të mençur, ju do të merrni arratinë nga dielli përvëlonjës i diturisë, ku Mbinjeriu do të kredhë, gjithë gaz, lakuriqësinë e tij.

Ju, o njerëz sublimë, me të cilët u ndesh shikimi im! Ky është, për ju, dyshimi im dhe e qeshura ime sekrete: e kuptoj se Mbinjeriun tim do ta quani një djall! Medet, u lodha nga sublimët dhe të mirët: nga "lartësitë" e tyre dëshirova të shikoja akoma më lart, jashtë, tej, larg, drejt Mbinjeriut! Më mbërtheu tmerri, kur më të mirët pashë lakuriq: atëherë më shpërthyen flatrat për të fluturuar tej, kah një të ardhme të largët.

Në më të largtën të ardhme, në më jugorin Jug, që artisti ka ëndërruar ndonjëherë: aty, ku zotat turpërohen nga çdo petk që u vesh trupin!

Po unë juve, o të afërm e fqinj, dua t'ju shoh të veshur bukur e të stolisur, sedërlinj e dinjitozë, siç u shkon për shtat të "mirëve dhe të drejtëve". E kështu i zbukuruar të ulem edhe unë midis

jush, që të gënjehem për ju e për veten time: kjo është maturia ime e fundit njerëzore”

Kështu foli Zarathustra.

Ora më e heshtur

“Ç’po më ndodh vallë, o miqtë e mi? Më shihni të shqetësuar, të yshtur e të bindur, kundra vullnetit tim, e gati për të ikur; medet, për t’u larguar nga ju!

Po, edhe njeherë tjetër Zarathustra duhet të kthehet në vetminë e tij: veç këtë herë ariu kthehet i padëshirë në strofkullën e vet!

Po ç’më ndodhi vallë? Kush ma dikton këtë gjë? Medet, kështu do zonja ime e zemëruar, kështu ajo më foli; s’jua ka thënë ndonjëherë emrin e saj?

Më foli mbrëmë në darkë, ora ime më e heshtur: ky është emri i zonjës sime të tmerrshme.

Ja, kështu ndodhi. Duhet t’ju tregoj gjithçka, që të mos ngurtësohet zemra juaj kundra atij që po largohet papritur. A e njihni tmerrin e atij që bie në gjumë?

Është i terrorizuar deri në gishtat e këmbëve, sepse ndien t’i rrëshqasë toka nën këmbë e t’i fillojë ëndërrimi.

Këtë po jua them për alegori. Dje në orën më të heshtur më rrëshqiti toka nën këmbë e më filloi ëndërrimi.

Akrepi nisi të zhvendoset, ora e jetës sime mori frymë, aq sa s’kisha ndjerë kurrë një heshtje të tillë përreth meje: ja, se si u frikësua zemra ime.

Pastaj diçka pa zë nisi të më fliste: “Ti e di, o Zarathustra?”

Bërtita nga tmerrin duke dëgjuar atë murmurimë, e gjaku më iku nga fytyra: megjithatë heshta. E ja tek përsëri ajo gjë e pazë më foli kështu: “Ti e di, o Zarathustra, por nuk do ta thuash!”

Më së fundi u përgjigja, me një zë sfidues:

“Po, e di, por nuk dua ta them!”

Sërish ajo gjë e pazë më foli: "Vallë ti nuk do, o Zarathustra? Pra, është e vërtetë që ti nuk do? Mos u fshih pas përçmimit tënd."

Duke qarë e duke u dridhur si fëmijë, unë i thashë: "Medet, do të doja, sa do të doja, po si? Hiqma këtë detyrë! I tejkalon fuqitë e mia?"

Po përsëri zëri i pazë më foli: "E ç'më intereson ti, o Zarathustra! Thuaj fjalën tënde e shkërmohu!"

E unë ju përgjigja: "Ah, është vallë fjala ime? Po unë, çfarë jam? Pres një më të denjë; se unë i denjë s'jam as për t'u shkëmuar për të!"

Atëherë zëri i pazë më foli kështu: "Ç'të intereson? Ti nuk je ende i përvulur aq sa duhet. Përvulësia e ka lëkurën goxha të fortë."

Ia ktheva: "E ç' nuk duroi vallë deri tani lëkura e përvulësisë sime! Unë banoj në këmbë të lartësisë sime: po sa të larta janë majat e mia? Askush s'ma ka thënë ende. Njoh mirë veç luginat e mia?"

Po përsëri zëri i pazë foli brenda meje: "O Zarathustra, ai që di të zhvendosë malet, di të zhvendosë edhe luginat dhe ultësitat".

E unë thashë: "Fjala ime nuk i ka zhvendosur ende malet, e ajo që kam thënë s'ka mbërritur ende te njerëzit. Është e vërtetë që unë iu drejtova njerëzve, por s'kam depërtuar ende në zemrën e tyre."

Sërish zëri i pazë foli brenda meje: "Po ç'mund të dish ti? Vesa bie mbi bar atëherë kur nata është më e heshtur."

E unë i vëreja: "Më tallën kur unë e gjeta rrugën time e u nisa drej saj; po në të vërtetë, këmbët e mia dridheshin."

Më thanë: ti harrove udhën, tani harro dhe si të ecësh!

Atëherë përsëri zëri i pazë foli brenda meje: "Ç'të duhet buzëqeshja e tyre? Je si ai që e ka harruar bindjen: ndërkohë që tani je ti ai që duhet të komandosh!"

"A se di vallë se kush është më i nevojshmi i njerëzve? Ai që komandon gjëra të mëdha."

Të përmbushësh gjëra të mëdha është e vështirë: por gjëja më e vështirë është të komandosh gjëra të mëdha.

E kjo është ajo që mund të të falet më pak: ti e ke fuqinë, dhe nuk do të komandosh!"

E unë ia ktheva: “Mua më mungon zëri i luanit për të komanduar”.

Atëherë një pëshpërimë foli brenda meje: “Fjalët më të heshtura janë ato që lindin furtuna. Mendimet që vijnë me këmbë pëllumbash udhëheqin botën.

O Zarathustra, ti duhet të shkosh si një hije e asaj që duhet të vijë! Kështu do të komandoshe e duke komanduar do të jesh në krye të njerëzve.

E unë iu përgjigja: “Më vjen turp.”

Atëherë përsëri zëri i pazë foli brenda meje: “Është e nevojshme që ti të bëhesh një fëmijë e ta harrosh turpin.

Krenaria rinore është akoma brenda teje, se vonë ti u rinove: por kush do të bëhet fëmijë, duhet ta kapërcejë edhe një herë rininë e tij.”

Kështu, unë nisa të mendoja gjatë e të filloja të dridhesha. Më së fundi thashë po atë që kisha thënë më parë: “Nuk dua”

Atëherë shpërthyen të qeshura kudo përreth meje. Medet, sa fort m’i shqyente rropullitë ajo e qeshur e si ma coptonte zemrën!

E për herë të fundit ndieva atë zë të më fliste: “O Zarathustra, frutat e tua janë pjekur, por ti nuk je i pjekur për frutat e tua!

Prandaj, në vetmi duhet të kthehesh: sepse ende duhet të piqesh.

E përsëri shpërtheu kudo një e qeshur e një arrati e çdokujt përreth meje: pastaj ra heshtja, njësoj sikur qetësia të ish dyfishuar. Ndërkaq unë dergjesha i plandosur përdhe, teksa djersa më kullonte nga gjymtyrët. Tash ju keni dëgjuar gjithçka, e përse unë duhet të kthehm në vetminë time. S’ju kam fshehur asgjë, o miq.

Po dëgjuat edhe këtë prej meje: se kush është më i heshturi i të gjithë njerëzve e kush do të jetë i tillë!

Oh, miqtë e mi! Kisha edhe diçka për t’ju thënë, diçka tjetër! E përse nuk ua jap? Mos jam gjë kurnac?”

Me të thënë këto fjalë, Zarathustra u mposht nga fuqia e dhimbjes dhe afrimi i orës së lamtumirës me miqtë e vet, ndaj nisi të qajë me zë të lartë; askush nuk dinte si ta këshillonte. Kur u bë natë, më pas, iku i vetmuar dhe i braktisi miqtë.

PJESA E TRETË

Ju shikoni lart, kur prireni kah lartësimin. E unë shoh poshtë, në thellësi, sepse tashmë jam i lartuar.

Kush prej jush mund të qeshë e njëherësh të jetë i lartuar?

Kush ngjitet nëpër male të larta, qesh sipër të gjitha tragjeditë e të gjitha trishtimeve të shtira!

“PËR TË LEXUARIN DHE TË SHKRUARIN”

Shtegtari

Ishte gati mesnatë, kur Zarathustra mori udhën e vet në kodrinën e ishullit, për të arritur që pa gdhirë bregun tjetër, sepse që prej atij donte të hipte në anije. Në fakt, aty ishte një paraportë, ku hidhnin shpesh spirancën anije të huaja, duke i marrë me vete të gjithë ata që donin të kalonin detin, që prej Ishujve të Bekuar. Ndërsa Zarathustra po ngjitej në mal, duke ecur nisi të mendonte endjen e tij të gjatë në vetmi, që nga koha e rinisë, se sa male, maja e kodrina kish ngjitur.

“Unë jam një shtegtar e një ngjitës lartësish, - i tha zemrës. - Nuk e dashuroj uniformitetin; më ngjan se nuk mund të rri dot gjatë në reshtje.

Çfarëdolloj gjëje të më mbërrijë, si fat e përvojë për t'u duruar, unë do të jem gjithmonë një shtegtar dhe ngjitës lartësish, se, tek e fundit, nuk eksperimentohet kurrë përveçse mbi vetveten.

Shkoi koha kur mund të më ndodhnin fatkeqësi. Pastaj, ç'gjë mund të më ndodhë vallë, që nuk më ka ndodhur akoma?

Është një kthim i vazhdueshëm që bën të kthehet më në fund tek unë Uni im. Gjithçka që prej tij kish udhëtuar gjatë në vende të huaj e ish shpërndarë mes të gjitha gjërave dhe fateve.

Di edhe diçka tjetër: që tashmë unë jam përpara majës sime të fundit dhe asaj që më është ruajtur për së fundi. Medet, më duhet të ngjis udhën më të vështirë! Medet, kam nisur udhëtimin tim më vetmitar!

Por ai që i përket llojit tim nuk arratiset në këtë orë, në orën që i thotë: “Tash i vetëm përshkoje udhën kah madhështisë tënde! Maja dhe humnera tashmë janë një gjë e vetme!”.

Ti përshkoje udhën kah madhështisë tënde: tash është bërë strehimi yt i fundit ajo që deri më tani e ke quajtur rreziku yt i fundit.

Përshkoje udhën kah madhështisë tënde; fakti që pas teje nuk ka asnjë rrugë, mund të të japë kurajën më të fortë.

Përshkoje udhën kah madhështisë tënde e askush nuk ka për të të ndjekur fshehurazi. Vetë këmba jote e ka fshirë udhën pas teje e në atë udhë rri shkruar, pamundësi.

Nëse të mungojnë tashmë të gjitha shkallët, atëherë ti duhet të dish të ngjitesh edhe mbi kokën tënde. Si mund të ngjitesh vallë ndryshe?

Mbi kokën tënde dhe tej zemrës tënde. Ajo, që te ky është e butë, duhet të bëhet shumë e fortë.

Ai që është kujdesur gjithmonë për veten, sëmuret në fund nga vetë kujdesi i tij. Lëvduar qoftë ajo që na bën të fortë! Unë nuk e dashuroj tokën ku rrjedh qumësht dhe mjaltë.

Duhet të mësosh përtej vetvetes, për të parë shumë. Një fortësi e tillë është e domosdoshme për atë që do të ngjisë malet.

Por ai që, veç me shikim këmbëngul në vullnetin e njohjes, ç'gjë vallë do të mund të nëpërshihnte në të gjitha gjërat, përveçse pamjes së tyre të jashtme?

Mirëpo ti, o Zarathustra, deshe të tejkëqyrje pamjen dhe arsyen e fshehtë të të gjitha gjërave. Kështu doje të ngjiteshe përtej vetvetes, përpara saj, për së larti, derisa të kishe përposh vetes yjet e tua.

Po! Të vështroj vetveten nga lart, ashtu si dhe yjet e mia. Vetëm këtë unë e quaj maja ime, kjo ka mbetur detyra dhe maja ime e mbrame.

Kështu i foli Zarathustra vetvetes përgjatë ngjitjes, duke e ngushëlluar zemrën me fjalë të forta, se ajo i ndihej e plaguar, si kurrë ndonjëherë më parë. Kur mbërriti në majë të kreshtës malore, pa të shtrihet përpara tij paanësia e detit. U ndal dhe heshti gjatë, por nata ishte e ftohtë në atë lartësi, e kthjellët dhe e yjëzuar.

“Unë e njoh fatin tim, - tha më së fundi me trishtim. - Forca! Përpara! Jam gati! Në këtë moment fillon vetmia ime e mbrame.”

“Medet, ky det i zi e i trishtë përposh meje! Medet, kjo melankoli e gufuar mbrëmjesore! Medet, fat e det! Unë duhet të zbres deri te ju!

Gjendem përpara më të lartit të maleve të mia e udhës sime më të gjatë. Ndaj, më duhet të zbres më thellë se sa kurrë është ngjitur ndonjëherë; më thellë në dhimbje se sa kurrë është ngjitur ndonjëherë, madje gjer edhe brenda rrjedhave të saj më të zeza! Kështu e do fati im. Përpara! Jam gati!

Po ku gjenden vallë malet më të larta? - pyeta një ditë. E kuptova se gjenden ndanë deteve.

Kjo dëshmi është e shkruar mbi shkëmbinjtë e tyre dhe mbi faqet e majave të tyre. Që nga thellësitë më të mëdha, i larti duhet të ngjitet në lartësinë e tij.

Kështu foli Zarathustra në majën e malit, ku bënte aq ftohtë. Po kur arriti në afërsi të detit, për t'u gjetur më në fund i vetëm mes shkëmbinjve, atëherë ndjeu lodhjen e rrugës, duke u mbërthyer nga një nostalgji edhe më e madhe.

“Tashmë gjithçka ende po fle, - tha. - Edhe deti fle. Syri i tij më sheh i heshtur dhe i dehur nga gjumi.

Po shpërndan ngrohtësi, e ndjej. Ndjej edhe se ëndërron. Mbështillet në vetvete, duke fjetur mbi nënkresa të forta.

Dëgjo! Dëgjo! Si vajton për kujtimet e tij të këqija! A ndoshta për shpresat e këqija? Medet, edhe unë jam i trishtë me ty, o përbindësh i zymtë; për shkakun tënd ndihem i tëri në ankth.

Medet, përse vallë dora ime nuk e ka fuqinë e mjaftueshme? Me dëshirë unë do të të çliroja nga ëndrrat e tua të këqija!

Ndërsa Zarathustra fliste kështu, qeshte me veten gjithë melankoli e hidhërim.

“Po si kështu, o Zarathustra! - i tha vetes. - Duke kënduar, ti doje t'i jepje ngushëllim edhe detit?”

Medet, o Zarathustra, i marrosuri shpirtmirë, besimplotë e i kryebekuar! Por ti gjithmonë kështu ke qenë: i je afruar gjithmonë me besim çdo gjëje të tmerrshme.

Ke dashur të përkëdhelësh çdo përbindësh. Një puhizë e ngrohtë frymimi, ca qime të buta, diku rreth putrës, e menjëherë ti je gati ta dashurosh e ta joshësh atë.

Dashuria është rreziku i vetmitarit, dashuri për gjithçka që vetëm rron. Realisht, është e denjë të shpotitet marrëzia dhe modestia ime në dashuri!”

Kështu foli Zarathustra e qeshi edhe njëherë, por atëherë u kujtua për miqtë që kishte braktisur. Sikur veç me mendime të ishte ndjerë fajtor ndaj tyre, nisi të shqetësohej për to. Menjëherë, ai që po qeshte nisi të shkruhej në të qara: Zarathustra po qante hidhnisht prej zemërimit e nostalgjisë.

Për vegimin dhe enigmën

1.

Kur mes ekuipazhit u shpërhap lajmi se Zarathustra ishte me anije, sepse bashkë me të ish ngjitur në bord një burrë tjetër, që vinte nga ishujt e lumtur, atëherë u ngjall një kureshtje e pritshmëri e madhe.

Mirëpo, Zarathustra heshti për dy ditë të tëra. Ishte i ftohtë e i shurdhër nga trishtimi, kështu që nuk u përgjigjej as shikimeve e as pyetjeve. Por mbrëmjen e ditës së dytë veshët e tij u ngritën, pavarësisht se nuk fliste ende.

Aq më tepër, që mund të dëgjoheshin shumë gjëra të jashtëzakonshme e të rrezikshme në atë anije që vinte nga larg e shkonte akoma dhe më larg. Zarathustra ishte mik i gjithë atyre që bëjnë udhëtime të gjata e nuk rrojnë dot pa rrezikuar. Ja! Ja! Teksa rrinte duke dëgjuar, më në fund gjuha iu zgjidh dhe akulli i zemrës u thye; atëherë filloi të flasë kështu:

“Për ju, o kërkimtarë të guximshëm, orvatës, e për këdo që hipi në bord të anijeve përkrah deteve frikë-ndjellës me vela të ndera, për ju o të dehur nga enigma, o miq të muzg-perëndimit, me shpirt të joshur nga zëri i flauteve të prira ndaj humnerave mashtruese, përderisa nuk doni ta ndiqni verbërisht fillin, duke e prekur me një dorë burracake. Aty ku duhet të zbuloni, aty e urreni përfundimin; për ju unë po e rrëfej enigmën që pashë, vegimin më vetmitar.

Gjer vonë ecja i trishtë në perëndimin e zbehtë, i trishtë e i rreptë, me buzë të kyçura. Më shumë se një diell kish perënduar për mua.

Një shteg që çonte me vështirësi midis shkëmbinjve, një shteg i lig, vetmitar, i pangushëlluar as nga bari e as nga shkurret: një shteg mali kërkëllinte nën ngulmimin e këmbës sime.

Kështu, duke përparuar në heshtje mbi shakullinën ironike të gurëve të zallit, duke shkëlmuar gurin që e bënte të rrëshqiste, këmba ime orvatej të ngjitej. Për lart, në kundërshtim me shpirtin që e tërhiqte për poshtë, që e gremiste drejt humnerës, shpirtin e rëndesës, djallin dhe armikun e tij më të betuar.

Për lart, edhe pse ai rrinte ulur mbi mua, gjysmë xhuxh e gjysmë urith; paralitik dhe paralizues; duke pikuar plumb nëpër veshët e mi dhe mendime si pikëza të plumbta në trurin tim.

“O Zarathustra, - pëshpëriste me shpoti, rrokje për rrokje. - Ti, gur i mençurisë! Ti je hedhur për lart por çdo gur i hedhur duhet të bjerë poshtë!

O Zarathustra, ti, gur i mençurisë; ti, gur prej thellësive; ti, thërrmonjës i yjeve! Ti prej vetvetes je hedhur për lart, por çdo gur i hedhur duhet të bjerë poshtë.

Je dënuar prej vetvetes e për t'u vrarë prej gurëve, o Zarathustra! Vërtet, ti e ke hedhur larg gurin, por ai do të bjerë përsëri mbi ty!

Xhuxhi heshti e kështu vazhdoi gjatë. Mirëpo, heshtja e tij po më shtypte se, nëse je vet i dytë në këtë gjendje, ndihesh më i vetmuar se të jesh vetëm.

Unë ngjitesha e ngjitesha, lart e më lart, ëndërroja, mendoja, po gjithçka më shtypte. I ngjaja një të sëmuri të lodhur nga lëngimi i tij i gjatë, që një ëndërr akoma dhe më e tmerrshme e zgjonte nga gjumi.

Por ka diçka brenda meje që unë e quaj kurajë e që deri më sot ka mposhtur çdo shkurajim. Kjo kurajë më së fundi më diktoi të ndahem e të them: “Xhuxh! O ti o unë!”.

Kuraja është vrasësi më i mirë, kuraja që sulmon, sepse në çdo sulm ka diçka që kumbon.

Mirëpo, njeriu është kafsha më kurajoze: andaj ai ka fituar mbi çdo kafshë tjetër. Me kumbime tingujsh, ai ka fituar mbi çdo dhimbje; dhimbja njerëzore është më e thella e të gjitha dhimbjeve.

Kuraja vret edhe maramendthin e humnerave. Po ku vallë njeriu nuk gjendet përpara humnerave? Vetë të shikuarit nuk është vallë kundrim humnerash?

Kuraja është vrasësi më i mirë; kuraja vret edhe mëshirim. Mirëpo, mëshirimi është kuraja më e thellë. Sa më thellë njeriu e depërton jetën, aq më thellë depërton edhe dhimbjen.

Po kuraja është vrasësi më i mirë, kuraja që sulmon; ajo vret edhe vdekjen, sepse thotë se, kjo vallë ishte jeta? Forca! Jetojeni edhe një herë. Në këtë thënie ka shumë muzikë. Kush ka veshë për ta dëgjuar, le ta dëgjojë.

2.

“Ndalu, xhuxh! - të thashë. - O ti, o unë! Po unë jam më i forti nga ne te dy, se ti nuk e njeh mendimin tim të thellë sa humnerat! Këtë nuk do të mund ta duroje dot!

Atëherë ndodhi diçka që më bëri të ndihesha më i lehtë: xhuxhi kurioz zbriti pas shpatullave të mia e u mblodh kruspull, në një gur përpara meje. Po një portë e madhe ish aty ku ne u ndalëm.

“Shikoje këtë portë të madhe, o xhuxh! - vazhdova. - Dy fytyra ajo ka. Këtu takohen dy rrugë: askush s’i ka përfunduar.

Ky shteg i gjatë këtu mbrapa zgjat një përjetësi e ky shteg i gjatë këtu përpara është një tjetër përjetësi.

Bien në kundërshti këto rrugë; përplasnin kryet më njëra-tjetrën e, pikërisht këtu, te kjo portë e madhe ato takohen.

Emri i portës së madhe shkruhet lart: Çasti.

Por, nëse dikush do të ecte nëpër njërin nga këto rrugë, duke shkuar gjithnjë e më përpara e më larg, a e beson ti o xhuxh se këto rrugë do të binin në kundërshti përjetësisht?

“Gjithçka që është e drejtë gënjen,” - murmuroi përçmues xhuxhi. Çdo e vërtetë është një kurbë; vetë koha është një qark!

“Ti, shpirt i rëndesës!” - thashë i zemëruar. Mos e merr shumë lehtë këtë gjë, se ndryshe do të të lë kruspull aty ku je, me këmbë të çalë, pikërisht unë që të solla kaq lart!

“Shikoje, këtë çast! - vijova. - Nga kjo portë-çast shkon e zgjatet për së prapthi një shteg i përjetshëm. Prapa nesh një përjetësi qëndron.

Nuk duhet vallë gjithçka që mund të shkojë të ketë shkuar njëherë më parë në këtë shteg? Nuk duhet vallë gjithçka që mund të ndodhë të ketë ndodhur njëherë më parë, të jetë përshkuar, të jetë përmbushur?

“Po sikur gjithçka të ketë qenë, ç’mendon ti o xhuxh për këtë çast? A nuk duhet të ketë qenë vallë edhe kjo portë më parë?”

E nuk janë të gjitha gjërat e zinxhirzuara në atë mënyrë që ky çast t’i tërheqë me vete të gjitha gjërat e së ardhmes? Pra, edhe vetveten?

Sepse gjithçka që mund të ecë, edhe nëpër këtë shteg të gjatë, që shkon aq larg përpjetë, duhet të kalojë një herë.

Po kjo merimangë e avashtë që zvarritet në qartësinë e hënës, po kjo e njëjta qartësi hëne, po unë e ti nën këtë portë të madhe, duke pëshpëritur së bashku, duke pëshpëritur për gjëra të përjetshme, nuk duhet të kemi qenë vallë edhe njëherë tjetër këtu? E duke u kthyer e kaluar nëpër shtegun tjetër, përpara nesh, përmes këtij shtegu të gjatë e të tmerrshëm, a nuk duhet të kthehemi vallë përjetësisht?”

Kështu flisja e gjithnjë e më ngadalë: sepse kisha frikë nga mendimet e mia dhe nga ato që i mbaja të fshehura. Atëherë, papritmas, dëgjova një qen të ulërinte aty pranë.

“A kisha dëgjuar ndonjëherë ndonjë qen të ulërinte kështu? Mendimi m’u kthye prapa në kohë. Po! Kur isha fëmijë, në fëmijërinë time më të hershme; atëherë kisha dëgjuar një qen të ulërinte kështu. Madje, edhe e kisha parë, me qimet ngritur lart, kokën e shtrirë së larti, drithërues, në një nga ato mesnata më të heshtura, kur edhe qentë besojnë në fantazma: aq sa më ngjalli mëshirë. Tamam atëherë po kalonte hëna, me një heshtje mortore, sipër shtëpisë; tamam atëherë ajo po rrinte atje lart, e qetë, si një gacë e rrumbullakët, e qetë mbi çatinë e rrafshët, si mbi pronën e tjetërkujt. Për këtë gjë, qeni atëherë pati frikë, sepse qentë u besojnë hajdutëve dhe fantazmave. Kur dëgjova të ulërinte akoma kështu, më ngjalli edhe një herë tjetër mëshirë.

“Ku ishte tani xhuxhi? Po porta e madhe? Po merimanga? E çdo pëshpëritje? A mos vallë po ëndërroja? A isha zgjuar? Befas, për një çast u gjeta në mes të shkëmbinjve të egër, i vetëm, i pikëlluar, në më të pikëlluarën qartësi hënore.”

Atje dergjej një njeri. Kur ja! Qeni, duke brofur me qime të ngritura dhe me angullima, më dalloi të vija e ulëriti sërish, duke britur. A kisha dëgjuar vallë një qen të ulërinte kështu, për të kërkuar ndihmë?

Se, në të vërtetë, atë çka pashë nuk e kisha parë kurrë. Pashë një bari të ri që përdridhej, përpëlitej i tëri, tkurrej me drithërima, i sflitur, si dhe një gjarpër të gjatë të zi t’i varej nga goja. A kisha parë ndonjëherë kaq neveri dhe tmerr të irnuar mbi një fytyrë? Ndoshta flinte? Pas kësaj, gjarpri iu zhyt në grykë dhe e sulmoi fort me dhëmbë.

E tërhoqa gjarpurin fort me dorë, po më kot. Ajo nuk arriti dot ta shkëpuste gjarpurin nga fyti. Atëherë brita: “Kafshoje! Kafshoje!

Këputja kokën! Kafshoje! Kështu bërtiste brenda meje tmerri, neveria, mëshira, gjithë e mira dhe e keqja ime; klithte tek unë me një britmë të vetme.

Po ju, o guximtarë përreth meje! Ju kërkimtarë orvatës, e kushdo që hipi në bordin e një anije kah deteve të pa eksploruara me vela të ndera! Ju, të pasionuarit e enigmave!

Zgjidhmani, pra, enigmën që pashë! Shpjegomani, pra, më vetmitarin vegim!

Sepse ishte një vegim dhe parashikim. Ç' pashë vallë atëherë, si simbol? Kush është ai që duhet ende të vijë?

Kush është bariu, në grykë të të cilit depërtoi gjarpri? Kush është njeriu, të cilit i depërtoi në grykë gjithçka më e rëndë e më e zezë që ekziston?

Po a e kafshoi bariu, siç ia këshilloi britma ime? A e kafshoi me një kafshim të fortë? E pështyu larg vetes kokën e gjarprit e u ngrit në këmbë me një të brofur.

S'ish më bariu, as njeriu, por një i transformuar, një i iluminuar ish ai që qeshte. Kurrë përmbi tokë s'ka qeshur njeri si ai!

O miqtë e mi, dëgjova një të qeshur që nuk ishte e qeshur njeriu, ndaj tash po më bën të vuaj një etje o një dëshirim, që nuk fashitet kurrë!

Dëshirimi i asaj të qeshure po më gërryen. Oh, po si do të duroj të jetoj akoma! E si mund ta duroja të vdisja tani?

Kështu foli Zarathustra.

Për lumturinë kundra dëshirës

Me të tilla enigma e hidhërime në zemër e kaloi detin Zarathustra. Por, kur ishte katër ditë udhë larg prej ishujve të lumtur dhe miqve të vet, kuptoi se e kish kaluar tashmë gjithë pikëllimin; po e kalëronte përsëri fatin e tij, fitimtar dhe të patundur. Atëherë, kështu i foli Zarathustra ndërgjegjes së ngazëllyer:

Kështu flisja e gjithnjë e më ngadalë: sepse kisha frikë nga mendimet e mia dhe nga ato që i mbaja të fshehura. Atëherë, papritmas, dëgjova një qen të ulërinte aty pranë.

“A kisha dëgjuar ndonjëherë ndonjë qen të ulërinte kështu? Mendimi m’u kthye prapa në kohë. Po! Kur isha fëmijë, në fëmijërinë time më të hershme; atëherë kisha dëgjuar një qen të ulërinte kështu. Madje, edhe e kisha parë, me qimet ngritur lart, kokën e shtrirë së larti, drithërues, në një nga ato mesnata më të heshtura, kur edhe qentë besojnë në fantazma: aq sa më ngjalli mëshirë. Tamam atëherë po kalonte hëna, me një heshtje mortore, sipër shtëpisë; tamam atëherë ajo po rrinte atje lart, e qetë, si një gacë e rrumbullakët, e qetë mbi çatinë e rrafshët, si mbi pronën e tjetërkujt. Për këtë gjë, qeni atëherë pati frikë, sepse qentë u besojnë hajdutëve dhe fantazmave. Kur dëgjova të ulërinte akoma kështu, më ngjalli edhe një herë tjetër mëshirë.

“Ku ishte tani xhuxhi? Po porta e madhe? Po merimanga? E çdo pëshpëritje? A mos vallë po ëndërroja? A isha zgjuar? Befas, për një çast u gjeta në mes të shkëmbinjve të egër, i vetëm, i pikëlluar, në më të pikëlluarën qartësi hënore.”

Atje dergjej një njeri. Kur ja! Qeni, duke brofur me qime të ngritura dhe me angullima, më dalloi të vija e ulëriti sërish, duke britur. A kisha dëgjuar vallë një qen të ulërinte kështu, për të kërkuar ndihmë?

Se, në të vërtetë, atë çka pashë nuk e kisha parë kurrë. Pashë një bari të ri që përdridhej, përpëlitej i tëri, tkurrej me drithërima, i sflitur, si dhe një gjarpër të gjatë të zi t’i varej nga goja. A kisha parë ndonjëherë kaq neveri dhe tmerr të irnuar mbi një fytyrë? Ndoshta flinte? Pas kësaj, gjarpri iu zhyt në grykë dhe e sulmoi fort me dhëmbë.

E tërhoqa gjarprin fort me dorë, po më kot. Ajo nuk arriti dot ta shkëpuste gjarprin nga fyti. Atëherë brita: “Kafshoje! Kafshoje!”

Këputja kokën! Kafshoje! Kështu bërtiste brenda meje tmerri, neveria, mëshira, gjithë e mira dhe e keqja ime; klithte tek unë me një britmë të vetme.

Po ju, o guximtarë përreth meje! Ju kërkimtarë orvatës, e kushdo që hipi në bordin e një anije kah deteve të pa eksploruara me vela të ndera! Ju, të pasionuarit e enigmave!

Zgjidhmani, pra, enigmën që pashë! Shpjegomani, pra, më vetmitarin vegim!

Sepse ishte një vegim dhe parashikim. Ç'pashë vallë atëherë, si simbol? Kush është ai që duhet ende të vijë?

Kush është bariu, në grykë të të cilit depërtoi gjarpri? Kush është njeriu, të cilit i depërtoi në grykë gjithçka më e rëndë e më e zezë që ekziston?

Po a e kafshoi bariu, siç ia këshilloi britma ime? A e kafshoi me një kafshim të fortë? E pështyu larg vetes kokën e gjarprit e u ngrit në këmbë me një të brofur.

S'ish më bariu, as njeriu, por një i transformuar, një i iluminuar ish ai që qeshte. Kurrë përmbi tokë s'ka qeshur njeri si ai!

O miqtë e mi, dëgjova një të qeshur që nuk ishte e qeshur njeriu, ndaj tash po më bën të vuaj një etje o një dëshirim, që nuk fashitet kurrë!

Dëshirimi i asaj të qeshure po më gërryen. Oh, po si do të duroj të jetoj akoma! E si mund ta duroja të vdisja tani?

Kështu foli Zarathustra.

Për lumturinë kundra dëshirës

Me të tilla enigma e hidhërimë në zemër e kaloi detin Zarathustra. Por, kur ishte katër ditë udhë larg prej ishujve të lumtur dhe miqve të vet, kuptoi se e kish kaluar tashmë gjithë pikëllimin; po e kalëronte përsëri fatin e tij, fitimtar dhe të patundur. Atëherë, kështu i foli Zarathustra ndërgjegjes së ngazëllyer:

“Jam përsëri vetëm e dua të jem i vetëm, me qiellin e pastër dhe detin e lirë. Ja tek është sërish përreth meje ora e pasdites!

Në orën e pasdites i gjeta për herë të parë miqtë e mi e, po në këtë orë, i ndesha edhe herën e dytë. Në atë orë, kur çdo dritë bëhet më e heshtur.

Përderisa ajo që i përket lumturisë është ende në udhëtim midis qiellit dhe tokës, kërkohet kësisoj për strehim një shpirt vezullues: për gëzim të gjithë kësaj çdo dritë bëhet atëherë më e heshtur.

Orë e pasdites së jetës sime! Një ditë edhe gëzimi im zbriti nëpër lugina, për të kërkuar një strehë, e i gjeta këta shpirta të hapur e mikpritës.

Ora e pasdites së jetës sime! E ç’ nuk dhashë për të pasur një gjë të vetme: këtë plantacion të gjallë të mendimit tim dhe këtë orë mëngjesore të shpresës sime më të lartë.

Një ditë, krijuesi kërkoi shokët dhe bijtë e shpresës së tij dhe ndodhi që të mos i gjente, sepse, së pari, duhet t’i krijonte ai vetë. Kështu jam edhe unë në mes të veprës sime: duke shkuar e duke u larguar nga fëmijët e mi. Për hir të dashurisë së tyre, Zarathustra duhet ta çojë deri në fund përmbushjen e vetvetes.

Se nga thellësia e shpirtit dashurohet vetëm fëmija dhe vepra jote; ndaj aty, ku ka një dashuri të madhe për vetveten, aty ka edhe një shenjë mbarësie. Kështu pashë të ndodhë kudo.

Ende lulëzojnë fëmijët e mi në pranverën e tyre të parë, rrinë pranë njëri-tjetrit e së bashku e lënë veten të tunden nga erërat, këto pemë të kopshtit tim e të truallit tim më pjellor.

Se vërtet! Aty ku këto pemë rrinë pranë njëra-tjetrës, aty gjenden edhe Ishujt e Lumtur.

Një ditë unë do të doja t’i shkulja e t’i mbillja ato sërish larg njëra-tjetrës, që të mësojnë vetminë, krenarinë dhe maturinë.

I nyjësuar e i përkulur me një fortësi të luhatshme duhet të rri ndanë detit, si një far i gjallë i pashtershmërisë së jetës.

Se aty ku stuhitë i vërsulen detit dhe pi ujë feçka e malit, aty çdokush duhet ta kalojë një herë ditën dhe natën e vet pa gjumë, për të provuar dhe njohur vetveten.

Duhet të provojë e të japë njohje, pra t'i përkasë llojit dhe fisit tim, të zotërojë një vullnet të hekurt, të heshtur, edhe kur flet. Aq dorëzonjës sa të merr edhe kur të jep: një njeri i tillë mund të bëhet një ditë shoku im, madje dhe shpirt-ngazëllues, së bashku me Zarathustrën, i atillë që të shkruajë dëshirën time në ligjet e mia, për t'i përmbushur sa më mirë të gjitha gjërat.

Ndaj, për hir të tij e të të afërmve të tij, unë duhet ta përmbush plotësisht vetveten. Ja pse tash i arratisem fatit e i ofrohem çfarëdolloj fatkeqësie për provën dhe njohjen time të fundit të vetes. Se, në të vërtetë, kish ardhur koha të shkoja; hija e shtegtarit, ngurrimi shumë i gjatë dhe ora më e heshtur, gjithçka më thoshin: "Është koha!".

Era frynte përmes vrimës së çelësit e thoshte: "Eja! Dinakërisht porta më hapej e më thoshte, Ik!".

Por unë dergjesha i zinxhirzuar nga dashuria për fëmijët e mi: dëshirimi ma kish hedhur lakun, dëshirimi i dashurisë, që unë të bëhesha preja e fëmijëve të mi e të humbisja në ta.

Të dëshirosh për mua do të thotë ta humbasësh vetveten. Po unë ju kam, o bijtë e mi! Në këtë përkatësi, duhet të ketë vetëm siguri, dhe jo dëshirë.

Mirëpo, ishte dielli i dashurisë sime ai që më ushqente. Zarathustra po piqej kështu në thelbin e vet. Çdo hije dyshimi tashmë kish fluturuar tej!

Kur ja tek më mbërtheu dëshira e dimrit dhe ngricës.

"Ah, sikur ngrica dhe dimri të më bëjnë të dridhem e ti kërcëllijë dhëmbët përsëri", - psherëtija; e bryma të akullta u ngritën prej meje.

E kaluara ime i theu varret e saj, më shumë se një dhimbje e varrosur e gjallë u zgjua: vetëm kish fjetur, e fshehur në një palëzim të përzishëm.

Gjithçka më jepte shenja: "Koha erdhi!" Por unë nuk dëgjoja: deri kur humnera ime u drodh e mendimi im më kafshoi.

Medet, o mendim humneror, ti je mendimi im! Kur do ta gjej forcën të të dëgjoj, të të rrëmoj e mos drithërohem më?

Zemra më rreh gjer në fyt, kur të ndjej të rrëmosh! Edhe heshtja jote kërkon të më zërë frymën, o ti humnerisht e heshtur!

Nuk kam guxuar ende të të thërisja të vije këtu lart: më mjaftonte të të mbartja me vete! Nuk isha ende aq i fortë për fodullëkun dhe dredhinë e luanit.

Më mjaftonte tmerrri i peshës tënde: por një ditë unë duhet ta gjej forcën dhe zërin luanor për të të thirrur këtu lart!

Kur një ditë ta kem kapërcyer këtë gjë, do të kapërcej edhe gjëra më të mëdha; e një fitore duhet të jetë vula e përmbushjes sime! Ndërkaq unë eci drejt deteve të pasigurtë; përkëdhelitë e rrezikut më ngadhnjejnë, rruhem nga përpara dhe nga krahët, e nuk shoh kurrfarë caku.

Për mua nuk ka mbrritur akoma ora e betejës sime të mbrame; apo sapo mbrriti ora? Në realitet, deti dhe jeta më shohin përreth me një bukuri të pabesë!

Orë mbasditore e jetës sime! O lumturi që i paraprin mbrëmjes! O port në kohë batice! O paqë e të pasigurtit! Sa pak besim kam te të gjithë ju!

Në realitet, si zë aspak besë bukurisë suaj dredharake! I ngjaj të dashuruarit që dyshon te të gjitha buzëqeshjet e pellushta të së dashurës!

E ashtu si xhelozitë e largon të dashurën nga vetja, i ëmbël dhe në ashpërsinë e tij, kështu unë po e largoj prej meje këtë orë të bekuar!

Shko, o orë e bekuar! Bashkë me ty më mbrriti një lumturi kundra dëshirës! Tash jam këtu i disponueshëm për dhimbjen më të thellë: ti s'ke mbrritur në kohë!

Shko, o orë e bekuar! Gjeje më mirë shtëpinë tënde atje tej, në mes bijve të mi! Nxito! E bekoji me lumturinë time përpara se mbrëmja të bjerë.

Ja tek po afrohet mbrëmja: dielli po perëndon. Lamtumirë, lumturia ime!

Kështu foli Zarathustra dhe priti për gjatë gjithë natës moslumturinë e tij, por e priti më kot.

Nata mbeti e qartë dhe e heshtur; vetë lumturia u afrua gjithnjë e më shumë tek ai. Por aty, nga agimi, Zarathustra' qeshi brenda zemrës dhe tha me ironi: "Lumturia po më vjen nga pas. Kjo ndodh, sepse unë nuk shkoj nga pas grave. E lumturia, në fakt, është një grua".

Përpara lindjes së diellit

"O qiell i kulluar sipër meje! O qiell i thellë! O humnerë drite!
Duke të kundruar unë ndihem i shkundur nga një dëshirim hyjnor.

Të lëshohen në lartësitë e tua qiellore, kjo është thellësia ime!
Të strehohem në qelibarësinë tënde, kjo është pafajësia ime!

Zoti është i pështjellë e i fshehur nga bukuria e tij; kështu,
edhe ti i mbulon yjet. Nuk flet: kështu më shpall mençurinë.

I heshtur mbi detin e trazuar, sot m'u shfaqe. Dashuria dhe turpi yt, droja jote, janë një zbulesë për shpirtin tim të trazuar. Sepse ti e pështjellë erdhe tek unë me bukurinë tënde, e heshtur më fole, duke më kallëzuar mençurinë tënde. Oh, po si mundem vallë të mos arrij ta zbuloj gjithë turpin e shpirtit tënd?

Përpara lindjes së diellit ti mbërrite tek unë, o vetmitar!

Ne jemi miq që nga zanafilla; kemi të përbashkët ankthin, tmerrin dhe arsyen; edhe dielli është i përbashkët për ne.

Ne flasim me njëri-tjetrin, sepse dimë shumë gjëra: heshtim reciprokisht e i buzëqeshim njëri-tjetrit dijen tonë.

Pse, nuk je ti drita e zjarrit tim?! Nuk ke ti vallë shpirti binjak, për të më kuptuar?

Bashkë kemi mësuar çdo gjë; bashkë kemi kuptuar të ngjitemi përtej vetvetes, kah vetvetes, e të buzëqeshim paqësisht.

Të buzëqeshim pa re, me sy shkëlqimtarë e prej largësive të pamasa, teksa poshtë nesh shtrëngesa, faje dhe qëllime avullojnë si shi.

Atëherë, kur unë endesha i vetëm, për çfarë kish uri vallë shpirti im përgjatë veseve dhe shtigjeve të paqëllimta? E kur ngjisja malet, kë kërkoja tjetër vallë, përveç teje, nëpër male?

E gjithë endja ime dhe ngjitja nëpër male ishte vetëm një nevojë dhe një pretekst i mbrapshtë, sepse do vetëm të fluturojë vullneti im: të fluturojë te ti!

E kë urreja unë më shumë se sa retë endacake e gjithçka tjetër që të errësonte? Urreja edhe vetë urrejtjen time, sepse të errësonte.

Nuk i duroj dot retë endacake, hajdutet mace tinëzare: na grabisin ty dhe mua, çka kemi të përbashkët: të padëgjuarën e të pacaktën Po-në dhe Amen.

Ne nuk i durojmë dot ndërmjetëset dhe intrigantet re endacake: qenie gjysmake që nuk dinë as të bekojnë e as të mallkojnë radikalisht.

Më mirë do të doja të isha në një fuçi nën një qiell të mbyllur ose, më shumë akoma pa qiell në një humnerë, sesa të të shihja ty, qiell shkëlqyes, i errësuar nga re endacake!

Aq shpesh kisha qejf t'i lidhja fortësish së bashku me fijen e praruara e me thekë të rrufeve, për t'i rënë daulles, si një bubullimë, në barkun e tyre të fryrë. Le të kumbojnë furishëm daullet, sepse ato më grabisin Po-në dhe Amen-in!

O qiell sipër meje! Oh i qelibarti! Shkëlqimtari! O humnerë vezëllitëse! Përse vallë po ta vjedhin Po-në dhe Amen-in tim?

Unë parapëlqej më mirë zhurmën, bubullimën dhe mallkimet e stuhive sesa qarkrrethuesen, ngurruesen qetësi prej maçoku. Në mes njerëzve urrej më shumë se këdo tjetër të përulurin, një gjë gjysmake, një re të ngadaltë e ngurruese që ecën.

"Kush nuk mund të bekojë, duhet të mësojë të mallkojë!" Ky parim ndriçimtar më ra prej qiellit të kthjellët: ylli besnik i qiellit tim, edhe në netët më të errëta.

Unë jam dikush që bekoj dhe them Po, nëse ti më rri përçark, o e qelibarta, vezulluesja, humnerë e dritës! Dhe e çoj në çdo humnerë Po-në time bekuese.

Unë jam dikush që bekon e thotë Po: ndaj kam luftuar gjatë. Një guximtar isha gjithmonë, sepse doja që një ditë duart e mia të qenë të lira për të bekuar.

Ky është bekim im: të jem sipër çdo gjëje, si mbi qiellin e saj, si mbi çatinë e saj të rrumbullakët, kupolën e saj të kaltër e sigurinë e saj të përjetshme. Sa i bekuar është ai që bekon kështu!

Sepse, të gjitha gjërat janë pagëzuar në burimin e përjetësisë dhe përtej së mirës e së keqes; vetë e mira dhe e keqja janë vetëm dukje e hije, pikëllime të buta e re që shkojnë.

Në të vërtetë, është bekim, jo mallkim. Nëse unë mësoj që "sipër çdo gjëje qëndron qielli i Fatit, qielli i pafajësisë, qielli i papërcaktueshmërisë, qielli i kurajës".

"Për fat, kjo është fisnikëria më antike e botës, që unë i ktheva çdo gjëje, duke e çliruar nga skllavëria e finalitetit.

Unë e vendosa këtë liri e këtë qetësi të kaltër qiellore siç ishte një kohë, mbi çdo gjë, kur ju mësoja se "sipër e nëpërmes tyre nuk duhet të vihet asnjë vullnet i përjetshëm".

E vendosa këtë mendjemadhësi e marrëzi në vend të këtij vullneti, kur mësova se, në tërësi, vetëm diçka është e pamundur: arsyetueshmëria!"

Gjithsesi, pak arsye, një grimcës mençurie, e hapërdarë nga ylli në yll, është një tharm i përzier me të gjitha gjërat. Është për hir të dashurisë, për marrëzinë që mençuria përzihet me të gjitha gjërat.

Pak mençuri është më se e mundshme; mirëpo, këtë siguri të bekuar unë e gjeta te të gjitha gjërat, se ato parapëlqejnë të vallëzojnë me këmbët e fatit. O qiell sipër meje! I kulluar! Sublim! Kjo është ora ime për qelibarësinë tënde, që të mos ekzistojë asnjë merimangë e përjetshme e asnjë cergë merimange e arsyes. Që ti të jesh për mua një pistë vallëzimi për fatet hyjnore, një tryezë hyjnore për lojën hyjnore të zareve e për lodërtarët hyjnorë!

Po skuqesh? Thashë vallë gjëra që s'thuhen? Blasfemova, ndërsa doja të të bekoja?

Apo është turpi, që jemi vet i dytë, ajo që të bën të skuqesh? Më dikton të shkoj e të hesht, sepse tash po mbërrin dita?

Bota është e thellë: më e thellë se sa mund ta ketë menduar ndonjëherë dita. Jo gjithçka mund të thuhet me fjalë përpara lindjes së ditës. Po ja: tashmë dita erdhi. Le të ndahemi!

O qiell sipër meje! O i turpshmi! O i zjarrti! O lumturia ime e parë para lindjes së diellit. Dita erdhi! Le të ndahemi!”

Kështu foli Zarathustra.

Për virtytin që zvogëlon

1.

Kur Zarathustra zbriti përsëri në tokë, nuk vrapoi menjëherë në malin dhe në shpellën e vet, por përshkroi shumë rrugë, u informua për këtë apo për atë gjë, duke i thënë kështu vetes me të qeshur: “Ja, një lumë që, përmes mijëra dredhimesh kthehet te burimi i tij!”.

Donte të dinte ç’kish ndodhur ndërkaq me njeriun: nëse ishte bërë më i madh apo më i vogël. E ja tek pa një resht shtëpish të reja; u mrekullua e tha: “Ç’kuptim kanë këto shtëpi?! Nuk duhet t’i ketë ndërtuar një shpirt i madh, sipas imazhit të tij!

Ndoshta ndonjë fëmijë torollak i ka nxjerrë nga kutia e tij e çokollatave? Oh, sikur një tjetër fëmijë të mund t’i rivendoste menjëherë në kuti!

Në këto dhoma e skuta, si munden vallë njerëzit të hyjnë e të dalin në to?! Duken të ndërtuara për kukullat e mëndafshta e për grykësit e mëdhenj, që e lënë veten të thithen”.

Zarathustra u ndal e nisi të meditojë. Më në fund, tha i trishtë: “Gjithçka është bërë më e vogël! Shoh kudo porta më të

ulëta: kush i përket racës sime, arrin ende të kalojë përmes tyre, por detyrohet të përkulet.

Oh, kur do të shkoj sërish në atdheun tim, ku nuk do të më duhet më të përkulem, të përkulem përpara të vegjëlve!”. Zarathustra psherëtiu e vështroi larg.

Në të njëjtën ditë mbajti ligjërimin e vet për virtytin që zvogëlon.

2.

“Unë po kaloj përmes njerëzve të këtij populli e po i mbaj sytë hapur: ata nuk ma falin të mos jem ziliqar për virtytet e tyre.

Orvaten të më kafshojnë, sepse u them se për njerëzit e vegjël nevojiten virtyte të vogla; sepse mezi arrij ta kuptoj si mund të jenë të nevojshëm njerëzit e vegjël.

I ngjaj kështu një gjeli të vendosur në një qymez të pazakontë, ku duan ta çukisin me sqep të gjitha pulat; por, megjithatë, unë s’ndjej mëri për to. Jam i sjellshëm, ashtu si me të gjitha mërzitë e vogla; të jem thumbues me të vegjlit, më ngjan një mençuri prej iriqi.

Të gjithë për mua flasin mbrëmjeve kur ulen rreth zjarrit; për mua flasin, por kurrë askush s’mendon për mua.

Kjo është qetësia e re që mësova: zhurma e tyre përreth meje u hedh një mantel mendimeve të mi.

Bërtasin mes tyre: “Ç’gjë vallë do prej nesh kjo re e errët? Të bëjmë kujdes, mos na sjellë ndonjë epidemi!

Pak më parë, një grua e tërhoqi pas vetes një fëmijë që donte të më afrohej: “Largojini fëmijët! - thirri. - Ata sy i djegin shpirtrat e fëmijëve”.

Kolliten kur flas: besojnë se kolla është një qortim kundra erës së fortë, por nuk dallojnë fërgëllitjen e gëzimit tim.

“Nuk kemi kohë për Zarathustrën,” – vërejnë, por ç’rëndësi ka një kohë, që nuk ka kohë për Zarathustrën?!

Edhe kur më lëvdojnë, si mundet vallë të fle mbi lavdet e tyre? Këto lavde janë për mua një brezore gjembash, që më gërvishtin edhe kur e heq.

Edhe këtë gjë e kam mësuar në mes tyre: që lëvduesi kapardiset sikur të jep diçka, por, në të vërtetë, do të fitojë akoma më shumë dhurata.

Pyetini këmbët e mia, nëse e durojnë mënyrën e tyre të lëvdimit dhe joshjes. Në fakt, në ritmin e një tik-taku të tillë ato nuk dëshirojnë as të kërcejnë e as të rrinë palëvizur.

Do të donin të më joshnin, duke më lëvduar virtytin e vogël; do të donin ta kalisnin këmbën time në tik-takun e lumturisë së vogël.

Por unë kaloj mes njerëzve të këtij populli e i mbaj sytë çelur: tashmë janë më të vegjël e më të vegjël do të bëhen. Këtu i shpie vlerësimi i tyre i lumturisë dhe virtytit.

Se madje, edhe te virtytet ata janë modestë, ngaqë dëshirojnë rehatinë; po me rehatinë përputhet veçse një virtyt modest.

Mësojnë një mënyrë krejt të veçantë për të ecur e përparuar: unë e quaj çalim; bëhen pengesë për këdo që ka ngut.

Dikush prej tyre shkon përpara duke parë nga pas, me qafën drejt.

Do të më pëlqente t'u përplasesha me forcë në gjoks.

Këmbët dhe sytë nuk duhet të gënjejnë, as ta kundërshtojnë njëra-tjetrën. Po ka shumë gënjeshtër në mes njerëzve të vegjël.

Disa prej tyre i duan të tjerët, por shumica do që të duhen. Disa prej tyre janë të sinqertë, por pjesa më e madhe janë veç komedianë të këqij.

Ka në mes tyre komedianë të ligj e komedianë që luajnë pa dëshirë. Të sinqertët janë gjithmonë të rrallë, por në veçanti komedianët e sinqertë.

Kanë pak burrëri, ndaj janë gratë e tyre ato që mashkullorizohen. Sepse vetëm ai që është shumë mashkull, mund ta çlirojë feminilitetin e një gruaje.

Hipokrizia më e madhe që gjeta mes tyre është se edhe ata që komandojnë, stimulojnë virtytin e atyre që shërbejnë.

“Unë shërbej, ti shërben, ne shërbejmë!” Kështu predikon hipokrizia e sunduesve. Mjerim, kur i pari i padronëve është veçse më i pari i shërbëtorëve!

Medet, edhe në hipokrizitë e tyre përhumbej kurioziteti i syve të mi; e shquajnë mirë lumturinë e tyre prej mize e zukamën përreth xhamave të dritareve të ndriçuara nga dielli.

Po ashtu, siç shoh aq shumë mirësi, shoh edhe aq shumë dobësi e, për më shumë drejtësi dhe mëshirim, edhe më shumë dobësi.

Janë të sinqertë, të drejtë e të mirë me njëri-tjetrin, ashtu siç janë të sinqerta, të drejta e të mira grimcat e rërës mes tyre.

Quajnë “dorëzim” thjesht përqaftimin e një lumturie të vogël; ndërkaq, nisin t’i përdredhin sytë kah një lumturie tjetër të vogël.

Thellë-thellë, ata duan thjesht një gjë: që askush mos t’u bëjë keq. Ndaj, u rrinë gati të tjerëve dhe nxitojnë t’u bëjnë mirë.

Po kjo është një burracakëri, edhe pse ata e quajnë “virtyt”.

Edhe kur ndonjëherë këta njerëz të vegjël flasin me ashpërsi, në zërin e tyre unë ndjej ngjirje; madje, çdo shkulum ere i bën akoma e më të ngjirur.

Janë të matur, virtytet e tyre i kanë gishtërinjtë të matur, por u mungojnë grushtet, gishtërinjtë e tyre nuk dinë të mblidhen në grusht.

Për ta është virtyt ajo që i bën të butë e modestë, ndaj e kanë transformuar ujkun në qen dhe njeriun në më të mirin e kafshëve shtëpiake.

“Le të rrimë në mes, - duket të më thotë me kënaqësi buzëqeshja e tyre. - Po njëlluj, si larg gladiatorëve të dergjur për vdekje ashtu dhe derrave të kënaqur.”

Ky është mediokritet, edhe pse ata e quajnë “moderim”.

3.

Shkoj përmes njerëzve e u hedh ndonjë fjalë, por ata nuk dinë as të marrin e as të ruajnë.

Habiten e mrekullohen se përse nuk ua shaj e nuk ua fyej veset dhe kënaqësitë. Por, në të vërtetë, unë nuk kam ardhur që t'i ruaj nga hajdutët e çikërrimave.

Habiten e mrekullohen se përse nuk jam gati t'ua shkathtësoj e mpreh maturinë; sikur të mos kishte boll mes këtyre njerëzve që shisnin dije, me atë zërin që u kërciste si shkumësi mbi dërrasën e zezë.

Kur unë bërtas: "Mallkuar qofshin të gjithë demonët burracakë që keni në trup, që duan veç të qaraviten, të palosin duart për lutje e adhurime!", ata ulërijnë: "Zarathustra, është ateist!".

Më shumë se të gjithë ulërijnë mjeshtrit e tyre të nënshtrimit, por pikërisht në veshët e tyre do të më pëlqente të ulërija: "Po! Unë jam Zarathustra, ateisti!".

Ah, këta mjeshtrit e nënshtrimit! Futen kudo ku ka meskinë, të sëmurë e zgjebarakë, si morrat. Vetëm neveria ime më mban nga dëshira për t'i shkëlmuar.

Epo mirë, atëherë! Ky është predikimi im për veshët e tyre: unë jam Zarathustra, ateisti që pyet: "A ka ndonjë më ateist se unë, që t'i gëzohem mësimin të tij?".

Unë jam Zarathustra, ateisti. Ku do t'i gjej të ngjashmit e mi? Të ngjashmit e mi janë të gjithë ata që i diktojnë vetes vullnetin e tyre dhe që i heqin asaj çdo lloj nënshtrimi.

Unë jam Zarathustra, ateisti. E pjek çdo rast në tiganin tim. Vetëm kur piqet mirë, e quaj si ushqimin tim e i uroj mirëseardhjen.

Më shumë se një rast më është shfaqur despotik: po akoma më despotik i është përgjigjur vullneti im. Ndërsa ai, ja menjëherë i lutet e i bie në gjunjë, për të gjetur tek unë një strehë dhe një zemër, duke shtuar ngashënjes: "E sheh pra, o Zarathustra, si vjen miku te miku!".

Po ç'ju flas e t'ju ulërij kot, kur nuk keni veshë për të më dëgjuar!

Andaj, dua t'u bërtas furtunave: Ju do të bëheni gjithnjë e më të vegjël, o njerëz të vegjël! Do të thyheni e do të copëtoheni, o të rehatuar! Do të shkoni në rrënim me të gjitha virtytet, mosveprimet dhe nënshkrimet tuaja të vogla!

Shumë i butë, shumë i luhatshëm është trualli juaj!

Nëse një pemë do të bëhet e lartë, asaj i duhet t'i ngulisë rrënjët e fuqishme në shkëmbej të fortë.

Edhe ajo që ju lini pa bërë, formëson kallëpin e së ardhmes njerëzore: edhe asgjëja juaj është një cergë merimange e një merimangë që rron e ushqehet me gjakun e së ardhmes.

Aq sa, kur merrni, është njëlloj sikur vidhni, o të virtytshmit e vegjël! Se edhe mes bataçinje fjala e nderit është: "Duhet të vidhet atëherë kur nuk mund të grabitet!".

Është e vërtetë, e ky është një mësim i nënshtrimit. Por unë ju them, o të dashuruarit e rehatisë, se ju merret e do t'ju merret gjithnjë e më shumë!

"Duajeni gjithmonë të afërmin si veten, por jini në radhë të parë të atyre që e duan vetveten! Dashuroni me një dashuri të madhe, dashuroni me një përçmim të madh!"

Kështu flet Zarathustra, ateisti.

Po ç'të flas, kur nuk ka veshë për të më dëgjuar?! Edhe këtu është shumë shpejt për mua.

Unë jam pararendësi i vetvetes, në mes njerëzve të këtij populli, jam vetë kënga ime e gjelit përmes rrugëve të errëta.

Po, ora e tyre po vjen! Edhe ora ime! Ata po bëhen nga ora në orë më meskinë, më të varfër, më sterilë; bar i keq, tokë e keqe!

Shpejt do të ngjajnë me një bar të tharë a me një shtupë. Se, në të vërtetë, të lodhur me veten, do të jenë më spazmues për ujin se sa për zjarrin.

Ora e bekuar e rrufesë! O mister përpara mesditës! Një ditë, dua t'i bëj ata zjarre shëtites dhe lajmëtarë me gjuhë flake; një

ditë ata duhet të shpallin me gjuhë zjarri se po vjen, është afër, mesdita e madhe!”

Kështu foli Zarathustra.

Në malin e ullinjve

“Dimri, ky mik i trishtë, banon në shtëpinë time, duart e mia janë të nxira nga shtrëngimi miqësor i duarve të tij.

Unë e nderoj këtë mik të trishtë, por me plot dëshirë e lë vetëm. Me dëshirë i arratisem e, nëse di të vraposh mirë, arrin t’i arratisesh.

Me këmbë e mendime të ngrohta unë arratisem atje ku nuk mbërrin era, kah qoshkës me diell të ullishtës sime.

Atje qesh me mikun tim të akullt e i jam mirënjohës, sepse m’i ngordh mizat në shtëpi e më hesht aq shumë zhurmë të vogla.

Ai nuk duron dot që të gumëzhijë ndonjë mizë, e jo më dy; i bën të vetmuara rrugët, aq sa edhe qartësia e hënës trembet të shndrijë.

Është një mik i rreptë, por unë e nderoj e nuk i lutem, si të zhburrnuarit, idhullit barkdalë të zjarrit.

Parapëlqej t’i skërmis pak dhëmbët se sa t’i lutem ndonjë idhulli. Kështu do karakteri im! Por, në veçanti, jam kundër gjithë idhujve flakërues, tymues e të zymtë të zjarrit.

Atë që e dua, unë e dua më shumë në dimër se sa në verë; me më shumë përqeshje e më shumë kurajë unë shpotis armiqtë e mi, tash që dimri banon në shtëpinë time.

Me plot kurajë, madje edhe kur shkoj pa u ndjerë për të rënë në shtrat; edhe atëherë lumturia ime e fshehtë qesh e bën rrëmujë, e qesh edhe ëndrra ime gënjeshtare.

Unë, adhures i përrulur? Kurrë në jetën time s’jam zvarritur përpara të fuqishmëve e, nëse kam gënjyer, kam gënjyer për hir të dashurisë. Ndaj, i qeshur jam edhe në shtratin tim dimëror.

Një shtrat i tillë më ngroh më mirë se një shtrat i pasur, sepse unë jam xheloz për varfërinë time. Ndërsa në dimër, ajo m’është

më besnike se kurrë.

E nis ditën çdo herë me një ligësi: e tall dimrin me një banjë të ftohtë e miku im i akullt i shtëpisë nis të hungërijë nëpër dhëmbë.

Më pëlqen edhe ta ngacmoj me ndonjë qiri dylli që, më në fund ta lërë qiellin të dalë jashtë prej perëndimit të përhimë.

Veçanërisht i lig jam në mëngjes: në orën mëngjesore, kur kuis kova e pusit dhe kuajt hingëllijnë me ngrohtësi rrugëve të përhimëta.

Pres me padurim që qielli shkëlqimtar më së fundi të çelet, ai qiell dimëror mjekërbardhë, ai plak me kryet e zbardhura... i heshturi, qiell dimëror, që e mban shpesh sekret edhe diellin e vet.

Mos vallë i mësova prej tij të gjatat heshtje ngazëlluese? Apo i mësoi ai nga unë? Apo secili nga ne i shpiku për hesap të vet?

Origjina e të gjitha gjërave të mira është e shumëfishtë; të gjitha gjërat e mira dhe kurajoze brofin nga gëzimi në skenën e jetës. Si mund ta bëjnë këtë gjë, veç njëherë!

Edhe një heshtje e gjatë është gjë e mirë dhe kurajoze, njëlloj siç shihet qielli dimëror nga fytyra të shndritshme e sy të qartë e të mëdhenj; njëlloj si ai fsheh diellin dhe vullnetin e tij të palëkundur diellor. Se, në të vërtetë, unë e kam kuptuar mirë këtë art e këtë kurajë dimërore.

Arti dhe dinakëria më e shtrenjtë m'është pikërisht kjo: që heshtja ime ka arritur të mësojë të mos tradhtohet nga heshtja.

Me një tringëllimë fjalësh dhe zares, unë fitoj mbi dinakërinë e atyre që ma presin rrugën solemnisht, se gjithë këtyre spiunëve të akullt është i shtrënguar t'u arratiset vullneti dhe qëllimi im.

Që askush të mos shohë në fund të shpirtit dhe vullnetit tim suprem, unë shpika heshtjen time të gjatë e ngazëlluese.

Kam takuar shumë njerëz të matur, që vellonin fytyrën e që turbullonin ujërat e veta, veçse askush të mos i shihte brenda.

Por, pikërisht tek ata u sulën më dëshmitarët, më të shkathët, më të zotët "zbulues të enigmave" dhe u nxorën jashtë mendimet më të fshehta.

Mirëpo, të kthjellët, kurajozët, të sinqertët, janë për mua të heshturit më të zgjuar: kaq i thellë është fundi i tyre sa s'e tradhton dot as uji më i kthjellët.

O ti, i heshturi qiell dimëror me mjekër të bardhë, ti, me kryet e zverdhura e me sy të rrumbullakët që po më shikon ngultas! O imazh qiellor i shpirtit dhe kuturisjes sime të çmendur!

Mos duhet të fshihem, si ai që ka gëlltitur erën, që të mos ma shqyejnë shpirtin?

Mos duhet të eci me paterica, që të mos kujtohen për këmbët e mia të gjata, gjithë këta ziliqarë e qaravitës që më rrinë përreth.

Këta shpirtira të përtymur, të ngrohur pranë zjarrit, të rraskapitur, të mykur e të pezmatuar, si mundet vallë zilia e tyre ta durojë lumturinë time?!

Ndaj, unë u shfaq atyre vetëm akullin dhe dimrin e majave të mia, e jo si mali im që brezohet ende me aq shume diell.

Ata dëgjojnë të fishkëllejnë vetëm stuhitë e mia dimërore e nuk e kuptojnë që unë lundroj edhe në dete të ngrohta, njëlloj si erërat nostalgjike, të athëta e të ngrohta të Jugut.

Kanë mëshirë për fatkeqësitë dhe fatin tim, po fjala ime kumbon: "Lëreni fatin të vijë tek unë! Ai është i pafajshëm, si një fëmijë!

Si mund ta durojnë ata lumturinë time, nëse unë nuk do ta rrethoja këtë lumturi me mynxyrat dhe sflitjet dimërore, me kësulat lëkurë-ariu e me vellot e qiejve me dëborë?

...Nëse unë vetë të mos kisha mëshirë për mëshirimin e tyre, për mëshirimin e këtyre ziliqarëve e qaravitësve?

Nëse përpara tyre të mos ofshaja e kërcisja dhëmbët nga të ftohtit e të mos e lija veten të mbështillesha me durim në mëshirimin e tyre?

Këtu qëndron mirëdashësia dhe kuraja e mençur e shpirtit tim, që ai nuk e fsheh dimrin, stuhitë dhe akullin e vet; madje edhe morthin e tij. Për dikë vetmia është arratia e një të sëmuri; për një tjetër arratia prej të sëmurëve.

Le të më dëgjojnë të ofshaj e të kërcas dhëmbët nga të ftohtët e dimrit, të gjithë këta bataqinjtë të mjerë e ziliqarë që më rrinë përreth! Me këto rrëqethje e ofshama unë marr arratinë nga dhomat e tyre të ngrohura.

Le t'u dhimbsem e t'më mëshirojnë për morthit e mi: "Në akullin e dijes do të vdesë i ngrirë," - thonë.

Ndërkaq, unë vazhdoj të ecë sa gjatë e gjerë e me këmbë të ngrohta në malin tim të ullinjve. Në qoshkun me diell të ullishtës sime, unë këndoj e shpotis çdo mëshirim."

Kështu foli Zarathustra.

Për të kaluarin përtej

Duke përshkuar ngadalë shumë popuj e shumë qytete të ndryshme, Zarathustra u rikthye, përmes rrugëve të tërthorta, në malin dhe shpellën e tij. E ja, teksa pa e ditur mbërriti edhe te dera e qytetit të madh. Por këtu një i çmendur, me jargë në gojë, i doli përpara me krahë të hapura dhe ia ndërpreu rrugën.

Ky i çmendur ishte po ai që populli e thërriste "majmuni i Zarathustrës". Në të vërtetë, ai kish kuptuar diçka nga stili dhe, lakimi i tij i zërit e peshkonte shpesh e me dëshirë në thesarin e mençurisë së tij. Ky i foli kështu Zarathustrës:

"O Zarathustra, këtu është qyteti i madh! Këtu ti s'ke asgjë për të kërkuar e gjithçka për të humbur. Përse të vish e të zhgërryesh në këtë llucë? Ki mëshirë për këmbët e tua! Pështy më mirë mbi portat e qytetit dhe ik!

Këtu është ferri për mendimet e vetmitarëve; këtu mendimet e mëdha përfundojnë në vlim e bëhen copë e çikë.

Këtu korruptohen të gjitha ndjenjat e mëdha: mund t'ju mrekullojnë e mahisin vetëm ndjenjat të vockla, të thata si harengat.

A nuk e ndjen vallë kundërmimin e thertoreve dhe gjellëtoreve të shpirtit?! A nuk tymon vallë ky qytet nga avujt e mishit të therur?!

Nuk i sheh shpirtrat të varen si rrecka të qullura e të ndyra, e prej këtyre rreckave ata bëjnë gazetata?!

Nuk e ndjen se si këtu shpirti bëhet lojë fjalësh?! Nxjerr jashtë një shpëlarje të papëlqyeshme fjalësh. Edhe me këtë shpëlarje fjalësh ata bëjnë gazeta.

Ndërsejnë njëri-tjetrin, por nuk e dinë se kundra kujt. E nxehin njëri-tjetrin, por nuk dinë përse. Bëjnë të tringëllijë edhe kallaji i tyre, edhe ari i tyre.

Janë të ftohtë e ngrohtësinë e kërkojnë te rakia; janë të ngrohur e kërkojnë freskinë pranë shpitrave të akullit; janë të gjithë të sëmurë e me tuberkuloz prej opinionit publik. Gjithë kënaqësitë e veset këtu janë si të shtëpisë. Ka edhe të virtytshëm e, shumë virtyte nëpunësish të aftë për gjithçka: shumë virtyte nëpunësish me gishtërinj shkruesish e mollaqe të forta e gjithnjë në pritje, bashkë me bekimin e yjeve të vogla mbi gjoks e të bijave të fryra si me pambuk, por pa të ndenjura.

Ka edhe shumë mëshirë, shumë puthadorë besnikë, një lumë i tërë puthjesh për zotin e ushtrive. "Nga lart" bien yje dhe e mrekullueshmja pështymë; për lart frymon dhe çdo gjoks pa yje. Hëna ka shpurën e vet, e shpura satelitet e saj; drejt gjithë asaj që vjen nga kjo shpurë, lutet populli lypsar, bashkë me të gjitha virtytet lypëse e dredharake. "Unë shërbej, ti shërben, ne shërbejmë", i lutet virtyti zellplot princit të tij, derisa ylli i merituar t'i ngjitet më në fund gjoksit thatim. Hëna rrotullohet rreth Tokës, kështu edhe princi rrotullohet rreth asaj që është tokësore: ky është ari i tregtarëve. Zoti i ushtrive nuk është zoti i shifrave të arit: princi propozon, por është tregtari ai që e disponon paranë.

Ndaj, për gjithçka që te ty është e shndritshme, e fortë dhe e mirë, o Zarathustra, pështy mbi këtë qytet tregtarësh dhe

largohu! Këtu gjaku rrjedh i qelbur, i flashkët dhe i shkumëzuar në damarë. Pështy mbi qytetin e madh, që është një kanal i madh ujërash të zeza, ku mblidhen të gjitha rrjedhat! Pështy mbi qytetin e shpirttrave të flashkët e të gjokseve të rreshkura, të syve të mprehtë, të gishtave veshtullore; në qytetin e shpirtngushtëve, të burracakëve, të pacipëve, të shkrimtarucëve e të plehraxhinjve, të ambiciozëve, të nevrrikëve ku, bashkë shkon gjithçka që është e korruptuar, ekuivoke, epsharake, e errët, e qelbëzuar, ulceroze, komplotiste! Pështy mbi qytetin e madh dhe ik!”

Por, në këtë çast, Zarathustra e ndërpreu të çmendurin me gojë shkumëzonjëse dhe ia taposi gojën.

“Mbylle, pra! - ulëriti Zarathustra. - Ligjërimet dhe mënyrat e tua kanë kohë që më janë neveritur!

Përse vallë ke jetuar aq gjatë në moçalishte, sa të bëhesh edhe ti vetë bretkosë e thithëlopë?

Nuk rrjedh vallë edhe në venat e tua gjak i qelbur, i shkumëzuar dhe moçalor, që të ka mësuar të kuak-kuakësh e të mallkosh kështu?

Pse nuk u largove në pyll, apo nuk e lërove ndonjëherë arën? Deti, a nuk është plot me ishuj të gjelbëruar?

Unë e përçmoj përçmimin tënd e, nëse më dënon mua, pse vallë s'dënon edhe vetveten?

Veç prej dashurisë duhet të ngrihet në fluturim përçmimi im, zogu im ogurmirë, e jo prej moçalishteve!

Të quajnë majmuni im, të çmendur me jargë nëpër gojë, por unë, që tani e tutje do të të quaj derrkuci im që hungëron, ty, që me hungërimën tënde shprish edhe lavdin e çmendurisë sime.

Po ç'që ajo gjë vallë që të bëri të hungërije herën e parë? Fakti që askush s'të ka adhuruar aq shumë. Ndaj rri ulur mbi atë fëlliqësirë, për të pasur arsye të hungërosh; për të pasur motiv hakmarrjeje. Se, në fakt, është hakmarrje, o i çmendur kryelartë, i gjithë ky shkumëzimi yt! Unë të kuptoj mirë!

Fjala jote e çmendur më djeg edhe kur ke të drejtë. Edhe sikur fjala e Zarathustrës të kishte mijëra herë të drejtë, ti, duke e përshtatur, do të bëje gjithmonë gabime!

Kështu foli Zarathustra. Pa qytetin e madh, psherëtiu e heshti gjatë. Së fundi, tha kështu: “Edhe ky qytet i madh, e jo vetëm ky i çmendur, më ngjall neveri! As për të, as për atë, s’ka asgjë për të përmirësuar e as për të përkeqësuar.

Mjerë ajo shtyllë zjarri, ku ajo do të digjet!

Sepse të tilla shtylla zjarri duhet t’i paraprijnë mesditës së madhe.

Por çdo gjë ka kohën dhe fatin e vet.

Sa për tani, po të jap këtë mësim, o i çmendur, përpara se të të braktis: nëse nuk arrin dot të dashurosh, duhet të kalosh përtej!”

Kështu foli Zarathustra, e kaloi përtej të çmendurit dhe qytetit të madh.

Për felëshuesit

Medet, a është vallë e tëra e përhitur dhe e fishkur, gjithçka që pak më parë mbi këtë livadh ishte e blertë dhe shumëngjyrëshe? Sa shumë mjaltë shprese u solla prej këtej bletoreve të mia!

Ato zemra rinore tashmë janë të gjitha të vjetra, madje, as të vjetra jo, veçse të lodhura, përtace, mjerane e që thonë: “Jemi bërë sërish të devotshme”.

Shumë kohë më parë i pashë të vraponin me këmbë të lehta nëpër hapësirë. Por këmbët e tyre të dijes janë të lodhura e tash shpifin edhe për vetë fluturimin e tyre mëngjesor.

Në të vërtetë, shumë prej tyre asokohe i lëviznin këmbët si në një vallëzim e i joshte e qeshura e mençurisë sime, por pastaj ndërruan mendje. Por sot i shoh të zvarriten të përkulur drejt Kryqit.

Një kohë fluturonin si mushkonjat edhe poetët e rinj, përreth dritës dhe lirisë.

Paksa më të vjetër, të nxirë e gojështurur, njerëz që rrinë veç pranë zjarrit.

A u pat munguar vallë zemra e kohës, në të cilën vetmia më pat gëlltitur si një balenë? Veshët e tyre ndenjën gjatë duke më dëgjuar mua më kot, bashkë me thirrjen time buçuese dhe paralajmërimin tim prej **kasneci**.

Medet! Janë gjithmonë pak ata, zemra e të cilëve ka pasur për një kohë të gjatë guxim dhe kurajë; këtyre pak njerëzve, edhe shpirti u mbeti i duruar, kurse pjesa tjetër është burracake.

Pjesa tjetër, që është gjithmonë shumica, të rëndomt, të tepërtit, të padobishmit: të gjithë këta nuk janë veçse burracakë.

Kush është i sojit tim, do të gjejë rrugës edhe sojin e përvojës sime: shokët e saj të parë do të jenë kufomat dhe palaçot.

Kurse shokët e saj të dytë do të quhen shokët besnikë: një lumë gjallesash, me shumë dashuri, me shumë marrëzi, me shumë adhurim foshnjarak.

Nuk do ta lidhë zemrën e tij me këta besnikë ai që është mes njerëzve të sojit tim; nuk duhet t'u besojë këtyre pranverave dhe livadheve shumëngjyrëshe, kush e njeh sojin njerëzor ikanak e burracak!

Nëse do të mundnin të vepronin ndryshe, atëherë edhe do të dëshironin ndryshe. Masat gjysmake e prishin atë që është një e tërë. Që gjethet zverdhen, a ka ndonjë gjë për t'u vajtuar?

Lëre t'i marrë lumi, o Zarathustra, e mos vajto! Më mirë fry bashkë me erën shushuritëse, fry mbi këto gjethë, o Zarathustra, sepse gjithçka që është për të rënë le të ikë prej teje sa më shpejt.

Ne u bëmë përsëri të përrshpirtshëm e të devotshëm," - rrëfejnë këta felëshues. Madje, shumë prej tyre janë shumë burracakë për ta pohuar.

Unë i shoh në sy e ua përplas në mollëzat e skuqura të faqeve: jeni përsëri nga ata që luten!

Po, është turp të lutesh! Jo për të gjithë, por për mua e për ty e për këdo që ka një ndërgjegje vetjake. Për ty është turp të lutesh!

E ti e di mirë: demoni burracak brenda teje, që dëshiron të t'i palosë duart e të t'i mbajë në prehër, për të ndenjur rehat.

Është po ai demon burracak, që të thotë: "Ka një zot!".

Por kështu, ti i përket sojit të atyre që i druhen dritës, atyre që drita nuk u jep pushim. Andaj, ditë për ditë, ti duhet të zhytesh gjithnjë e më shumë në errësirë dhe në mjegull.

Në të vërtetë, ti e ke zgjedhur mirë orën: tamam tani zogjtë e natës fluturojnë jashtë prej foleve. Mbërriti ora e gjithë atyre që i druhen dritës, ora mbrëmjesore dhe festive, por që për ta s'është e tillë.

Se unë e ndjej dhe e nuhas: mbërriti ora e tyre e gjuetisë dhe e procesionit, por padyshim jo e një gjuetie të egër, por e një gjuetie të matur, të gjymtuar, të një gjuetie tinëzare dhe burracake. Një gjuetie për hipokritët plot ndjenja: të gjitha kurthet e zemrës janë tashmë të ndera përsëri. Aty ku unë ngre një tendë, prej andej del jashtë fluturimthi një flutur e vogël nate.

Ndoshta, e strukur i qëndronte aty pranë edhe një tjetër flutur e vogël nate. Sepse unë ndjej aromën e aq shumë bashkëshoqeve të vogla të fshehura; aty ku ka qoftë edhe një dhomëz, ka plot fanatike të reja, ndaj aq i fortë është kutërbimi kudo përreth.

Ulen bashkë çdo mbrëmje e thonë: "Lërnani të kthehemi fëmijë e të themi, o i miri Zot, me gojën dhe stomakun e prishur nga ëmbëlsirat e përshpirtshme.

Ose netëve të gjata rrinë e shohin një merimangë dinake me kryq shënjuar, që rri në pritë, ashtu në cergën e vet, duke përdikuar dredhinë e duke mësuar: "Është mirë ta endësh pëlhurën nën kryqe!".

Ose ulen përgjatë gjithë ditës me tojat nëpër moçale e besojnë se janë të thellë, por ai që peshkon aty ku nuk ka peshq. Unë nuk e quaj as edhe sipërfaqësor.

Ose mësojnë të hareshëm e të devotshëm t'u bien harpave nga një kompozitor himnesh, që do të dëshironte të kompozonte

në zemrën e ndonjë vashëze të re, sepse është i lodhur nga plakat dhe nga lavdet e tyre.

Ose mësojnë të rrëqethen nga ndonjë i çmendur gjysmë erudit, që nëpër dhoma të errëta pret që shpirtrat të vijnë drejt tij. E kështu shpirti i zhduket tërësisht.

Ose dëgjojnë një endacak plak me mjekër, që e ka mësuar prej erërave të pezmatuara theksin melankolik, ndaj kumbon si era dhe predikon melankolinë me theks të pezmatuar.

Disa prej tyre janë bërë madje dhe roje nate, e tani dinë t'u bien brirëve e të bredhin netëve, për të zgjuar gjëra të vjetra e të fjetura prej kohësh.

Pesë fjalë gjërash të vjetra dëgjova mbrëmë te muri i kopshtit. Vinin prej atyre rojeve pleq të natës, të trishtë e të tharë.

“Si At që është, nuk mendon shumë për fëmijët e tij; etërit tokësorë bëjnë më shumë se ai.”

“Është goxha i plakur! Nuk kujdeset më për fëmijët e tij.” Kështu i përgjigjej roja tjetër.

“Po a ka fëmijë? Askush s'mund ta provojë, po s'e provoi ai vetë. E pres prej kohësh, që të ma provojë.”

Të ta provojë? Sikur ai të kish provuar ndonjëherë ndonjë gjë! Të provojë është e vështirë, e mban brenda atë që i besohet.

Po! Po! Besimi e bën të lumtur, besimi tek ai. Kjo është karakteristikë e njerëzve të plakur. Kështu jemi edhe ne.

Kështu thoshin në mes tyre rojet pleq të natës, të ndrojtur nga drita, duke u fryrë me trishtim brirëve të tyre. Kjo ndodhi dje mbrëma, pranë murit të kopshtit.

Por mua zemra po më përpëlitej nga të qeshurit; donte të thyhej, po nuk dinte se ku, e u rrokullis thellë në diafragmën e kraharorit.

Në të vërtetë, kjo do të jetë vdekja ime, që unë e mbyta nga të qeshurat, nëse shoh gomarë të dehur dhe dëgjoj rojet e natës të dyshojnë mbi Zotin në këtë lloj mënyre.

Pse vallë, a nuk ka kaluar koha edhe për të gjitha këto dyshime?

Kush mund t'i ringjallë akoma përralla të tilla të fjetura, që

kanë frikë nga drita?

Me zotat e vjetër historia ka mbaruar prej kohësh; në të vërtetë, ata patën një fund të mirë e të lumtur.

Vdekja e tyre nuk ishte ndonjë perëndim [Aluzion me veprën "Perëndimi i idhujve" të Vagnerit]. Kjo është gënjeshtëri! Përkundrazi, një ditë ata vdiqën nga të qeshurit.

Kjo ndodh kur një zot shpall formulën më ateiste: "Ka vetëm një zot!". Ti nuk do të kesh tjetër zot, përveç meje! Një zot plak mjekërmadh, xheloz, a mund të arrinte deri këtu? E atëherë të gjithë zotat qeshën dhe u kolovatën nëpër fronet e tyre, duke shpallur se "Nuk është vallë ky thelbi i divinitetit, që nuk ka një zot të vetëm, por ka disa zota?"

Kush ka veshë për ta kuptuar, le ta kuptojë."

Kështu foli Zarathustra në qytetin që ai dashuronte e që quhej "Lopa laroshe". Që prej aty, i duhej të ecte edhe dy ditë për të arritur në shpellën e vet dhe të kafshët e tij, por shpirtin e kishte vazhdimisht të hareshëm, që po i afrohej çasti i rikthimit.

Rikthimi

O Vetmi! Ti vetmi, atdheu im! Shumë gjatë jetova i egër në një vend të egër, sa të mos kthehesha me lot gëzimi në strehën tënde!

Tash kërcënomë veç me një gisht, siç kërcënojnë nënat! Buzëqeshmë, siç buzëqeshin nënat! Thuamë, pra: "E kush ish vallë ai që shkoj një ditë nga unë, si një erë stuhie?"

Duke u larguar, shpalli: jetova shumë gjatë me vetminë, e kështu u çmësova të heshtja. Po tash, a e mësove?

O Zarathustra, unë di gjithçka që ti, në mes shumësisë ndihesh i braktisur, më i vetmuar se me mua.

Tjetër gjë është braktisja, tjetër gjë vetmia: këtë mësove! Në mes njerëzve ti do të jesh gjithmonë një i egër dhe i huaj: i egër

dhe i huaj, edhe sikur të të donin, sepse, para së gjithash, ata duan të respektohen.

Ndërsa këtu, ti je në strehën dhe shtëpinë tënde. Këtu ti mund të thuash lirisht çdo gjë e të shfryhesh gjer në fund. Këtu nuk ke se pse të turpërohesh nga ndjenjat intime e kryeneçe.

Këtu të gjitha gjërat vijnë ledhatuese për buzët e tua e të lajkatojnë, sepse duan të të hipin mbi shpinë. Ti, mbi çdo shëmbëllim kalëron këtu drejt çdo të vërtete.

I sinqertë dhe besnik ti mund t' u flasësh këtu të gjitha gjërave e, në të vërtetë, si një lëvdim u kumbon veshëve të tyre fakti që dikush flet qartë dhe drejt mbi të gjitha gjërat.

Por tjetër gjë është braktisja. A e mban mend akoma, o Zarathustra?

Kur zogu krakëriti mbi kryet e tua, ndërsa ti ishe në pyll, i pavendosur se ku do të shkoje? Por, kur pa e ditur, me një kufomë pranë, the se mund të të udhëheqin kafshët e mia. T' u duk më e rrezikshme të rroje midis njerëzve sesa kafshëve. Kjo ishte braktisja!

S' e mban mend, o Zarathustra, kur po qëndroje ulur në ishullin tënd, si një shatërvan vere mes puseve bosh, kur jepje e falje pa kursyer, dhuroje e shuheshe për të eturit, derisa në fund vetëm ti mbete i etur mes të dehurve, duke vajtuar gjatë natës: të marrit nuk është më e bekuar se të dhënit [Aluzion me shprehjen e Krishtit, që gjendet te Shën Pali. "Të dhënit është më e ëmbël se të marrit"]. Të vjedhurit, s' është më i bekuar se të marrit. Kjo ishte braktisja!

O Vetmi! Ti vetmi, atdheu im! Sa përkëdhelës dhe bekues më flet zëri yt!

Ne si bëjmë pyetje njëri-tjetrit, ne nuk i ankohe mi njëri-tjetrit, ne shkojmë hapur bashkë, përmes portave të hapura.

Meqenëse te ty gjithçka është e qartë dhe e hapur, edhe orët vrapojnë me këmbë më të lehta; në errësirë koha shkon më rëndë-rëndë se në dritë.

Këtu hapen të gjitha fjalët dhe të gjitha peshtafet e fjalëve të jetës: këtu çdo jetë do të bëhet fjalë e çdo bërje do të mësojë të flasë nga unë.

Por atje tej, përposh, çdo fjalë është e kotë. Atje tej, mençuria më e mirë është të harrosh e të kalosh përtej: këtë kuptova tani.

Kushdo që midis njerëzve do të donte të kuptonte gjithçka, do t'i duhej të prekte gjithçka. Por unë kam duar shumë të pastra, për ta bërë një gjë të tillë.

Ja se pse unë s'mund ta thith frymën e tyre. Medet, rrojta aq gjatë mes britmave dhe gulçimave të tyre të qelbura!

O heshtje e bekuar përreth meje! O parfume të pastra përreth meje! Oh, se si frymon kjo qetësi e pastër nga thellësia e gjoksit tim! Oh, si duket të rrijë, në pritje për të dëgjuar, kjo e bekuara qetësi!

Atje poshtë të gjithë flasin e askush s'dëgjon. Le të bërtasë mençuria me kumbim kambanash: tregtarët e tregut do ta fitojnë betejën me tringëllimën e monedhave të tyre.

Të gjithë flasin, po askush nuk di më të kuptojë. Gjithçka bie në ujë, por asgjë s'bie më puseve të thella.

Të gjithë flasin midis tyre, gjithçka reduktohet në formula. Ajo që dje ishte akoma shumë e fortë, edhe për vetë kohën e për dhëmbët e saj, sot varet, ashtu e gërryer dhe e kruar, nga nofullat e njerëzve të sotëm.

Të gjithë flasin, gjithçka është zhvëlluar. Ajo që një kohë quhej sekret dhe misteri i shpirtave të thellë, sot u përket trumbetuesve të shesheve dhe bataçinjve të tjerë.

O njerëzim, ç'gjë e çuditshme! O rropamë, përmes rrugëve të errëta! Tash ti je sërish prapa krahëve të mi: rreziku im më i madh më qëndron prapa krahëve.

Te butësia dhe mishërimi është çerdhëzuar gjithmonë rreziku im më i madh; çdo njerëzim do që të kursehet e të falet.

Me të vërteta të fshehura, me duar e zemra të marrosura e të pasura me gënjeshtat e vogla të mëshirimit: kështu jetova gjithmonë në mes të njerëzve.

I veshur ndryshe u ula në mes tyre, gati ta mohojë veten, që të arrija t'i duroja, duke e bindur madje vullnetarisht veten: "I marrosur, ti nuk i njeh njerëzit!".

Çmësohet njeriu, kur jeton midis njerëzve; te çdo njeri ka shumë dukje. Për çfarë shërbejnë sytë zjarrmi-shumë, zjarrmi-gjatë?

Kur më çnjihnin, unë, i marrosuri, isha me ta më i butë se sa me veten: isha i mësuar me ashpërsinë kundra vetvetes e shpesh i hakmerresha asaj për butësinë e vet.

I pickuar nga miza helmuese dhe i gërryer si një gur, nga aq shumë pikëza ligësie, rrija mes tyre e i thosha vetes se "gjithçka që është e vogël është e pafajshme për shpirtvogëlsinë tënde".

Veçanërisht, tek ata që quhen "të mirë", gjeta mizat më të helmatisura: pickojnë në pafajësi të plotë, gënjejnë në pafajësi të plotë. Si mund të jenë të drejtë me mua?

Kush jeton mes të mirëve, mëson të shtiret si i mëshirshëm. Mëshirimi e bën ajrin të afshët për të gjitha shpirtrat e lira. Budallallëku i të mirëve është i pafund.

Të fsheh vetveten dhe pasurinë: këtë mësova atje përposh se, në të vërtetë, ju gjeta veç të varfër në shpirt. Gënjeshtër e mëshirimit tim ishte se unë dija për secilin, për secilin që shihja dhe e nuhasja, sa shpirt i mjaftonte e sa shpirt i ishte i tepërt.

Të urtit e tyre të rreptë unë i quaja të urtë, jo të rreptë. Kështu mësova t'i gëlltisja fjalët. Varrmihësit e tyre unë i quaja kërkimtarë dhe provëtarë. Kështu mësova të thosha një gjë për një tjetër.

Varrmihësit gërmojnë jashtë sëmundjeve të tyre. Ndaj, nën gërmadhat antike qëndrojnë kutërbime të tmerrshme. Nuk duhet të rrëmosh nëpër pellgje. Duhet jetuar në mal. Po tani, me flegra të bekuara, unë frymoj sërish lirinë e maleve. Më në fund, hunda ime u çlirua nga aroma e njerëzimit.

I lehtësuar nga ajri therës, si nga një verë shumëzuese, shpirti im teshtin; teshtin dhe më uron hareshëm: "Shëndet!"

Kështu foli Zarathustra.

Për tri gjërat e liga

Në ëndërr, në të mbramen ëndërr të mëngjesit, unë sot po rrija në një gjuhë toke; jashtë prej botës, mbaja një peshore në dorë dhe peshoja botën.

Oh po, shumë shpejt mbërriti aurora, se e zjarrmuar më zgjoi, xhelozja. Ajo është gjithnjë xheloze për ngrohtësinë e ëndrrave të mia mëngjesore.

Të matshme për kë ka kohë, të rrokshme për një mendimtar të zot, të arritshme në fluturim për flatra të forta, të interpretueshme për zhbiruesit hyjnorë të mistereve. Ja, kështu e gjeti botën ëndrra ime!

Ëndrra ime, një velëtare e guximshme, e gjysmë anije, gjysmë nuse e erërave, e heshtur si një flutur, e duruar si skifterët mbretërorë. Ja se si pati sot kohën dhe durimin për ta peshuar botën!

E bindi mençuria ime, mençuria ime e qeshur, e përditshme, që rri zgjuar e që i shpotit të gjitha "botët e pafundme". Prandaj thotë: "Aty ku është forca, edhe numri bëhet padron, se ai ka më shumë forcë.

Sa e sigurt ëndrra ime shihte këtë botë të pafundme, jo kurioze, as për të vjetrën e as për të renë, duke mos u frikësuar për asgjë, duke mos u lutur për asgjë: njëlloj sikur një mollë e tultë t'i ofrohej dorës sime, një mollë e artë dhe e pjekur, me lëkurë të freskët e të pellushtë.

Kështu më afrohej bota, njëlloj sikur një pemë ma bënte me shenjë, një pemë me një kurorë të gjerë degësh e gjethesh, me një vullnet të fuqishëm, të përkulur për t'i shërbyer, si sup apo si ndenjësë, kujtdo që është i lodhur prej udhëtimit. Kështu qëndronte bota në gjuhën time të tokës, njëlloj sikur duar të hijshme e të hajthme më sillnin një peshtaf, një peshtaf të hapur për ekstazat e syve turpërisht adhures. Kështu sot m'u shfaq përballë bota, jo dhe aq e mistershme, për ta bërë të ndrojtur

dashurinë njerëzore, jo dhe aq zhbiruese, për të bërë të fjetur diturinë njerëzore. Diçka e mirë njerëzore sot bota ish për mua, edhe pse aq keq flitet për të.

Sa i falem ëndrrës sime mëngjesore, sepse sot, me humor të mirë, arrita ta peshoj botën! Kjo ëndërr erdhi sot tek unë si diçka e mirë njerëzore, aq shumë ngushëlluese për zemrat.

Erdhi që unë ta imitoj përgjatë ditës e të mësoj prej saj gjërat më të mira: që unë tash të vendos në peshore tri gjërat më të këqija e t'i peshoj mirë nga ana njerëzore.

Kush mësoi të bekojë, mësoji edhe të mallkojë. Po cilat janë tri gjërat më të mallkuara? Këto dua të vendos mbi peshore.

Epsh, etje për pushtet, egoizëm: këto tri gjëra kanë qenë deri më sot më të mynxyrshmet, më të mallkuarat dhe të përgojuarat, e unë dua t'i peshoj ato mirë nga ana njerëzore.

Epo mirë! Këtu gjuha ime e tokës, e atje deti, le të sulet furishëm kundra meje. Lozonjare, leshtore, kjo monstër e vjetër dhe besnike qensh me njëqind koka, që unë e dua aq shumë.

Epo mirë? Këtu unë dua ta mbaj peshoren mbi detin shkumëzues e po zgjedh edhe një dëshmitar, që të të vigjilojë ty, o pemë vetmitare, që unë të dua aq shumë, me atë parfum të fortë e atë kurorë të spikatur degësh e gjethesh.

Mbi ç'urë e tashmja po shkon kah së ardhmes? Falë ç'fuqie ajo që është lart përkulet për poshtë? E ç'do të thotë të tejkalosh edhe supremen?

Tash peshorja rri në ekuilibër dhe e palëvizshme: i kam hedhur tri pyetje të rënda në njërën anë; pjata tjetër përmban tri përgjigje, po kaq të rënda.”

2.

“Epshi: një torturë e një hosten për gjithë përçmuesit e trupit të veshur me grathore dhe i mallkuar si “botë” nga gjithë transhentalistët, sepse nënqesh dhe shpotit gjithë mjeshtrit e gënjeshtreve dhe marrëzive.

Epshi: për horrin një zjarr i ngadaltë, ku ai digjet; për të gjithë drunjtë e kalbur, për të gjitha rrekat kutërbuese, një stufë tymuese dhe flakëritëse.

Epshi: për zemrat e lira e të pafajshme kopsht i hareshëm i tokës, mirënjohje grafullonjëse e së ardhmes për të tashmen.

Epshi: për të pafuqishmin një helm i sheqerosur, por për vullnetin luanor një ripërtëritës i madh i zemrës; vera e verërave, e ruajtur me aq përkujdes e xheloz.

Epshi: shembëllsia e madhe e gëzimit për lumturinë dhe shpresën e epërme. Se, në të vërtetë, shumë gjërave u është premtuar martesë e, më shumë se sa martesë, madje shumë gjërave, që në mes tyre janë më të huaj se burri dhe gruaja. Po kush vallë e ka kuptuar tërësisht se sa të huaj janë burri dhe gruaja?

Epshi: unë do të doja të kisha gardhe përreth mendimeve dhe fjalëve të mia, derisa derrat dhe ëndërrimtarët të mos kalojnë në kopshtin tim.

Etja për pushtet: fshakullimi i zjarrtë për atë që ka zemrën më të fortë; martirizim mizor, që ruhet për më mizorët, flaka e errët e turrave të gjalla të druve.

Etja për pushtet: frenim i pabesë që u diktohet popujve më kryeneçë; përqeshësja e të gjitha virtyeteve të dyshimta, që zbut çdo kalë e çdo krenari.

Etja për pushtet: tërmeti që thyen e gërmon gjithçka që është e kalbur dhe bosh; që shkallmon, trallis, shungullon, aq hakmarrëse ndaj varreve të zbardhëlljera; pikëpyetja dritëzonjëse pranë përgjigjeve të parrëmbyeshme.

Etja për pushtet: përpara shikimit tënd njeriu zvarritet, zbutet, jepet e bëhet më i neveritshëm se gjarpri dhe thiu, derisa më në fund shpërthen prej tij ulëritës përçmimi i madh.

Etja për pushtet: mjeshtëria e tmerrshme e përçmimit të madh, që u predikon në fytyrë qyteteve dhe mbretërive: "Larg prej këtej!". Derisa një ditë do të jenë ata që t'i bërtasin: "Larg ti prej këtej!".

Etja për pushtet: që josh, megjithatë, edhe më vetmitarët, të lartët në paqe me vetveten, e zjarrtë si një dashuri, që kënaqësi-ndjellëse pikturon mbi qiejt tokësorë bekimet e purpurta.

Etja për pushtet: kush mund ta quajë sëmundje, nëse ajo që është lart shikon poshtë, falë etjes për pushtet? Në të vërtetë, asgjë e sëmurë dhe molepsëse s'gjendet në një aspirim dhe ngritje të tillë.

Derisa lartësia vetmitare të mos jetë përjetësisht vetmitare dhe e shpague në vetvete, mali do të zbresë në luginë dhe erërat e lartësive do të të fashiten fushave.

Oh, po kush do ta gjejë vallë emrin e drejtë, emrin virtuoz të një aspirimi të tillë?! "Virtyt dhurues," - e quajti një ditë Zarathustra virtytin, që nuk ta zë goja ta emërosh.

Atëherë e, në të vërtetë, ishte hera e parë kur ndodhi që fjala e tij lartësoi egoizmin, egoizmin e shëruar, të shëndetshëm, që gurgullon nga një shpirt i fuqishëm, nga një shpirt i fuqishëm, të cilit i përket një trup i lartë, i bukur, fitimtar, i këndshëm, që gjithçka përreth i bëhet shëmbëllim.

Trup i zhdërvjellët dhe bindës valltari, të cilit shpirti i dashuruar, pas vetvetes i është simbol dhe thelb. Kënaqësia që provojnë ndaj vetvetes trupa dhe shpirtra të tillë vetëquhet "Virtyt".

Me fjalët e tij, për të mirën dhe të keqen, brezohet ky gëzim i vetvetes, si prej një pylli të shenjtë. Me emrat e lumturisë së tij dëbohet prej vetes gjithçka që është e përçmueshme.

Dëbohet prej vetes gjithçka që është burracake. I duket i përçmueshëm ai që është gjithmonë i shqetësuar, ai që psherëtin, që ankohet, por edhe ai që kënaqet me avantazhe të vogla.

Përçmon gjithashtu edhe atë mençuri që përkundet në dhimbje, sepse, në realitet, ka edhe një mençuri që lulëzon në errësirë, një mençuri mbrëmjesore, që psherëtin gjithmonë: "Gjithçka është e kotë!".

Dyshimi i ndrojtur i duket pak o gjë. Kushdo kërkon betime më shumë se duar e shikime; po kështu edhe çdo mençuri pak e besueshme, sepse kjo është cilësi e shpirtrave burracakë."

Akoma më pak vlerëson ata që kënaqen me pak, shpirtin qenshmërisht të nënshtruar që, i zbehtë rrëzohet menjëherë mbi kurriz, se ka edhe një mençuri që është servile, e ngjashme me qentë, që shfaqet e devotshme dhe e gatshme të respektohet.

Për të është i urryer dhe i përbuzshëm ai që nuk do të mbrohet, ai që gëlltit jargët dhe toleron shikimet e liga, i shumëduaruar, i krejtdorëzuar, i gjithëshpaguari: e gjitha kjo është servile.

Që dikush servile përpara zotave dhe shënimeve hyjnore, ashtu si ndaj njerëzve dhe opinionëve të marrëzishme njerëzore, është e njëjta gjë: egoizmi i bekuar pështyn mbi çdo zakon servil.

E keqe: kështu quhet gjithçka që është e përlulur dhe servile, e ulët, ajo që s'është e lirë, sytë që shkelen nga frika, zemrat e ndrydhura e çdo mënyrë e shtirur dorëzimi, që të puth me buzë të fryra burracake.

Pseudomençuri: kështu quhet gjithçka që shërbëtorët, pleqtë dhe të lodhurit distilojnë; në mënyrë të veçantë, të gjitha ato marrëzi të liga, të çalltisura e dinake klerikale.

Mirëpo, pseudo të urtët, gjithë priftërinjtë, të lodhurit e botës e ata që kanë shpirt femëror e lakenjsh, sa qitje të shëmtuara kanë pasur, gjithmonë, sa shumë kanë luajtur me egoizmin dhe me intrigat e tyre!

Pikërisht ky ishte virtyt e quhej virtyt, ky intrigim kundra egoizmit!

Altruistë: kështu dëshironin të ishin dhe, me arsye, të gjithë këta burracakë të lodhur të botës, këto merimanga të kryqëzuara!

Por, për të gjithë, tashmë erdhi dita, ndryshimi, shpata e gjykimit, mesdita e madhe. Se atëherë shumë gjëra do të bëhen më të qarta.

Kush thotë: "Unë i shenjtë e i shëndetshëm dhe egoizëm i bekuar", në realitet, thotë, si profet, atë që di: "Ja tek po mbërrin, është afër mesdita e madhe!".

Kështu foli Zarathustra.

Për shpirtin e rëndesës

1.

“Gjuha ime është gjuha e popullit: flas në mënyrë të përzemërt e të zakonshme për njerëzit e veshur me mëndafsh. Po edhe më e huaj kumbon fjala ime ndaj të gjitha sepjeve dhe kartëmbështjellësve.

Dora ime është dora e një të çmenduri. Mjerë të gjitha tryezat e muret e gjithçka që ka hapësirë për zbukurimet budallaqe dhe shkarravinat idiote!

Këmba ime është këmbë ekuini (lloj kali). Me të unë çukërmoj e galopoj shkëmbinjtë e masivet malorë, sa gjatë e gjerë; jam një demon gëzimi në galopimet e shpejta. Stomaku im mos është vallë ndonjë stomak shqiponje, se dashuron, në të vërtetë, veçse mishin e qengjit? Por, gjithsesi, është një stomak zogu. Ushqehet me pak e me gjëra të pafajshme, i gatshëm dhe i paduruar të fluturojë, të fluturojë tej. Ky është pra soji im, si të mos kisha vallë brenda vetes diçka prej sojit të flatrorëve! Para së gjithash, është tipike e sojit të flatrorëve që unë jam armik i shpirtit të rëndesës.

Tamam armik për vdekje, armik prej natyre, armik me gjithë thellësinë e shpirtit! Oh, po ku vallë nuk fluturoi e rifluturoi kjo armiçësia ime! Edhe mund të këndoja ndonjë këngë, madje do të doja të këndoja, edhe pse gjendem vetëm në një shtëpi bosh e më duhet të këndoj veç për veshët e mi. Sigurisht që ka këngëtarë të tjerë, të cilëve vetëm shtëpia e mbushur plot ua bën fytyrën e butë, gjestin shprehës, syrin e rrjedhshëm dhe zemrën e zgjuar.

Por unë s’u ngjaj atyre!

2.

Kush do t’u mësojë njerëzve një ditë të fluturojnë, ai do të ketë shkallmuar çdo cak. Gjithë gurët e kufijve do të fluturojnë në ajër, ai do ta ripagëzojë tokën, duke e quajtur “e lehta”.

Struci vrapon shumë më shpejt se sa kali më i shkathët, por edhe ai e përkul akoma kokën e tij të rëndë në tokën e rëndë. Kështu bën edhe njeriu, që nuk ka mundur deri më sot të fluturojë.

Kush synon të bëhet i lehtë e flatror, duhet ta dojë vetveten. Kështu mësoj unë.

Natyrisht, jo me dashurinë e të sëmurëve e të molepsurve, sepse tek ata kutërbon edhe dashuria për vetveten!

Duhet mësuar të dashurohet vetja. Kështu mësoj unë, me një dashuri të drejtë e të shëndetshme, që të qëndrojë pranë saj pa u endur sa andej-këndej.

Një shpërhapje e dashurisë së këtij lloji quhet “dashuria për të afërmin”. Me këtë fjalë është gënjyer gjer më sot, në mënyrën më hipokrite e më të mirë, veçanërisht nga ana e atyre që u mërzitëshin të gjithëve.

Është e vërtetë se, të duash vetveten nuk është ndonjë urdhër i Zotit, as për sot e as për nesër. Por përkundrazi, më i hijshmi, më dinaku dhe më i duruari i të gjitha arteve.

Në të vërtetë, për zotëruesin e vet çdo zotërim fshihet me kujdes; nga të gjitha minierat, jotja është e fundit që shfrytëzohet. Kështu deshi shpirti i rëndesës.

Pothuajse që në djep shpërhapen fjalë e vlera të rënda, të ngarkuara me “të mirën” dhe të “keqen”. Kështu quhet prika që na dorëzojnë menjëherë sa lindim. Falë saj, na falet të jetuarit.

Për këtë, fëmijët lihen që të vijnë te ne, që t’u pengohet ta duan veten. Kështu deshi shpirti i rëndesës.

E ne e mbartim besnikë mbi vete gjithçka na u dha për prikë, mbi shpatulla të forta e përgjatë maleve të vrazhdë. Kur djersijmë, na thonë: “Po, jeta është e rëndë për t’u përballuar!”.

[Mirëpo, është vetë njeriu ai që është aq i rëndë në vetvete për t’u përballuar. Kjo ndodh, sepse mbart shumë gjëra të huaja mbi shpatullat e tij. Ngjan me devenë, përgjunjet dhe e lë veten të ngarkohet paq.]

Veçanërisht i forti, njeriu që mban peshë të rënda mbi shpatulla, i respektueshëm prej natyre, shumë fjalë e vlera të huaja e të rënda i vihen mbi shpinë e pas kësaj jeta i duket një shkretëtirë.

Është e vërtetë, se edhe shumë gjëra tonat janë të vështira për t'u mbartur. Shumë gjëra të brendshme të njeriut janë si stridhe, nazeqare, veshtullore e të vështira për t'u kapur, që vetëm një guaskë fisnike me zbukurime fisnike mund t'i paraqesë. Pra, edhe ky art lipset të mësohet: të kesh një guaskë, një pamje të bukur dhe një verbëri të urtë!

Ngandonjëherë, njeriu të mashtron në disa gjëra, për faktin se guaska e tij është e shprishur, e shëmtuar, i është bërë shumë guaskë. Shumë mirësi e energji të fshehura nuk kuptohen kurrë; më të shijshmet gjëra nuk gjejnë asnjëherë shijuesin e tyre.

Gratë, të hijshmet, e dinë mirë këtë gjë: pak më të shëndosha, pak më të dobëta. Oh, ç'fat qëndron në kaq pak ndryshim!

Burri është më i vështirë për t'u zbuluar, akoma edhe më shumë ndaj vetvetes. Shpesh shpirti gënjen, në lidhje me zemrën. Kështu vepron shpirti i rëndesës.

Por, natyrisht që e ka zbuluar vetveten ai që thotë: kjo është e mira dhe e keqja ime. Me këtë ai e bën memec urithin dhe xhuxhin, që thonë: "Mirë për të gjithë, keq për të gjithë".

Nuk duron dot as edhe ata që e quajnë të mirë çdo gjë, si dhe këtë botë më të mirën. I quan gjithmonë "të kënaqurit".

Kënaqja e gjithçkaje, që di të gjejë shije në gjithçka, nuk është padyshim shijimi më i mirë. Unë i nderoj gjuhët e pabindura dhe stomakët nazeqarë, që kanë mësuar të thonë "unë", "po", "jo".

[Të përtypësh dhe të tresësh gjithçka, do të thotë t'i përkasësh sojit të derrave.]

Të thotë gjithmonë I-A [në gjermanisht JA=PO], veç këtë ka mësuar gomari, e kushdo që i takon sojit të tij.

Të verdhën e thellë dhe të kuqen e ngrohtë do shija ime, që e përzien ngjyrën e gjakut me të gjitha ngjyrat. Por kush e

ngjyen shtëpinë e vet me të bardhë, për mua zhvillon një shpirt të zbardhëllyer.

Disa dashurohen me mumiet, disa të tjerë me fantazmat; të gjithë bashkë, armiq të mishit e të gjakut. Oh, sa kundër shijes më shkojnë të dyja palët, sepse unë dashuroj gjakun!

Nuk dua të banoj, as të rrëmoj aty ku gjithkush pështyn e vomit: kjo është shija ime. Parapëlqej të jetoj midis hajdutëve dhe shpërbetarëve. Askush nuk mban ar në gojë!

Por edhe më shumë jam kundër adhuruesve burracakë. Kafshën më të pështirë që gjeta në mes të njerëzve e quaj parazit; nuk do të dashurojë e, megjithatë rron prej dashurisë.

Për mua janë të palumtur të gjithë ata që kanë vetëm një zgjedhje: të bëhen bisha të liga ose zbutës të ligj. Unë s'do ta ndërtoja kasollen time pranë tyre.

I quaj të palumtur edhe ata që duhet të presin gjithmonë; më shkojnë kundër shijes gjithë doganierët, tregtarët, mbretërit, rojtarët e mbretërive apo të dyqaneve.

Në fakt, edhe unë mësova të pres, madje deri në fund, por të prisja veç për veten time. Mbi të gjitha, mësova të rri në këmbë, të eci pa pushim, të vrapoj, të kërcej, të vallëzoj e të kacavirrem.

Ky është mësimi im: kush do të mësojë të fluturojë, më parë duhet të mësojë të qëndrojë në këmbë, të ecë pa pushim, të vrapojë, të kërcejë, të vallëzojë e të kacavirret. Nuk mësohet të fluturuarit menjëherë!

Mësova të ngjitem nëpër disa dritare me shkallë litari, me këmbë të shkathëta u kacavora drekëve të lartë të anijeve: të rrija ulur në direkët e lartë të dijes nuk m'u duk lumturi e vogël; të përshkëndit si një flakës e vogël mbi direkët e lartë të anijeve. Natyrisht, një dritëz e vogël, por një siguri e madhe për marinarët rrugë-humbur e të rënë në det.

Në shumë mënyra e përmes shumë rrugëve arrita të mbërrija tek e vërteta ime: jo përmes një shkalle të vetme u ngjita në majë, ku syri im endet në hapësirën e shikimit tim.

Gjithmonë pa dëshirë e kërkova rrugën; kjo më ka shkuar gjithmonë kundra shijes. Parapëlqeva ta pyesja e ta kërkoja rrugën prej vetes.

Ndaj, gjithë udhëtimi im ishte një pyetje e një kërkim. Në të vërtetë, duhet të mësohesh t'u përgjigjesh edhe pyetjeve të tilla. Por kjo është shija ime: jo e mirë, jo e keqe, por shija ime, për të cilën tashmë s'kam as frikë, as sekret.

"Kjo, pra, është rruga ime! Ku është juaja? - Iu përgjigja atyre që më pyesnin mbi "rrugën" se, në fakt, rruga nuk ekziston!"

Kështu foli Zarathustra.

Për rrasat antike dhe të reja të ligjeve

1.

Jam ulur e po pres; përreth meje ka rrasa të thyera antike ligjesh dhe rrasa të reja të shkruara përgjysmë. Kur do të vijë ora ime? Ora e zbritjes sime, e perëndimit tim, sepse edhe një herë tjetër dua të shkoj te njerëzit.

Jam, pra, në pritje, sepse më parë duhet të më mbërrijnë shenjat që ora ime ka ardhur, d.m.th luani që buzëqesh me plimin e pëllumbave.

Ndërkaq, si një njeri që ka kohë, flas me veten. Askush s'më tregon ndonjë gjë të re, kështu që unë i rrëfhem vetes.

2.

Kur mbërrita mes njerëzve, i gjeta të ulur mbi një hamendësim antik: të gjithë hamendësonin të dinin prej kohësh se ç'që e mirë dhe e keqe për njerëzit.

Çdo ligjërim mbi virtytin atyre u ngjante diçka e vjetër dhe rraskapitëse. Kushdo që donte të flinte rehat, përpara se të shkonte në shtrat fliste për të mirën dhe të keqen.

I shqetësova këta të fjetur, kur mësova se askush nuk e di akoma se ç'është e mirë dhe e keqe, përveç krijuesit.

Ai që krijoi qëllimin e njeriut e jep domethënien dhe ardhmërinë e tij në tokë, ai është i pari që krijon atë që është e mirë dhe e keqe.

Kështu, u diktova atyre t'i shembnin katedrat e tyre të vjetra, ku rrinte ulur vetëm hamendësimi antik; u diktova atyre të qeshnin me mjeshtrit e mëdhenj të virtytit, me shenjtët, me poetët dhe shpëtimtarët e botës.

U diktova atyre të qeshnin me të urtët e tyre të zymtë, si dhe me ata që, si dordolecë të zinj, rrinë hipur, qortues, paralajmërues mbi pemën e jetës.

Ndenja gjatë nëpër rrugët e mëdha varrezore, aq pranë korbave dhe ngordhësirave, e qesha me të shkuarën e tyre dhe shkëlqimin e saj, tashmë të qullët e të perënduar.

Në të vërtetë, i ngjashëm me predikuesit e pendesës dhe me të çmendurit, unë brita me rropamë e zemërim ndaj të gjitha madhështive dhe vogëlsirave të tyre, sepse, kaq të vogla janë gjërat e tyre më të mira. Po edhe gjërat e tyre të këqija kaq të vogla janë! Ndaj unë qesha.

Bërtiste e qeshte dëshira ime e zjarrtë dhe e mençur, e lindur nëpër male, mençuria ime e egër. Dëshira ime e zjarrtë që rreh flatrat.

Shpesh, në mes të të qeshurave, më tërhiqte nga pas, drejt largësive: fluturoja duke u rrëqethur, si një shigjetë, përmes një ekstaze të dehur nga dielli. Në të largëtat kohë të ardhme, që s'i ka parë kurrë asnjë ëndërr, në Jugun e zjarrtë, që s'e ka ëndërruar kurrë asnjë artist. Atje ku zotat, duke kërcyer, turpërohen nga çdo lloj veshjeje. Në fakt, unë flas me krahasime dhe si poetët, çaloj e belbëzoj se, në të vërtetë, më vjen turp të jem akoma poet.

Aty ku gjithçka më ngjante si një vallëzim e një kapriço hyjnore, e bota e lirë, e paqtë, në rrjedhë drejt vetvetes, si një përvjedhje dhe rikërkim i përjetshëm i aq shumë zotave, si një kundërthënie e bekuar, si një ritakim, ripërkitje e të gjithë këtyre zotave.

Aty ku çdo kohë më ngjante një shpoti e bekuar e çastit, ku nevoja është edhe liri, që luante e bekuar me thumbat e saj.

Aty ku rigjeta demonin tim antik e armikut tim për vdekje, shpirtin e rëndesës, bashkë me gjithçka që ai ka krijuar: shtrëngimin, urdhrin, nevojën, pasojën, qëllimin, vullnetin, të mirën e të keqen.

Pse vallë nuk duhet të jenë të gjitha këto gjërat, mbi të cilat mund të vallëzohet?! Nuk duhet të ekzistojnë, për dashuri të lehtësisë dhe shkathhtësisë, urithët e dreqërit e ngathët?

3.

Ishte atje, ku unë rroka përgjatë rrugës fjalën Mbinjeri, si dhe idenë se njeriu është diçka që duhet të tejkalohet, që njeriu është një urë, e jo një qëllim; që ai duhet të quhet i lumtur për mesditën dhe mbrëmjen e tij, si rrugë për aurora të reja; për fjalën e Zarathustrës, për mesditën e madhe dhe për atë që unë vendosa pezull mbi njeriun, si një të kuqe të dytë purpurore në muzg.

Në të vërtetë, unë i tregova ato me gisht, që të shikonin edhe yje e net të reja. Sipër reve, ditën dhe natën, të shndrijë e shtrirë edhe e qeshura, si një tendë shumëngjyrëshe.

U mësova atyre gjithë poetizmin tim dhe frymëzimet e mia: për ta rikompozuar e vënë së bashku gjithçka, që te njeriu është fragment, enigmë dhe rast i tmerrshëm.

Si poet, zgjidhës enigmash e shpëtimtar i fatit, unë u mësova të krijojnë të ardhmen e, duke shpëtuar të rikrijojnë gjithçka që ish më parë.

Të shpëtojnë të shkuarën te njeriu e të rikrijojnë çdo "ish", deri kur vullneti të thotë: "Kështu desha! Kështu do të dua!".

Këtë unë e quajta shpëtim; vetëm këtë u mësova atyre ta quanin shpëtim.

Tani po pres shpëtimin tim, që të shkoj për të fundit herë në mes tyre.

Sepse dua të shkoj edhe një herë tjetër mes njerëzve. Në fakt, dua të perëndoj e, duke u dergjur, dua t'u jap atyre më të pasurën dhuratë të të gjitha dhuratave të mia.

Këtë e mësova nga dielli. Atëherë kur perëndon, ai derdh në det arin e gjithë pasurisë së tij të pashtershme, aq sa edhe më i varfëri i peshkatarëve të lundrojë me rrema të praruara. E pashë këtë një herë dhe, duke e parë, nuk ngopesha dot së qari.

I ngjashëm me diellin do të perëndojë edhe Zarathustra: tash rri ulur e pret. Përreth ka rrasa të thyera ligjesh antike dhe rrasa ligjesh të reja, të shkruara përgjysmë.”

4.

“Ja, këtu është një rrasë e re. Po ku janë vallë vëllezërit e mi, që do ta çojnë rrasën, bashkë me mua, luginave dhe zemrave njerëzore?

Dashuria ime e madhe për më të largëtit dikton të mos e kursesh të afërmin tënd. Njeriu është diçka që duhet tejkaluar.

Ka shumë rrugë e mënyra tejkalimi: kjo është çështja jote. Veç një palaço mund të mendojë se “njeriu edhe mund të kapërcehet”.

Tejkaloje veten edhe tek i afërmi yt: një të drejtë që t'i mund ta rrokësh vetë, nuk duhet të presësh që të ta japin.

Atë që bën, s'mund të ta ribëjë askush. Nuk ekziston, siç e sheh, shpërblimi.

[Kush nuk mund ta komandojë veten, duhet të bindet. Më shumë se një arrin ta komandojë veten, por mungojnë akoma ata që guxojnë të binden.]

5.

Kështu do karakteri i shpirttrave fisnikë: nuk duan të fitojnë asgjë pa dhënë asgjë e, më pak nga të gjitha, vetë jetën.

Vetëm kush i përket popullit, do të jetojë për asgjënë, por ne të tjerëve, që jeta na është dhuruar, mendojmë gjithmonë se ç'gjë

të mirë t'i japim si shpërblim. Se, në të vërtetë, është fisnike ajo fjalë që thotë: ajo çka na premtton jeta, ne duam ta mbajmë.

Nuk duhet të duash të shijosh, kur nuk dhuron shijim. Madje, as duhet të duash fare të shijosh!

Shijimi dhe pafajësia janë gjërat më me cipë të botës: nuk lipset t'i kërkosh. Duhet t'i zotërosh, më tepër le të kërkosh fajin dhe dhimbjen!

6.

O vëllezër, kush është prodhim i hershëm, gjithmonë sakrifikohet! Ne jemi prodhime të hershme. Të gjithë kullojmë gjak në altarët sekretë të sakrifikimeve; ne të gjithë digjemi e piqemi për nder të idhujve antikë.

Pjesa jonë më e mirë është ende e re: kjo i ngacmon qiellzat e vjetra. Mish i ynë është i butë, lëkura jonë është pothuajse si një lëkurë qengji. Si mund të mos i ngacmojnë priftërinjtë pleq të idhujve?

Se është brenda nesh ku banon prifti plak i idhujve, kur piqet pjesa jonë më e mirë për bankete. Medet, o vëllezër, si mundet vallë të korrat e hershme të mos bëhen fli!

Kështu e do karakteri ynë: unë i dua ata që nuk parapëlqejnë të ruhen. Unë i dua me gjithë dashurinë time ata që perëndojnë, sepse janë ata që kalojnë përtej."

7.

Të jesh i sinqertë është diçka që pak e kanë. E kush mundet, nuk do! Por më pak nga të gjithë munden të mirët.

Ah, këta të mirët! Njerëzit e mirë nuk e thonë kurrë të vërtetën; për shpirtin është sëmundje të jesh aq i mirë.

Jepen, edhe këta të mirët, dorëzohen, zemra e tyre flet, intimiteti i tyre bindet, por ai që bindet nuk e ndjen vetveten!

Gjithçka që të mirët e quajnë të keqe, duhet të mblidhet bashkë që të lindë një të vërtetë. O vëllezër, mos jeni vallë aq të ligj për këtë të vërtetë?

Rreziku i guximshëm, mosbesimi i gjatë, mohimi mizor, mërzia, të këputurit në mes; sa rrallë të gjitha këto shkojnë bashkë? Por me këto fara vjen e krijohet e vërteta.

Pranë një ndërgjegjeje të keqe është rritur deri tani çdo shkencë. Copëtohuni, copëtomëni, o ju që i njihni rrasat antike të ligjeve!

8.

Nëse detet kanë trarë kapërcyes, nëse urëzat dhe parmakët kapërcejnë lumenjtë, atëherë nuk gjen besim ai që thotë se “gjithçka rrjedh”.

Edhe budallenjtë e kundërshtojnë. “Si”? - thonë ata. - Gjithçka është në lumë? Po trarët e parmakët, a nuk kalojnë vallë sipër lumit?

Sipër lumit, gjithçka është e fortë, të gjitha vlerat e gjërave, urat, konceptet, “e mira” dhe “e keqja”. Gjithçka është e fortë!

Kur mbërrin pastaj dimri i ashpër, zbutës i lumit, atëherë edhe më të shkathëtit e dinakët nisin të mësojnë të dyshojnë se, në fakt, nuk janë vetëm budallenjtë që pyesin: “Nuk qëndron vallë gjithçka e palëvizur?”

“Thellë-thellë, gjithçka rri palëvizur.” Ky është mësimi i drejtë dimëror, diçka e mirë për kohët jo pjellore, një përballje e mirë për dimërimin dhe kolltukët.

“Thellë-thellë, gjithçka rri palëvizur.” Mirëpo, era e pranverës predikon të kundërtën.

Era e çakullimit, një dem, që nuk është demi që tërheq parmendën, një dem i fuqishëm, shkatërrues, që copëton akullin me brirët e tij të tërbuar. Mirëpo, akulli i copëton pasarelat.

Atëherë, o vëllezër, nuk është vallë tashmë gjithçka në lumë?

Nuk kanë rënë të gjitha pasarelat dhe parmakët në ujë?

Kush mbështetet akoma tek “e mira” dhe “e keqja”?

“Mjerë ne! Rrofshim ne! Fry o erë e çakullimit! Këtë predikoni, o vëllezër, nëpër të gjitha rrugët!

9.

Ekziston një marrëzi antike, që quhet e mirë dhe e keqe. Rrota e kësaj marrëzie është rrotulluar deri këtu në gojën e profetëve dhe astrologëve.

Një kohë u besohej profetëve dhe astrologëve, ndaj besohej se “gjithçka ishte fat” e që “ti duhet të bësh kështu, sepse ashtu duhet”!

Më vonë u dyshua te profetët dhe astrologët, ndaj u mendua se “gjithçka është liri, ti mundesh, sepse do!”.

Vëllezër, për yjet dhe për të ardhmen deri më sot është folur me hamendje e pa ditur asgjë, ndaj edhe për të mirën e të keqen është folur me hamendje, pa ditur asgjë.

10.

“Ti nuk duhet të vjedhësh! Ti nuk duhet të vrasësh! Këto parime njëherë quheshin të shenjta, para tyre përuleshin gjunjët dhe kryet e hiqeshin edhe këpucët.

Po unë ju pyes: Ku ka pasur vallë në botë hajdutë dhe vrasës më të këqij se sa këto fjalë të shenjta?

Nuk është vallë në thelb të çdo jete vjedhja dhe vrasja? E t'i quash të shenjta të tilla fjalë, nuk është njësoj sikur ta vrasësh vetë të vërtetën?

Nuk ishte predikim vdekjeje, ta quaje të shenjtë atë që kundërshton e përballet me çdo jetë?

Vëllezër, copëtojini, thyejini rrasat antike të ligjeve!

11.

Ky është mëshirimi im ndaj së shkuarës: që të shoh se si u sakrifikua, se si u sakrifikua për mëshirën, për shpirtin, për marrëzinë e çdo brezi që vjen e transformon në urë të vet, gjithçka që ish.

Mund të vijë një i fuqishëm, i madh, një despot dinak që, me hijeshinë dhe mynxyrën e tij të arrijë ta shtrëngojë dhe

dhunojë gjithë këtë të shkuar, gjersa ajo të bëhet për të buka, shenja paralajmëruese, stema dhe kënga e këndesit.

Mirëpo, ky është rreziku tjetër dhe mëshirimi tjetër që unë kam: kush i përket popullit, shkon me mendimin e tij gjer te gjyshërit, por me gjyshërit ndërpritet rrjedha e kohës për të.

Kështu mund të sakrifkohet edhe tërësia e së shkuarës, sepse mund të ndodhë që njëherë plebenjtë të bëhen padronë e të mbysin në ujërat e tyre të cekëta çdo kohë.

Ndaj, o vëllezër, është e nevojshme një fisnikëri e re, që të jetë kundër çdo mase popullore dhe çdo tiranie, që të shkruajë sërish mbi tabela të reja fjalën "fisnikëri".

Janë të nevojshëm shumë fisnikë e një varietet i tërë fisnikësh, që të krijohet aristokracia. Ose, siç e thashë njëherë, nëpërmjet një krahasimi: pikërisht ky është diviniteti, të ekzistojnë zota, por jo një zot!

12.

"Vëllezër, unë ju dëftoj e ju shuguroj një aristokraci të re: duhet të bëheni dëshmitarët, mbjellësit dhe kultivatorët e së ardhmes. Në të vërtetë, jo një aristokraci që mund të blihet, siç bëjnë tregtarët me arin e tyre, sepse shumë pak vlerë ka ajo që ka çmim.

Që tash e tutje, nderi juaj nuk do të varet nga se vini, por se ku do të shkoni. Vullneti dhe këmba juaj, që do të shkojë përtej vetvetes: kjo përbën nderin tuaj të ri.

Jo sepse i keni shërbyer ndonjë princi, ç'rëndësi kanë tashmë princat! Apo se jeni bërë pengesa e asaj që tashmë ishte e fortë dhe në këmbë, për t'u bërë akoma dhe më e fortë.

As edhe pse nderi juaj ishte bërë kurtizania e ndonjë oborri, e ju patët mësuar të qëndronit në këmbë, si një çafkë laramane, për orë e orë të tëra mbi një liqenth ujëpakë. Sepse, të qëndrosh kështu në këmbë është meritë e kurtizaneve e, në të vërtetë, të

gjitha kurtizanet besojnë se i përket bekimit, pas vdekjes, lejimi i të qëndruarit ulur.

As edhe pse një shpirt, që ata e quajnë të shenjtë, i udhëhoqi paraardhësit tuaj në tokën e premtuar që, për mua, nuk është ndonjë elozh, sepse atje rritet më e keqja e të gjitha pemëve, Kryqi. As ajo nuk është tokë për t'u lëvduar!

Në fakt, kudo ku "shpirti i shenjtë" i ka udhëhequr kavalierët e vet, kortezhe të tilla janë paraprirë gjithmonë nga dhi, pata, kryqe e mendje të sëmura.

Vëllezër, aristokracia juaj nuk duhet të shohë prapa, por përpara! Duhet ta bëni veten t'ju dëbojnë nga të gjitha tokat e etërve dhe stërgjyshërve!

Duhet të dashuroni tokën e bijve tuaj. Kjo dashuri qoftë aristokracia juaj e re: tokën ende të pazbuluar, në më të largëtin e deteve! Drejt tyre, ju them t'i drejtoni velat, duke i kërkuar pa u lodhur kurrë!

Bijve ju duhet t'u lini shlyerjen e fajeve të të qenit bij të baballarëve tuaj. Duhet ta rishpëtoni kështu gjithë të shkuarën!

Këtë rrasë të re po vendos tash mbi kryet tuaja!"

13.

"Përse të jetosh? Gjithçka është e kotë! Të jetosh është si të bluash kashtë. Jeton, e digjesh pa u ngrohur!"

Këto llomotitje të vjetra janë quajtur gjithmonë "mençuri", madje, pikërisht pse janë të vjetra kutërbojnë myk, nderohen akoma e më shumë. Edhe myku fisnikërohet.

Fëmijëve u lejohej të flasin kështu: kanë frikë nga zjarri, sepse janë djegur në të. Ka shumë foshnjëri te librat antike të mençurisë.

Po kush "bluan gjithmonë kashtë", si mundet vallë të flasë keq për shirësen? Lipset t'ua taposësh gojën të çmendurve të tillë!

Disa ulen në tryezë e nuk sjellin asgjë me vete, madje as edhe një grishje të mirë urie, e pastaj blasfemojnë se "gjithçka është e kotë".

Mirëpo, të ngrënit e të pirit, o vëllezër, në fakt, nuk është ndonjë art i kotë. Copëtojini, copëtomini rrasat e ligjeve të atyre që nuk janë kurrë të kënaqur!”

14.

“Për të kulluarin, gjithçka është e kulluar!” Kështu flet populli. Por unë ju them: për derrat, gjithçka bëhet e ndyrë!

Prandaj, të eksituarit dhe melankolikët, që edhe zemrën e kanë të varur (pezull) predikojnë: “Bota vetë është një bishë e neveritshme”. Sepse të gjithë ata janë shpirtra të papastër e, në veçanti, ata që nuk kanë as qetësi e as pushim, përveçse kur e shohin botën përmbys, transcendentalistët.

Këtyre unë u them ballë për ballë, edhe pse fjalët nuk kumbojnë hijshëm: Bota, si njeriu, ka dhe ajo të ndenjura, e ky është fakt!

Ka shumë baltë nëpër botë, e ky është fakt! Por jo për këtë arsye bota është një botë e shpifur!

Ka një mençuri në shprehjen se shumë gjëra në botë kutërbojnë. E njëjta neveri krijon krahë e forca parathonjëse të burimeve të kulluara. Edhe te më e mira ka diçka të pështirë, edhe te më i miri ka diçka që duhet të tejkalohet.

Vëllezër, ka aq shumë mençuri, në faktin se ka aq shumë baltë në botë!

15.

Këto ligjërime dëgjova t’i bënin ndërgjegjes së tyre shumë transcendentalistë; në fakt pa ligësi e hipokrizi, pavarësisht se në botë nuk ka ligësi e hipokrizi më të këqija se këto.

Lëreni botën siç është, mos ngrini kundra saj as edhe një gisht!

Lëreni që, kush të dojë le t’i mbysë, t’i therë, t’i torturojë e dëbojë njerëzit: mos ngrini as edhe një gisht kundra tyre! Kështu do mësojnë ta mohojnë botën.

Ti duhet ta zësh për fyti e ta mbysësh arsyen tënde, sepse ka një arsye edhe për këtë botë; kështu do të mësosh edhe ti ta mohosh botën.

Copëtojini, shkallmojini, o vëllezër, këto rrasa antike të njerëzve të devotshëm. Kundërshtojini ligjërimet e shpifësve të botës!

16.

“Kush mëson shumë, çmëson të ketë dëshira të forta.” Kjo pëshpëritet nëpër të gjitha ato rrugica të errëta.

“Mençuria të lodh, nuk ia vlen barra qiranë; ti nuk duhet ta dëshirosh!” I kam gjetur shpesh të varura këto rrasa të reja edhe nëpër tregje.

Copëtojini, o vëllezër, shkallmojini edhe këto rrasa të reja ligjesh! I kanë varur të lodhurit e botës dhe predikuesit e vdekjes, bashkë me të burgosurit se, kujdes, ato nuk janë veçse predikime në favor të skllavërisë.

Ata kanë mësuar keq, madje edhe nga gjërat më të mira, e gjithçka shumë shpejt e me ngut, duke ngrënë keq u është prishur stomaku.

E shpirti është një stomak i prishur që këshillon vdekjen, sepse dhe në realitet, o vëllezër, shpirti është një stomak!

Jeta është një burim drite, por për atë, nëpërmjet të cilit flet një stomak i prishur, babai i mjerimit, për të janë të helmuara të gjitha burimet.

Të njohë: ky është gëzimi i vullnetit luanor! Por kush është lodhur, është bërë edhe “pasiv”, ngashënjim i të gjitha dallgëve. Kjo është gjithmonë mënyra e veprimit të njerëzve të dobët që humbasin nëpër rrugë. Në fund, lodhja e tyre pyet: “Përse kemi përshkuar vallë kaq shumë rrugë? Tek e fundit, gjithçka është po njësoj”.

Atyre u kumbon i këndshëm në vesh predikimi: “Nuk ia vlen mundimi! Nuk duhet të dëshironi!”. Mirëpo, ky është një predikim në favor të skllavërisë.

O vëllezër, Zarathustra po mbërrin si një erë e freskët dhe e furishme për të lodhurit e rrugës; do të bëjë të teshtijnë shumë prej hundëve të tyre.

Frymimi im i lirë kalon edhe përmes mureve, depërton nëpër qeli e në shpirtrat e të burgosurve.

Vullnet të lirë, sepse vullneti është krijim: kështu ju mësoj. Vetëm me qëllimin për t'ju rikrijuar duhet ta mësoni atë.

Por edhe të mësuarit, ju duhet ta kuptoni nga unë, ndaj mësojeni mirë!

Kush ka veshë për ta kuptuar, le ta kuptojë!

17.

“Ja tek duket anijëza atje tej! Përposh do të përfundojë, ndoshta, në hiçin e madh. Po kush vallë do të hipë në këtë “ndoshta”?

Askush prej jush nuk do të hipë mbi barkën e vdekjes! Përse atëherë duhet të jeni të lodhur me botën?

Të lodhur me botën! Nuk ishit të mirë të bëheshit as edhe ikanakë të saj! Ju gjeta të dëshirueshëm për tokën, madje të dashuruar edhe me lodhjen tokësore.

Jo për hiç gjë ju varet buza: një dëshirë e vockël tokësore ka mbetur akoma. Në sy, a nuk ju vërehet vallë një re e vockël e një gëzimi të paharruar tokësor?

Ka në tokë shumë sajesa të mira, ca të dobishme, ca të tjera të pëlqyeshme. Për arsye të tyre, toka është për t'u dashuruar.

Sajesa të ndryshme janë aq të mira sa u ngjasojnë gjinjve të grave: të dobishme e të pëlqyeshme, në të njëjtën kohë.

Po ju, o të lodhur nga bota! Ju, kolltukë tokësorë! Do të ishte mirë t'ju përkëdhelnim me kamxhik, për t'ua bërë këmbët me fshikullime, sërish të shkathëta e të lehta!

Sepse, nëse nuk jeni të sëmurë e krijesa të mykura, me të cilat toka është lodhur, atëherë jeni kolltukë dinakë, o hamës të mëdhenj, o mace tinëzare e epsharake. E nëse nuk do të donit të vraponit përsëri hareshëm, atëherë duhet të na hiqeni qafe!

Nuk duhet të jeni kurrë mjek të të pashërueshmëve: kështu mëson Zarathustra. Ndaj, hiquni qafe!

Por lipset më shumë kurajë, për t'u hequr qafe, se sa për të bërë një varg të ri. Këtë e dinë të gjithë mjekët dhe poetët.

18.

Vëllezër, ka rrasa ligjesh të krijuara nga lodhja e të tjera të krijuara nga përtacia e qelbëzuar që, edhe pse flasin në po të njëjtën mënyrë, duan të dëgjohen në mënyra të ndryshme.

Shikojeni këtë që po lëngon! Është veçse një pëllëmbë larg nga qëllimi i tij, por prej lodhjes ka rënë kryeneçërisht i plandosur në pluhur, ky trimoshi!

Prej lodhjes i gogësin udhës, tokës, qëllimit dhe vetvetes; nuk arrin dot të bëjë as edhe një hap, ky trimoshi!

Tash dielli përndizet mbi të e qentë ia lëpijnë djersën, por ai dergjet në kryeneçësinë e vet e parapëlqen të lëngojë: të lëngojë, një pëllëmbë larg qëllimit të vet.

Ju duhet ta zvarrisni prej flokësh drejt qiellit të vet, këtë hero!

Është më mirë, pra, që ta lini të dergjet aty ku është shtrirë, që t'i mbërrijë gjumi, ngushëlluesi, me zhaurimën freskuese të shiut. Lëreni të dergjet aty derisa të mos zgjohet vetë, derisa të mos e mohojë vetë lodhjen dhe gjithçka që lodhja i ka mësuar!

Vetëm, vëllezër, dëbojini prej tij qentë, hipokritët e ndyrë e gjithë krimbat gëlues: gjithë atë llum gëlues "njerëzish të kulturuar", që është gjithmonë lakmitar për djersën e heronjve!

19.

"Gjurmoj përreth meje rrathë e kufij të shenjtë; një numër personash gjithnjë e më i vogël ngjitet me mua maleve, përherë e më të lartë. Ndërtoj një zinxhir malesh me male gjithnjë e më të shenjtë.

Po kudo ku do të ngjiteni me mua, o vëllezër, kujdesuni që asnjë parazit të mos ngjitet me ju!

Paraziti është një krimb zvarritës, që futet e do të majmet në kurriz të pjesëve tuaja të dobëta e të sëmura.

Ky është arti i tij, që të kuptojë, duke përgjuar shpirtrat që ngjiten lart, se cilat janë anët e tyre të dobëta. E ndërton folenë e vet të pështirë në mjerim e dobësi, në turpin tuaj të brishtë.

Aty ku i forti është i dobët, fisniku shumë bujar, aty ai e ndërton folenë e tij të pështirë. Paraziti banon aty ku i madhi i ka të vogla pikat e tij të dobëta.

Cili është modeli më i lartë i çdo qenieje eksituese e cili më i vogli e më i ulëti? Ja, tipi më i vogël e më i ulët është paraziti; por kush i përket racës më të lartë është njëherësh edhe ai që ushqen pjesën më të madhe të parazitëve.

Ai është shpirti që ka shkallën më të gjatë për t'u ngjitur e për të zbritur më thellë se të tjerët. Atëherë, si të mos ngulen mbi të pjesa më e madhe e parazitëve?

Është shpirti më i gjerë që mund të vrapojë brenda vetes sa më larg që të mundet e të endet ku të dojë; shpirti më i zhytur në nevoja e që, për trill bie dhe humbet te Rasti; shpirti që është e që bie i humbur te Bërja; shpirti që zotëron e që, megjithatë, bie në tensionin dhe në dëshirën për të kaluar përtej; shpirti që i arratiset vetvetes e që i rikthehet asaj në një rreth më të gjerë; shpirti më i mençur, që është njëherësh më i ëmbli në shushurimën e marrëzisë; shpirti që më shumë dashuron vetveten, në të cilin të gjitha gjërat gjejnë rrjedhjen dhe tërheqjen, baticën dhe zbaticën e tyre.

Oh, sa do të donte më i larti shpirt të mos ishte strehim i parazitëve më të këqij!”

20.

“Vëllezër, mos jam gjë mizor? Po unë them se, asaj që është duke rënë, duhet t'i jepet një shtytje për ta rrëzuar tërësisht.

Totalitetin e sotshëm që po bie, që po shkon në rrënim. Kush vallë do ta ndjente ta pengonte? Po unë, tamam unë, do ta doja t'i jepja edhe një shtytje tjetër!

A e njihni dëshirimin e rrokullisjes së gurëve në humnerë? Shikojini këta njerëzit e sotëm se si rrokullisen në thellësitë e mia.

Unë jam një prelud i tingëlluesve më të mirë, o vëllezër! Një shembull! Veproni sipas shembullit tim!

E atij që nuk i mësoni të dëshirojë. Bëmëni një nder: mësojini të rrëzohet sa më shpejt!”

21.

“Unë i dashuroj guximtarët, por nuk mjafton të jesh shpatar i zoti, lipset edhe të dish të gjesh se “kë të qëllosh”.

Shpesh, ka më shumë vlerë përmbajtja dhe të kaluarit pëftej, për t'u kursyer në pritje të një armiku më të denjë.

Duhet vetëm të keni armiq për të urryer, por jo për të përçmuar: duhet të jeni krenarë për armikun tuaj. E kam thënë edhe herë tjetër. Duhet ta kurseni veten, miqtë e mi, për një armik më të denjë, ndaj është e nevojshme t'u shmangeni shumë gjërave, veçanërisht shumë njerëzve, që ua shurdhojnë veshët me fjalë të tilla, si populli e popujt.

Ruajeni të kulluar shikimin nga “pro” dhe “kundër” e tyre! Shumë gjëra tek ata janë të drejta e shumë të padrejta, aq sa t'i shohësh të kallet zemërimi.

Të shohësh brenda vetes e të goditesh brenda saj, është si një gjë e vetme; andaj shkoni nëpër pyje dhe lëreni të flejë shpata juaj.

Shkoni në udhën tuaj e lini që populli dhe popujt të shkojnë në udhën e tyre! Janë, në të vërtetë, udhë të errëta, ku nuk dritëson asnjë shpresë e vetme.

Kush ju sundon është tregtari; ajo që ende ju rishkëlqen është veçse ari i dyqanxhiut, kinkaleri e pështirë. Nuk është më koha e mbretërive: ai që sot quhet popull, nuk i meriton.

Shikojeni se si këta popuj imitojnë tashmë mall-shitësin: zgjedhin edhe pjesëzat më të vogla të përfitimeve në çdo plehërishte.

Përgjojnë njëri-tjetrin, i zhvatin gjithnjë njëri-tjetrit ndonjë sekret.

Këto i quajnë “rregulla të fqinjësisë së mirë”. Oh, të lumturat kohë të shkuara, kur një popull thoshte vetëm “dua të jem sundimtari i popujve!”.

Se, o vëllezër, më i miri duhet të sundojë, më i miri patjetër të sundojë. Atje ku doktrina thotë të kundërtën, atje është më i miri që mungon.”

22.

Mjerë sikur ata ta kishin bukën falas! Kundër ç'gjeje atëherë do të mund të bërtisnin! Ushqimi është zbavitja e tyre e drejtë, ndaj duhet ta sigurojnë me vështirësi.

Janë bisha për pre: titulli i “punës” së tyre është akoma “grabitja”, titulli i “fitimit” të tyre akoma mashtrimi, ndaj duhet ta fitojnë me vështirësi.

Duhet të bëhen bisha më të mira, më të sjellshme, më dinake, më të ngjashme me njeriun. Se njeriu është me të vërtetë bisha më e mirë që ekziston.

Njeriu ua ka vjedhur tashmë të gjitha bishave virtytet e tyre; kjo, sepse njeriu është gjetur në mes vështirësive më të mëdha se të gjitha bishat e tjera.

Vetëm zogjtë janë sipër tij. Nesër njeriu do të mësojë edhe të fluturojë, mjerë të tjerët! Gjer ku vallë nuk do të fluturonte dëshirimi i tij i zjarhtë grabitqar?”

23.

Kështu unë e dua burrin dhe gruan: të aftë njërin në luftë, e tjetrin në lindje, por që të dy të aftë për të vallëzuar me kokë e me këmbë.

Le të quhet si e humbur për ne ajo ditë kur nuk do të kërcenim, të paktën një herë! E gënjeshtërt qoftë për ne çdo e vërtetë që nuk duron dot një buzëqeshje!

24.

Shpallja e martesës: kujdes, mos qoftë për ju një mbyllje e keqe! Mbylleni shumë shpejt, kështu kjo pasohet me prishjen e saj.

Por megjithatë, është gjithmonë më mirë ta prishësh martesën se sa ta përkulësh atë, t'i gënjesh asaj! Një grua me tha: "Po, e prisha martesën, por më parë ajo më kishte prishur mua!".

Çiftëzimet e këqija i kam parë gjithmonë të kenë hakmarrjet më të këqija: duan t'ia shpallin gjithë botës, se nuk mund të shkojë secili në udhën e vet.

Ndaj, unë dua që të ndershmit t'i thonë njëri-tjetrit: "Ne duhemi, lërnani të shohim, nëse mund të vazhdojmë të duhemi! Mos duhet vallë që premtimi ynë të përbëjë ndonjë gabim?"

Na lini një shtyrje të afatit dhe një martesë të shkurtër, për të parë nëse jemi të aftë për martesën e madhe! Është diçka e vështirë të jesh gjithmonë vetë i dytë!".

Kështu i këshilloj të gjithë të ndershmit. E ç'do ish vallë dashuria ime për Mbinjeriun e për gjithçka që duhet të vijë, po të flisja ndryshe!

Se o vëllezërit e mi, kopshti i martesës nuk duhet të shërbejë vetëm për shtim, por edhe për rritje.

25.

Kush bëhet i mençur në njohjen e origjinave antike, do të kërkojë më në fund edhe burimet e së ardhmes dhe origjina të reja.

Vëllezër, nuk do të kalojë shumë kohë e do të dalin popuj të rinj dhe burime të reja do të rrokullisin drejt humnerave të reja.

Tërmeti, që i zbulon tokës shumë burime e që shkakton shumë të vdekur nga etja, sjell në dritë edhe forca të brendshme e gjëra të fshehura.

Tërmeti zbulon burime të reja. Nga tërmeti i popujve antikë do të shpërthejnë burime të reja.

Nëse dikush bërtet: ja dhe një burim për aq shumë të etur, një zemër për shumë nostalgji, një vullnet për aq shumë instrumente, përreth tij mblidhet një turmë e tërë. Ai nis të kërkohet nga aq shumë të tjerë.

Kush mund të komandojë, kush duhet të bindet. Kjo është ajo çka kërkohet! Medet sa i gjatë është kërkimi, këshillimi, shkëshillimi, mësimi dhe orvatja!

Shoqëria njerëzore është një orvatje - kështu ju mësoj unë - një kërkim të gjatë kërkon ai që komandon.

Një orvatje, o vëllezër, e jo një kontratë! Copëtojeni, shkallmojeni këtë fjalë të zemrave të buta e masave gjysmake!

26.

Vëllezër! Cili është shkaku i rrezikut më të madh që iu kanos së ardhmes së njerëzimit? Nuk është vallë për shkak të të mirëve dhe të këqijve?

Për shkak të atyre që ndjejnë me zemër e thonë se “ne e dimë ç’është e mirë dhe e drejtë dhe i zotërojmë ato; mjerë ata që i kërkojnë ende!”.

Pavarësisht dëmeve që mund të bëjnë të këqijtë, dëmi i të mirëve është më i dëmshmi i të gjitha dëmeve.

Pavarësisht dëmeve që mund të bëjnë shpifësit e botes, dëmi i të mirëve është më i dëmshmi i të gjitha dëmeve.

Vëllezër! Një herë dikush pa në zemrat e të mirëve dhe të drejtëve dhe tha: “Janë farisenj”. Por askush s’e kuptoi.

Vetë të mirët dhe të drejtët nuk mund ta kuptonin: shpirti i tyre ishte burgosur prej ndërgjegjes. Budallallëku i të mirëve është patejçueshmërisht dinak. Kjo është e vërteta: të mirët duhet të jenë farisenj, pasi nuk kanë zgjedhje tjetër. Të mirët duhet ta kryqëzojnë atë që gjen virtytin e vet. Kjo është e vërteta.

I dyti që zbuloi vendin e tyre, vendin, zemrën dhe mbretërinë tokësore të të mirëve dhe të drejtëve, ishte ai që pyeti: “Kë urrejnë vallë me shumë?”.

Ata urrejnë më shumë krijuesin që shkallmon rrasat e ligjeve dhe vlerave antike, shkallmuesin që e quajnë vrasës.

Të mirët, në fakt, nuk mund të krijojnë: ata janë gjithmonë zanafilla e fundit: kryqëzojnë atë që shkruan shumë vlera mbi rrasat e reja të ligjeve. Duke i sakrifikuar vetes të ardhmen, kryqëzojnë çdo të ardhme të njerëzimit.

Të mirët kanë qenë gjithmonë zanafilla e fundit.

27.

Vëllezër, a e kuptuat vallë edhe këtë fjalë? Po ato që unë thashë një ditë mbi njeriun e fundit?

Cili është shkaku i rrezikut më të madh që iu kanos së ardhmes së njerëzimit? Nuk është vallë për shkak të të mirëve dhe të drejtëve?

Copëtojini, shkallmojini të mirët dhe të drejtët! Vëllezër, a e kuptuat vallë edhe këtë fjalë?”

28.

Po ikni nga unë? Jeni të frikësuar? Dridheni përpara kësaj fjale? Vëllezër, kur ju bëra thirrje t'i copëtoni të mirët dhe rrasat e ligjeve të të mirëve: vetëm atëherë unë e nisa njeriun për në baticën e vet. Mirëpo, këtu hyn tek ai frika e madhe, tmerri i madh, e keqja e madhe, pështirosja e madhe, sëmundja e madhe e detit. Brigje dhe siguri të gënjeshtërtja ju kanë mësuar të mirët; në gënjeshtërtëri të mirëve ju lindët dhe u besuat të sigurt. Gjithçka, që në thellësi u përgënjeshtërtua dhe u shtrembërua nga të mirët. Po kush zbuloi tokën “njeri”, zbuloi edhe tokën “e ardhme njerëzore”. Ju duhet të jeni lundërtarët e mi trima dhe të duruar. Ecni, pra, me kokën lart, o vëllezër, mësoni të ecni drejt! Deti është i stuhishëm: shumë kanë nevojë për ju që të ngrihen.

“Deti është i stuhishëm: gjithçka gjendet në det. Forca, pra!

Nisuni! Zemra të vjetra marinarësh!

E ç'është toka e etërve! Timoni do të ndalojë aty ku është toka e bijve tanë, më e stuhishme se deti. Drejt saj vërsulet dëshirimi ynë më i madh!”

29.

“Përse je kaq i fortë? - e pyeti një ditë diamantin qymyri i kuzhinës. - Nuk jemi vallë të afërm?”

“Përse jini kaq të butë, o vëllezër? - ju pyes unë. - A s'jeni vallë vëllezërit e mi?”

Përse kaq të butë, kaq të zbutur e të dorëzuar? Përse në zemrat tuaja ka kaq shumë mohim dhe sakrificë? Përse ka pak fat në shikimet tuaja?

Nëse nuk doni të jeni fat dhe pashtershmëri, si mundet vallë të fitoni?

Nëse fortësia juaj nuk do të përshkënditë, të presë e të përthajë, si mundeni vallë një ditë të krijoni bashkë me mua?

Krijuesit janë të fortë. Bekim duhet të jetë për ju damkosja e gjurmëve të duarve tuaja mbi mijëvjeçarë, si mbi dyllë. Bekimshkruarja mbi vullnetin e mijëvjeçarëve, si mbi bronz, si mbi bronzin më të fortë, si mbi bronzin më fisnik. Është e fortë vetëm ajo që është epërisht fisnike.

Këtë rrasë të re ligji, o vëllezër, unë po ngre mbi ju: të bëheni të fortë!

30.

“O ti, vullneti im! Ti, kthesa e çdo nevoje, ti nevoja ime! Shpëtomë nga të gjitha fitoret e vogla!”

Ti, misioni i shpirtit tim që unë e quaj Fat! Ti, brenda meje! Ti, sipër meje! Shpëtomë e më ruaj për një fat të madh!

Madhështinë tënde të mbrame, vullneti im, ruaje për ndërmarrjen tënde të fundit, që ti të jesh i pashtershëm në fitore! Medet, kush nuk i nënshtrohet fitores!

Medet, kujt nuk iu errësua shikimi, në këtë muzg të dehur!

Medet, kujt nuk iu lëkund këmba, kush nuk çmësoi të qëndronte në këmbë, në fitore!

Që unë një ditë të jem i gatshëm e i pjekur për mesditën e madhe, i gatshëm dhe i pjekur si një bronz i përskuqur, re e mbarsur me rrufe dhe gji të gufuar nga qumështi; i gatshëm për vetveten dhe për vullnetin tim më sekret; një hark i dashuruar me shigjetën e vet, një shigjetë e dashuruar me yllin e vet; një yll, i gatshëm dhe i arrirë për mesditën e vet të përndezur, të brimuar, të bekuar përballë rrezeve shkatërruese të diellit; një diell ajo vetë dhe një vullnet i patundur diellor, i gatshëm për t'u shkatërruar në fitore.

O vullnet i ndehur në çdo nevojë, ti, nevoja ime! Më ruaj për një fitore të madhe.

I shëruari

1.

Një mëngjes, jo shumë pas kthimit të tij në shpellë, Zarathustra brofi nga shtrati si një i çmendur, duke bërtitur me një zë të tmerrshëm e duke debatuar, sikur në shtrat të mos kish qenë vetëm ai, por dhe dikush tjetër që nuk donte të ngrihej. Kaq i fortë kumboi zëri i Zarathustrës sa që kafshët e tij vrapuan për tek ai të frikësuara. Nga të gjitha shpellat e zgavrat e afërta me shpellën doli jashtë çdo lloj specie duke fluturuar, duke rrahur flatrat, duke u zvarritur a duke kërcyer sipas natyrës së këmbëve dhe flatrave të veta. Atëherë Zarathustra tha këto fjalë: "Çohu, o mendim i thellë sa humnera, nga brendësitë e mirë! Jam këndesi dhe agimi yt, o krimb i fjetur në këmbë! Në këmbë! Po të zgjon zëri im!

Hiqi fashat që të kanë mbështjellë sytë e bindu, sepse unë dua të të dëgjoj! Në këmbë! Në këmbë! Këtu ka aq shumë bubullima rrufesh, që edhe varret të mësojnë të dëgjojnë!

Largoje nga sytë e tu gjumin e çdo mpakësi e verbëri! Dëgjomë edhe në sytë e tu: zëri im është një shërim edhe për të lindurit e verbër.

Kur të jesh zgjuar, duhet të mbetesh përjetësisht i zgjuar. Nuk është në karakterin tim t'i zgjoj nga gjumi katragjyshërit, për t'u thënë më pas të flenë përsëri.

Po lëviz, po shtriqesh, po gërhet? Në këmbë! Në këmbë! Mos gërhit, duhet të më flasësh! Po të thërret Zarathustra ateisti!

Unë, Zarathustra, ndërprerësi i dhimbjes, ndërprerësi i rrethit, po të thërras, o mendimi im humneror!

Përsëndetmëni! Ti po vjen, të ndjej! Thellësia ime po flet, shtyhet drejt dritës thellësia ime më e skajshme.

Përsëndetmëni! Eja! Jepma dorën! Eh! Lërmë! Ah! Ah! Ç'pështirësi, pështirësi, pështirësi, mjerë unë!

2.

Por sapo tha këto fjalë, Zarathustra u shemb përdhe e u dergj gjatë si një trup i vdekur. Kur u kthye në vete, ishte i zbehtë e drithërues, ndaj mbeti shtrirë e për një kohë të gjatë nuk deshi as të hante e të pinte.

Mbeti në një gjendje të tillë për shtatë ditë; por kafshët e tij nuk e linin për asnjë çast, as natën as ditën, përveç shqiponjës që fluturonte për të kërkuar ushqim. Gjithçka kapte a zinte pre, ajo e vendoste në shtratin e Zarathustrës. Kështu që, më së fundi, Zarathustra rrinte i shtrirë në mes rrushkut të verdhë e të kuq, në mes veshulëve me rrush, mollëve të trëndafilta, bohçeve të pishave dhe barërave aromatikë. Në këmbët e tij dergjeshim edhe dy qengja, që shqiponja me aq shumë mund ua kish zhvatur barinjve.

Më në fund, pas shtatë ditësh, Zarathustra u ngrit nga shtrati, mori në dorë një mollë të trëndafilte, e adhuroi e iu ndje e ëmbël aroma e saj. Atëherë, kafshët e tij menduan se kish ardhur çasti të flisnin me të.

“O Zarathustra, - i thanë. - Ka shtatë ditë që dergjesh kështu, me sy të rënduara nga gjumi. Nuk do të ngrihesh përsëri në këmbë?

Dil nga shpella jote: bota, si një kopsht po të pret! Era luan me parfumet e rënda që duan të vijnë drejt teje e gjithë përrrenjtë lakmojnë t’i vijnë pas.

Të gjitha gjërat digjen për ty, që për shtatë ditë mbete i vetëm. Dil nga shpella! Të gjitha gjërat duan të jenë ilaçi yt!

Ndoshta, një ndërgjegje e re mbërriti te ty, e ashpër dhe e rëndë? U dergje si një brumë që tharmohet, teksa shpirti yt mbushej e grafullohej.”

“O kafshët e mia, - u përgjigj Zarathustra, - vazhdoni të llomotisni kështu e më lini që unë t’ju dëgjoj! Llomotitja juaj më gjallon deri në atë masë sa, kur llomotisni, bota më ngjan me një kopsht.

Sa bukur është që ekzistojnë fjalë dhe tinguj! Nuk janë vallë fjalët dhe tingujt si ylbere dhe ura iluzore, midis asaj që është përjetësisht e ndarë?

Çdo shpirti i takon një tjetër botë dhe për çdo shpirt një tjetër shpirt është në botën e përtejme. Dukja mashtron pikërisht mes atyre gjërave që ngjajnë, sepse humnera më e vogël është më e vështira për t’u mbushur. Për mua, si mund të ekzistojë diçka jashtë meje? Nuk ekziston asgjë jashtë nesh, por ne e harrojmë sapo kumbon zëri. Sa bukur është që ne harrojmë!

Nuk iu bashkëngjitën gjërave emra dhe tinguj, në mënyrë që njeriu ta gjente veten te gjërat. Një marrëzi e bukur është të folurit: me të njeriu vallëzon mbi të gjitha gjërat.

Sa të pëlqyeshme janë të gjitha ligjërimet e të gjitha mashtrimet e tingujve! Me tingujt, dashuria jonë vallëzon mbi ylberet shumëngjyrëshe.

“O Zarathustra, - i thanë atëherë kafshët, - për ata që mendojnë si ne, të gjitha gjërat vallëzojnë për qejf të vet: vijnë e të zgjasin dorën, qeshin e ikin e kthehen përsëri.

Gjithçka shkon, gjithçka rikthehet; përjetësisht rrotullohet rrota e ekzistencës. Gjithçka vdes, gjithçka lulëzon sërish; përjetësisht përshkohet cikli i ekzistencës.

Gjithçka copëtohet, gjithçka bashkohet prapë; përjetësisht ekzistenca ndërton shtëpinë e vet. Gjithçka ndahet, gjithçka afrohet përsëri; e kështu i mbetet përjetësisht besnik i vetvetes unaza e ekzistencës.

Në çdo çast fillon ekzistenca; përreth çdo "këtu"-je topi shkon "atje".

Qendra është kudo. Dredharak është shtegu i përjetësisë.
[Aluzion për mendimin hinduist dhe budist]

"O palaço e vegëlza! - u përgjigj Zarathustra, e qeshi përsëri. - Sa mirë e dini atë që duhet të kryhet në shtatë ditë e si më depërtoi në fyt ajo monstër për të më mbytur. Po unë ia këputa kokën me një të kafshuar dhe e pështyva larg prej meje.

Po ju, ju tashmë e keni bërë një këngë? Tash dergjem këtu, i lodhur edhe nga ai kafshim e ajo vjellje, i sëmurë madje edhe nga vetë çlirimi im.

E ju rrini e shikoni gjithë këtë? Kafshët e mia, edhe ju jeni mizore? Dëshët të ishit të pranishme në dhimbjen time të madhe, siç bëjnë njerëzit. Njeriu është në të vërtetë më mizori i kafshëve.

Deri më sot ka qenë krijesa më e kënaqur e tokës, çdo herë që ka qenë i pranishëm nëpër tragjedi, në dyluftimet e demave, në kryqëzime. Kur shpiku ferrin, ai qe parajsa e tij në tokë.

Kur njeriu i madh bërtet nga dhimbja, i vogli i vjen menjëherë pranë e gjuha i varet jashtë deri në qafë nga kënaqësia. Por thotë se ky është "mëshirim".

Njeriu i vogël, në veçanti poeti, me sa zell e kujdes e akuzon jetën me fjalë.

Dëgjojeni, por dëgjoni edhe gëzimin që fshihet n'ato akuza.

Këta akuzuesit e jetës: jeta i nënshtron me një drithërimë qerpiku. "Ti më do? - iu thotë pacipërisht. - Prit edhe për pak, se tash nuk kam kohë për ty!"

Njeriu është kundër vetvetes më mizori i të gjitha kafshëve. Dëgjoni kënaqësinë që fshihet në vajtimet dhe në akuzat e gjithë atyre që quhet “mëkatarë, “mbrojtës të kryqeve” a pendestarë!

Po unë vetë, a mos dua të jem akuzuesi i njeriut? Medet, o kafshët e mia, veç këtë gjë mësova deri tani, që njeriut i nevojiten gjërat e tij më të këqija, për të arritur ato më të mirat. Që gjithë gjërat e tij më të këqija janë forca e vet më e mirë dhe guri më i fortë për krijuesin suprem, që njeriu duhet të bëhet i mirë dhe i keq njëherësh.

Nuk u gozhdova në këtë shtrat të drunjtë martiri, për të ditur që njeriu është i keq, po përse bërtita, siç nuk kish bërtitur kurrë njeri? Medet, ajo që brenda tij është më e liga, është ende pako gjë! Medet, që gjërat e tij më të mira janë akoma pako gjë!

Neveria e madhe për njeriun: kjo është ajo që ma mori frymën e ma nguci fytin; kjo është po ajo që më tha magjistari: “Gjithçka është e barabartë, asgjë s’vlen, dija vret.

Një muzg i gjatë më vjen përpara duke çaluar, një trishtim i dehur dhe mortësisht i lodhur, që më flet duke hapur gojën. Përjetësisht kthehet njeriu, ai me të cilin ti je i lodhur, njeriu i vogël”. Trishtimit tim i hapej goja dhe i zvarriteshin këmbët, por pa mundur të flinte.

Masa njerëzore në shpellë u transformua për sytë e mi, gjoksi i saj u zgavrua, gjithçka e gjallë m’u duk një qelbëzim njerëzor dhe një grumbull kockash i një të shkuare të kalbur.

Psherëtimat e mia binin mbi të gjitha varret e njerëzve e nuk mund të ngriheshin dot më. Psherëtimat dhe pyetjet e mia kuak-kuaknin, mbyteshin, gërmonin dhe ankoheshin natë e ditë.

Medet, njeriu rikthehet përjetësisht! Njeriu i vogël rikthehet përjetësisht.

Lakuriq i pashë një ditë që të dy, njeriun më të madh dhe njeriun më të vogël. Shumë të ngjashëm me njëri-tjetrin, shumë njerëzorë, edhe shumica prej tyre.

Shumë i vogël edhe më i madhi. Kjo ishte neveria ime për njerëzit. Se edhe për më të voglin ka një rikthim të përjetshëm. Ndaj provoja një neveri të madhe për gjithçka ekzistuese.

“Oh, neveri! neveri! neveri!” Kështu fliste Zarathustra, psherërinte e tmerrohej, sepse i kujtohej sëmundja e tij. Por kafshët nuk e lanë të vazhdonte.

“Mos fol më, o ti që po shërohesh! - iu përgjigjen. – Por dil jashtë, aty ku bora po të pret, si të ish një kopsht.

Shko, nisu drejt trëndafilave, bletëve dhe tufave të pëllumbave! Veçanërisht, drejt zogjve këngëtarë, gjersa të mësosh prej tyre të këndosh.

Të kënduarit është diçka që u takon të shëruarve: i shëndetshmi mund të flasë. Edhe nëse e shëndetshmi i do këngët, i do të ndryshme nga ato që i dëshiron i shëruari.

“O ju, palaço dhe organo të prishura, heshtni pra! - u përgjigj Zarathustra e u buzëqeshi kafshëve të tyre. - Fort mirë e dini se ç’lloj ngushëllimi gjeta gjatë këtyre shtatë ditëve!

Që më duhet sërish të këndo, ky është ngushëllimi që zbulova për veten e ky është shërimi im. Mos doni të sajdis përsëri ndonjë këngë?

“Mos fol më, - ia kthyen përsëri kafshët e tij. - Më mirë, o i shëruar, bëj ndonjë lirë a ndonjë instrument të ri! Sepse, shiko o Zarathustra, për këngët e tua të reja lipset një lirë e re.

Këndo e kumbo fort, o Zarathustra, e shëroje shpirtin me këngë të reja. Kështu ti do ta durosh fatin tënd të madh, që nuk ishte i askujt tjetri në botë. Kafshët e tua e dinë mirë, o Zarathustra, se cili je e cili duhet të bëhesh. A e di, ti je mjeshteri i rikthimit të përjetshëm: ky është fati yt. [Doktrina e rikthimit të përjetshëm është intuita më e çmuar dhe më e lartë e Niçes, së cilës ai i dedikoi shumë faqe në të gjitha veprat e fundit.]

Fakti që, për së pari, ti duhet ta mësosh këtë doktrinë, si mund të mos përbënte ky fati yt i madh rrezikun tënd më kanosës dhe sëmundjen tënde më të rëndël!

Shiko, se ne e dimë atë ç'ka ti mëson: që të gjitha gjëra e përjetshme rikthehen e ne bashkë me to: që ne kemi qenë një pafundësi herësh, e të gjitha gjërat bashkë me ne. Ti na mëson se ekziston një vit i madh i së ardhmes, një vit i madh e monstruoz që, i ngjashëm me një orë rëre duhet të vazhdojë të kthehet përmbys, për t'u zbrazur sërish. Në mënyrë që të gjitha këto vite kozmike të jenë të ngjashme me njëra-tjetrën në gjerat e mëdha e të vogla e ne vetë të jemi gjithmonë e sërish të ngjashëm me njëri-tjetrin në çdo vit, në gjërat e mëdha e të vogla.

Nëse ti tash do të doje të vdisje, o Zarathustra, shiko, ne dimë edhe si do të flisje në një rast të tillë. Mirëpo, kafshët e tua të lusin të mos vdesësh akoma. Ti do të flisje pa u dridhur, madje duke marrë frymë lumturisht, sepse do të të hiqej qafe një peshë e madhe dhe një afsh i nxehtë, o i shumëduar.

“Tash unë po vdes e po davaritem, - do të thoshe, - e për një grimë s'do të jem më asgjë. Shpirtrat janë po kaq mortorë sa dhe trupat.”

Por nyja e shkaqeve, në të cilat u pështolla, rikthehet e do të më ribëjë sërish. Unë vetë u përkas shkaqeve të rikthimit të përjetshëm.

Unë kthehem, do të kthehem përsëri, me këtë diell, me këtë tokë, me këtë shqiponjë, me këtë gjarpër; por jo për një jetë të re ose një jetë më të mirë apo një jetë përngjashme. Do të kthehem sërish përjetësisht, për të jetuar po këtë jetë, si në gjërat e mëdha ashtu dhe te gjërat e vogla, e do e mësoj përsëri rikthimin e përjetshëm të të gjitha gjërave, për të shpallur përsëri fjalën e mesditës së madhe të tokës dhe njeriut e për të paralajmëruar sërish Mbinjeriun përpara njerëzve.

E thashë fjalën time e prej fjalës sime po vritem. Kështu do fati im i përjetshëm; si një paralajmërues unë shkoj përkrah perëndimit tim.

Ora erdhi, kur ai që po perëndon t'i japë vetes bekimin e vet. Kështu përfundon perëndimi i Zarathustrës.”

Kur kafshët shqiptuan këto fjalë, heshtën dhe pritën që Zarathustra t'u thoshte ndonjë gjë, por Zarathustra nuk i dëgjoi as edhe në heshtje. Qëndronte i palëvizur me sytë e mbyllur, i ngjashëm me një të fjetur, edhe pse nuk po flinte aspak, sepse, në të vërtetë, ai po fliste me shpirtin e vet. Gjarpri dhe shqiponja, kur e panë kaq të mendueshëm, e respektuan heshtjen e madhe që e rrethonte dhe u larguan me kujdes.

Për nostalgjinë e madhe

O shpirti im, të mësova të thuash "sot" si "një ditë" dhe "një herë", e të vallzosh rrugëve vallen tënde mbi çdo Këtu, Atje e Atjetej.

O shpirti im, të çlirova nga të gjitha strehat e fshehta duke të pastruar nga pluhuri, merimangat dhe gjysmëhijet.

O shpirti im, ta lava prej vetes turpin e vockël dhe këngëzën e virtytit e të binda të shkoje lakuriq përballë syve të diellit.

Me stuhinë që quhet "shpirt", unë fryva mbi detin tënd të valëzuar; i shpërhapa të gjitha retë, dhe mbyta varësin, që quhet 'mëkat'.

O shpirti im, të dhashë të drejtën të thuash Jo siç thotë stuhia, e të thuash Po siç thotë Po qielli i hapur: e ti i palëvizur qëndron si drita dhe përmes stuhisë mohonjëse kalon.

O shpirti im, të dhashë liri mbi gjith ç'ish krijuar dhe s'kish krijuar: kush e njeh, siç e njeh ti, vullnetin e së ardhmes?

O shpirti im, të mësova përçmimin, jo atë që të mbërrin së një krimb gërryes, por të madhin, dashuronjësin përçmim, që gjithnjë e më shumë dashuron aty ku më shumë përçmohet.

O shpirti im, unë të kam mësuar të bindesh në mënyrë që të rrënjosësh në vetvete edhe bindjen e shkaqeve: njëlloj si dielli, që e nxit detin të besojë në lartësinë e vet.

O shpirti im, të çrrënjosa çdo bindje, gjunjëzim a lutje të Zotit: të dhashë unë vetë emrin e "kthesës së të ardhmes" dhe "fatit".

O shpirti im, të dhashë emra të rinj e mekanizma të shumëllojshëm, të quajta “fat”, “rrethhapësira e hapësirave”, “litarthi kërthizor i kohës” dhe “këmbanë e kaltër”.

O shpirti im, mbretërisë tënde tokësore i dhashë të pijë gjithë dijen, gjithë verërat e reja, e gjithë verërat pabesueshmërisht të vjetra e të forta të dijes.

O shpirti im, çdo diell unë e derdha sipër teje, çdo natë, çdo heshtje e çdo nostalgji: e ti m'u rrite si një pemë jete.

O shpirti im, ja tek rri përpara meje jashtëzakonshmmërisht i pasur e i rëndë, një vresht me gjinj të fryrë e veshtulë të plotë ari brun: të plotë e të mbarsur me lumturinë tënde, të gjithë një pritje e vërshimit, po gjithësesi me drojen e pritjes.

O shpirti im, nuk ka në asnjë vend një shpirt më të dashuruar, të gjerë dhe gjithëkuptues! Ku vallëtakohen e përputhen më mirë se sa tek ty, e shkuara dhe e ardhmja?

O shpirti im, të dhashë gjithçka, e duart e mia tash të boshatisura janë për ty: po tani! Tani ti më thua duke buzëqeshur e tërë melankoli: “kë nga ne duhet të falenderojmë?”

Nuk duhet falenderuar dhuronjësi nga ai që ka marrë dhuratën? Nuk është dhurimi domosdoshmëri? Nuk është të marrurit një gjest mëshirimi?

O shpirti im, unë e kuptoj buzëqeshjen e melankolisë tënde: vetë pasuria jote e tejskajshme priret tani kah duarve të përgjëruara.

Plotësia jote i kthen sytë mbi detet e stuhishëm dhe kërkon e pret; nostalgjia e plotësisë strehohet nga qielli i qeshur i syrit tënd!

Se në të vërtetë, o shpirti im! Kush vallë do ta shihte buzëqeshjen tënde dhe nuk do të shkruhej në lotë? Edhe vetë engjëjt shkrehen në lotë nga mirësia e pamasë e buzëqeshjes tënde.

Është kjo mirësi dhe tejskajshmëria e mirësive të tua, që nuk duan as të ankohen e as të qajnë: po gjithësesi, o shpirti im, buzëqeshja jote i dëshiron lotët dhe goja të dridhet për psherëtimat.

S'është vallë çdo e qarë një akim? E nuk është çdo ankim një akuzë!

Kështu i thua vetvetes, ja përse ti do, o shpirti im, më mirë të qeshësh se sa të shfrysh në lotë therrës të gjithë dhembjen për plotësinë tënde e për gjithë nevojën që ka vreshti për krasitësin dhe krizën (lloj drapëri) e krasitësit!

Por nëse nuk do të qash dhe as ta shfrysh në vaj melankolinë tënde të purpurt, ti duhet të këndosh, o shpirti im! Se sheh, po qesh dhe unë vetë duke të parathënë kështu: Këndo, më të dehurën këngë, derisa të gjithë detet të qetësohen për të dëgjuar nostalgjinë tënde, derisa mbi të gjithë detet e nostalgjisë të lundrojë anija, mrekullia e artë, për arin e së cilës fërgëllojnë të gjitha gjërat e mira, të këqija, të veçanta; edhe shumë specie të vogla e të mëdha kafshësh, e të gjitha ato me këmbë të lehta e të çuditshme për të vrapuar, do të sulen shtigjeve të kaltra e vjollcë, kah asaj mrekullie të artë, anijes së lirë dhe timonierit të saj; mirëpo ai është krasitësi që pret, me krizën e vet prej diamanti, çlirues yt i madh, o shpirti im, i paemëri, të cilit vetëm këngët e së ardhmes do arrijnë t'i gjejnë një emër! Se vërtet, që tashmë frymimi yt parfumon prej këngëve të ardhme, që tashmë ti guxon e endërron, që tashmë ti pi i etur nëpër të gjitha burimet e thella kumbuese e ngushëlluese, që tashmë pushon melankolia jote në lumturinë e këngëve të ardhme!

O shpirti im, tash të dhashë gjithçka, madje edhe të fundmen gjë, e duart e mia të boshatisura janë për ty: e që të frymëzova të këndosh, ja, kjo është dhurata ime e fundit!

Që unë të frymëzova të këndosh, thuaje, thuaje ti, tani: cili vallë prej nesh duhet të falenderohet! Pra, këndomë, këndomë, o shpirti im! E lërmë të falenderoj!”

Kështu foli Zarathustra.

Kënga e dytë e vallëzimit

1.

Sapo kundrova në syrin tënd, o jetë, e pashë të vezullojë ari në bebëzën tënde mbrëmjesore. Zemra ime u ndal nga dëshirimi: pashë të vezullonte një anije e artë mbi ujërat mbrëmjesore, një barkë vezulluese ari që mbytej, mbushej me ujë e rikthehej përsëri lart për të valëzuar.

Më hodhe një shikim te këmba ime e dehur për vallëzim, një shikim valëzues, të qeshur, pyetës, zhbirues. Veç dy herë i drodhe **çaparet** me duart e tua të vogla e, ndërkaq, këmba ime fërgëllonte nga dehja e vallëzimit.

Thembrat e mia tërhuzeshin e gishtërinjtë e këmbëve përpiqeshin të kuptoheshin me njëri-tjetrin, sepse vallëzuesi veshin e vet e ka në gishtërinjtë e këmbëve.

Unë brofa kah teje, po ti u tërhoqe përpara brofjes sime e kundra mëje kullove gjuhën e krifës fluturuese të flokëve të tu.

Atëherë unë brofa tej teje dhe gjarpërinjve të tu, po ti u ngurose pranë meje e kruspulluar, gjysmë çapi larg me syrin gjithë dëshirim. Me shikim të dykuptimtë, rrugë të dykuptimta më mësove e mes rrugëve të dykuptimta mësoi dredhitë këmba ime.

Unë e kam frikë afrinë tënde, të dashuroj largësinë; arratia jote më josh, të kërkuarit ndaj meje më bllokoi e vuaj, po ç'gjë s'do të vuaja me dëshirën për ty!

Për ty, që akulli të flakërin, që urrejtja të rrëmben, që arratia të lidh pas vetes, e shpotia të mallëngjen. E kush vallë nuk do të urrente, o e madhërishmja joshëse, o ngashëruese, o tunduese, o kërkimtare, o zbuluese!

E kush nuk do të të dashuronte, o mëkatore e pafajshme, e paduruar, ikanake, me sy vogëlushi!

Ku po më josh tash, ti o lule dhe demon? Se ja tek më përvidhesh përsëri, o i shthururi dhe i ëmbli mosmirënjohës!

Unë vazhdoj me ritmin tënd, të ndjek pas edhe në gjurmën më të vogël. Ku je vallë? Jepma dorën, qoftë edhe një gisht!

Këtu ka shpella dhe kaçube: do të humbasim. Ndalo! Mos lëviz! Nuk sheh të kuisin ketra e kukuvajka? Ti kukuvajkë! Dhe ti o ketër! Do të më shpotisësh?

Deri në ç'pikë kemi arritur? Nga qentë ke mësuar të ulërish e të hungërish. M'i skërmitë plot hijeshi në fytyrë dhëmbët e tu të vegjël e të bardhë, bashkë me sytë e tu të ligj që kërcyen kundra meje nga thellësia e gëzofit qimedredhur.

Është një vallëzim i shfrenuar: unë jam gjahtari. A do të jesh langoi apo kastori im?

Qëndro më pranë! Shpejt, kërcimtare e ligë! Tash, çohu! Përpara! Mjerë unë që u rrëmbeva nga kërcimet e tua!

Oh, shikoje, si akull krenaria ime, e sa mëshirë po lut! Plot dëshirë do të shkoja me ty nëpër shtigje më të këndshëm!

Shtigje të dashurisë përmes gëmushave të qeta e shumëgjyreshe! Ose atje tej, përgjatë detit, ku notojnë e vallëzojnë peshq të artë.

Mos je gjë e lodhur? Aty poshtë kullosin dhi e perëndime: nuk është mirë të flesh, nëse barinjte u bien fyejve. Kaq shumë e lodhur je? Lërmë të të marr në krah, lëshoi duart në ije! Po të kishe etje, unë do të dija si të të ç'zhurisja, por goja jote nuk do të pijë.

Oh, e mallkuara dhe vetëtitësja nepërkë që rrëshqet nëpër vrima! Ku shkove vallë? Në fytyrë unë ndiej dy prekje të dorës tënde që më lë vula të kuqe! Jam vërtet i lodhur së qeni gjithmonë bariu yt budalla. Ti shtrigë, deri tani kam kënduar për ty; tash ti duhet të nisësh e të ulërish për mua.

Në ritmin e fishkëllimës së kamxhikut ti duhet të vallëzosh e të ulërish. Nuk e kam harruar kamxhikun, vërtet! Jo!

2.

Atëherë jeta m'u përgjigj në këtë mënyrë, duke shtupuar veshët e vet të hijshëm:

“O Zarathustra! Mos bëj kaq potere me kamxhikun tënd! Ti e di, poterja i vret mendimet, e tash po më vijnë shumë mendime të ëmbla. Që të dy jemi vërtet të padobishëm, s’bëjmë asgjë, në të mirë e në të keq. Përtej së mirës e së keqes gjetëm tokën e premtuar dhe luadhin tonë të blertë: vetëm për ne të dy! Ndaj, duhet të jemi të mirë me njëri-tjetrin!

Por edhe po s’u dashuruam tërësisht, mos vallë duhet t’i varim buzët se nuk dashurohemi tërësisht?!

Që unë jam e mirë dhe shpeshherë shumë e mirë, ti e di besoj; po arsyeja është se jam xheloz për mençurinë tënde. Ah, kjo e çmendura plakë e mençurisë!

Nëse një ditë do ta humbisje vërtet mençurinë, atëherë do të merrte arratinë edhe dashuria ime.

Në këtë pikë jeta shikoi e menduar para dhe pas vetes e tha ngadalë: “O Zarathustra, ti nuk më je shumë besnik!”.

Ti nuk më do aq sa thua; e di që mendon të më braktisë shumë shpejt.

Është një kabanë e rëndë, e vjetër dhe zhurmëshumë, që natën bën potere, madje deri te shpella jote. Nëse e dëgjon këtë kabanë të bjerë në orën e mesnatës, midis 12-s dhe 1-shit, atëherë, atëherë ti mendon, o Zarathustra, e di, që të më lësh e të ikësh.

“Po, - iu përgjigja, duke nguruar. - Po ti e di edhe se ...”, duke i pëshpëritur diçka në vesh, aty, në mes gërshetave të saj të verdha, të shpërndara e të shpërhedhura.

Veç ti e di, o Zarathustra? Askush tjetër!

U pamë, e kthyem sytë nga livadhi i blertë, mbi të cilin shkiste e freskëta mbrëmje, duke qarë së bashku. Atëherë, më e shtrenjtë m’u duk jeta se mençuria.

Kështu foli Zarathustra.

3.

NJË

O njeri! Dëgjon?

DY

Se ç'thotë mesnata e thellë?

TRE

Fli, fli!

KATËR

Nga një ëndërr e thellë u zgjova.

PESË

Bota është e thellë.

GJASHTË

Është më e thellë se sa mendon dita.

SHTATË

I thellë është dënimi.

TETË

E gëzimi më i thellë se dhimbja.

NËNTË

Dënimi thotë: Kalo!

DHJETË

Po çdo gëzim e do përjetësinë.

NJËMBËDHJETË

E do përjetësinë, përjetësinë e thellë.

DYMBËDHJETË

E do të thellën, të thellën përjetësi!

Shtatë vulat

(Ose kënga e "Po"-së dhe e "Amen"-it)

1.

Nëse unë jam një profet, i mbushur me atë shpirt profetik që endet mbi qafat e larta të maleve në mes të dy deteve, e shket midis së shkuarës dhe së ardhmes, si një re e rënduar, armik i ultësirave shtypëse dhe e gjithë asaj që është e lodhur, e nuk mundet as të rrojë e as të vdesë; i gatshëm në gjoksin e errësuar për shkreptimën dhe rrezën e dritës çlirimtare, të mbarsur me vetëtima që thonë Po, që ecin përpara, duke u thënë Po rrufeve profetike, atëherë i bekuar është kush është i mbarsur kështu! Se, në të vërtetë, duhet të rrijë varur gjatë sipër maleve si një re e zezë dhe e zymtë shiu, si ai që do të vijë një ditë të ndezë dritën e së ardhmes.

Si mund të mos digjem vallë në zjarrin e përjetësisë e të unazës së unazave, të unazës martesore të rikthimit të përjetshëm?

Nuk e kam gjetur ende gruan, me të cilën dua të bëj fëmijë, përpos që ajo të jetë gruaja që dua, se unë të dua ty o përjetësi!

Se unë të dua, o përjetësi!

2.

Nëse zemërimi im i shkallmoi varret, i hodhi tej gurët e sinorëve, e i vërviti në humnerat e thikta tabelat e copëtuara të ligjeve; nëse shpotia ime i fryu tej fjalët e qelbëzuara, e unë jam tash si një fshesë për merimangat e kryqëzuara e si një erë që shpërndan kthinat e mykura të vdekjes; nëse u ula ngadhënjyes aty ku dergjen zotat antikë, duke bekuar botën e duke dashuruar botën e tyre pranë monumenteve të shpifësve të saj; nëse dua madje dhe kishat e varrezat e zotave, kur qielli kundron me shikimin e tij të qartë përmes fytyrave të tyre të zbuluara, e me dëshirë ulem si barishtja dhe lulëkuqja e purpurt mbi tempujt e shembur; si mundet vallë të mos digjesha për përjetësinë e për unazën e unazave, unazën martesore të rikthimit të përjetshëm?!

Nuk e kam gjetur ende gruan, me të cilën dua të bëj fëmijë, përpos që ajo të jetë gruaja që dua. Se unë të dua ty o përjetësi!
Se unë të dua, o përjetësi!

3.

Nëse mbërriti tek unë një gulçim i gulçimit krijues dhe i asaj domosdoshmërie qiellore, që shtrëngon edhe rastin të kërcejë vallen e yjeve; nëse kam qeshur me vetëtimën krijuese, së cilës, duke i murmuruar, por e bindur, i vjen pas bubullima e gjatë e veprimit; nëse kam luajtur me zare me zotat, në tryezën e zotave, derisa toka u drodh, u ça e shpërtheu si shatërvan një rrëke zjarri; se toka tryeza e zotave është dhe, aq drithëruese për fjalët e reja krijuese e për hedhjen hyjnore të zareve, atëherë, si mundet vallë të mos digjesha për përjetësinë dhe për unazën e unazave, unazën martesore të rikthimit të përjetshëm?!

Nuk e kam gjetur ende gruan, me të cilën dua të bëj fëmijë, përpos që ajo të jetë gruaja që dua. Se unë të dua, ty o përjetësi!
Se unë të dua, o përjetësi!

4.

Nëse kam pirë me gllënjka të mëdha në atë kupën e parfumuar dhe shkumëzuese, ku janë të përziëra të gjitha gjërat; nëse dora ime derdhi të shkuarën në të ardhmen, zjarrin në shpirt, gëzimin në dhimbje dhe më të keqen të më e mira; gjersa unë vetë jam një kokërr e asaj kripte çliruese, që i përziën aq mirë të gjitha gjërat në gojë, sepse është një kripë që lidh të mirën me të keqen, madje, edhe përbërësi më i keq është i domosdoshëm për aromën dhe për grafullimin e skajshëm, atëherë si mundet vallë të mos digjesha për përjetësinë dhe për unazën e unazave, unazën martesore të rikthimit të përjetshëm?!

Nuk e kam gjetur ende gruan, me të cilën dua të bëj fëmijë, përpos që ajo të jetë gruaja që dua. Se unë të dua, ty o përjetësi!
Se unë të dua, o përjetësi!

5.

Nëse jam aq i dëshiruar për detin dhe për gjithçka që ka natyrën e detit, e jam gjithnjë e më shumë i lidhur me të sa më furishëm ai kundërshton; nëse gjendet brenda meje ajo kënaqësi e të kërkuarit, që shtyn velën kundrejt asaj që s'është eksploruar ende; nëse në kënaqësinë time ka edhe një kënaqësi prej marinari; nëse ngazëllimi im bërtet: "Është zhdukur bregu, është rrëzuar barriera e fundit, paanësia fërgëllon përreth meje, koha dhe hapësira vezullojnë gjer larg, ndaj, përpara! O, e vjetra zemër!", atëherë, si mundet vallë të mos digjesha për përjetësinë dhe për unazën e unazave, unazën martesore të rikthimit të përjetshëm?!

Nuk e kam gjetur ende gruan, me të cilën dua të bëj fëmijë, përpos që ajo të jetë gruaja që dua. Se unë të dua, ty o përjetësi!
Se unë të dua, o përjetësi!

6.

Nëse virtyti im është virtyti i një vallëzuesi, dhe unë vetë kam kërcyer me të dyja këmbët në ekstazën e praruar e zmeraldiane; nëse ligësia ime është një ligësi buzagaze, që rri mes rrëpirave me trëndafila dhe gardheve me zambakë, se tek e qeshura grumbullohet çdo e keqe, por e shenjtëruar dhe e pafajësuar, përmes lumturisë së vet; nëse është Alfa dhe Omega ime ajo që i bën të lehta të gjitha gjërat e rënda, që e bën çdo trup valltar dhe çdo shpirt zog se, në fakt, kjo është vërtet Alfa dhe Omega ime.

Atëherë, si mundet vallë të mos digjesha për përjetësinë dhe për unazën e unazave, unazën martesore të rikthimit të përjetshëm?!

Nuk e kam gjetur akoma gruan, me të cilën dëshiroj të kem fëmijë, përveçse asaj gruaje që dashuroj. Se unë të dua, o përjetësi!

Se unë të dua përjetësi!

7.

Nëse kam shtrirë sipër meje qiej të paquar e kam flatruar me krahët e mi në vetë qiejt e mi; nëse duke luajtur kam notuar në largësi të mëdha drite dhe më ka mbërritur zogu-mençuri i lirisë sime, ja kështu flet zogu-mençuri: "Shiko, se nuk ka as Sipër e as Poshtë! Lëshohu, ti o i lehti, nëpër çdo vend, kudo, përpara, prapa! Këndo! Mos fol më! Të gjitha fjalët janë bërë vallë për të rëndit! Të gjitha fjalët nuk janë ndoshta gënjeshtër për të lehtit? Këndo! Mos fol më!

Atëherë, si mundet vallë të mos digjesh për përjetësinë dhe për unazën e unazave, unazën martesore të rikthimit të përjetshëm?

Nuk e kam gjetur akoma gruan, me të cilën dëshiroj të kem fëmijë, përveçse asaj gruaje që dashuroj. Se unë të dua, o përjetësi!

Se unë të dua përjetësi!

PJESA E KATËRT

Medet, kush vallë në botë bëri marrëzira më të mëdha se sa ato të mëshirimit? E ç'gjë në botë solli më shumë dëm sesa marrëzitë e mëshirimit?

Mjerë të dashuruarit që nuk kanë një majë, që të ngrihet mbi mëshirimin e tyre!

Kështu më tha një ditë djalli: "Edhe Zoti e ka ferrin e tij, domethënë dashurinë e vet për njerëzit".

E kam dëgjuar rishtazi shqiptimin e këtyre fjalëve: "Zoti vdiq; e vrau mëshirimi i tij për njerëzit".

“PËR TË MËSHIRSHMIT”“

Kurbani i mjaltit

Kaluan sërish muaj e vite në shpirtin e Zarathustrës, po ai nuk i vinte re, veç flokët i zbardheshin. Një ditë, teksa po rrinte ulur mbi një shkrep jashtë shpellës, e vështronte në heshtje përpara vetes, ku shtrihej deti e përtej tij humnerat e thepisura, kafshët e veta, pasi i kishin bredhur gjatë rreth e qark, më në fund iu ndalën përballë.

O Zarathustra, - i thanë, - mos je vallë duke parë për lumturinë tënde?"

"Ç'rëndësi ka lumturia, - iu përgjigj ai. - Ka kohë që unë nuk synoj lumturinë, synoj vetëm veprën time."

"O Zarathustra, - thanë atëherë kafshët, - ti flet si dikush, të cilit gjërat i shkojnë shumë mirë. Mos prehesh vallë në një liqen kaltërosh lumturie?"

"Shakatarë të çmendur, - iu përgjigj Zarathustra duke qeshur. - Sa bukur e pikasët krahasimin. Po ju e dini se lumturia ime është e rëndë, dhe jo si një valë që shket lehtë: më ndjek këmba-këmbës e nuk do të më lërë, aq sa ngjan me një paqe të lëngëzuar."

Atëherë, kafshët ranë përsëri në mendime dhe bënë një rrotullim rreth tij, duke iu ndalur përsëri përballë.

"O Zarathustra, - thanë. - Mos vallë për këtë arsye ndodh që ti bëhesh gjithnjë e më i verdhë e i nxirë, edhe pse flokët e tu kërkojnë të duken të bardha si fije lini? A e sheh pra, që ti rri ulur mbi fatkeqësinë tënde!"

"Ç'thoni kështu, o kafshët e mia? - tha Zarathustra e qeshi. - Në të vërtetë blasfemova kur fola për paqen. Siç po më ndodh mua, kështu u ndodh gjithë atyre frutave që bëhen të pjekura.

Ka mjaltë në venat e mia, që e bën gjakun tim më të trashë dhe shpirtin tim më të qetë.”

“Qoftë kështu, - o Zarathustra, - iu përgjigjën kafshët e iu shtrënguan përreth. - Po sot nuk do vallë të ngjitesh në një mal të lartë? Ajri është i kulluar e bota mund të shihet më qartë se kurrë.”

“Po, o kafshët e mia, - u përgjigj. - Ju më këshilloni nga thellësia e zemrës; sot unë dua të ngjitem në një mal të lartë. Por kujdesuni që atje mjaltin ta kem gjithë llojesh: të verdhë, të bardhë, të mirë, mjaltë ngjyrë ari e të freskët nga hojet, sepse dijeni se, aty sipër unë dua të bëj kurbanin e mjaltit.”

Po kur Zarathustra arriti në majë, i dërgoi në shtëpi kafshët që e patën shoqëruar, duke ngelur vetëm; atëherë qeshi me gjithë zemër, vështroi rrotull vetes dhe tha këto fjalë:

“Nëse u fola për një kurban dhe për një kurban të mjaltit, ishte vetëm një dredhi e ligjërimit tim. Në fakt, një marrëzi e dobishme! Këtu lart më lejohet të flas më lirisht se sa përpara shpellave të eremitëve dhe kafshëve të tyre shtëpiake.

E ç'të sakrifikosh! Unë dua të dhuroj atë që m'u dhurua nga dhuruesi me mijëra duar. Si mundet vallë që këtë ta quaj kurban?

Edhe kur u kërkova mjaltë, dëshirova vetëm një karrem, një mjaltë të ëmbël, një lëng veshtullor, tek i cili vijnë të gjithë arinjte dhe zogjtë e çuditshëm, të këqij e të bezdisshëm; karremin më të mirë, siç u vjen për mbarë gjahtarëve dhe peshkatarëve. Nëse bota është si një pyll i errët kafshësh dhe një kopsht mrekullish, për gjithë gjuetarët e egër, mua ajo më duket më shumë si një det i pasur dhe i patejçueshëm, një det plot peshq shumëngjyrësh e peshkaqenë, tek i cili kanë aq shumë dëshirë edhe zotat, për t'u bërë peshkatarë dhe hedhës rrjetash. Kaq e pasur është bota me gjëra të çuditshme të mëdha e të vogla!

Veçanërisht, bota e njerëzve, deti i njerëzve, ku unë po hedh tash grepin tim të artë e po bërtas: hapu, humnerë njerëzore!

Hapu dhe hidhmë peshqit dhe peshkaqenët e tu vezullues!
Me karremin më të mirë dua të kap sot në grepin tim peshqit më të çuditshëm njerëzorë.

Madje, edhe vetë fatin tim unë e hedh tej sa gjatë e gjerë, midis lindjes, mesditës dhe perëndimit, për të parë nëse nuk kanë mësuar të ngjiten pas tij shumë peshq njerëzorë, derisa, duke kafshuar grepin tim të mprehtë e të fshehur, do t'u duhet të tërheqin në lartësinë time banuesit shumëngjyrësh të humnerave; për lart, deri te më i ligu i gjithë peshkatarëve të njerëzve.

Ky, në të vërtetë jam unë, që nga fillimi dhe origjina, tërheqës, frymëzues, ripërtëritës, një aktivizues, një edukator, një rritës dhe një korrigjues, që njëherë e një kohë nuk i tha më kot vetes: "Bëhu ai që je!".

Kështu, edhe njerëz të tjerë mund të vinë që sot e tutje këtu lart tek unë; unë ende jam duke e pritur shenjën që do të tregojë kohën e zbritjes sime. Nuk jam duke zbritur tani, në mes të njerëzve, siç bëra një herë më parë.

Po pres këtu, dinak dhe shpotitës mbi malet e larta, as i duruar e as i paduruar. Përkundrazi, si ai që ka çmësuar të durojë, sepse s'është më një njeri i duruar.

Fati im, në fakt, po më lë kohë. Mos vallë më ka harruar, apo mos rri ulur pas një shkrepit të madh, në hije, duke kapur miza?

Në të vërtetë, i jam mirënjohës fatit tim të përjetshëm, që nuk më ndjek e nuk më vërsulet, por më lë kohë për budallallëqe e ligësi; aq sa sot unë jam ngjitur deri në majë të këtij mali të lartë për të peshkuar.

A ka kapur vallë ndonjë njeri peshk në majë të një mali të lartë?

Edhe pse është një marrëzi ajo që dua të bëj këtu lart, më mirë kjo marrëzi se sa të bëhem solemnisht aty poshtë i verdhë e i zbehtë prej pritjes; si një njeri që hedh shkelma si mushka e dridhet i tëri nga zemërimi i pritjes, së asaj stuhie bulëzuese e të shenjtë të maleve, e si një i paduruar që u bërtet luginave: "Do

dëgjoni, apo t'ju fshikulloj me kamxhikun e Zotit!”.

Jo se unë zemërohem më për të tilla gjëra: ato janë aq të mira sa më bëjnë madje të qesh. Por duhet të jenë të çmendura këto daulle të mëdha buçitëse që, ose mund të flasin sot, ose kurrë më!

Se përndryshe, unë dhe fati im nuk do të flasim as për të sotmen, as për të përherëshmen: ne kemi durim e kohë boll për të folur. Se një ditë ai do të vijë, e pastaj s'do të ketë kurrë fund.

Kush vallë do të vijë një ditë e s'do të ketë kurrë fund? Hazar-inë i madh, mbretëria jonë e madhe dhe e largët njerëzore, mbretëria mijëvjeçare e Zarathustrës.

Po sa e largët do të jetë kjo “largësi”? E ç'më intereson! Nuk është hiç më pak i sigurt ky vend, ku unë po qëndroj fort me të dyja këmbët, si mbi një bazë të përjetshme, si mbi një shkëmb të fortë zanafillor, i këtij mali shumë të fortë, shumë të lartë e të stërmoçëm, tek i cili bashkohen të gjitha erërat, si te sinori i tyre, e ku unë pyes “Ku? Nga ku? Për ku?”.

E ti qesh, qesh, e shtrenjta, e qashtra ime ligësi! Nga malet e larta unë po rrokullis përposh të qeshurën tënde kërcitëse të ironisë. Joshmi me vezullimin tënd më të bukurit njerëz-peshq! Atë që më përket në të gjitha detet, atë që në vetvete e brenda vetes është e imja në të gjitha gjërat, nxirrma jashtë, udhëhiqma për lart: se e pret më i ligu i gjithë peshkatarëve.

Hidhuni përtej, o grepat e mi! Për poshtë, për lart, o karrema të lumturisë sime! A e sheh vesën tënde më të ëmbël, o mjalti i zemrës sime! Kafshoje grepi im, barkun e gjithë **mjerimit** më të zi! Dil jashtë, jashtë, o syri im! Oh, sa shumë dete që më rrethojnë, ç'muzgje kohësh njerëzore pritet të vijnë! Sipër meje, ç'qetësi e purpurt! Ç'heshtje pa një re!

Britma e dhimbjes

Edhe ditën tjetër, Zarathustra po qëndronte përsëri në shkëmbin përpara shpellës, ndërsa kafshët kishin dalë nëpër botë, për të sjellë sërish ushqim në shtëpi, po edhe mjaltë. Ssepse Zarathustra e kish harxhuar mjaltin e vjetër deri në pikëzën e fundit. Por ndërsa vazhdonte të rrinte ulur me një shkop në dorë e të ravijëzonte mbi tokë formën e hijes së siluetës së tij, duke mos medituuar aspak për veten dhe hijen e vet, brofi menjëherë dhe ndjeu një rrëqethje; sepse dallooi pranë vetes edhe një hije tjetër.

Pa vetëtimthi përreth dhe u ngrit në këmbë, kur ja tek u duk pranë tij profeti, po ai profet që ai kish bujtur një ditë e kish ushqyer dhe çetur në tryezën e tij, lajmëtarin e lodhjes së madhe, i cili i mësonte se “gjithçka është e njëjtë, për asgjë s’ia vlen barra qiranë, bota është pa kuptim dhe dija ta merr frymën”.

Mirëpo, fytyra e tij ndërkaq ishte transformuar; kur Zarathustra e vështroi në sy, zemra u frikësua përsëri: shumë ogure të këqija dhe vetëtima të përhimëta e përshkonin atë fytyrë.

Profeti e kuptoi se ç’po ndodhte në shpirtin e Zarathustrës, ndaj ia kaloi dorën përpara fytyrës, si të donte t’i fshinte gjurmët; po të njëjtën gjë bëri edhe Zarathustra. Kur të dy në heshtje u qetësuan e, si të thuash erdhën në vete, ia dhanë dorën njëri-tjetrit, si shenjë që donin vërtet të njiheshin.

“Qofsh i mirëseardhur! - tha Zarathustra. - Ti, o profet i lodhjes së madhe, nuk do të jesh kot një ditë mik i tryezës sime. Ha e pi edhe sot me mua e më fal, nëse një plak i hareshëm e i kënaqur do të të ulet pranë!”

“Një burrë plak i hareshëm dhe i kënaqur, - u përgjigj profeti, duke tundur kokën. - Ai që ke dashur të jesh ti ke qenë, o Zarathustra, përderisa ke një kohë të pafund që rri këtu lart. Po varka jote, së shpejti nuk do të qëndrojë më në tokë të thatë.”

“Pse, jam vallë në tokë të thatë?” - pyeti Zarathustra, duke qeshur.

“Dallgët përreth malit tënd, - iu përgjigj profeti, - po rriten e po gufohen. Dallgët e dhimbjes së madhe e të pendimit të thellë, së shpejti do ta ngrenë lart edhe varkën tënde e do ta degdisin tej.”

Zarathustra, atë çast heshti dhe u mrekullua.

“Ende nuk dëgjon gjë? - vazhdoi profeti. - Si vjen këtu lart zhurma dhe murmurimi i humnerës?”

Zarathustra vazhdoi të heshte e nisi të mbante vesh me kujdes. Atëherë dëgjoji një britmë të gjatë e të largët, që humnerat ia përcillnin njëra-tjetrës, sepse askush nuk donte ta mbante brenda vetes: kaq e ligë ajo ish.

“O lajmëtar ogurkeq, - tha së fundi Zarathustra. - Ko është britma e dhimbjes, është britma e një njeriu që vjen padyshim nga një det i zi. Po ç'më duhet mua dhimbja njerëzore! Mëkati im i fundit që m'u kursye, a e di cili ish?”

“Mëshirimi, - iu përgjigj profeti nga thellësia e zemrës, e i ngriti lart të dyja duart. - O Zarathustra, unë po vij për të të udhëhequr drejt mëkatit tënd të fundit!”

Sapo dëgjoji këto fjalë, britma kumboi përsëri, duke jehuar më gjatë e më dhimbshëm se kurrë, madje dhe shumë më afër.

“A e ndjen? A e dëgjon o Zarathustra? - ulëriti profeti. Britma është për ty, po të thërret: eja, eja, eja. Erdhi koha, mbërriti momenti!”

Zarathustra heshti, i tronditur dhe i pështjelluar. Më në fund, pyeti si një njeri që do të ngacmojë vetveten. Po kush është ky që po më thërret?

“Po ti tash e di, - u përgjigj me të shpejtë profeti. Përse shtires? Është Njeriu i Epërm që po të thërret!”

“Njeriu i Epërm, - briti Zarathustra, i mbërthyer nga tmerrri. - Ç'kërkon vallë ai? Ç'kërkon vallë Njeriu i Epërm? Ç'kërkon?” E lëkura e trupit i mbushej e tëra me djersë.

Profeti nuk iu përgjigj frikësimit të Zarathustrës, por vazhdoi të dëgjonte, duke mbajtur veshin nga humnera. Por, pasi kish heshtur një copë herë, e hodhi vështrimin përsëri tek ai dhe pa

Zarathustrën të qëndronte në këmbë, duke u dridhur.

“O Zarathustra, - filloi me zë të pikëlluar. - Ti s’më ngjan aspak me atë që lumturia e bën të vallëzojë; se ti duhet të vallëzosh, po kujdes se mos biesh i plandosur për vdekje!

Por, edhe sikur të doje të vallëzoje para meje e të kërceje të gjitha trillet e tua, përsëri askush nuk duhet të më vijë e të më thoshe: “Ja tek është i fundmi njeri i lumtur që vallëzon!”.

Më kot do të arrinte dikush në këtë lartësi për të kërkuar, se do të gjente shpella dhe zgavra, skuta e strehime, por jo miniera gëzimi, as dhoma thesaresh e as vena të reja lumturie.

Lumturi: si mund të gjesh lumturi pranë të varrosurve të gjallë e vetmitarëve të këtij soji! Mos vallë duhet të shkoj e ta kërkoj lumturinë e mbrame në ishujt e lumtur e larg, në mes të deteve të harruara?

Jo. Gjithçka është e njëjtë, asgjë nuk vlen, nuk ka vlerë asnjë kërkim, nuk ka më as dhe ishull të lumtur!

Kështu psherëtinte profeti; por në psherëtimën e tij të fundit Zarathustra u bë përsëri i kthjellët e i sigurt, i ngjashëm me një njeri që del në dritë prej thellësisë së një shpelle. “Jo! Jo! Jo! - briti me zë të fortë, duke përkëdhelur mjekrën. - Këtë unë e di mirë! Ka akoma ishujt të lumtur, ndaj mos fol për këtë gjë, ti, thes i trishtë psherëtimash!

Pusho së llomotituri, ti re shiu e paradites! Nuk jam vallë këtu, i lagur prej mundimit tënd e i qullur gjer në palcë si një qen? Tash unë po shkundem e po shkoj për t’u tharë: mos u habit! Mos të dukem gjë i pasjellshëm? Këtu është oborri im!

Përsa i përket Njeriut tënd të Epërm, mirë pra! Po e kërkoj menjëherë në këto pyje: prej tyre mbërriti britma. Ndoshta e frikëson ndonjë bishë e egër.

Është në mbretërinë time: këtu nuk duhet t’i bëhet keq, se ka vërtet shumë bisha të këqija përreth meje.”

Me të thënë këto fjalë, Zarathustra u kthye për të ikur.

Atëherë profeti tha: “O Zarathustra, je një kopuk! Tashmë e di: ti do të çlirohesh prej meje. Do të bëje mirë të vrapoje nëpër pyll e t’u bëje gjueti bishave të këqija.

Po ç’mund të bëhet me ty? Në mbrëmje të duhet të kthehesh përsëri tek unë, në shpellën tënde do të vij e të rri i rëndë e i duruar, si një mollok, e do të të pres”.

“Ashtu qoftë! - ulëriti Zarathustra sërish, duke ikur. - Ajo ç’ka është e imja në shpellën time është dhe e jotja, o miku im! Ti do të doje të gjeje akoma mjaltë, epo mirë! Lëpije, o gërnjar, e ëmbëlsoje shpirtin tënd! Sonte na duhet të jemi të gatshëm për njëri-tjetrin, të përzemërt e të hareshëm, se dita do të ketë mbaruar. Ti vetë duhet të vallëzosh me këngët e mia, si ariu im i zbutur e i mësuar.

Nuk e beson? Tunde kokën? Mirë! Mirë, ariu im plak, se edhe unë jam një profet.”

Kështu foli Zarathustra.

Bashkëbisedim me mbretërit

1.

Zarathustra nuk kish bërë as edhe një orë rrugë nëpër male e pyje, kur befas pa një kortezh të çuditshëm. Pikërisht, në rrugën që ai po ndiqte mbërritën dy mbretër, të stolisur me kurora dhe brezore të purpurta dhe shumëgjyrëshe si çafkat. Ata shtynin përpara një gomar të ngarkuar paq.

“Ç’duan këta mbretër në mbretërinë time?” - tha Zarathustra, i habitur në zemrën e vet, e u fsheh menjëherë pas një gëmushe. Por kur mbretërit i kaluan përballë, ai shpalli, me gjysmë zëri, si një njeri që flet veç me vetveten: “E çuditshme! E çuditshme! Po si mund të qëndrojnë bashkë këto gjëra? Dy mbretër shoh, por veç një gomar”. Atëherë, të dy mbretërit ndaluan, buzëqeshën, kthyen sytë kundrejt pikës nga vinte zëri dhe panë njëri-tjetrin

në fytyrë. Gjëra të këtij lloji i mendojmë edhe ne mes nesh, tha mbreti që qëndronte në të djathtë, por nuk i themi kurrë.

Mbreti, që qëndronte në të majtë, tundi supet dhe u përgjigj se mund të jetë ndonjë bari delesh ose një vetmitar që ka jetuar për një kohë të gjatë mes pemëve dhe shkëmbinjve. Të mospasurit e një shoqërie prish edhe zakonet më të mira.

“Zakonet e mira? - ia ktheu pa dëshirë e me hidhërim mbreti tjetër. - Po nga cilat gjëra duam të arratisemi? S’janë vallë “zakonet e mira”? S’është vallë “shoqëria jonë e mirë”?”

Më mirë të rrosh vërtetësish mes barinjve dhe eremitëve se sa në mes të plebenjve tanë të gënjeshtërt, të praruar e të pabrumë, pavarësisht se ajo quhet “shoqëri e mirë”, e shpallet si “fisnikëri”. Sepse, gjithçka tek ta është e gënjeshtërt dhe e kaluar e, para së gjithash, gjaku i tyre, falë sëmundjeve të vjetra, të shëmtuara e falë shëruesve më të këqij.

I miri dhe më i respektuari sot për mua është ai fshatari i shëndetshëm, i pagdhenduri, hileqari, i palëkundshmi, kryeneçi: ky është sot soji më i mirë.

Fshatari është sot njeriu më i mirë; raca e fshatarëve duhet të jetë ajo që duhet të sundojë.

Kur, në fakt, sundojnë plebenjtë: por unë nuk gënjem. Plebe do të thotë rrëmujë.

Rrëmujë plebenjsh: gjithçka i sipërvihet njëra-tjetrës, një pështjellim shenjtësh e ngatërrestarësh, fisnikësh e çifutësh e i çdo lloji tjetër kafshe të Arkës së Noes.

Zakone të mira. Gjithçka te në është e gënjeshtërt dhe e kalbur. Askush s’di më të adhurojë; pikërisht atyre ne u përvindhemi. Janë qenë ëmbëltorë dhe shumë të ngjitur, të sheqerosur me gjethe palmash.

Pështirosja më rritet akoma më tepër, për faktin se edhe ne mbretërit jemi bërë gënjeshtarë, të mbarsur me rrangullina, të veshur me luksin e vjetër e të zverdhur të gjyshërve pleq, gjoks mbuluar me medalje false, për më dinakët dhe më budallenjtë e për të gjithë ata që sot tregojnë, falë forcës.

Nuk jemi të parët, por, megjithatë, duhet të përfaqësohemi. Për këtë paraqitje xhepat i kemi plot.

Turmave u kemi marrë arratinë, prej gjithë atyre të shpupuriturve dhe shkarravitësve të shumtë, miza të mërzitshme, kutërbim tregjesh, të spitulluar nga krenaria. Phu, ç' erë e keqe të jetosh në mes të turmës! Phu, të jesh pjesë e të parëve të turmës! Ç' pështirosje! Ç' pështirosje! Ç' pështirosje! Ç' na mbetet vallë ne mbretërve!

“Ja tek të filloi përsëri sëmundja e vjetër, - tha në këtë çast mbreti në të majtë. - Po të dërrmon pështirosja, o vëllai im i mjerë! E di mirë se dikush po na dëgjon.”

E Zarathustra, që kish hapur sy e veshë për këto ligjërime, doli befash nga skuta ku qe fshehur dhe iu paraqit mbretërve:

“Ai që po ju dëgjon, e po ju dëgjon me dëshirë, o mbretër, quhet Zarathustra. Unë jam po ai që njëherë tha: “Ç' u mbetet akoma mbretërve? Më falni, por unë e prita me shumë hare bisedën tuaj kur thatë: “Ç' na mbetet vallë ne mbretërve?!”.

Aq më tepër, që këtu është mbretëria dhe zotërimi im. Ç' po kërkon në mbretërinë time?

A mos vallë gjetët rrugës atë që po kërkoja dhe unë: Njeriun e Epërm. Kur mbretërit i dëgjuan këto fjalë, rrahën gjoksin e shpallën me zë të lartë: U zbuluam!

Me shpatën e kësaj fjale ti çjerr natën e errët të zemrës sonë. Ti zbulove ankthin tonë, sepse, shiko, ne jemi në udhë për të kërkuar pikërisht Njeriun e Epërm; njeriun që qëndron sipër nesh, edhe pse jemi mbretër.

Për tek ai duam ta udhëheqim këtë gomar. Njeriu i Epërm në tokë duhet të jetë edhe zotëria më i lartë.

◻ Në të gjithë fatet njerëzore nuk ka fatkeqësi më të madhe se sa kur të fuqishmit e tokës nuk janë edhe më të parët e njerëzve. ◻ Në këtë rast, gjithçka bëhet false, e shtrembëruar, monstruoze.

Se, në qofshin të fundit e më bisha se njerëzit, ja tek rritet menjëherë çmimi i plebenjve e, së fundi, virtyti plebe arrin të pohojë se veç unë jam virtyti.

“Ç’dëgjova vallë? - u përgjigj Zarathustra. - Sa shumë mençuri paska te këta mbretër! Jam në ekstazë e do të më pëlqente t’ju thurja ca vargje me rimë, edhe pse mund të dalin jo të përshtatshme për veshët e çdokujt. Kam shumë kohë që nuk kam hiç sqimë për veshgjatët. Mirë, pra, le të fillojmë!

Një ditë, në të bollëkut vitin një,
e dehura Sibilë foli plot zë:

Mjerë ne! Gjithçka po shkon së prapthi! Sa keq!

Bota s’pat rënë kurrë kaq poshtë, si për dreq!

Lavire është Roma dhe e lavireve fole.

Një bishë Perandori dhe Zoti një hebre!

2.

Mbretërit u zbavitën shumë, duke dëgjuar këto vargje të rimuara të Zarathustrës, por mbreti në të djathtë tha: “O Zarathustra, sa mirë bëmë që morën udhën për të të parë!

Armiqtë e tu, në fakt, na e shfaqën imazhin tënd nëpër pasqyra; aty ti shfaqeshe me maskën e një demoni e me një pamje përqeshëse, ndaj ne patëm frikë prej teje.

Po ç’dobi na solli? Ti gjithmonë na thumboje veshët dhe zemrat me sentencat e tua. E në fund thamë: e ç’na duhet pamja jote? Ne duhet të dëgjojmë atë, atë që na mëson: “Ju duhet ta dashuroni paqen vetëm si mjet për luftëra të reja, duhet të dashuroni paqen e shkurtër më shumë se atë të gjatë!”.

Askush s’ka shpallur ndonjëherë fjalë më luftarake:

“Ç’gjë vallë është e mirë? Të jesh guximtar është gjë e mirë. Lufta e mirë është ajo që shenjtifikon çdo gjë”.

O Zarathustra, gjaku i etërve tanë u trazua me këto fjalë brenda trupit tonë; qe si zëri i pranverës për butet e vjetra me verë.

Kur shpatat kryqëzoheshin, të ngjashme me gjarpërinjtë me njolla të kuqe, atëherë etërve tanë jeta u dukej e bukur. Çdo diell i paqes u ngjante i mpakët e i ngrohtë, dhe prehja u ngjante turp.

Oh, si psherëtinin etërit tanë kur mureve shihnin të vezullonin të shndritshmet shpata të thata!

Po njëlloj si ata qenë të etur për luftë. Një shpatë, në fakt, shndriste nga dëshira për të pirë gjak.

Teksa mbretërit flisnin dhe bisedonin me aq zjarr lumturie për etërit e vet, Zarathustra u mbërthye nga dëshira e fortë për t'u tallur me rrëmbimin e tyre. Sepse këta mbretër i dukeshin paqësorë, me ato fytyrat e tyre të vjetra e të hajthme. Por u përmbajt. "Epo mirë, - tha. - Rruga të shpie aty ku gjendet shpella e Zarathustrës; kjo ditë do të ketë një mbrëmje të gjatë!"

Aq më tepër që tash, një britmë ndihme po më thërret të largohem prej jush.

Do të jetë e nderuar shpella ime, nëse ju, o mbretër, do të uleni aty e do më prisni. Po, sigurisht që duhet të prisni gjatë!

Kjo s'prish edhe aq punë! Ku mësohet sot më mirë pritja sesa në oborre mbretërore? Gjithë ai virtyt, që u ka mbetur mbretërve, a nuk quhet sot "Të dish të presësh?"

Kështu foli Zarathustra.

Shushunja

E Zarathustra vazhdoi i mendueshëm më tej, duke hyrë thellë në pyll e duke kaluar nëpër toka moçalore; e, siç u ndodh atyre që meditojnë mbi gjëra të rënda, pa e kuptuar shkeli mbi një njeri. Menjëherë një britmë dhimbjeje, dy të shara e nja njëzet fjalë fyese iu spërkatën në fytyrë, aq sa ai, i frikësuar, ngriti shkopin dhe e goditi atë që sapo kish shkelur. Po më pas, reflektoi e zemra qeshi nga budallallëku që kish bërë.

"Më fal, - i tha të shkelurit që qe ngritur i tërbuar dhe kish rënë përsëri. - Më fal e dëgjoje mirë këtë krahasim që po të tregoj.

Si një shtegtar që, duke ëndërruar gjëra të largëta, pengohet befaz në një rrugë vetmitare mbi një qen që fle, një qen që shtriqet

në diell e që të dy, të mbërthyer nga zemërimi i vërsulen njëri-tjetrit, si armiq të betuar, por njëloj të frikësuar për vdekje: po kështu na ngjau dhe ne të dyve.

Megjithatë, megjithatë, sa pak më mungoi që të mos e përkëdhelja atë qen dhe atë vetmitar. Nuk janë vallë që të dy vetmitarë?

“Kushdo ti qofsh, - tha gjithmonë i zemëruar i shkeluri, tash po më duket se po më shkel edhe me fjalën e jo vetëm me këmbën tënde! Shikomë, mos jam gjë qen?”

Duke folur kështu, u ngrit dhe nxori nga kënetat kraheve të tij të zhveshur. Ma parë shtrihej për së gjati në tokë, i fshehur dhe i panjohshëm, i ngjashëm me atë që gjuan e pret kafshët moçalore.

Po ç'farë po bën? - ulëriti Zarathustra i frikësuar, kur pa se nga krahu i zhveshur rridhte shumë gjak. - Ç'të ka ndodhur? Mos të ka kafshuar, fatkeqësisht, një bishë e keqe?”

I përgjakuri buzëqeshi, por gjithmonë i zemëruar. “E ç'të duhet ty! - bërtiti, duke bërë të ikte. - Këtu jam në shtëpinë time e në sinorët e mi. Kushdo mund të më pyesë, por vështirë mund t'i përgjigjem një budallai si ti.”

“Gaboresh, - i tha Zarathustra, duke iu lutur dhe duke e ndalur. - Gaboresh, këtu nuk je në shtëpinë tënde, por në mbretërinë time e dua që askush të mos lëndohet.”

Sidoqoftë, thirrme si të duash: unë jam ai që duhet të jem e quhem Zarathustra.

A e sheh! Atje sipër rruga të shpie për në shpellën e Zarathustrës, ajo nuk është larg. Nuk do t'i kurosh tek unë plagët e tua? Të paska shkuar keq në këtë jetë, o fatkeq! Më parë të kafshoi bisha, pastaj të shkeli njeriu.

Me të dëgjuar emrin e Zarathustrës, njeriu i shkelur ndryshoi çehren e fytyrës. “Ç'më ngjau! - ia briti. - Kush më intereson tjetër në këtë jetë, në mos veç Zarathustra dhe një kafshë që rron me gjak, shushunja?”

Për dashurinë e shushunjave unë preheshja në këtë moçal si një peshkatar. Për plot dhjetë herë krahu im qe thëthirë prej tyre, gjer atëherë kur mbërriti më e bukura shushunjë, për të thithur gjakun tim, ti Zarathustra! Oh ç'lumturi! Oh ç'mrekulli! Qoftë e lumturuar ajo ditë që më tërhoqi në këtë moçal! Qoftë e lëvduar më e mira ventuzë e gjallë, qoftë lëvduar shushunja e madhe e ndërgjegjes, Zarathustra!

Kështu foli i shkeluri e Zarathustra u gëzua prej fjalëve të tij, prej mënyrës elegante dhe të respektueshme që ai i kish shqiptuar ato.

“Kush je? - pyeti e i zgjati dorën. - Mes nesh mbeten për t'u sqaruar dhe shpjeguar shumë gjëra, por tash më duket se po çelet një ditë e kthjellët e plot dritë.”

“Unë jam i ndërgjegjësuar i shpirtit, - u përgjigj tjetri, - e në gjërat e shpirtit nuk ka askënd më të rreptë, më të ashpër e më kërkues se unë, përveç atij, prej të cilit unë kam mësuar prej vetë Zarathustrës. Shumë gjëra më mirë të mos i dish fare se sa t'i dish përgjysmë.”

Më mirë të jesh i çmendur dhe me opinionin tënd se sa i mençur e me mendjen e të tjerëve.

Unë shkoj deri në fund: ç'rëndësi ka në ajo është e vogël apo e madhe? Në quhet moçal apo qiell? Më mjafton një fund i thellë sa një pëllëmbë, veç të jetë një tokë e qëndrueshme. Një fund i thellë sa një pëllëmbë dhe mbi të mund të rrihet në këmbë. Në ndërgjegjen e drejtë të dijes nuk ka as të vogël e as të madh.

“Kështu, pra, ti qenke njohësi i shushunjave? - pyeti Zarathustra. - Dhe e ndjek shushunjën deri në thellësitë më të skajshme, o i ndërgjegjshëm?”

“O Zarathustra, - u përgjigj i shkeluri, - ajo do të ishte një paanësi. Si mund ta guxoja gjithë këtë?! Unë jam mjeshtri dhe njohësi i asaj që është truri i shushunjës: kjo është bota ime! Dhe është padyshim një botë.

Më lejo që këtu të marrë fjalën krenaria ime, se në këtë gjë nuk kam shok. Ja pse thashë se këtu jam si në shtëpinë time.

Oh, që prej sa kohe i shkoj pas kësaj gjëje unike, trurit të shushunjës, që e vërteta veshullore të mos më shpëtojë më nga dora! Këtu është mbretëria ime!

Për të hodha tej gjithçka tjetër, për të gjithçka tjetër s'më intereson më; pranë mençurisë sime prehet dhe padija ime e zezë.

Ndërgjegjja ime për gjërat e shpirtit e kërkon këtë prej meje, që unë të di veç një gjë të vetme e të injoroj gjithçka tjetër: më ngjallin neveri gjithë mediokrit në shpirt, gjithë të pështjelluarit, të lëkundurit apo sentimentalët.

Aty ku rresht besnikëria ime, unë jam i verbër dhe dua të jem i verbër. Po aty ku dua të di, dua të jem edhe besnik, d.m.th i fortë, i rreptë, i cakëzuar, mizor, i pashtershëm.

Ajo që ti the një ditë o Zarathustra, se "shpirti është jeta, që e skalit vetveten te jeta", më tërhoqi dhe më udhëhoqi drejt doktrinës tënde. Se, në të vërtetë, me vetë gjakun tim e kam rritur dijen.

"Ashtu siç dhe shihet," - e ndërpreu Zarathustra, sepse gjaku vazhdonte të rridhte akoma prej krahut të zhveshur të të ndërgjegjësuarit. Dhjetë shushunja i ishin ngjitur pas.

Oh, ti o mik i çuditshëm, sa shumë gjëra po më mëson ky spektakël, vetë prania jote! Jo gjithçka do të mund të vërshoja në veshët e tu të rreptë.

Epo mirë! Le të ndahemi këtu! Po do të dëshiroja me qejf të ritakoheshim. Aty lart, udha të shpie për në shpellën time: sonte ti duhet të jesh miku im i nderuar.

Me dëshirë do të doja ta përkujdesja dhe rehatoja trupin tënd, sepse ishte vetë Zarathustra ai që ta shkeli atë me këmbë: po mendohem për këtë. Por tash një britmë dhimbjeje po më thërret larg teje."

Kështu foli Zarathustra.

Magjistari

1.

Kur Zarathustra po vinte përqark një thepire, pa befas, jo shumë larg, por poshtë tij, në po atë udhë ku ai po drejtohej, një njeri që po debatonte si i xhindosur e që më në fund ra si i plandosur përdhe. "Ndal, atje! - i tha zemrës së vet Zarathustra. - Ai duhet të jetë Njeriu i Epërm, prej tij duhej të vinte ajo britmë e trishtë dhimbjeje; dua të shoh në mund ta ndihmoj. Por kur arriti në vendin ku ai prehej, gjeti veç një plak që përpëlitej me sy të zgurdulluar. Po edhe pse Zarathustra u përpoq aq shumë për ta ngritur e për ta mbajtur në këmbë, mundimi i tij qe i kotë. I mjeri, as që e vuri re se dikush ishte pranë tij: vazhdonte të shihte përreth me një pamje të dëshpëruar, si një i braktisur nga e gjithë bota. Por pas një kohe të gjatë, duke u dridhur e përpëlitur nisi të ankohej kështu:

Kush më ngroh, kush akoma më do?

Jepmëni duar të ngrohta!

Jepmini zemrës një mangall!

Përtokë i gjatuar, nga rrëqethjet sulmuar,

si një njeri që po vdes e i ngrohin këmbët,

i shkundur e i përshkundur. Medet! Nga një ethe

e panjohur, e i dridhur nga akulli e të mprehtat

maja që m'i vërvit ti, o mendim!

I fshehtë! I paemërueshëm! I lemerishëm!

Ti, gjahtar në galop pas reve!

Prej teje, si i rrufe-goditur,

o sy përçmues, që shpotit në errësi të unë prehem,

e përkulem, kruspullohem, i torturuar

jam prej martirëve të përjetshëm,

tash prej teje goditur.

O gjahtar i tmerrshëm i zotave,

prej teje, o i panjohuri Zot!

Qëlllo akoma më fort!

Qëlllo në shenjë!

Shpoje, shkallmoje zemrën time!

Pse vallë gjithë ky martirizimi im
me shigjeta majëthyera?

Pse kthehesh të më shohësh
e gjithmonë të më torturosh

me sytë e tu hyjnorë e shkrepës?

Nuk do të më vrasësh,

por vetëm të më martirizosh?

Por për çfarë do më bësh kurban.

Ti o Zot i lig, i panjohur?

Ah? Po nxjerr kryet?

Në këtë mesnatë

ç'kërkon vallë?

Fol! Më shtyn e më shtyp,

shumë afër po më vjen!

Ik! Ik tutje!

A e ndjen se unë frymoj,

a e dëgjon zemrën time,

ti, o ziliqar, po përse vallë ziliqar?

Ik! Përse mban një shkallë?

A do thellë zemrës sime

të zbresësh aty poshtë, në më të fshehtat

mendime të depërtosh?

Ti, i pacipi! Hajdut i panjohur!

Ç'do të rrëmosh?

Ç'do vallë të dëgjosh?

Ç'do vallë të torturosh,

do të më torturosh mua,

ti, o zot-xhelat?

A mos duhem, njëlloj si qeni,
të vijë vërdallë përpara teje?
E i dehur, jashtë vetes sime,
të tund bishtin me dashuri?

Më kot! Qëllomë akoma
o thumbues i tmerrshëm!
Jo një qen; gjahu yt i egër jam,
o gjahtar mizor!
Burgu yt më kryelartë,
o kushar që fshihesh
prapa reve!
Fol! Ç'do vallë, ti o kombëtar,
prej meje, ti i mbështjelli në rrufe?
Fol! Ç'do këtu vallë, ti, o Zot i panjohur?

Si? Një shpërblim?
E ç'do vallë për shpërblim?
Kërkon shumë – këtë të këshillon krenaria ime –
e fol shkurt, edhe për pak!
Ah, ah, mos më do mua?
Mua, gjithçka timen?
Ah, ah!
E më torturon, ashtu i marrosur siç je.
A martirizon krenarinë time?
Jepmë dashuri, kush akoma më ngroh?
Kush akoma më do? Jepmë duar të ngrohta!
Jepmë mangall në zemër,
dhuroma mua, vetmitarit,
të cilit edhe një akull, një copë akulli
i thjeshtë, i mëson të dashurojë,
të dashurojë madje dhe armiqtë e vet,
dhuroma, po, po, dhuroma!

O armik i tmerrshëm, veten tënde tek unë!

Ik pra!

E ja tek më shkoi
i fundmi dhe i vetmi miku im,
armiku më i madh,
i panjohuri
Zoti im-xhelat!

Jo! Kthehu përsëri

me të gjitha martirizimet e tua!

Tek i fundmi i eremitëve

ti kthehu përsëri!

Të gjitha rrëketë e vajit tim

rrjedhin gufueshëm kah teje!

Dhe flakërima e fundit e zemrës sime

për ty ndizet!

Oh, kthehu përsëri,

o Zoti im i panjohur! O dhimbja ime! O lumturia ime e fundit!

2.

Në këtë çast, Zarathustra nuk mundi të duronte më gjatë, mori shkopin duke e goditur me gjithë forcë atë që ankohej.

“Mjaft! - bërtiti me një të qeshur të rysur. Mjaft, o komedianë! O falsifikator! O gënjeshtar! Unë të njoh mirë! Unë dua të të ngroh këmbët, o magjistar i lig, e di mirë si ngrohen tipa si ty!

Pusho! Ia kthehu plaku e u ngrit lart nga toka; mos më godit më, o Zarathustra! Bëra kështu veç për lojë! Gjëra të këtij lloji i përkasin profesionit tim; doja të të vija në provë, kur luajta rolin e këtij të mençuri! Po, në të vërtetë, ti pe aq mirë thellë brenda meje e nuk më dhe as një provë të vogël të vetes, se je i ashpër, o i mençuri Zarathustra! Qëllon fort me “të vërtetat” e tua; shkopi yt ma nxori nga shpirti këtë të vërtetë.

“Mos u lajkato, - u përgjigj Zarathustra, gjithnjë e më i eksituar dhe i ngrysur. - Ti o komedian kokë e këmbë! Je i gënjeshtërt, ç'më flet për të vërtetën!

Palloi i pallonjve, det mendjelehtësie e kotësie, ç'pjesë luajte përpara meje o magjistar i lig? Kujt duhet vërtet t'i besoja kur ti ankoheshe në këtë mënyrë?

“Unë luaja pjesën e të penduarit në shpirt, - tha burri plak. - Ti vetë e shpikë një ditë këtë fjalë; poeti dhe magjistari që, më së fundi kthejnë kundra vetes shpirtin e tyre, atë të tjetërsuarin që vdes i ngrirë, falë dijës dhe ndërgjegjes së tij të keqe.

Rrëfihu, pra, o Zarathustra; t'u desh aq shumë kohë gjersa të zbuloje artin dhe gënjeshtren time. Ti besove në nevojën time, kur më ngrite kokën me të dyja duart, e të dëgjova të ofshaje: E kanë dashur pak, shumë pak. Që të kishte gënjyer deri në këtë pikë, ja, për këtë gazmohej ligësia ime!”

“Ti mund të kesh gënjyer edhe më dinakë se sa unë, - tha ashpër Zarathustra. - Unë nuk rri e ruaj gënjeshtarët, më duhet ta shmang maturinë, kështu e do fati im.

Ndërkohë, që për aq sa të njoha, ti duhet të gënjesh! Të duhet të interpretosh në dy, tri, katër apo pesë mënyra. Edhe kjo që sapo tregove, sipas meje, nuk është as aq e vërtetë e as aq e gënjeshtërt.

O falsifikator i lig, si mund të bëje ndryshe! Do të falsifikojë madje edhe sëmundjen tënde, nëse do të doje të shfaqeshe lakuriq përpara mjekut.

Kështu e fshehe gënjeshtren, kur the: “E bëra vetëm për lojë!

Jo, sepse në të kishte shumë seriozitet; mes të tjerash, ti je edhe një pendestar i shpirtit! Unë e pikasa se çfarë je: iu shfaqe të gjithëve si një magjistar, por për veten nuk ke as gënjeshtër e as dredhi; për veten ti je një magjiprishës!

Si të vërtetën tënde unike pate neverinë. Asnjë fjalë te ty s'është e sinqertë, veç gojës tënde ose, më mirë, neveria që të rri ngjitur në gojë.”

“Kush je ti vallë? - ulëriti atëherë magjistari plak me zë arrogant. - Kush mund të më flasë kështu mua, më të madhit të atyre që jetojnë sot?” E lëshoi prej syve të tij një shigjetëzim të mpakur shikimi mbi Zarathustrën. Po shumë shpejt u transformua i tëri e tha trishtueshëm:

O Zarathustra, jam i lodhur, i pështirosur nga magjitë e mia, e nuk jam aspak i madh. Pse t’i shtirem kot vetvetes? Po ti e di, unë e kërkoja madhësinë!

Desha të përfaqësoja rolin e një njeriu të madh e binda shumë njerëz, por kjo gënjeshtër arriti t’i mposhtë fuqitë e mia. Kundra saj u theva dhe u dërmova.

O Zarathustra, gjithçka është gënjeshtër brenda meje, por që unë tash jam i thyer, kjo është e vërtetë!”

“Kjo të nderon, - tha Zarathustra i zymtë e me shikimin e ngulur përtokë. - Të nderon, të kesh kërkuar madhësinë, por edhe të tradhton. Ti nuk je i madh.

Magjistar i lig plak, kjo është gjëja jote më e mirë dhe më e ndershme; ajo që unë nderoj te ty është rrëfimi se ‘unë nuk jam i madh’.

Ja pse të çmoj si një pendestar të shpirtit, edhe pse veç për një grimë ti ke qenë i ndershëm.

Pa tregomë, ç’kërkon këtu mes pyjeve dhe shkëmbinjve të mi? Kur m’u gjende në mes të rrugës, ç’provë kërkoje prej meje? Në ç’gjë kërkoje të më tundoje?

Kështu foli Zarathustra, e sytë i përshkëndisnin. Magjistari plak heshti një moment, pastaj tha:

“Të tundova! Unë vetëm sa u përpoqa”.

O Zarathustra, unë kërkoj një të sinqertë, një të drejtë, një të thjeshtë, univok, të panjollë, një oazë mençurie, një shenjt të njohjes, një njeri të madh.

Akoma s’e ditke o Zarathustra, unë kërkoj Zarathustrën!

Në këtë pikë u nder një heshtje e gjatë në mes të dyve: Zarathustra u zhyt thellë në vetvete, aq sa dhe mbylli sytë. Por

më pas, duke iu kthyer bashkëbiseduesit të vet, i shtrëngoi dorën e magjistarit e tha, plot hijeshi e ligësi:

“Epo mirë, pra! Atje tej rruga të shpie në shpellën e Zarathustrës. Aty ti mund të kërkosh atë që dëshiron.

Kërkoju ndonjë këshillë kafshëve të mia, shqiponjës dhe gjarprit tim: ato mund të të ndihmojnë për ta gjetur. Se shpella ime është e madhe. Unë vetë, në të vërtetë, s’kam parë ende ndonjë njeri të madh. Për gjithçka që është e madhe, edhe syri më i mprehtë sot duket si trashaman. Rrojmë në mbretërinë e plebenjve.

Kam takuar më shumë se një njeri që stërzgjatej e fryhej si kacek e që populli i bërtiste: “Ja një njeri i madh!”. Po kujt i shërbejnë këta kacekë? Në fund, era e gjen një vrimë e del.

Në fund, plas edhe bretkosa aq shumë e fryrë, e era shpërthen jashtë. Ti vrimosh barkun një mendjemadhi është një zbavitje e këndshme. Dëgjomëni mirë, o djem!

Kjo është dita e plebenjve. Kush e di vallë se ç’është e madhe e ç’është e vogël? Kush e ka kërkuar madhësinë me fat? Vetëm një i çmendur, se vetëm të çmendurit kanë fat.

Ti kërkon njerëzit e mëdhenj, o i çmendur i çuditshëm? Kush ta ka mësuar? Është koha sot për këtë gjë? O kërkues i lig, përse më tundon?”

Kështu foli Zarathustra, i lehtësuar në zemër e, duke qeshur, nisi të shkojë nëpër udhën e vet.

Jashtë shërbimit

Jo shumë kohë pasi Zarathustra ishte çliruar nga magjistari, pa përsëri dikë që qëndronte ulur në mes të rrugës nga ai po kalonte, një burrë të gjatë e të zi, me një fytyrë të zbehtë e thatime; e mbeti sinqerisht goxha i tronditur. Mjerë ti! - i tha zemrës. - Ja, teksa po rri ulur vetë shqetësimi i mumjezuar; më ngjan gati si i sojit të priftërinjve. Ç’duan vallë në mbretërinë time?

Si! Sapo iu përvodha atij magjistari, e tash duhet të më presë rrugën një tjetër sajues magjish, një lloj mjeshtri shtrigërish dhe shërues, një bërës i zyrtë mrekullish nga ana e Zotit, një turpërim i tij, një mohues i botës, që djalli ta marrë!

Por djalli nuk është kurrë në atë vend ku duhet: mbërrin gjithmonë shumë vonë, ai xhuxh i mallkuar e çalaman.

Kështu mallkonte Zarathustra, i paduruar në zemër, duke meditaruar si t'i përvidhej duke përhedhur shikimin larg burrit të zi. Po ja, gjërat shkuan në mënyrë të kundërt. Në atë çast që arriti ta vërë re, njëlloj si dikush që ndeshet me një lumturi të papritur, ai u ngrit në këmbë e shkoi si shigjetë drejt Zarathustrës.

“Kushdo qofsh, ti o endacak, - i tha, - jepi ndihmë një fatkeqi, një kërkimtar plak, që lehtësisht mund ta pësojë në këtë vend.

Kjo botë m'është e huaj dhe e largët, kam dëgjuar edhe ulërime bishash; ai që mund të më ofronte një strehim s'është më.

Po kërkoja më të fundmin njeri të devotshëm, një shenjti e oshënar që, i vetëm në pyll, nuk ka dëgjua ende atë që e di çdokush.”

“Pse, ç'gjë di çdokush?” - pyeti Zarathustra. - Pak a shumë këtë gjë, se i vjetri Zot, të cilit i besonte çdokush, tash nuk është më?”

“Kështu thua ti, - u përgjigj plaku i turbulluar. - Po unë, që i shërbeva këtij zoti plak deri në çastin e fundit?

Tani jam jashtë shërbimit, pa Zot, por megjithatë nuk jam i lirë, as i gëzuar për një orë të vetme, e as kur zhytem nëpër kujtime. Andaj u ngjita nëpër këto male, për t'i bërë vetë një festë nga ato që u takojnë papëve të vjetër dhe etërve të kishës se, në do ta dish, unë jam papa i fundit. Një festë, unë them, me kujtime të përshpirtshme e shërbesa hyjnore.

Aq më tepër, që tash vdiq edhe ai njeriu më i devotshëm, ai shenjti i pyllit që vazhdimisht e lëvdonte Zotin e vet me këngë e murmurime. Nuk e gjeta më, kur qeshë në kasollen e vet; aty gjeta vetëm dy ujqër që ulërinin duke vajtuar vdekjen e tij, se të gjithë kafshët e donin. Atëherë u largova edhe unë.

Mos kam ardhur më kot në këto pyje e male? - mendova. - Kështu që zemra ime vendosi të kërkojë një tjetër, më të devotshmin e të gjithë atyre që nuk besojnë në Zot. Pra, erdha të kërkoj Zarathustrën!”

Kështu foli plak, e vështroi me sy të kujdesshëm atë që i rrinte përballë. Mirëpo, Zarathustra e mbërtheu dorën e papës plak dhe ndenji gjatë, duke e kundruar i admiruar.

“Shiko atje, ti, o shenjtëri, - tha pas kësaj. - Ç’dorë e bukur dhe e gjatë! Është dora e një individi që ka shpërndarë gjithmonë bekime, por tash po të mban shtrënguar ai që ti kërkon, pra vetë Zarathustra. Jam vetë ateisti Zarathustra që po flas. Kush është më ateist se unë, që të kënaqem me ato që thotë?”

Kështu foli Zarathustra, duke depërtuar me shikime mendimet dhe sekretet e brendshme të papës plak. Në fund, ai filloi të fliste:

“Kush më shumë e deshi dhe e zotëroi, ai e humbi dhe më tepër se të tjerët. Tani, mos vallë mes ne të dyve jam unë më ateisti? Po kush mund të gëzohet për këtë?”

“Ti i shërbeve deri në fund, - pyeti Zarathustra i mendueshëm, pas një heshtjeje të thellë.

A e di se si vdiq? Është e vërtetë ajo që thuhet, se vdiq prej dhembshurisë, duke parë se si njeriu varej në kryq, e duke mos duruar që dashuria për njeriun të bëhej ferri i tij e së fundi edhe vdekja e tij?”

Papa plak nuk iu përgjigj, por e vështroi vëngër me një shprehje të dhimbshme e të zymtë.

“Lërë të shkojë, - i tha vetes Zarathustra, pas një meditimi të gjatë, teksa i mbante gjithmonë sytë të fiksuar në sytë e plakut. - Lërë të shkojë; tashmë ai s’është më. Edhe pse s’të nderon mosthënia e një fjale të mirë për këtë të vdekur, ti e di po kaq mirë sa edhe unë se kush ishte, e se ç’shtigje të çuditshme ai përshkoi.”

E thënë mes tri syve, - tha me dinakëri papa plak (sepse ishte i verbër nga njëri sy), për Zotin di më shumë unë se sa

Zarathustra. Dashuria ime i shërbeu atij për shumë vite, vullneti im bëri gjithçka ai desh. Një shërbëtor i mirë di gjithçka, madje edhe gjëra që padroni i tij ia fsheh dhe vetes.

Ishte një zot i fshehtë, plot me sekrete. Me thënë të vërtetën, për të pasur një bir përdori rrugë të tërthorta. Në prag të besimit të tij qëndron një kurorë-shkelje.

Kush e kremton si një Zot dashurie, nuk ka ndonjë kuptim të madh për dashurinë. Nuk donte vallë ky zot të bënte edhe gjykatësin. Po kush dashuron, dashuron përtej çdo çmimi dhe mundimi.

Kur ishte i ri, ky zot aziatik që i ashpër e hakmarrës, e ndërtoi një ferr, duke u zbavitur me të dashurit e vet.

Kur më në fund u plak, u bë i butë, i qullët dhe i dhembshur, më i ngjashëm me një gjysh se sa me një at ose, më saktë, me një gjyshe plakë, që s'e mbanin dot këmbët.

Qëndronte aty, i ulur në cep të stufës së vet, duke u ankuar për këmbët e dobësuar, krejt i lodhur e pa grimë vullneti, derisa një ditë u shua i tëri prej dhembshurisë së tij të madhe.

"Ti, papë plak, - e pyeti me dredhi Zarathustra, - a e ke parë këtë gjë me sytë e tu, se mund të ketë shkuar edhe kështu, por edhe ashtu, a në ndonjë mënyrë tjetër? Kur zotat vdesin, vdesin gjithmonë në mënyra të ndryshme."

Sidoqoftë! Kështu apo ashtu, në këtë apo atë mënyrë, ai mbaroi. Mua më neveriste ta shihja dhe ta dëgjoja në atë gjendje, ndaj nuk mund të thosha asgjë më të keqe për të.

Unë dashuroj gjithçka që flet qartë dhe troç. Por ai, - ti e di, o prift plak, se diçka prej sojit tënd, sojit të priftërinjve, ai kish padyshim, ishte i pabesë.

Aspak i qartë, dukej sikur e kish zënë keq me ne, që s'e kuptonim, ndaj murmuriste. Po atëherë, pse s'fliste më qartë? Nëse faji ishte i veshëve tanë, përse vallë nuk na kishte dhënë veshë të përshtatshëm për të kuptuar? Po nëse brenda kishim dyllë, kush na e kish vënë vallë? Shumë gjëra i shkuan keq këtij

poçari; duket që nuk qe kaq i zoti në zanatin e vet!

Po që më pas të hakmerrej edhe me vazot e krijesat e tij, se i kishin dalë keq, ky është vërtet një mëkat kundra shijes së mirë.

Se ka një shije të mirë dhe një mëshirim fetar, por së fundi, ajo bërtet: "Mjaft, me një Zot të këtij lloji! Më mirë të mos të jemi të çmendur, më mirë të jemi ne vetë zotër!"

"Po ç'po dëgjoj! - tha në këtë çast papa plak, duke zgjatur veshët. - O Zarathustra, ti je më besimtar se sa beson, me mosbesimin tënd. Ndonjë zot brenda teje ta ka konvertuar ateizmin.

Mos është vallë vetë ky besim ai që nuk të lë më të besosh në asnjë zot? Qashtërsia jote e pamasë do të shpjerë edhe përtej së mirës dhe së keqes!

Shiko pak se ç't'u kursye? Ti ke sy, duar, gojë, që janë të paradhëna të bekohen në përjetësi. Nuk bekohet veç me dorë. Në afinitetin tënd, edhe pse do të jesh më ateisti i të gjithëve, unë nën të ndjej një aromë ëmbëluese temjani, që vjen prej bekimeve të gjata e më bën të ndihem mirë dhe keq njëherësh.

Lërmë të jem miku yt, o Zarathustra, për një natë të vetme! Në asnjë vend të tokës nuk mund të rri më mirë si me ty!"

"Amin, e ashtu qoftë! - shtoi Zarathustra me shumë habi. - Atje tej është rruga që të shpie për në shpellën e Zarathustrës.

Me shumë dëshirë do të të shpija unë vetë, o shenjtëri, sepse i dua gjithë njerëzit fetarë, por tash një britmë e ankthshme po më thërret nga larg.

Në mbretërinë time askush nuk duhet të ndihet keq; shpella ime është port i mbarë. M'është diçka e shtrenjtë të ndihmoj çdo qenie të trishtë, duke e ngritur në këmbë e duke e bërë të ecë me këmbët e veta.

Po kush mund të ta heqë vallë prej shpatullave melankolinë? Jam shumë i dobët për këtë gjë. Në të vërtetë, duhet të presim gjatë derisa dikush të arrijë ta zgjojë Zotin tënd."

Ky zot i vjetër tashmë nuk rron më. Ka vdekur vërtet.

- Kështu foli Zarathustra.

Njeriu më i shëmtuar

Sërish, këmbët e Zarathustrës nisën të bridhnin nëpër male e pyje; sytë e tij kërkonin e kërkonin, por nuk e shquanin gjëkund atë që dëshironin të shihnin, nevojtarin e madh e ndihmën lutëse. Megjithatë, gjatë rrugëtimit ai ngazëllehej në zemër e ndihej i kënaqur. Sa gjëra të mira, - thoshte, - më dhuroi kjo ditë si shpërblim të nisjes së keqe! Ç'bashkëbisedues të çuditshëm pata sot!

Do të doja t'i përtypja gjatë fjalët e tyre, si të qenë kokrra të shijshme gruri. Dhëmbët e mi do t'i bluajnë e do t'i bëjnë pluhur, derisa të rrjedhin si qumësht në shpirtin tim.

Por kur rruga u kthye në shtegun përreth një rrëpire, peizazhi ndryshoi menjëherë e Zarathustra u gjend në mbretërinë e vdekjes. Në të lartësoheshin të mëdhenj shkëmbej të zinj e të kuq: nuk kish bar, as këngë zogjsh. Ishte, në të vërtetë, një luginë që i shmangeshin të gjitha kafshët, përfshirë këtu edhe ato grabitqaret; vetëm një soj i shëmtuar gjarpërinjsh të blertë e të fryrë, kur plakeshin vinin të vdisnin këtu. Ndaj ajo quhej "varri i gjarpërinjve".

Zarathustra u mbërthye nga kujtime të zymta, sepse kishte ndjesinë të kish qenë edhe një herë tjetër në këtë luginë. Sikur u rëndua i tëri, aq sa nisi të ecë ngadalë, gjithmonë e më ngadalë, derisa më në fund u ndal. Atëherë, sapo ngriti sytë, pa të kruspulluar në rrugë diçka që kishte dhe s'kishte pamjen e një njeriu, diçka të papërcaktueshme. U ndje i mbërthyer nga turpi, që kish kundruar me sytë e tij një gjë të tillë; i skuqur gjer në majë të flokëve të tij të bardhë, e hoqi shikimin e shpejtoi këmbët, për t'u larguar nga ai vend i shëmtuar. Po ja, teksa ai shkretim mortor nisi të gjallohej, nga trualli i tij shpërtheu një gurgullimë e një gulçim, njëlloj si e ujit që gurgullon dhe gulçon netëve nëpër tubat e mbyllura. Më në fund, zhurmëria u transformua në një zë njeriu e në një ligjëratë njerëzore, që thoshte kështu:

Zarathustra, Zarathustra! Gjeje enigmën time!

Fol, Fol! Ç'është vallë hakmarrja kundra dëshmitarit?

Unë po të tërheq pas, këtu akulli është i lëmuar! Kujdes, kujdes se mos krenarisë tënde i thyhen këmbët!

Ty të duket vetja i mençur, o krenari Zarathustra! Zbuloje, pra, enigmën, që unë përfaqësoj! Ti, o zhbiruesi i aq e aq enigmave! Tregomë, pra se cili jam!

Ndërsa Zarathustra i dëgjoji ato fjalë, ç'besoni se ngjau në shpirtin e tij? Mëshirimi zbriti mbi të; befasi, u rrëzua përtokë, siç bie një lis, që i pat qëndruar gjatë aq shumë goditjeve e, rëndë-rëndë, papritmas, lëshohet në mes të tmerrit të vetë atyre që deshën ta rrëzonin. Por u ngrit shpejt në këmbë e fytyra iu bë e ashpër.

"Të njoh mirë, - tha më zë të bronzte. - Ti je vrasësi i Zotit! Lërmë të shkoj! Nuk e duroje dot atë që të shihte, që të shihte kudo e gjer në thellësi të shpirtit, o më i shëmtuari i njerëzve! Ndaj u hakmore me atë dëshmitar!"

Kështu foli Zarathustra e deshi të ikte; por i papërshkrueshmi mbërtheu një kind të veshjes së tij e nisi të belbëzonte e të kërkonte fjalët.

"Qëndro! - tha më së fundi. - Qëndro! Mos shko më tej! Provo të gjesh se cila sëpatë të la shakull përtokë. Për shëndetin tënd, o Zarathustra, që je përsëri në këmbë! Ti e zbulove, e di mirë, si ndihet në shpirt ai që vrau, vrasësi i Zotit. Qëndro, pra!

Ulu këtu afër meje, nuk do të shkojë koha kot. Drejt kujt doja të shkoja, në mos drejt teje? Qëndro! Ulu këtu! Por mos më kundro! Respektoje shëmtimin tim! Ata më ndjekin këmba-këmbës: vetëm ti je streha ime e mbrame. Jo me urrejtjen e tyre, jo me xhelatët e tyre! Oh, unë do të qeshja me një persekutim të tillë dhe do të isha krenar e i kënaqur! Suksesi, a nuk ka qenë vallë deri më sot i të gjithë të persekutuarve? Se kush përndjek mirë, mëson të ndjekë lehtësisht, madje arrin të të ndjekë deri në fund. Por është mëshirimi, mëshirimi i tyre, ai prej të cilit unë

mora arratinë e po kërkoj strehim te ty. O Zarathustra! Mbromë, ti strehimi im i mbramë, ti i vetmi që më ke kuptuar, se ti e ke kuptuar se si ndihet me shpirt ai që vrau Zotin. Qëndro! Por nëse do të shkosh, o i paduruar, mos kalo nga rruga, nëpër të cilën erdha unë. Ajo është udhë e keqe. Je i zemëruar me mua, se kam kohë që llomotis mbarë e prapë? Përse vallë të jap këshilla? Por dije, unë jam njeriu më i shëmtuar, që ka edhe këmbët më të mëdha e më të rënda. Aty ku kalova unë, rruga është e shëmtuar, se unë përshkruaj të gjitha rrugët e prishura e të fëlliqura. Por ndërsa ti më kalove përpara syve, duke heshtur, e vështrova mirë se u skuqe, andaj të njoha, o Zarathustra! Çdokush tjetër do të më kishte hedhur ndonjë lëmoshë, a mëshirimin e vet, me fjalë e me shikime. Por, sa për këtë gjë, unë nuk jam dhe aq lypsar, e ti e zbulove; unë jam shumë i pasur, i pasur në madhësi, në gjëra të tmerrshme, në gjëra të shëmtuara, në gjëra të pathëna ndonjëherë. Turpi yt, o Zarathustra, më nderoi. Me mundim arrita të dal jashtë nga turma e mëshiruesve, për të vetmin që sot mëson se “mëshirimi është molepsje”, pra, ty, o Zarathustra! Qoftë Zot a diçka njerëzore, mëshirimi shkon kundra turpit. Edhe mosdashja e të ndihmuarit mund të jetë më fisnike se çdo virtyt që shpërthen menjëherë për të kërkuar ndihmë.

Ndërsa sot, ajo që njerëzit e vegjël e quajnë virtytin më të lartë, është mëshirimi. Njerëzit e vegjël nuk kanë respekt për fatkeqësinë e madhe, për shëmtinë e madhe e për përfundimin e madh e të palumtur. Unë shoh përtej gjithë këtyre njerëzve, siç sheh qeni përtej shpinës së deleve gëluese. Janë njerëz të vegjël, të përhimë, me lesh të mirë e vullnet të fortë.

Siç hedh një skifter vështrimin përçmues tej ultësirave moçalore, me kokën pas, kështu unë e shtyj shikimin tej gëlimit të velave të vogla e të përhimë e tej shpirtrave të vegjël e me vullnet.

Për një kohë të gjatë iu dha të drejtë këtyre njerëzve të veckël; madje u arrit t'u jepej atyre edhe fuqia, kur tash ata na mësojnë se “është e mirë vetëm ajo që njerëzit e vegjël e quajnë të mirë”.

“E vërtetë” sot quhet ajo çka tha predikuesi që doli nga gjiri i tyre, ai shenjt i çuditshëm dhe fjalëmirës i njerëzve të vegjël, që vetëshpalli se “unë jam e vërteta”.

Ai mendjemadhi, që prej një kohe të gjatë ua kish ngritur kreshtën njerëzve të veckël, duke shpërhapur një gabim të madh në mësimin e tij: “Unë jam e vërteta!”.

Po a mund t'i jetë përgjigjur ndonjëherë ndokush me mirësjellje ligjërimin të një mendjemadhi? Mirëpo, ti o Zarathustra, shkove përtej tij, duke thënë: “Jo! Jo! Tri herë jo!”.

Ti na e paralajmërove rrezikun e gabimit të tij, ti vetë ishe i pari që na e paralajmërove rrezikun e mëshirimit. Jo të gjithë, askush tjetër, veç ti dhe ata të sojit tënd.

Ti turpërohesh nga turpi i vuajtësit të madh, andaj thua: “Nga mëshirimi vjen një re e madhe; kujdes, o njerëz!”.

Kur mëson: “Të gjithë krijuesit janë të fortë e çdo dashuri e madhe shkon përtej mëshirimit të tyre”, o Zarathustra, sa mirë më ngjan se i njeh shenjat e kohës.

Por edhe ti vetë ruaju nga mëshirimi yt, sepse shumë janë nisur në udhë për te ty, shumë të vuajtur, dyshimtarë, të dëshpëruar, shumë të tjerë gati në të mbytur, e shumë të tjerë në sflitjen e të ftohtit.

Madje, po të them të ruhesh edhe nga unë. E zbulove kush që enigma ime më e mirë dhe më e keqe, unë vetë, dhe ajo që kam bërë. E njoh sëpatën që do të të godasë e do të të shembë përdhe.

Por ai duhet të vdiste; ai shihte me sy që shihnin gjithçka, ai shihte thellësinë dhe humnerën e njeriut, të gjitha turpet dhe gjërat e tij të shëmtuara e të fshehura.

Mëshirimi i tij nuk njihte turp; depërtoi në skutat e mia më të ndyra. Duhej të vdiste ai njeri aq kurajoz, aq dredharak, aq i mëshirshëm.

Më shihte gjithmonë: desha të hakmerresha për atë dëshmitar. Përndryshe, do të isha i vdekur.

Ai Zot që shihte gjithçka, edhe njeriun, duhej të vdiste. Njeriu nuk e duron të gjallë një dëshmitar të llojit të tij.

Kështu foli njeriu i shëmtuar, por Zarathustra u ngrit dhe u bë gati të largohej: ndihej si i ngrirë deri në rropulli.

“O i papërshkrueshëm, - tha. - Ti më paralajmërove rrezikun e udhës tënde. Për të të falënderuar, unë po të këshilloj rrugën time. A e sheh, atje tej është shpella e Zarathustrës. Shpella ime është e madhe dhe e thellë, ka shumë cepa, kushdo që do të fshihet më mirë aty do të gjejë strehën e vet.

Afër saj ka me qindra strehime sekrete e vende të fshehta për çdo zvarranik, kafshë fluturuese apo që ecën hopthi.

O i mërguar, që kërkon të jesh i mërguar, a nuk do vallë të jetosh më mes të njerëzve dhe mëshirimit njerëzor? Epo mirë, pra, bëj si unë, kështu edhe ti do të mësoje prej meje! Se, kush bën vetë, mëson. Para së gjithash, fol me kafshët e mia. Kafshët më krenare e më dinake janë ato që mund të na japin këshillat më të mira.

Kështu foli Zarathustra, e shkoi në udhën e vet, më i menduar e më ngadalë se më parë; e pyeste veten për shumë e shumë gjëra e probleme, por nuk arrinte dot të përgjigjej kaq lehtësisht. Sa i mjerë është njeriu, mendonte në zemër. Sa i shëmtuar, sa gulçues, sa plot i mbushur me turp. —

Thuhet se njeriu e duron vetveten. Medet, sa e madhe duhet të jetë kjo dashuri e vetvetes! Sa përçmim duhet të mposhtë!

Edhe ai atje e dashuronte, e përçmonte veten; për mua ai është një i dashuruar i madh, një përçmues i madh.

Nuk kam gjetur askënd që të kishte ndonjë përbuzje kaq të thellë: edhe kjo është lartësuese për të. Mjerë unë, mos vallë ky ishte Njeriu i Epërm, të cilit ia dëgjova britmën?!

Unë i dua përçmuesit e mëdhenj. Mirëpo, njeriu është diçka që duhet tejkaluar.

Lypësi vullnetar

Kur Zarathustra pati braktisur më të shëmtuarin e njerëzve, ndjeu të ftohtë dhe vetmi: ndjeu, pra, ti shkiste nëpër gjymtyrë shumë ftohtësi dhe vetmi, aq sa edhe pjesë të tjera të trupit nisën t'i ngrinin. Teksa po vazhdonte të ngjitej, gjithnjë duke u ngjitur e zbritur kullotave të blerta e luadheve të shkreta, aty ku kohëve të vjetra duhej të kishte vërshuar ndonjë rrëke, papritmas ndjeu sërish ngrohtësi dhe u bë i përzemërt.

“Ç’po më ndodh kështu? - pyeti. - Diçka e ngrohtë dhe jetësore po më gëzon, duhet të jetë në këto rrethina. Jam më pak i vetmuar; vëllezër e shokë më çikin në mënyrë të pandërgjegjshme, frymimi i tyre i ngrohtë po prek shpirtin tim.”

Por kur hodhi sytë rreth vetes, për të kërkuar ngushëlluesit e vetmisë së vet, ja tek vështroi disa lopë të mbledhura grumbull mbi një rrafshinë; ishte afërsia dhe kundërmimi i tyre që ia kish ngrohur zemrën.

Mirëpo, këto lopë dukeshin krejtësisht të përqendruara të dëgjonin një orator, ndaj nuk i treguan shumë interes mbërritjes së tij. Porsa Zarathustra iu afrua më shumë, dëgjoi me qartësi një zë njerëzor që fliste nga mesi i grupit të lopëve; shihej që ato i kishin kthyer kryet drejt tij.

Atëherë brofi me vullnet përpara dhe depërtoi midis kafshëve. Duke i shmangur nga njëra-tjetra, pasi pati frikë se mos ndonjëerës prej tyre i kish ndodhur ndonjë fatkeqësi, e mëshirimi i lopëve asaj mund t'i sillte shumë pak dobi. Por ishte gabuar se, pa shiko pak, një burrë i shtrirë përtokë dukej t'u fliste kafshëve, për t'i bindur se nuk duhet të kishin asnjë frikë prej tij; ishte paqësor, një predikues i maleve, të cilit mirësia ngjante t'i fliste edhe prej syve.

“Ç’kërkon këtu?” - i bërtiti Zarathustra me habi.

“Ç’kërkoj këtu? - iu përgjigj tjetri. - Të njëjtën gjë që kërkon ti, o gjithçkaprishës, lumturinë në tokë! Por, meqë jam këtu, do

të doja të kuptoja diçka për këto lopë, pasi ka një pjesë të mirë të mëngjesit që po flas me to; tash po arrinin të më thoshin diçka. Përse i shqetësoj? Derisa të mos konvertohemi e të bëhemi si lopët, nuk do të mbërrijmë në mbretërinë e qiejve. Një gjë duhet të mësojmë prej tyre: mbllaçitjen.

Se, në të vërtetë, njeriu edhe sikur të fitonte gjithë botën e të mos e mësonte këtë gjë, mbllaçitjen, për çfarë do t'i duhej gjithçka tjetër? Nuk do të çlirohej nga ankthi i tij, nga ankthi i tij i madh, që sot quhet neveri. Kush sot vallë nuk e ka zemrën, gojën dhe sytë gjithë neveri? Edhe ti! Edhe ti! Pa shikoj këto lopë!

Kështu foli predikuesi i malit e hodhi sytë nga Zarathustra, sepse gjer atëherë i kish mbajtur të përqendruar me aq dashuri ndaj lopëve. Por, në atë çast, ai ndryshoi pamje.

“Kush është ky, me të cilin po flas? - bërtiti i frikësuar dhe brofi përpjetë. - Ky është njeriu që s'ka neveri, ky është vetë Zarathustra, tejkaluesi i neverisë së madhe. Ky është syri, kjo është goja, është zemra e vetë Zarathustrës.”

E, ndërsa fliste kështu, vazhdonte t'i puthte duart atij, për të cilin fliste, me sytë e njomur e i turbulluar, si një njeri që sheh t'i zbresë papritur nga qielli një dhuratë e çmuar. Lopët, të habitura, e kundronin gjithë këtë skenë.

“Mos fol për mua ti, o krijesë e çuditshme e dashur! - tha Zarathustra e toni i zërit ia largoi butësinë. - Fol më mirë për veten! Nuk je vallë ai lypësi vullnetar, që një herë hodhi përtej vetes një pasuri të madhe, ai që kish turp nga pasuria e tij dhe nga të pasurit e mori arratinë te të varfrit, për t'iu dhuruar pasurinë e zemrës së vet? Po pavarësisht nga kjo, ata nuk e pranuan.

“Po, pavarësisht nga kjo, ata nuk më pranuan, - ia ktheu lypësi vullnetar. - E ditke mirë, ndaj përfundova te këto kafshë e te këto lopë.”

“Kështu mësove, - e ndërpreu Zarathustra, - se më e vështirë është të japësh se sa të marrësh e, se të dish të dhurosh është art, i mbarmi dhe më i rafinuar art mjeshtëror i mirësisë.”

“E çuditshme kjo, - u përgjigj lypësi vullnetar. - Pikërisht sot, kur gjithçka e ulët është ngritur lart në mënyrën e një batice të ndrojtur, kuptohet, të një batice plebe. Se ti e di, tashmë ka mbërritur ora e revoltës së madhe, së ngadaltës, së gjatës e dashakeqes revoltë të skllëverve dhe plebenjve: të një revolte që rritet gjithnjë e më shumë.

Tash ndodh që njerëzit e ulët zemërohen për çdo bamirësi dhe shprishje pa hesap. Ndaj të stërpasurit bëjnë mirë që të kenë kujdes!

Ata që sot, të ngjashëm me shishe barkfryra, pikojnë nga grykë shumë të ngushta, janë pikërisht ato shishe, të cilave u thyhet me qejf gryka.

Dëshirimi i zjarrtë i sojit të ulët, zilia hidhnake, shpirti i hidhur i hakmarrjes, krenaria plebe: e gjitha kjo më shpërtheu në fytyrë. Nuk është e vërtetë që të varfrit janë të bekuar. Mbretëria e qiejve gjendet mes lopëve. *sepse ata u blloqen.*

“E pse jo mes të pasurve?” - pyeti Zarathustra, teksa po ndalonte lopët që po i afroreshin miqësisht t’i mbanin erë paqësorit.

“Ç’po më tundon? - u përgjigj ai. - Ti e di më mirë se unë se ç’më shtyu drejt më varfanjakëve, o Zarathustra. Nuk ishte vallë neveria për të pasurit tanë? Për ata të dënuarit, për të qenë të pasur, që nxjerrin përfitime nga çfarëdolloj fëlliqësire, me sy të ftohtë, mendime të athëta, për të gjithë këtë llomështi, kutërbimi i së cilës arrin deri në qiell, për gjithë këtë sërë kallpe plebenjsh të praruar, baballarët e të cilëve qenë hajdutë me duar të shkathëta apo grabitqarë qelbësirëngrënës e koleksionues rreckash, me gratë e tyre mendjelehta, dëshirmtare, të pacipa: ka pak dallim mes tyre dhe bishtpërdredhurave.

Plebe lart e plebe poshtë! Kush është sot “më i varfëri” dhe “më i pasuri”? Për dallimin në mes tyre e kam humbur kujtesën, ndaj ika larg, sa më larg, derisa mbërrita te këto lopë.

Kështu foli paqësori, duke i marrë erë ajrit e duke djersitur, teksa fliste, aq sa lopët u habitën sërish. Mirëpo, Zarathustra vazhdonte t’i shihte gjithnjë me buzëqeshje në fytyrë, edhe pse

fliste me kaq ashpërsi e tundte herë pas here kokën.

“Ti je dhunues i vetvetes, o predikues i maleve, duke shqiptuar fjalë kaq të rënda! Nuk e ke gojën të përshtatshme për një ashpërsi të tillë, as syrin. Madje, mendoj se nuk ke as stomak të përshtatshëm; të bën keq gjithë ky zemërim, urrejtje e shkumëzim inati. Stomaku yt do gjëra më të buta: nuk je kasap. Më shumë më ngjan me një pemë-mbjellës apo herbarist. Ndoshta përtyp edhe kokrra gruri. Por padyshim, se je i huaj nga kënaqësitë e mishit, se të pëlqen mjalti.”

“Këtë gjë e ke pikasur, - iu përgjigj lypësi vullnetar më i lehtësuar në zemër. - Unë e pëlqej mjaltin, përtyp edhe kokrra gruri, sepse kërkoj atë që ka shije të këndshme dhe e bën frymimin të pastër, atë që kërkon më shumë kohë, ditë të tëra e të mundshme pune, për përtacët paqësorë dhe hajdutët e çikërrimave. Por këto lopë kanë bërë gjithçka më mirë nga të tjerët, kanë mësuar mbllaçitjen dhe të ndenjurin e bekuar në diell, duke u shmangur nga të gjitha ato mendime të këqija, që ta plasnin zemrën.”

“Mirë, pra, - tha Zarathustra. - Duhet të shohësh edhe kafshët e mia, shqiponjën dhe gjarprin tim; me ta nuk krahasohet asgjë mbi tokë. Shiko atje tej, ku rruga të shpie në shpellën time; ji miku im këtë natë. Fol me kafshët e mia mbi lumturinë e kafshëve, gjersa të kthehem unë, sepse tash një britmë dhimbjeje po më thërret me ngut larg prej teje. Tek unë do të gjesh edhe mjaltë të ri, mjaltë të freskët dylli: haje. Ndaj, ndahu tash shpejt nga lopët e tua, o i shtrenjti im, edhe pse të vjen keq, sepse miqtë janë mjeshtërit më të dashur.”

“Me përjashtim të njërit, që unë e kam më të dashurin, - u përgjigj lypësi vullnetar, - je ti ai njeriu i mirë, më i mirë edhe se një lopë, o Zarathustra!”

“Larg! Larg prej meje! Ti lajkatar antipatik!” - briti Zarathustra me të keq. - Ç’po më miklon e turbullon me lavdet dhe mjaltin e lajkave të tua? Larg! Larg nga unë!” - briti sërish, duke tundur shkopin kundra lypësit të butë, i cili ia mbathi me të shpejtë.

Hija

Sapo lypësi vullnetar mori arratinë, Zarathustra mbeti përsëri vetëm, e atëherë dëgjoji brenda vetes një zë që i thërriste: “Nдалu, o Zarathustra! Nдалu, prit pra! Po, jam unë, o Zarathustra, unë, hija jote!”.

Mirëpo, Zarathustra nuk priti, sepse zotëruese e tij u bë një inat i papritur për gjitha atë popullim e turmëzimin përreth maleve të tij.

“Ku shkoi vallë vetmia ime? - tha. - Se për mua, e gjitha kjo është shumë; këto male gëlojnë, mbretëria ime s’është më e kësaj bote, unë kam nevojë për male të reja. Po më thërret hija ime? Po ç’më duhet hija ime! Le të vrapojë pas meje! Unë po iki.”

Kështu i foli Zarathustra zemrës së vet dhe u nis me ngut.

Po ai që i qëndronte mbrapa e ndoqi, kështu që shpejt u bënë tre në udhë: në krye lypësi vullnetar, pastaj Zarathustra dhe i treti e i fundit hija e tij. Nuk vijoi shumë gjatë, sepse Zarathustra nisi të mendonte për budallallëkun që kish bërë e, me një të tundur të shpatullave, largoi nga vetja çdo bezdi e përçmim.

“Si?! – tha, - Nuk kanë ndodhur vallë gjithmonë mes nesh, eremitëve të vjetër e të shenjtë, gjërat më të çuditshme? E tash dëgjoj gjashtë këmbë pleqsh budallenj që përplasen duke ndjekur njëra-tjetrën. Po a mund të ketë frikë Zarathustra nga hija? Tek e fundit, besoj se ajo i ka këmbët akoma edhe më të gjata se unë.”

Kështu foli Zarathustra, duke qeshur me shikimin e me gjithë brendinë e tij, pastaj u ndal e u kthye rrëmbimthi prapa, aq sa gati e përplasi përtokë ndjekësin e vet, pra hijen. Kaq afër ajo e ndiqte këmba-këmbës, edhe pse ishte e dobët. Sapo i hodhi një vështrim, Zarathustra u frikësua sikur të kish parë befas një fantazmë: kaq hollake, e nxirë, e kërrusur dhe e mbijetuar i dukej ndjekësja e vet.

“Kush je ti?, - pyeti dhunshëm Zarathustra! - Ç’bën këtu e përse quhesh hija ime? Nuk më pëlqen.”

“Më fal, - u përgjigj hija, - që jam e tillë e që nuk të pëlqej, o Zarathustra! Ja pse të lëvdoj ty dhe shijen tënde të mirë! Unë jam veçse një shtegtare që të ka ndjekur aq gjatë, hap pas hapi. Gjithmonë nëpër rrugë, por pa qëllim, pa shtëpi; kështu që vetëm pak më mungon të quhem çifuti shëtites, vetëm se nuk jam e përjetshme dhe nuk jam çifut. “Si? Unë duhet të jem gjithmonë nëpër rrugë? E ngritur mbi krahët e çdo ere, endacake e tejflakur? O tokë, për mua shumë e rrumbullakët je! Të jam ulur në çdo sipërfaqe, e ngjashme me një pluhur të lodhur kam fjetur nëpër pasqyra e nëpër xhamat e dritareve: të gjithë marrin prej meje, askush nuk më jep, ndaj unë dobësohem e dobësohem; gati ngjaj me një hije.

Po unë fluturova drejt teje, o Zarathustra e të ndoqa më gjatë se çdokush tjetër, madje edhe pse t’u fsheha, për të mos më njohur, përsëri isha hija jote më e mirë. Kudo, sapo ti uleshe, ulesha dhe unë.

Me ty shkova në më të largëtat e të ftohtat botë, e ngjashme me një fantazmë që bredh me dëshirë mbi dëborë e mbi çatitë dimërore. Me ty kërkova të depërtoja në gjithçka që ishte e ndaluar, e keqe, e pakapshme. Nëse brenda meje ka një grimë virtyti, kjo konsiston në faktin se unë nuk kam frikë nga asnjë shtrëngesë.

Me ty theva gjithçka që zemra ime adhuronte, hodha përmbys gjithë gurët e sinorëve dhe statujat, shkova pas të gjitha dëshirimeve të mia më të rrezikshme; rashë kështu një herë në të gjitha mëkatet.

Me ty ç’mësova besimin tek fjalët, vlerat dhe emrat e mëdhenj. Kur djalli ndërron lëkurë, nuk humbet vallë edhe emri i tij? Sepse dhe ai ndoshta është lëkurë. Djalli është vërtet lëkurë. “Asgjë s’është e vërtetë, gjithçka është e lejuar.” Kështu i thashë vetes. Në ujërat më të ftohta u fundosa bashkë me kokën dhe zemrën. Medet, sa shpesh mbeta atje lakuriq e i kuq si një gaforre!

Medet, ku shkoi vallë e gjithë e dashamirësia ime, droja dhe besimi te të mirët! Medet, ku është ajo pafajësi e fshehur që

zotëroja një ditë, pafajësia e të mirëve dhe e gënjeshtreve të tyre fisnike!

Shumë shpesh, në të vërtetë, kam ndjekur hap pas hapi të vërtetën; së fundi, ajo ma vendosi thembrën mbi kokë. Disa herë mendova edhe ta gënjeja, kur ja, pikërisht atëherë e rroka të vërtetën.

Shumë gjëra m'u zhvilluan: tashmë nuk më intereson asgjë. Asgjë s'rron më shumë se ajo që unë dua. Si mund ta dua vallë akoma vetveten?

Të jetoj ashtu siç më pëlqen, ose të mos jetoj më: kështu dua, kështu do edhe më i shenjti.

Po medet! Si mund të provoj vallë kënaqësi?

A kam vallë ndonjë qëllim? Një port, ku të drejtohet anija ime? Një erë të mbarë? Medet, veç ai që di se ku të shkojë, di edhe se cila është era e mbarë dhe era e duhur.

Ç'më ka mbetur akoma? Një zemër e lodhur dhe e pacipë; një vullnet i papërqendruar; krahë të shpupuritur; një shtyllë kurrizore e thyer.

Ky kërkim i një shtëpie time, o Zarathustra, ti e di mirë, ky kërkim ka qenë dënimi im që më përpiu.

Ku është shtëpia ime? Këtë pyes e kërkoj e kërkoj, por nuk e gjej. O e përjetshmja "kudo", o e përjetshmja "në asnjë vend", o e përjetshmja "më kot"!

Kështu foli hija e fytyra e Zarathustrës, me të dëgjuar këto fjalë u për zgjat.

"Ti je hija ime, - tha më në fund, me trishtim. - Rreziku yt nuk është i vogël, o shpirt i lirë shëtites! Ke kaluar një ditë të keqe, por kujdes mos të mbërrijë ndonjë mbrëmje edhe më e keqe!

Të paqëndrueshmëve, si puna jote, në fund, edhe një burg u duket i bekuar. A i ke parë ndonjëherë se si flenë kriminelët pasi kapen? Flenë qetë e shtruar, sepse shijojnë sigurinë e tyre të re.

Kujdes, mos bëhesh pre e një besimi të kufizuar, e një marrëzie të ashpër dhe të rreptë! Se, në të vërtetë, të josh e të

tundon vetëm ajo që është e kufizuar dhe e qëndrueshme.

E ke humbur qëllimin? Medet, si do të ngushëlloheshe vallë për diçka që e ke humbur për fajin tënd? Me të ti ke humbur edhe rrugën!

E mjera endacake e mendjelojtur, e lodhura flutur! A do të kesh vallë këtë mbrëmje çlodhje dhe strehim? Atëherë, shko atje te shpella ime!

Nga kjo anë rruga të shpie në shpellë. Tani dua të iki me ngut nga ty; si një hije tash po nderesh mbi mua.

Dua të iki vetëm, që përreth meje gjithçka të qartësohet përsëri. Për këtë duhet të jem i hareshëm e akoma gjatë më këmbë, se në mbrëmje tek unë do të vallëzohet!”

Kështu foli Zarathustra.

Në mesditë

E Zarathustra vrapoi e vrapoi, po nuk gjeti më askënd, kështu që i vetëm e rigjeti gjithnjë e më shumë veten, e gëzoi dhe e shijoi më mirë vetminë, duke menduar për gjëra të bukura, për orë të tëra. Por aty nga mesdita, kur dielli i digjte tamam mbi kokë, Zarathustra kaloi përballë një peme të vjetër, të përkulur e me gunga, përreth së cilës përdridhej duke e përqaftuar e gjithë dashuria e madhe e një hardhie, që dukej sikur e fshihte të tërën; prej saj vareshin kah shtegtarit aq shumë veshtujt verdhë rrushi. Atëherë iu ndez dëshira ta shuante pakëz etjen e të shijonte një veshtull rrush; po teksa zgjati dorën iu ndez një dëshirë akoma dhe më e madhe për diçka tjetër: të shtrihej ndanë asaj peme, bash në orën e mesditës së plotë, e të flinte.

E Zarathustra kështu bëri; sapo u shtri përtokë, në heshtjen dhe fshehtësinë e barit shumëngjyrësh, harroi edhe etjen e tij të vogël e ra në gjumë. Se, ashtu siç thotë një proverb i Zarathustrës, një gjë është më e domosdoshme se

tjetra. Vetëm se sytë i mbetën hapur; ato, në fakt nuk qenë kurrë të ngopur së pari dhe admiruari pemën dhe dashurinë e hardhisë. Po pastaj, teksa dremiste, Zarathustra i foli kështu zemrës së vet:

“Hesht! Hesht! Në këtë moment bota nuk është bërë vallë e përsosur? Çfarë po më ndodh? Ashtu si një erë e këndshme, e padukshme, vallëzon mbi një det të shtruar, lehtë, lehtë si një pupël, po ashtu vallëzon gjumi mbi mua.

Nuk më mbyllen sytë që shpirti të më rrijë zgjuar, por ai është i lehtë si një pupël. Më bind; nuk di se si, më prek shkarazi me një dorë ledhatuese, madje dhe më shtrëngon. Po, më shtrëngon ëmbëlsisht, që unë ta shtriq gjithë shpirtin tim: kështu përzgjatet e lodhet, ky i çuditshmi shpirt. Pikërisht, në mesditë, mbërriti për të mbrëmja e ditës së shtatë? Vallë pat shtegtuar për një kohë të gjatë mes gjërave të mira e të pjekura?

U shtriq akoma dhe më gjatë, u shtriq tërësisht e u dergj i heshtur, ky shpirti im i çuditshëm. Ka shijuar aq shumë gjëra të mira, ky trishtim i praruar e shtyp, ia përdredh gojën.

Si një anije që arrin në portin e saj të qetë, ajo shkon të zbarkojë në tokë, e lodhur nga endja e gjatë dhe nga detet e pasigurt. Nuk është vallë toka më besnike?

Kur një anije e tillë mbërrin në stere, ajo zbarkon e shtrëngohet fort pas saj, aq sa veç një merimangë mund ta thurë cergën e vet nga bregu tek ajo e të mos ketë më nevojë për fije më të forta. Si kjo anije në portin e vet më të qetë, kështu dhe unë do të pushoj sot pranë tokës besnik, gjithë besim në pritje, lidhur pas saj me fijeat më të lehta.

O lumturi! O lumturi! A do vallë të këndosh, o shpirti im! Ti dergjesh në bar, por kjo është orë sekrete dhe solemne, atëherë kur asnjë bari nuk e kumbon fyellin e vet.

Respektoje! E ngrohta mesditë po fle fushave! Mos këndo! Hesht! Bota është e përsosur.

Mos këndo, o zog që endesh mbi bar, o shpirti im! Madje, as

mos pëshpërit! Shih, është kaq qetësi! Antikja mesditë fle, lëviz gojën: a s'po pi ajo në këtë moment ndonjë pikë lumturie? Një pikë antike brune e një lumturie të praruar, të një vere të praruar? Diçka dembeloset përmbi të e lumturia e tij qesh. Kështu qesh vetëm një Zot. Heshtje!

“Për fat, kaq pak i mjafton lumturisë! Kështu thosha një ditë e më dukej vetja i mençur. Por ishte blasfemi: tash e kuptova. Të marrosurit inteligjentë flasin më mirë. Nga ajo që është më e vogla, më e shtypura, më e lehta, një fëshfërimë hardhuce, një pëshpërimë, një vetëtimë, një rrahje qepallash: ja nga kaq pak gjë është mbujtur lumturia më e arrirë! Heshtje! Ç'po më ndodh, pa dëgjo! Mos koha fluturoi tej? Nuk po bie vallë? Nuk u rrëzova, dëgjo! Në pusin e përjetësisë?

Ç'po më ndodh? Heshtje! Diçka më ther, medet, në zemër! Në zemër! Oh copëtohu, copëtohu, zemër, pas një lumturie të tillë, pas një **shpimi** të tillë!

Si? Bota s'është bërë vallë e përsosur në këtë moment? E kolme dhe e pjekur? Oh, e rrumbullakëta unazë e praruar, ku fluturon? Unë po vrapoj pas teje! Shpejt!

Heshtje! (Në këtë moment, Zarathustra gërhiti e ndjeu se po flinte)

“Ngrehu!, - i tha vetes, - ti o gjumash i mesditës! Përpara, pra, o këmbë të plakura! Është koha të shkojmë, ju mbetet ende një rrugë e gjatë për të bërë.

Tashmë keni pushuar, po për sa gjatë? Një gjysmë përjetësie! Përpara, pra, o zemra ime e vjetër! Sa kohë të duhet të zgjohesh nga një gjumë i tillë?

(Po, ndërkaq ai dremiti përsëri, e ishte shpirti i tij ai që fliste kundra e që e kundërshtonte aq fort.)

Lërmë, pra! Heshtje! Bota s'është bërë vallë e përsosur në këtë moment? Oh topi i artë dhe i rrumbullakët!

Ngrehu, - tha Zarathustra, - o hajdute e vockël e përtace! Si? Do të doje të gërhisje gjithmonë, të gromësisje, të pëshpëritje e të gremiseshe nëpër puse të thellë?

Po kush je vallë? Oh shpirti im! (Këtu ai brofi përpjetë, sepse një reze dielli, e dalë nga qielli, e goditi drejt e në fytyrë.)

Oh qiell sipër meje, - tha duke pëshpëritur e duke u ulur përtokë. - Ti më sheh vallë? A e dëgjon këtë shpirtin tim të çuditshëm?

Kur do ta pish këtë pikë vese që ra mbi të gjitha gjërat tokësore, kur do ta pish këtë shpirt të çuditshëm, kur vallë, o burim i përjetësisë? Humnerë e qetë dhe e tmerrshme e orës së mesditës! Kur do ta ripish brenda vetes shpirtin tim?"

Kështu foli Zarathustra e u ngrit nga vendi i vet pranë pemës, si prej një dehje të panjohur; ndërkohë, dielli tashmë ishte ngjitur sipër kokës së tij. Dikush nga kjo mund të mendonte me të drejtë se Zarathustra nuk kishte fjetur gjatë.

Përshëndetja

Ishte pasdite e vonë, kur Zarathustra, pas një endje e kërkimi të gjatë e të kotë, u kthye në shpellë. Por, kur arriti përballë saj, jo më larg se njëzet hapa, ndodhi ajo që ai s'e priste aspak: dëgjoji përsëri një piskamë të fortë ndihme. Po, për çudi, kësaj here ajo vinte nga vetë shpella e tij. Ish një thirrje më e gjatë, e shumëfishtë dhe e veçantë. Zarathustra e dallooi qartë që përbëhej nga shumë zëra; edhe pse, nga larg, dëgjohej e kumbonte si e britur nga një gojë e vetme.

Atëherë brofi te shpella, kur ja! Ç'spektakël i tërë e priste pas asaj që sapo kish dëgjuar! Të gjithë rrinin të ulur përreth, njëri afër tjetrit, të gjithë ata, me të cilët ish takuar gjatë ditës: mbreti i së djathtës dhe mbreti i së majtës, magjistari plak, papa, lypësi vullnetar, hija, i ndërgjegjësuar i shpirtit, profeti i trishtë dhe e ish mbështjellë me dy brezore të purpurta, sepse dëshironte, si të gjithë të shëmtuarit, të vishej e të dukej i bukur.

Në mes të gjithë kësaj shoqërie të tronditur qëndronte shqiponja e Zarathustrës, e gafruar dhe e shqetësuar, sepse duhej t'u përgjigjej shumë gjërave, ndaj të cilave krenaria e saj nuk gjente dot përgjigje; e gjarpri dinak vazhdonte t'i varej mbi qafë.

Ja, gjithë këtë pa Zarathustra me shumë habi; pastaj nisi të këqyrte secilin prej miqve me një kuriozitet të hareshëm, lexoi në shpirtrat e tyre e u befasua sërish. Ndërkaq, të gjithë ata qenë ngritur nga shtrojat, duke pritur me respekt se çdo të thoshte Zarathustra. E Zarathustra foli kështu:

“Ju të dëshpëruar! Ju krijesa të çuditshme, mos vallë dëgjova britmën tuaj të dhembjes?! Tashmë e di edhe se ku duhet ta kërkoj atë që gjer më sot kërkoja më kot: Njeriun e Epërm; rri ulur këtu në shpellën time, Njeriu i Epërm! E përse duhet të habitem? Nuk e josh vallë drejt meje me mjaltë e me shijen dinake të lumturisë sime?!

Gjithsesi, mua më duket se ju nuk krijoni një shoqëri të mirë, ia hidhëroni zemrën njëri-tjetrit me britmat tuaja të dhimbjes, teksa rrini këtu së bashku. Duhet shtuar një tjetër, një që t'ju bëjë sërish për të qeshur, një qejfli i hareshëm, një kërcimtar për së gjati e për së larti, një i çmendur plak. Hë, si thoni?

Falmëni, o të dëshpëruar, nëse ju flas me këto fjalët e mia të vockla, të padenja për miq të tillë! Po ju nuk e dini se ç'e bën të guximshme zemrën time: jeni ju vetë dhe shfaqja juaj; folmëni! Çdokush merr kurajë, duke parë dikë që dëshpërohet. Ti flasë një të dëshpëruari është diçka, për të cilën çdokush ndihet goxha i fortë. Mua ma dhuroat forcën ju, ajo dhuratë e shtrenjtë që më bëtë, o miqtë e mi fisnikë! Një dhuratë të posaçme për këtë rast! Epo mirë, atëherë mos u shqetësoni që edhe unë t'ju dhuroj diçka timen.

Kjo është mbretëria ime dhe zotëria ime. Por ajo ç'ka është imja këtë mbrëmje e për këtë natë, duhet të jetë edhe juaja. Kafshët e mia duhet t'ju shërbejnë: shpella ime qoftë dhoma juaj e pushimit!

Në shtëpinë tme askush nuk duhet të dëshpërohet, në strehën time unë mbroj gjithkënd nga kafshët e tij të egra. Ja, kjo është gjëja e parë që ju afrojmë: sigurinë.

Gjëja e dytë është gishti im i vogël; kur ta keni, merreni edhe gjithë dorën, patjetër, madje edhe zemrën! Mirë se erdhët këtu, mirë se erdhët, o bujtësit e mi!”

Kështu foli Zarathustra e qeshi prej dashurisë dhe ligësisë. Pas kësaj përshëndetje, bujtësit u përkulën edhe një herë, duke heshtur me respekt. Mbreti i së djathtës iu përgjigj në emër të të gjithëve.

“Për faktin se ti, o Zarathustra, na ofron dorën dhe përshëndetjen, të njohim pikërisht si Zarathustra. Ti përkulesh para nesh; gati sa na e plagose dhe respektin. Po kush vallë do të përkulej si ty me kaq krenari? Kjo na lehtëson e është ngushëllim për sytë e për zemrat tona.

Veç për të parë gjithë këtë skenë, do t’ia kish vlejtur ngjitja jonë në male edhe më të larta se këto. Kemi ardhur pikërisht për të parë, sepse donim të shihnim se ç’gjë mund t’i qartësojë sytë e turbulluar.

Dhe ja, kur gjithçka tashmë pushoi, gjithçka që kish sjellë britmën tonë të dhimbjes. Tashmë ndijimet tona u çelën, bashkë me zemrën nga entuziazmi. Mungon veç pak që kuraja jonë të marrë flatra.

Asgjë, o Zarathustra, s’është më ngushëllues në tokë se sa një vullnet i fortë dhe i lartë: ai është një bimë e bukur. Një peizazh i tërë mund të jetë i gëzuar që sipër tij të rritet një pemë e tillë.

Me një pishë, unë i krahasoj ata që rriten si ty, o Zarathustra: të lartë, të heshtur, të fortë, vetmitarë, me drurin më të mirë për t’u lakuar, të mrekullueshëm. Së fundi, edhe e ndehur me degët e saj të forta e të blerta drejt hapësirës së zotërimeve të tua, ajo lëshon pyetjet e saj të vështira erërave dhe stuhive, e gjithçkaje që ngjan me lartësitë; duke u përgjigjur akoma dhe më fort si një sundues, si një fitimtar. E kush vallë nuk do të ngjitej maleve të larta për të kundruar pemë të këtij lloji?

Te kjo pemë, o Zarathustra, ushqehet edhe ai që e ka shpirtin e zymtë, ai që ka humbur udhën; me këtë pamje edhe i shqetësuari bëhet i sigurt dhe e shëron zemrën e vet. Se vërtet, sot drejt malit dhe pemës tënde po kthehen aq shumë sy; një nostalgji e madhe është çelur në zemra, e shumë kanë nisur të pyesin: po kush është vallë Zarathustra?

E atyre që një kohë ti u pikove në vesh këngën dhe mjaltin tënd, të gjithë skuta-fshehurit, vetmitarët, endacakët, i kanë thënë befaz zemrës së tyre se “A jeton akoma Zarathustra?”. Nuk ia vlen më të jetojmë, gjithçka është e njëjtë, gjithçka është e kotë, po të mos jetojmë me Zarathustrën.

Përse nuk vjen vallë ai që është paralajmëruar që prej shumë kohësh? Pyesin aq shumë të tjerë. Mos e ka gëlltitur vetmia, apo mos duhet që të shkojmë ne tek ai?

Tash po ndodh që vetë vetmia të kalbet e të plasarit, si një varr që hapet e që s'arrin t'i mbajë dot të vdekurit e vet. Kudo shihen të ringjallurit.

Tash dallgët po lartësohen e lartësohen rreth malit tënd, o Zarathustra. Pavarësisht se lartësitë e tua janë të zgjedhura, shumë njerëz duan të arrijnë gjer aty: anija jote nuk duhet të ngelet ende në stere.

Fakti që ne të dëshpëruarit erdhëm deri në shpellën tënde dhe nuk kemi për t'u dëshpëruar më, është një shenjë dhe një paralajmërim se njerëzit më të mirë po vijnë, madje edhe ata që përbëjnë mbeturinën e fundit të Zotit midis njerëzve; d.m.th të gjithë njerëzit e nostalgjisë së madhe, të neverisë së madhe, të gjithë ata që nuk duan të jetojnë e që, ose do të mësojnë sërish të shpresojnë, ose do të mësojnë prej teje, o Zarathustra, shpresën e madhe!”

Kështu foli mbreti i së djathtës e kapi dorën e Zarathustrës për ta puthur. Por Zarathustra u mbrojti nga ky nderim e brofi i trembur nga prapa, duke heshtur për një çast, si të fluturonte drejt largësive të mëdha. Por pas pak çastesh ai ishte përsëri me

shpirt pranë bujtësve të vet, duke i vështruar me sy të qartë e pyetës e duke u thënë:

“Bujtësit e mi, juve o njerëz të epërm, dua t’ju flas me një gjermanishte të pastër. Nuk jeni ata që prita në këto male!

(Me një gjermanishte të pastër? Zoti na ndihmoftë! Klithi në këtë çast mbreti i së majtës për llogari të vet. Duket që ai nuk i njeh këta të shtrenjtit gjermanë, këta lloj njerëzish orientalë. Po nëse donte të thoshte “ashpër dhe gjermanisht”, epo mirë, sot kjo nuk është gjëja më e keqe.)

Të gjithë së bashku mund të jeni njerëz të epërm, - vijoi Zarathustra, - por për mua, nuk jeni aq të fortë e aq të mëdhenj.

Për mua, d.m.th. për të pashtershmen që hesht brenda meje, por që nuk do të heshtë në përjetësi. E nëse ju më përkisni mua, nuk më përkisni si krahu im i djathtë. Kush, në të vërtetë, qëndron mbi këmbë të dobëta e të sëmura, i ngjashëm me ju, gjëja e parë që do, qoftë duke e ditur, qoftë duke kërkuar ta injorojë, është që të kursehet. Por unë nuk i kursej krahët edhe këmbët e mia, nuk i kursej as luftëtarët e mi. Si mundeni ju vallë t’i shërbeni luftës sime? Me ju unë shkatërroj çdo fitore. Ndokush prej jush mund të rrëzohej, nëse nuk do të dëgjonte zhurmërimën e fortë të daulleve të mia.

Për mua ju nuk jeni aq të bukur e të fort-lindur. Unë kam nevojë për pasqyra përsosmërisht të qarta për doktrinën e mia; në syprinën tuaj deformohet edhe imazhi im. Shpatullat tuaja janë të rënduara nga pesha e kujtime; në skutat tuaja kërcejnë shkurtabiqë të këqij. Ka plebenj të fshehur edhe te ju. Edhe pse jeni shtatlartë e të sojit më të mirë, shumë brenda jush është e shtrembër dhe e mbujtur keq. Nuk ka farkëtar në botë që mund t’ju korrigjojë e t’ju bëjë të drejtë.

Ju jeni veçse fragmente, që më të lartët se ju t’ju kalojnë sipër. Ju jeni si shkallët: mos u zemëroni, pra, me atë që ngjitet drejt lartësisë së tij duke kaluar sipër jush! Nga fara juaj mund të lindë edhe një bir siç duhet për mua dhe një trashëgimtar i përkryer;

por kjo është një gjë e largët. Edhe ju vetë nuk jeni ata, të cilëve u përket trashëgimia dhe emri im. Nuk jeni ju ata që prisja në këto male, por me ju dua të kryej për herë të fundit zbritjen time. Për mua ju jeni shenjat paralajmëruese të faktit se të tjerë, më të lartë, janë në udhë drejt meje: jo njerëzit e nostalgjisë së madhe, e përçmimit të madh, e ngimjes së madhe, as ata që ju i quani mbetja e fundit e Zotit, Jo! Jo! Tri herë Jo! Të tjerë unë pres në këto male, e nuk dua të bëj asnjë hap pa ata, më të lartët e më të fortit, më fitimtarët, më të qetët, më të mirë-ndërtuarit në trup e në shpirt: luanë të hareshëm duhet të mbërrijnë tek unë.

O bujtësit e tij, ju, qenie të çuditshme, nuk keni dëgjuar asgjë për fëmijët e mi? As që ata janë në udhë drejt meje? Folmëni, pra, për kopshtet e mi, për ishujt e mi të lumtur, për sojin tim të ri e të bukur. E përse vallë nuk më flisni për këtë?

Kjo është dhurata e mikpritjes që unë pres nga dashuria juaj, që të më flisni për bijtë e mi. Për këtë unë jam i pasur, për këtë unë u bëra i varfër, E ç'nuk dhashë, e ç'nuk do të jepja të kisha një gjë të vetme: këta bij, këtë plantacion të gjallë, këto pemë të jetës së vullnetit tim e të shpresës sime më të lartë!”

Kështu foli Zarathustra dhe e ndali ligjërimin e vet, sepse u mbërthye nga nostalgjia, duke mbyllur sytë dhe gojën përpara gufimit të zemrës së vet. Edhe të gjithë bujtësit e tij heshtën e qëndruan të emocionuar në heshtje; vetëm profeti plak bënte shenja me gjeste e me duar.

Darka e shenjtë

Në këtë moment, profeti e ndërpreu përshëndetjen e Zarathustrës me bujtësit e vet, doli përpara si dikush që nuk ka më kohë për të humbur, mbërtheu dorën e Zarathustrës dhe bërtiti: O Zarathustra! Por një gjë është më e domosdoshme se sa tjetra, e thua ti vetë: kështu që, për mua, një gjë tash është më

e domosdoshmja se çdo gjë tjetër. Një fjalë e thënë në momentin e duhur; nuk më ftove për darkë, e këtu përreth ke shumë që kanë bërë një rrugë të gjatë. Nuk do vallë të na shuash urinë me ligjërimet e tua? Keni menduar të gjithë për të ftohtit, për mbytjen, për frymëzënin a për situata të tjera dramatike, por askush nuk u kujtua për dramën time, atë të vdekjes nga uria.

(Kështu foli profeti e, sapo kafshët e Zarathustrës dëgjuan këto fjalë, ia mbathën me të shpejtë nga frika, sepse kuptuan se, pavarësisht aq shumë gjërave që kishin sjellë në shtëpi gjatë ditës, përsëri ato nuk do të mjaftoni ta shuanin urinë e profetit).

“Mund të vdesësh edhe nga etja, - vazhdoi profeti. - Po edhe pse këtu ndiej të vërshojë ujë, nga këto ligjërata të mençurisë, pa mbeturina e pengesa të lodhshme, unë për vete do të doja verë.

Jo të gjithë janë si Zarathustra, pirës të lindur të ujit. Uji nuk mjafton për njerëzit e lodhur e të rraskapitur: ne na duhet verë; ajo të sjell menjëherë shëndet e rizgjim.” Në këtë moment, meqë profeti kërkoi verë, mbreti i së majtës, i heshturi, nisi dhe ai të flasë.

“Sa për verën, - tha, - kemi menduar ne, unë dhe im vëlla, mbreti i së djathtës. Verë kemi boll, një gomar të ngarkuar plot. Na mungon veç buka.”

“Buka?, - u përgjigj Zarathustra dhe qeshi. - Vetëm bukë që eremitët nuk kanë. Por njeriu nuk rron vetëm me bukë, por dhe me mish të mirë qengji; unë kam dy të tillë; ata duhet menjëherë të theren e të përgatiten me erëza dhe sherbelë: kështu më pëlqejnë. Edhe rrënjë e fruta ka me bollëk, për çdo lloj llupësi e nepsqari; ka dhe arra e **enigma** të tjera për t'u shkërmoqur. Duam, pra, të bëjmë një darkë të mirë? Po ai që do të darkojë me ne duhet të punojë, edhe mbretërit. Me Zarathustrën, edhe një mbret mund të jetë kuzhinier.”

Me këto premtime, të gjithë filluan të jenë të kënaqur; vetëm lypësi vullnetar ishte kundra mishit, verës dhe rrënjëve.

“Pa dëgjojeni pak, këtë prishanik, Zarathustrën!, - tha duke bërë shaka. - A mos shkon vallë nëpër male e shpella për të

organizuar darka të tilla? Tash e kuptoj se ç' donte të thoshte ku njëherë na mësoi se: qoftë e lëvduar e vockla mizerie. Donte t'i largonte nga vetja lypsarët."

"Qetësohu, - ia ktheu Zarathustra, - ashtu siç po bëj unë. Vazhdo e bëj sipas zakoneve të tua, o njeri i mirë, përtyp kokrra gruri, pi ujë e lëvdo gjellët e tua të parapëlqyera, nëse kjo të bën të kënaqur!

Unë jam ligjvënës për njerëzit e mi, por jo për të gjithë. Ai që më përket duhet t'i ketë kockat e forta e këmbët e lehta, i gatshëm për luftë e për festa, e të mos jetë i përgjumur, i topitur dhe ëndërrimtar; i gatshëm, si për gjërat më të vështira ashtu edhe për gëzimet, i shëndetshëm e i fortë.

Gjërat më të mira më takojnë mua dhe njerëzve të mi; nëse nuk na i japin, ne përsëri do t'i marrim: ushqimin më të mirë, qiellin më të kulluar, mendimet më të forta dhe gratë më të bekuara.

Kështu foli Zarathustra, por mbreti i së djathtës u përgjigj:

"E çuditshme! A janë dëgjuar vallë gjëra më të zgjuara nga goja e një të urti? Se, në të vërtetë, gjëja më e çuditshme te një i urtë është që ai të jetë i zgjuar, dhe jo gomar".

Kështu foli mbreti i së djathtës dhe u habit, teksa gomari i shtoi ligjërimin të tij pa dëshirë, edhe një pëllitje I-A. Kjo ishte në përgjithësi fillimi i asaj ngrënie të gjatë, që në librat e historisë quhet "Darka e shenjtë". Aq më tepër, që në të nuk u fol për asgjë tjetër, përveç Njeriut të Epërm.

Për Njeriun e Epërm

1.

Kur erdha për herë të parë mes njerëzve, bëra një budallallëk të denjë për eremitët, një budallallëk të madh: u sula te sheshi i tregut.

E ndërsa i flisja të gjithëve, nuk i flisja askujt. Në mbrëmje miqtë e mi qenë palaçot dhe kufomat, madje dhe unë vetë isha bërë si një kufomë.

Me të ardhur mëngjesi i një dite të re, më mbërriti një e vërtetë e re, ku mësova të thosha: “Ç’më duhet tregu i plebenjve, zhurmërima e plebenjve dhe veshët e tyre të gjatë?”.

“O Njerëz të Epërm, mësojeni këtë gjë nga unë: në treg askush nuk u beson Njerëzve të Epërm! Nëse doni të flisni, atëherë plebenjtë do t’ua shkelin syrin, duke ju thënë: “Jemi të gjithë të barabartë”.

“O Njerëz të Epërm, - duket të thotë me shaka plebeu. - Nuk ekzistojnë Njerëzit e Epërm, ne jemi të gjithë të barabartë, njeriu është njeri. Para Zotit jemi të gjithë të barabartë!”

Para Zotit! Po tash ky zot ka vdekur. Përpara plebenjve ne nuk duam të jemi të barabartë. O Njerëz të Epërm, largohuni prej tregut!

2.

Para Zotit! Po tash ky Zot ka vdekur! O Njerëz të Epërm, ai Zot ishte rreziku juaj më i madh!

Veç tani, kur ai dergjet në varr, ju jeni ringjallur përsëri. Veç tani ka mbërritur Mesdita e Madhe, veç tani Njeriu i Epërm është bërë padron!

Ai i kuptoni këto fjalë, o vëllezër? Ju jeni të frikësuar, zemrat tuaja janë pre e marramendjes? Po ju shpaloset një humnerë e thellë? Iu leh prapa krahëve qeni i skëterrës?

Forca, pra, ngrihuni o njerëz të epërm! Veç tani mali po pjell të ardhmen e njeriut. Tashmë, Zoti ka vdekur që të rrojë Mbinjeriu.

3.

Më dyshimtarët sot pyesin: Si mund të ruhet njeriu? Mirëpo, vetë Zarathustra është i pari dhe i vetmi që pyet: “Si mund të tejkalohet njeriu? Mbinjeriun e kam për zemër, kjo është gjëja ime e parë dhe e vetme, e jo njeriun: jo i afërmi, jo i varfëri, jo i vuajturi, jo më i miri.

Vëllezër, ajo ç'ka dashuroj te njeriu është se ai është një urë dhe një perëndim. Edhe te ju ka shumë gjëra që më bëjnë të shpresoj e të dashuroj.

Që ju përçmoni, o Njerëz të Epërm, kjo më bën të shpresoj. Përçmuesit e mëdhenj, në të vërtetë janë adhuruesit e mëdhenj.

Fakti që ju dëshpëroheni është gjë për t'u nderuar. Nuk keni kuptuar ende se si të dorëzoheni, as keni mësuar dredhitë e vockla të maturisë. Sot, në të vërtetë, padronë janë bërë njerëzit e vegjël: ata predikojnë njëzëri përkushtim, modesti, dinakëri, zell, respekt e një varg të tërë virtytësh të vogla.

Gjithçka e natyrës femërore, gjithçka që rrjedh nga një racë servile, e përzierë veçanërisht me plebenjtë, kjo është ajo që kërkon të bëhet sot Zot i çdo fati njerëzor. Ç'neveri! Ç'neveri! Ç'neveri!

Bëhen pyetje pa fund, pa u lodhur kurrë: "Si mund të ruhet njeriu në mënyrën më të mirë, sa më gjatë e sa më të pëlqyeshme? Me të gjitha këto, ata janë padronët e sotëm.

Tejkalojini, o vëllezër, këta padronë të sotëm, këta njerëz të vegjël! Ata janë rreziku më i madh për Mbinjeriun!

Tejkaloni, o Njerëz të Epërm, të voglat virtyte, të voglat maturi, përkujdesjen për kokrrizat e rërës, punën e milingonave, shijen meskine, "lumturinë e shumicës së njerëzve"!

Parapëlqeni të dëshpëroheni, përpara se të dorëzoheni. Në të vërtetë, unë ju dua se sot ju nuk dini të rroni, o Njerëz të Epërm! Kështu ju rroni në mënyrën më të mirë të mundshme!

4.

A keni kurajë o vëllezër? A jeni të gjalluar? Jo kuraja përballë dëshmitarëve, por kurajën e eremitit dhe të shqiponjës, që nuk e sheh dot madje as Zoti? Shpirtrat e ftohtë, njerëzit si mushka, të verbrit, të dehurit, për mua nuk janë guximtarë. Ka guxim ai që e njeh frikën, por dhe që e mposht atë; ai që e sheh humnerën, por me krenari. Ai që e sheh humnerën, por me syrin e shqiponjës; kush e rrok humnerën me kthetrat e shqiponjës, ai ka kurajë.

5.

“Njeriu është i lig!” Kështu më thanë për ngushëllim të gjithë të mençurit. Medet, sikur kjo të ishte e vërtetë! Se ligësia është forca më e mirë e njeriut.

Njeriu duhet të bëhet më i mirë dhe më i keq: ky është mësimi im. Më e keqja është e domosdoshme për më të mirën e Mbinjeriut.

Mund të ketë qenë e mirë për atë lloj predikatori të njerëzve të vegjël, të ketë vuajtur e të ketë pësuar mëkatet e njerëzve. Por unë gëzohem për mëkatin më të madh, ashtu si edhe për ngushëllimin tim më të madh.

Aq më tepër, që të tilla fjalë nuk janë të duhura për veshët e gjatë, se jo çdo fjalë i shkon për shtat çdo goje. Këto janë gjëra të imta e të largëta: nuk mund t’i kapin dot thonjtë e deleve.

6.

O Njerëz të Epërm, mos vallë mendoni se unë jam këtu për të ndrequr gjithçka të keqe që ju keni bërë?

Apo që kam dëshirë të përgatis një shtrat më të butë për vojtësit, apo për t’u treguar shtigje të reja të tronditurve, të sfliturve e të përhumburve?

Jo! Jo! Tri herë jo! Gjithmonë e më tepër, gjithmonë e më të mirët në mes sojit tuaj duhet të shkojnë në rrënim, sepse jeta për ju duhet të jetë gjithmonë e më e shëmtuar dhe e rëndë. Vetëm kështu, vetëm kështu njeriu ngrihet në lartësitë ku e godet dhe e shkatërron rrufeja. Ngrihet pra në lartësinë e duhur për rrufenë!

Drejt pak gjërave, të gjata e të largëta, shkon mendimi dhe dëshira ime. E ç’më duhet mizeria juaj e vogël, e shkurtër, e shumëfishtë!

Për mua ju ende nuk vuani aq sa duhet, sepse vuani veç për veten, s’keni vuajtur ende për njeriun. Do të gënjenit, po të thoni të kundërtën. Askush nga ju nuk vuan atë që kam vuajtur unë.

7.

Nuk më mjafton që rrufeja të mos jetë më e dëmshme. Nuk dua ta largoj, përkundrazi, duhet ta mësoj të veprojë në mënyrën time.

Mençuria ime po grumbullohet prej kohësh si një re, duke u bërë gjithnjë e më e heshtur dhe e errët. Kështu bën çdo mençuri, që një ditë i duhet të pjellë rrufe.

Për njerëzit e sotëm unë nuk dua të jem dritë, as të quhem dritë. Dua tua lëbyr sytë. Rrufe e mençurisë sime, verboji!

8.

Mos dëshironi përtej mundësive tuaja: ka një falsitet të keq tek ata që duan të shkojnë përtej mundësive të tyre.

Veçanërisht, kur duan gjëra të mëdha, sepse zgjojnë mosbesim për gjërat e mëdha, këta komedianë e gënjeshtarë dinakë, gjersa bëhen gënjeshtarë edhe karshi vetes, të ngrysur, kufoma flokëbardhë, të maskuara me fjalë bubulluese, me virtyte të spikatura e vepra të gënjeshtërta e vezulluese. Ja, për këtë shqetësohuni, o Njerëz të Epërm! Asgjë, në fakt, unë nuk çmoj sot më të rrallë e më të çmuar se sa ndershmëria.

E sotmja, a nuk u përket vallë plebenjve? Mirëpo, plebenjtë nuk dinë se ç'është e madhe, e vogël, e drejtë dhe e ndershme: ata janë pafajësish të shtrembër e gënjejnë gjithmonë.

9.

Zotëroni sot një mosbesueshmëri të lartë, o Njerëz të Epërm, o kurajozë! O të sinqertë! Mbajini të fshehta ndjenjat e brendshme! E sotmja është e plebenjve.

Atë që plebenjtë mësuajnë një ditë ta besojnë pa bazë, kush mundet vallë ta përmbysë me arsye?

Në treg vlejnë gjestet, kurse gjërat e thella plebenjtë i bëjnë mosbesues.

Nëse ndonjëherë u ka triumfuar rastësisht e vërteta, atëherë pyesni vërtet dyshimtarë se, ç'gabim aq trashanik luftoi vallë për të. ☺

[Ruhuni nga të urtët! Ata ju urrejnë, sepse janë sterilë. Kanë sy të ftohtë e të reshtur, përpara tyre çdo zog është pa pupla. Ndokush lëvdohet se nuk gënjen, mirëpo, pafuqia për të gënjer nuk është ende dashuri për të vërtetën. Ruhuni prej tyre!

Imuniteti nga ethet nuk është ende dije. Unë nuk besoj te shpirtrat e ftohtë. Kush nuk mund të gënjejë, nuk di se ç'është e vërteta.]

10.

Nëse doni të ngjiteni, atëherë luani këmbët! Mos lejoni t'ju mbartin lart, mos rrini ulur mbi shpatullat e mbi kryet e të tjerëve! Je hipur mbi kalë? Tash ngjitu rrëmbimthi drejt qëllimit tënd! Mirë, pra, o miku im, po edhe këmba jote e çalë është në kalë. Kur ta kesh mbërritur qëllimin, kur të zbresësh nga kali, pikërisht aty, në lartësinë tënde, o Njeri i Epërm, do të të shkasë këmba!

11.

O krijues, ju o Njerëz të Epërm! Jini të mbarsur veç me fëmijët tuaj, mos e lejoni veten të bindeni, të gënjeheni! Kush është vallë i afërmi juaj? Edhe pse punoni "për të afërmin", nuk krijoni asgjë për të! Çmësojeni fjalën "në favor të", o krijues; është pikërisht virtyti juaj ai që do që ju të mos bëni asgjë "në favor të", "për" apo "sepse". Për këto fjalë të gënjeshtërtë dhe mesquine, ju duhet t'i mbyllni veshët.

"Në favor të të afërmit" është virtyt veç për njerëzit e vegjël: ai di se "të gjithë janë të barabartë" dhe se "njëra dorë lan tjetrën"; nuk ka as të drejtën e as forcën e egoizmit tuaj.

Në egoizmin tuaj, o krijues, është matura dhe provania e atij që është i mbarsur.

Ajo që askush s'e ka parë me sytë e tij, fryti: që është i mbrojtur, i përkujdesur dhe i ushqyer nga gjithë dashuria juaj.

Aty është e gjithë dashuria juaj për fëmijën, aty është edhe i gjithë virtyti juaj.

Vepra juaj, vullneti juaj është “i afërmi juaj”: mos e lini veten të gënjeheni nga vlerat e gënjeshtërtat.

12.

O krijues, o Njerëz të Epërm! Kush po bëhet gati të lindë është i sëmurë, por edhe ai që ka lindur është i papastër.

Pyetini gratë: nuk lindet për qejf. **Dhimbja i bën të kakarisin pulat dhe poetët.** O krijues, edhe te ju shumë gjëra janë të papastra. Kjo ndodh, sepse duhet të ishit nëna.

Një tjetër fëmijë: oh, sa shumë fëlliqësi vjen në këtë botë! Largohuni! Kush ka lindur, duhet ta pastrojë shpirtin e vet!

13.

Mos jini të virtytshëm përtej forcave tuaja e mos dëshironi nga vetja asgjë të padëgjuar!

Ecni mbi gjurmët, tashmë të përshkruara nga virtyti i etërve tuaj! Si do të donit të ngjiteni, nëse nuk ngjitet me ju edhe vullneti i etërve? Kushdo që të jetë fëmija i parë, kujdes të mos bëhet i fundit! Aty ku nxijnë veset e baballarëve tuaj, mos kërkoni të ngjani si shenjtorë!

Ç’do të ndodhte, sikur të donte të ishte i papërlyer ai, babai i të cilit ishte i prirë të shkonte pas grave, pas pijeve dhe mishit të derrit? Do të ishte marrëzi! Në të vërtetë, do të qe vërtet shumë për një njeri të tillë, të ishte burri i një, dy ose tri grave.

Edhe sikur të themeloheshin manastire e sipër portave të tyre të shkruhej “Shtegu i shenjtërisë”, unë do të thosha: “E për çfarë! Për një marrëzi!”.

U fabrikua një burg dhe një strehim: bëftë fëmijë të mbarë! Por unë nuk e besoj.

Nëvetmi rritet ajo që mbart çdokush, edhe bisha e brendshme, ndaj ajo s’duhet t’u këshillohet shumicës së njerëzve.

A ka pasur vallë mbi tokë gjë më të ndyrë se sa shenjtorët e shkretëtirës?

Për ta e përreth tyre nuk tërbohej vetëm djalli, por edhe derri.

14.

Të ndruajtur, të turpshëm, ngatërrestarë, të ngjashëm me një tigër që ka gabuar prenë. Kështu, o Njerëz të Epërm, ju kam parë të zvarriteni shpesh. Ishte një gjah që ju kish shkuar keq. Po ju o lojtarë zaresh, ç'bëtë? Nuk mësuat të luani e të talleshit, ashtu siç duhet luajtur e tallur. Nuk rrimë vallë të gjithë të ulur në një tryezë të madhe loje e ironie?

Nëse nuk keni arritur diçka të madhe, a jeni vallë ju vetë ata të gabuarit? Nëse jeni ju, të gabuarit, mos vallë për këtë arsye është i gabuar edhe njeriu? Po nëse është i gabuar njeriu, epo mirë, atëherë!

15.

Sa më i lartë soji, aq më rrallë arrin të ndodhë mirë ndonjë gjë. Ju këtu, o Njerëz të Epërm, a nuk jeni të gjithë të dalë keq?

Gëzohuni, s'ka rëndësi! Sa shumë gjëra janë ende të mundshme! Mësoni të qeshni me veten tuaj, ashtu siç qeshet! Ç'mrekulli që keni dalë keq a përgjysmë, ju të dështuarit përgjysmë! Nuk tharmon e rrit pinjollë në ju e ardhmja e njeriut?

Sa te njeriu është më e largët, më e thellë, më yjore, po aq vallë forca e saj e padëgjuar nuk shkumëzon e gurgullon e gjitha së bashku në damarët tuaj.

Ç'mrekulli që ndonjë damar të çahet!

Mësoni të qeshni me veten tuaj, ashtu siç duhet të qeshet. Oh ju, o Njerëz të Epërm, sa gjëra janë akoma të mundshme!

Ndërkaq, sa shumë gjëra janë arritur tashmë! Sa e pasur është kjo tokë me gjëra të përkryera, të vogla e të mira, me gjëra të arrira! Vendosuni pranë të voglave gjëra të mira e të përkryera, ju, o Njerëz të Epërm! Maturiteti i tyre i praruar ta shëron zemrën. Gjërat e përkryera të yshtin të shpresosh.

16.

Cili ka qenë mëkati më i madh në botë deri më sot? Mos vallë fjala e atij që tha: “Ruajuni nga ata që qeshin!”? Pse vallë s’gjeti ai mbi tokë asnjë motiv për të qeshur? Do të thuash se kërkoi keq, se edhe një fëmijë e gjen.

Mirëpo, ai nuk dashuronte aq sa duhet se, përndryshe, do të na kish dashur edhe ne që qeshim. Po ai na urrente e na përçmonte, duke na uruar me kërcëllime e dhimbje dhëmbësh. Po për çfarë është vallë e domosdoshme të mallkosh menjëherë, kur nuk dashurohesh? Më duket diçka me shije të keqe.

Aq më tepër, që kështu bënte ai njeri që nuk binte në pakte e ujdj, absolutisti. Rridhte nga populli. Nuk dashuronte aq sa duhet: ky qe halli i tij se, përndryshe, do të ishte më pak i zemëruar se pse nuk e dashuronin. Çdo dashuri e madhe nuk e kërkon dashurinë: do diçka më shumë. Përvidhuni gjithë këtyre absolutistëve! Janë njerëz të mjerë e të sëmurë, një racë plebenjsh: e shohin me sy të shtrembër jetën dhe e kanë me sy të keq tokën.

Përvidhuni gjithë këtyre absolutistëve! Kanë këmbë të rënda dhe zemra shtypëse: nuk dinë të vallëzojnë. Kështu që, si mund të jetë toka e lehtë për ta!

17.

Të gjitha gjërat e mira arrijnë nëpër rrugë të kundërta me qëllimet e tyre. Të ngjashme me macet, që harkojnë kurrizin e mjaullijnë së brendshmi, duke shpërhapur lumturinë që pritët të vijë, po kështu qeshin të gjitha gjërat e mira.

Ecja tradhton e bën të nëpërduket, nëse ndokush po shkon tashmë në rrugën e tij; kështu ju do të më shihni dhe mua të eci. Por ai që arrin në afërsi të qëllimit të vet, ai po, vallëzon.

Në të vërtetë, nuk jam bërë ende statujë, as qëndroj në këmbë i ngurtë, i topitur e i ngrirë si një kolonë; dashuroj vrapimin e shpejtë.

Edhe pse në tokë ka moçale e përrenj të rrëmbyeshëm, ai që ka këmbë të lehta vrapon nëpër baltë e vallëzon si mbi hekur të

patinuar. Ngrijini zemrat lart, o vëllezër, forca! Akoma dhe më lart, por mos i harroni këmbët!

Ngrijini edhe këmbët, ju o vullnetarë të mirë ose, akoma dhe më mirë: qëndroni me kokë poshtë!

18.

Këtë kurorë të njeriut të qeshur, këtë kurorë trëndafilash e kam vënë edhe unë mbi krye, edhe unë vetë e shenjtifikova qeshjen time. Nuk kam gjetur ende askënd të fortë aq sa duhet për këtë gjë. Zarathustra valltari, Zarathustra i lehti, që bën shenja me krahë, gati për fluturim, mik i gjithë zogjve, i përgatitur e i gatshëm, i shkathët për harenë dhe qetësinë;

Zarathustra magjistari, ai që flet e qesh qartë, jo i paduruar, jo absolutist, ai që dashuron shenjtin dhe arratinë. Edhe unë vetë e kam vënë mbi krye këtë kurorë.

19.

Ngrijini zemrat tuaja, o vëllezër, sa më lart! Gjithmonë e më lart! Por mos harroni këmbët! Ngrijini edhe këmbët tuaja, o valltarë të zot, ose, më mirë akoma, varuni me kokë poshtë!

Ka edhe te lumturia një kafshë të rëndë, ka nga ata që i kanë këmbët të flashkëta që në lindje e mundohen në mënyrë qesharake, si një elefant që do të qëndrojë drejt e me kokë në tokë.

Po më mirë të çmendesh nga lumturia se sa nga fatkeqësia; më mirë të vallëzosh ngathtësisht se sa të ecësh i çalë. Ja kështu më mëson mençuria ime; edhe gjëja më e keqe ka gjithmonë dy anë të medaljes; edhe gjëja më e keqe ka këmbë vallëzuese, ndaj mësoni, o Njerëz të Epërm, të qëndroni mirë mbi këmbët tuaja të drejta!

Harrojini vlimet e dhimbjes dhe gjithë trishtimin e plebenjve! Oh, sa të trishtë më duken sot këta plebenj qesharakë! Mirëpo, e sotmja është e plebenjve.

20.

Bëni si era kur lëshohet përposh nga humbellat malore: do të vallëzojë në ritmin e flautit të vet, kur ndërkohë detet drithërojnë e dallgëzohen nën gjurmët e saj.

Jepi krahë gomarit, mil luaneshat; qoftë i lëvduar ky shpirt i mirë dhe i pazbutur që mbërrin si një erë stuhie mbi gjithë të sotmen e mbi çdo plebe, armik i kokëve të krehura dhe i çikërrimtarëve e i të gjitha gjetheve të fishkura e gramishtave. Lëvduar qoftë ky shpirt i stuhishëm, i lirë dhe i egër, që vallëzon mbi moçalet e mbi brengat si mbi livadhe!

Që urren plebenjtë e zgjebosur dhe çdo lloji të turbulluar njerëzish të mangët. I lëvduar qoftë ky shpirt i gjithë shpirtave të lirë, stuhia e qeshur që fryn pluhur në sytë e gjithë atyre që shohin veç zi e kanë lunga e çibanë në fytyrë!

Ju, o Njerëz të Epërm, gjëja juaj më e keqe është kjo: nuk keni mësuar të vallëzoni ashtu siç duhet, të vallëzoni edhe përtej vetvetes! Ç'rëndësi ka që jeni ndërtuar keq!

Sa gjëra janë të mundura ende, ndaj mësoni një herë e mirë të qeshni me veten. Ngrijini zemra lart, ju o valltarë të mirë, lart! Gjithnjë e më lart! Mos harroni edhe të qeshurën e mbarë! Këtë kurorë të njeriut të qeshur, këtë kurorë trëndafilash. Te ju, o vëllezërit e mi, unë po e hedh këtë kurorë. Kam shenjtëruar qeshjen, ndaj ju, o Njerëz të Epërm, mësoni të qeshni!

Kënga e melankolisë

1.

Teksa Zarathustra po thoshte këto fjalë, kish mbërritur në hyrje të shpellës, por, me të mbaruar, iu largua rrëmbimthi miqve, duke dalë jashtë.

“O parfume të kulluara përreth meje, - briti, - o qetësi e bekuar që po më mbështjell! Ku janë kafshët e mia? Shpejt,

shpejt, dil jashtë, ti o shqiponjë dhe gjarpri im! Thomëni, o kafshët e mia, të gjithë këta Njerëz të Epërm a nuk lëshojnë vallë një aromë të mirë? Parfume të kulluara përreth meje. Tash e di dhe e ndiej përfundimisht se unë ju dua, o kafshët e mia!”

Zarathustra e përsëriti edhe një herë: unë ju dua, o kafshët e mia!

Mirëpo, shqiponja dhe gjarpri iu afruan pranë, kur ai shqiptoi këto fjalë, duke e vështruar në sy. Kështu që u bënë të tre bashkë që po nuhasnin të qetë ajrin e pastër.

Sepse jashtë ajri qe shumë më i mirë se sa brenda, pranë Njerëzve të Epërm.

2.

Sapo Zarathustra u largua nga shpella, magjistari plak u çua, hodhi përqark një shikim dinak e tha: Shkoi! Tashmë, o Njerëz të Epërm, duke i ngacmuar me po të njëjtin emër lajkatar e miklues që u kish dhënë ai, ndihem i tëri i rrëmbyer nga shpirti im i keq i gënjeshtres dhe magjisë, nga djalli im melankolik, që është armik i Zarathustrës, ndaj faleni! Tash ai do të bëjë magjira përpara nesh, se është tamam ora e tij; unë luftoj më kot me këtë shpirt të lig.

Ju të gjithëve, cilitdo qoftë emri që i jepni vetvetes, duke u quajtur “shpirtra të lirë”, “të vërtetë”, “qëndrestarë të shpirtit” apo “nostalgjikët e mëdhenj”; ju të gjithëve, që vuani si unë nga përbuzja, për të cilët Zoti i vjetër vdiq e një Zot i ri në pelena nuk është shfaqur ende, ju po u mbërrin aq volitshëm shpirti im i lig dhe djalli magjindjellës.

Ju njoh, o Njerëz të Epërm, e njoh dhe atë; e njoh këtë tip të keq që unë e dua pa dëshirë Zarathustrën. Shpesh më ngjan me një larvë të bukur shenjti, me një figurë të re e të çuditshme me maskë, tek i cili pëlqehet shpirti im i keq me djallin melankolik. Unë e dua Zarathustrën, kështu më ngjan shpesh, pikërisht për shkak të shpirtit tim të keq. Po tash po më sulet e po më shtrëngon ky shpirt i melankolisë, ky djall muzgor se, vërtet o

Njerëz të Epërm, zbavitësh. Hapini mirë sytë, zbavitësh, tek e sheh të mbërrijë lakuriq, nuk e di, në formën e mashkullit a të femrës, se ai po vjen, po më shtrëngon. Medet! Mprihini mirë shqisat! Dita po shuhet, mbi të gjitha gjërat tash po mbërrin mbrëmja, edhe mbi gjërat më të mira. Dëgjoni e shikoni, o Njerëz të Epërm, çfarëdo djalli qoftë, mashkull a femër, se si po mbërrin ky shpirt i melankolisë mbrëmjesore!”

Kështu foli magjistari plak, pa përreth e pastaj nisi t'i bjerë harpës.

3.

Kur drita përqartësohet
e kur vesa ngushëllimin e vet
pikon mbi tokë.

E padukshme, po edhe e pazëshme,
se këpucë të hijshme mban në këmbë,
ngushëllues, si të gjithë ata që ngushëllojnë.
A mendon vallë, zemra ime e ngrohtë,
se si një ditë vere kishe etje,
kishe etje për lot qiellorë
e pika vese, e lodhur dhe e munduar,
ndërsa mbi shtigje barishtesh të zverdhura
përreth teje, përmes pemëve të zeza,
rreze të ligëta tejshtonin mbrëmjeve
shikime të verbuara nga syri i diellit?

“Ti, i dashuruar pas së vërtetës” e qeshnin.

Jo! Je vetëm një poet!

Një kafshë, e ngadaltë, gjahtarë,

që do të gënjejë,

duke ditur e duke dashur të gënjejë,

të kërkojë pre,

i lyer dhe i maskuar

larva e vetvetes,
 ashtu si dhe preja e vetvetes.
 I dashuruar pas së vërtetës?
 Jo! Veç një i çmendur! Veç një poet!
 Që flet me imazhe,
 duke lartuar britma prej larvave të marrosura,
 vërshuar poshtë urave të ndërtuara me fjalë,
 përposh ylberëve të pikturuar aq gjatë,
 mes qiejve gënjeshtarë,
 e trojeve gënjeshtare,
 një endacak i përqark-ardhur
 e veç një i çmendur! Veç një poet!

I dashuruar pas së vërtetës?
 Jo i qetë, por i palëvizur, i ftohtë e i kthjellët,
 i shndërruar në statujë,
 në kolonë hyjnore,
 jo përballë tempujve,
 rojtare e një Zoti.
 Jo! Armiqësor ndaj monumenteve
 të së vërtetës, në çdo pyllishte më shumë se
 nëpër pragje shtëpish, plot me vrull felin,
 përbiruese pas çdo dritareje,
 brenda çdo rasti,
 rrëmuese e çdo pylli
 të virgjër pasionalisht,
 ku nëpër çdo pyll virgjëror,
 në mes bishave lariushe,
 ti vrapoje i bukur, i shëndetshëm e mëkatar
 me buzët lakmitare,
 që gjakojnë skëterrë dhe shpotitës,
 vrapoje, ti o kurthngritës e grabitqar.
 Apo si një shqiponjë që vështrime të gjatë,

të gjatë ngërthen mbi humnerën,
nëpër rrëpirat e saj.
Oh, se si poshtë, ajo flatrohet e tëra,
gjithnjë e më poshtë, atje tej,
në thellësi akoma dhe më të mëdha.

E pastaj,
befas, si shigjetë
me vrullin instinktiv,
sulet mbi qengjat,
papritmas, e uritur,
lakmitare për qengjat,
e tmerrshme për shpirtrat e qengjave,
e tmerrshme për gjithçka që ka sy
delesh, leshtorë, sy qengjash,
sy të përhimë, dashamirës qengjash.

Kështu,
si prej shqiponjash e panterash
janë dëshirimet e poetit,
dëshirimet e tua mes mijëra larvash,
Ti o i çmenduri! Ti poet!

Ti që shihje te njerëzit
delet dhe Zotin:
për të zhvatur Zotin nga njeriu,
delen nga njeriu,
e për të qeshur duke i zhvatur.
Kjo, kjo është lumturia!
Lumturi pantere dhe shqiponje!
Lumturi poeti dhe të çmenduri!

Kur drita qartësohet,
drapri i hënës,

i blertë përmes zjarreve të kuq
 ziliqar del jashtë.
 Armike e ditës,
 tinëzar në çdo hap,
 dengje të tëra trëndafilash,
 duke korrur, derisa ato të bien,
 të bien të lëshuara netëve të zbehta.

Kështu u rrëzova një ditë edhe unë
 nga marrëzia e së vërtetës sime,
 nga ankthi i ditës sime,
 i lodhur nga dita, i sëmurë nga drita;
 zbrita kundrejt mbrëmjes dhe hijes.
 I vetëm, i etur e i përzhitur,
 për të vërtetën e vetme.
 A e mban mend vallë, o zemër e ngrohtë,
 se ç'etje kishe?
 Që unë tashmë i braktisur
 jam nga çdo e vërtetë
 veç një i çmendur.
 Një poet!

Për shkencën

Kështu këndoi magjistari e të gjithë ata që qenë mbledhur aty,
 si pa e kuptuar, hynë si zogjtë në rrjetën e dëshirimit të tij dinak
 dhe melankolik. Vetëm i ndërgegjegjësuari i shpirtit nuk u mbërthye
 në të; ia hoqi në çast harpën nga duart magjistarit dhe ulëriti:
 "Ajër! Lini të hyjë brenda ajër i pastër! Lini të hyjë Zarathustra! Ti
 e bën këtë shpellë shtypëse dhe murtajësjellëse, o magjistar plak
 dhe i lig! Ti të josh, o i rremë, o dinak, me dëshira e vende të egra
 e të panjohura. Mjerë ne, nëse një si ti i përkushtohet me fjalë dhe

vepra së vërtetës! Mjerë gjithë shpirtrat e lirë që nuk ruhen nga magjistarë të tillë! Liria e tyre mbaroi: ti bind e josh njerëz nëpër burgje, o djall plak e melankolik! Nga ankimet e tua kumbon një thirrje fyellore; ti je si ata që me elozhet e tyre të dëlirësisë ftojnë në fshehtësi praktikumin e kënaqësisë epsharake!”

Kështu foli i ndërgjegjësuari, por magjistari plak shihte përreth dhe shijonte fitoren e tij, duke degdisur tej zemërimin, që i ngjallte i ndërgjegjësuari.

“Hesht! - i tha me zë të ulët. - Këngët e mira kërkojnë jehonë të mirë; pas një kënge të mirë është e nevojshme një heshtje e gjatë. Kështu bëjnë të gjithë këta Njerëz të Epërm. Mos ke kuptuar pak nga kënga ime? Te ty ka pak nga shpirti magjik.

“Ti më lëvdon, - ia ktheu i ndërgjegjësuari, duke u ndarë nga ty. - Epo mirë, por te ju të tjerët, çfarë shoh? Rrini akoma aty me shikime të zymta, ju, o shpirtra të lirë, po ku shkoi liria juaj! Më ngjani gati si ata që kanë parë gjatë të vallëzojnë gra lakuriqe e të pacipa: janë vetë shpirtrat tuaj ata që vallëzojnë!

Te ju, o Njerëz të Epërm, duhet të ketë shumë më tepër nga ajo që ky magjistar e quan shpirti i tij i lig i magjisë dhe mashtrimit: duhet të jemi medoemos të ndryshëm.

Në të vërtetë, kemi folur e diskutuar mjaft së bashku, përpara se Zarathustra të kthehej në shpellë, sepse unë nuk e injoroja faktin se ne jemi të ndryshëm. Edhe këtu lart kërkojmë gjëra të ndryshme, ju dhe unë.

Unë kërkoj më shumë siguri, prandaj erdha te Zarathustra. Ai është në të vërtetë kulla më e patundur dhe mëshirimi i vullnetit, ndërkohë që gjithçka lëkundet, ndërkohë që e gjithë toka dridhet.

Po ju, ashtu siç i bëni sytë, të duket se kërkon më shumë pasiguri, më shumë tmerr, më shumë rrezik, më shumë tërmet. Madje, do të mendoja se jeni të tunduar, falmëni mendjemadhësinë time, o Njerëz të Epërm, edhe nga më e keqja dhe më e rrezikshmja jetë, ajo që më ngjall më shumë frikë, nga

jeta e bishave të egra, nga jeta e pyllit, e shpellave, e thepave të maleve dhe humbellave mashtruese.

Nuk ju pëlqen ai që ju shpie jashtë rrezikut, por ai që ju udhëheq në çfarëdolloj rruge, pra korruptuesi. Edhe pse brenda jush ka një dëshirim të tillë, përsëri ai është i pamundur.

Frika, në të vërtetë, është sentimenti themelor dhe i trashëguar i njeriut; me frikën shpjegohet çdo gjë, mëkati i zanafillës dhe virtytet e trashëguara. Prej frikës ka lindur edhe virtyti im, që quhet shkencë.

Frikën, në fakt, prej bishave të egra, që arriti të kultivohej më shumë te njeriu, duke përfshirë edhe bishën që fshihet brenda tij, e së cilës ai i frikohet, Zarathustra e quajti "bisha e brendshme".

Kjo frikë e moçme, e bërë më së fundi më fine, më shpirtërore, më fetare, sot më duket se quhet shkencë."

Kështu foli i ndërgjegjësuar, por Zarathustra, që po kthehej në shpellë, e kish arritur të dëgjonte ligjërimin e fundit, duke ia kapur kuptimin, i hodhi një tufë trëndafilash e nisi të qeshte me të vërtetat e tij.

"Si!, - kundërshtoi. - Ç'po më dëgjojnë veshët kështu, se, në të vërtetë, o je i çmendur ti o jam unë? Ja pse po ta përkëmbej të vërtetën tënde.

Frika jonë, në fakt, është një përjashtim. Kuraja, aventura dhe pasioni për të pasigurtën dhe të paprovuarën më duket se kanë përbërë gjithë parahistorinë e njeriut.

Kafshëve më të egra e më kurajoze ai u rrëmbeu virtytet; veç kështu u bë njeri.

Kjo kurajë, e shndërruar më së fundi fine, shpirtërore dhe fetare, kjo kurajë njerëzore me flatrimin e shqiponjës dhe me maturinë e gjarprit, ja, kjo më duket se sot quhet..."

"O Zarathustra!" - bërtitën të gjithë së bashku ata që qenë mbledhur aty, si një gojë, e ia plasën një të qeshure të madhe, që u ngrit prej tyre si një re e rëndë. Edhe magjistari qeshi e shtoi me dinakëri: Epo mirë! Shkoi dhe shpirti im i lig! Pse vallë nuk

ju thashë të ruheshit prej tij e s'ju tregova se ai është ngatërrestar, një shpirt i rremë dhe mashtrues?

Veçanërisht, kur paraqitet lakuriq. Po ç'mund të bëj unë vallë kundra dredhive të tij! Mos vallë e krijova unë atë dhe botën?

Epo mirë, atëherë! Le të kthehemi sërish të mirë e të biem dakord. Edhe pse Zarathustra më sheh me sy të keq, ju dëgjojeni atë me kujdes. Ushqen mllef kundra meje; përpara se të bjerë nata, do të mësojë të më dojë e të më lëvdojë përsëri; nuk mund të rrojë gjatë pa të tilla marrëzi. Ai i do armiqtë e vet dhe e përdor këtë art më mirë nga të gjithë ata që kam njohur. Ndaj, pikërisht për këtë gjë ai h'akmerret me miqtë e tij."

Kështu foli magjistari plak dhe Njerëzit e Epërm e duartrokitën aq sa Zarathustra u detyrua të vijë rrotull nëpër shpellë, duke ua shtrënguar me ligësi dhe dashuri dorën miqve të vet, njëlloj si ai që do të kuptohet me të gjithë e t'u kërkojë falje për diçka.

Por kur mbërriti te porta e shpellës, ja tek e mbërtheu përsëri dëshira për të dalë jashtë e për të ndenjtur me kafshët e veta; donte t'u përvidhej të gjithëve.

Mes bijave të shkretëtirës

1.

"Mos shko! - bërtiti atëherë shtegtari, që e quante veten hija e Zarathustrës. Rri me ne, përndryshe do të na sulej përsëri trishtimi i vjetër e i zyrtë. Magjistari plak na dha gjithçka të keqe që kish, kurse tani, Papa i mirë e i devotshëm, me sy të përlotur po niset sërish të lundrojë në detin e melankolisë. Mbretërit, nga ana e tyre, do të donin të bënin një figurë të mirë para nesh; ata e kanë kuptuar këtë gjë më mirë nga të gjithë. Por, po të mos kishin dëshmitarë, vë bast se edhe ata do ta rinisnin atë lojë të ligë, të keqe të reve shëtitëse, të grishjes së melankolisë, të qiellit të mbyllur, të

diellit të errësuar, të erës fishkëllyese të vjeshtës, lojën dashakeqe të ulërimave dhe britmave të dhimbjes. Rri me ne, o Zarathustra! Ka shumë mjerim të fshehur që kërkon të flasë me ty, shumë re, shumë ajër të rëndë! Ti na ke ushqyer me ushqim të fortë dhe burrëror dhe me sentenca të thekshme: mos lër që frutave t'u sulen sërish shpirtra të errët e jetëshkurtër! Vetëm ti na e bën ajrin përreth të pastër e të frymshëm! Ku mund të gjendet në tokë ajër më i mirë se sa në shpellën tënde? Kam parë shumë vende, aq sa hunda ime mësoi të ndiejë e të çmojë shumë atmosfera, por te ky vend pranë teje, flegrat e mia provojnë kënaqësinë e tyre të madhe.

Përveçse... përveçse ... oh, falma një kujtim të vjetër! Falma një këngë të vjetër bashkëjetese, që unë e kompozova në mes bijave të shkretëtirës. Në mes tyre ka një ajër të ngjashëm, të mirë dhe qartësisht oriental, atje unë isha larg nga e vjetra Europë, plot me re të lagështa melankolike.

Asokohe i doja ato bija të lindjes dhe atë mbretëri tjetër të kaltër të qiejve, mbi të cilën nuk rëndonin as re e as mendime.

Ju nuk mund ta imagjinoni se sa hijshëm ato rrinin ulur kur nuk vallëzonin, të thella, por pa mendime, si sekrete të vegla, si enigma të lidhura me fjongo, si arra dyshe, të çuditshme e të larmishme në të vërteta, por pa re. Enigma, që e lënë veten të zbulohen; ja për dashurinë e këtyre vashëzave sajova një psalm bashkëjetese.

Kështu foli shtegtari dhe hija; përpara se dikush të përgjigjej, ai tashmë kish marrë harpën e magjistarit plak dhe kish kryqëzuar këmbët, duke parë përreth vetes, i qetë e i urtë. Mirëpo, me flegrat e hundës nuhaste ngadalë, duke zhbiruar ajrin, si të qe dikush që në një vend të ri po nuhaste për herë të parë ajër të huaj. Pastaj, me një lloj mugullimi, nisi të këndojë.

2.

Shkretëtira rritet. Mjerë ai që shkretëtira fsheh brenda vetes!

- Mretulli!

Ah! I madhërishëm!
 Tamam i madhërishëm!
 Një fillim i denjë!
 I madhërishëm dhe afrikan!
 I denjë për një luan e për një majmun
 ulëritës a moralist, por jo për ju.
 Ju, o mike të shtrenjta,
 te të cilat këmbët e mia,
 për herë të parë,
 një europiani nën palma,
 iu lejua të pushojnë. Sela*.

Po është vërtet e çuditshme!
 Ja, atje rri unë tash,
 pranë shkretëtirës, po edhe larg
 nga shkretëtira,
 i rrënuar, në hiç:
 i përpirë i tëri
 nga kjo oazë kaq e vockël:
 ai hapi gojën
 e hijshme, duke gërhitur,
 më kundërmuesen e të gjitha gojëve.
 E unë rashë prej andej, këtu, mes jush,
 o mike të shtrenjta! Sela.

Përshtëndetje, asaj balene,
 që i lejoi mikut
 të qëndronte i gjallë. A e kuptoni
 aluzionin tim të mençur?
 Përshtëndetje barkut të saj,
 nëse qe vërtet
 një bark që pëlqente oaze,

* [Shprehje e nxjerrë nga Bibla, që do të thotë "mbaroi", "nuk flitet më"]

si ky. Por që unë s'e besoj,
sepse vij nga Europa,
më dyshimtare se të gjitha
ato gra e femra të vjetra.
Zoti dhëntë ta përmirësojë!
Amen!

Ja, pra, që unë po rri te kjo oazë e vockël,
i ngjashëm me një hurmë brune, të ëmbëlsuar,
akulluese, të ankthshme
për një gojë të rrumbullakët vajze,
po akoma dhe më shumë për dhëmbët prerës,
të ftohtë, të një vajze, si borë të bardhë,
drejt së cilës gulçon
zemra e çdo hurme të ngrohtë. Sela.

I ngjashëm me këto frute
të jugut, madje shumë i ngjashëm,
prehem këtu, këtu, prej insekteve
të vogla flatrore
rrethuar e sulmuar,
i ngjashëm me akoma më të voglat
faje të marrosura,
të dashurisë dhe trilleve,
i rrethuar nga ju,
të heshturat, plot ogure,
vajza-mace,
sfinskoret, Dudu e Sulejka,
që unë me një fjalë
të përfshij shumë kuptime,
(e m'i faltë Zoti
këto gabime gjuhësore!)
unë rri këtu, duke frymuar ajrin,

atmosferën e parajsës,
ajrin e lehtë, shkëlqimtar, ajrin e mbytur
prej arit, që më i mirë
prej hënës nuk zbriti kurrë,
ndoshta që krejt rastësisht
apo mos për ndonjë dredhi të kurajës?
Siç rrëfejnë poetët antikë.
Po unë dyshimtari gjithë këtë
e vë në dyshim, se vij
nga Europa,
toka më dyshimtare se të gjitha
femrat dhe gratë plaka.
Dhëntë Zoti ta përmirësojë!
Amen!

Duke e parë tërë këtë atmosferë të magjishme
me flegrat e gufuara si kupa,
pa të ardhme, pa kujtime,
unë rri këtu, mes jush,
mike të shtrenjta,
e kundroj palmën
që e ngjashme me një valltare
përkulet, përdridhet e ijët valëzon,
sa kur e sheh të ndjell ta imitosh.
E ngjashme me një valltare që, më duket
se për një kohë të gjatë, rrezikshmërisht,
veç mbi një këmbë qëndroi.
E kështu më ngjan.
Se harroi të kishte dhe këmbën tjetër?
Unë më kot, më kot,
e kërkova xhevahirin e humbur,
dua të them këmbën tjetër –
në afrinë e shenjtë

të së dashurës dhe së hijshmes
 fund të saj valëzues e palë-përkundur.
 Po, nëse doni, o miket e mia të bukura,
 besomëni plotësisht:
 ajo e humbi këmbën!
 E humbi!
 Përgjithmonë e humbi këmbën tjetër!
 Mëkat, për këtë këmbë të humbur!
 Po ku mund të rrijë vallë e trishtë
 dhe e braktisur këmba tjetër?
 Është vallë e frikësuar
 nga një krrelë e artë e kërcënuese
 e një luani të egër? Apo mos vallë tash
 është rrjepur, rropulli-zbrazur,
 e mëshirisht, medet, e ngrënë çik e nga çik! Sela.
 Oh, mos qani,
 ju, o zemra të njoma!
 Mos qani,
 o zemra hurmash e gjinjsh qumështi!
 Ju o zemërza,
 jomballi *(lloj luleje)!
 Mos qaj më,
 ti o e zbehta Dudu!
 Forca, Sulejka, kurajë! A mos duhet
 vallë diçka e fortë, diçka më
 forcëdhënëse, për të të gjalluar?
 Një thënie e bekuar?
 Një apel solemn?

 Në këmbë, forca, dinjitet!
 Dinjitet i virtytshëm! I denjë për Europën!
 Fry, vazhdo, fry ende
 o mantel virtytesh!

Ah!

Mugulli akoma dhe një herë, moralisht!

O luani moralistik,

Mugulli para bijave të shkretëtirës!

Se një ulërimë e virtytshme,

të dashura vashëza,

vlen shumë më tepër se e gjithë

zjarrmia europiane dhe fama e saj.

E unë këtu jam gati,

sepse jam europian

e s'mundet, ndryshe, o im Zot!

Amen!

Shkretëtira po rritet: mjerë ai që shkretëtira fsheh brenda vetes.

Rizgjimi

1.

Pas këngës së shtegtarit dhe hijes, shpella u mbush befas me shumë zhurmë dhe të qeshura: të gjithë miqtë e mbledhur aty po flisnin të gjithë së bashku, madje edhe gomari, tashmë i inkurajuar nga e gjitha kjo, nuk po qëndronte më i qetë. Zarathustrën e mbërtheu një lloj dhimbje ironike ndaj miqve të vet, pavarësisht se gëzohej ndërkaq për alegrinë e tyre, sepse kjo iu duk si një shenjë shërimi. Kështu ai u përvodh e doli jashtë, duke folur me kafshët e tij.

“Ku shkoi vallë ankthi i tyre? - pyeti, duke frymuar më me lehtësi e duke e rimarrë veten nga pakënaqësia e vogël që e pat mbërthyer. - E kanë harruar, më duket, britmën e dhimbjes! Edhe pse, për fat të keq, s'kanë harruar të bërtasin. Zarathustra mbylli veshët me duar, sepse nisi të dëgjojë të përzihej në mënyrë të veçantë pëllitja I-A [Ja = po në gjermanisht] e gomarit, me

gjithë zhurmërimën e hareshme të atyre Njerëzve të Epërm.

“Janë të gëzueshëm,” - filloi të pyeste përsëri, po pse vallë? Ndoshta në kurriz të mikut të tyre. Edhe pse mësuan prej meje të qeshnin, nuk është gjithsesi mënyra ime e të qeshurit ajo që kuptuan. Po ç’rëndësi ka!? Janë njerëz të vjetër: shërohen sipas mënyrës së tyre, qeshin sipas mënyrës së tyre; veshët e mi kanë duruar shumë gjëra më të këqija e s’janë bërë nopranë, falë gjithë kësaj.

Kjo ditë është dita e fitores: tashmë po zbret, po fluturon shpirti i rëndesës, armiku i madh antik. Sa mirë do të përfundojë kjo ditë, që kish filluar aq rëndë e aq keq!

Se tash ajo po përfundon; po vjen mbrëmja, po kalëron mbi det, ajo kalëruesja e zonja! Sa lumtur lëkundet, ajo që po rihip në shalët e saj të purpurta!

Qielli sheh qartësisht nga lart, bota nderet më poshtë. Ju, o krijesa të çuditshme, që keni ardhur tek unë, ia vlen barra qiranë të jëtoni pranë meje.

Kështu foli Zarathustra. E përsëri mbërriti tek ai britma dhe e qeshura e Njerëzve të Epërm të shpellës. Madje, pikërisht në këtë moment ajo rifilloi.

Po e gëlltisin, karremi im po vepron, po largohet prej tyre edhe armiku i shpirtit të rëndesës. Tashmë, ata po fillojnë të qeshin me veten? A po e dëgjoj mirë?

Ushqimi im burror vepron, fjala ime plot forcë e lëngje: se vërtet që nuk i kam ushqyer me perime të rreme, po me ushqim luftëtarësh, ushqim pushtuesish: dëshirime të reja kam zgjuar në ta. Shpresa të reja në këmbët dhe në krahët e tyre, zemra e tyre po tendoset. Ata po gjejnë fjalë të reja dhe shpirti i tyre shpejt do të frymojë kurajë.

Një ushqim i tillë nuk është për fëmijët, as për femrat nostalgjike plaka apo të reja. Për rropullitë e tyre duhet tjetër gjë; unë nuk jam as mjeku e as edukatori i tyre.

Neveria po largohet nga këta Njerëz të Epërm. Epo mirë! Kjo është fitorja ime. Në mbretërinë time ata ndihen të sigurt,

çdo turp i budallepsur davaritet, përshkundet.

Përshkunden edhe zemrat e tyre, kthehen tek ato orët e mira, nisin të bëhen festa, të hanë përsëri e të bëhen mirënjohës.

Kjo për mua është shenja më e mirë: po bëhen mirënjohës. Nuk do të kalojë shumë kohë që ata të sajojnë festa e t'u ngrenë gurë përkujtimore gëzimeve të tyre të vjetra.

Janë shëruar! Kështu i foli Zarathustra i gëzuar, zemrës së vet e doli jashtë, por kafshët iu mblodhën përreth, duke nderuar gëzimin dhe heshtjen e tij.

2.

Papritur veshi i Zarathustrës u paqtua: shpella, që deri atëherë ishte plot me zhurmë e të qeshura, u bë e heshtur, gati me një heshtje të vdekjes, por hunda e tij nuhaste një kundërmim, si të një temjani trungjesh të zjarrtë pishe, që lëshonte një erë shumë të mirë.

“Ç’po ndodh? Ç’po bëjnë?” - pyeti veten, e iu drejtua hyrjes, në mënyrë që të shihte, pa u parë nga miqtë e vet. Po ç’farë mrekullie! Ç’po i shihnin sytë!

“Të gjithë janë bërë sërish të devotshëm, luten, janë të çmendur,” -briti ai, e u mrekullua pa masë. Pa shiko pak! Të gjithë këta Njerëz të Epërm, dy mbretërit, papa jashtë shërbimit, magjistari i keq, lypësi vullnetar, shtegtari dhe hija, profeti plak, i ndërgjegjësuar i shpirtit dhe njeriu i shëmtuar. Të gjithë rrinin në gjunjë, si fëmijë e gra plaka besimtare, duke iu lutur gomari kur, ja teksa njeriu i shëmtuar nisi të bëjë gargalizma e të shfrynte, si të donte të nxirrte jashtë prej vetes diçka të pashprehshme. Aq më tepër, kur arriti më në fund të flasë, gjithçka ishte një lituani e devotshme dhe e çuditshme, plot lavde për gomarin e nderuar e të adhuruar. Lituania tingëllonte kështu:

Amen! Lavd e nderime, dije, vlerësim, mirënjohje e forcë Zotit tonë, në jetë e në amshim!

Ai mban barrën tonë, mori përsipër figurën e shërbëtorit dhe, i duruar në zemër, nuk tha kurrë jo. Kush e dashuronte

Zotin e vet, u dënua për të.

Po gomari pëlliti I-A.

Nuk flet, edhe pse i thotë gjithmonë "Po" botës së krijuar prej tij. Kështu ai e kremtoi atë. Dinakëria e tij është të mosfolurit: në këtë mënyrë, është e rrallë që ai të gabojë.

Po gomari pëlliti I-A.

Kalon nëpër botë me një pamje të parëndësishme. E përhimëta është ngjyra e trupit të tij, në të cilin ai fsheh virtytin. Nëse ka shpirt, e fsheh; por çdokush beson te veshët e tij të gjatë.

Po gomari pëlliti I-A.

Ç'dituri e fshehur është ajo që ka veshë të gjatë e që thotë veç "Po" e kurrë "Jo"? Nuk e krijoi vallë botën sipas imazhit të tij, më trashamanin që t'ishte e mundur?

Po gomari pëlliti I-A.

Ti përshkon shtigje të drejta e të shtrembra; pak të intereson ajo që njerëzve u duket e drejtë dhe e gabuar. Përtej së mirës dhe së keqes gjendet mbretëria jote. Pafajësia jote është ajo e të mosditurit se ç'është pafajësia.

Po gomari pëlliti I-A.

A e sheh se si nuk e largon askënd nga vetja, as mbretërit e as lypësit. Lëri të të afrohen, nëse duhet, fëmijët e vegjël e, nëse fëmijët e këqij të vënë në lojë, ti thuaji thjesht I-A.

Po gomari pëlliti I-A.

Dashuron gomaricat e fiqtë e freskët dhe nuk je nazemadh për asnjë ushqim. Një carangth ta pickon zemrën, nëse ke uri. Këtu shfaqet te ty një dije hyjnore.

Po gomari pëlliti I-A.

Festa e gomarit

1.

Në këtë pikë të lituanisë, Zarathustra nuk mundi të përmbahej më, bërtiti edhe ai I-A, madje akoma dhe më fort se gomari, duke brofur në mes të miqve të tij të budallepsur. “Po ç’farë po bëni, o bijtë e mi?” – ulëriti, duke i ngritur nga toka ata që po luteshin. Mjerë ju, po t’u shihte dikush tjetër nga Zarathustra! Çdokush do të besonte se me këtë besim të ri ju jeni bërë blasfemuesit më të këqij a më të çmendur se të gjitha fanatiket plaka. Edhe ti vetë, o papë plak, si i vë bashkë ato që po bën me qenien tënde? Duke adhuruar në një mënyrë të tillë një gomar, si të ishte Zot?”

“O Zarathustra, - përgjigj papa, - falmë, por në gjërat e Zotit unë jam akoma dhe më i ditur se ty. Dhe kështu është e drejta. Ta adhurosh Zotin, në këtë formë, ashtu si në asnjë formë tjetër. Pa mendoje njëherë këtë shprehje, o miku im fisnik: do ta kuptosh menjëherë se në këtë shprehje qëndron e vërteta. Ai që tha: “Zoti është shpirti”, ishte po ai që deri më sot në tokë ka bërë hapin dhe kërcimin më të madh drejt ateizmit. Një shprehje të këtij lloji nuk është e lehtë ta ndreqësh. Zemra ime e vjetër brof e kërcen nga gëzimi, kur sheh se në tokë ka ende diçka për t’u adhuruar. Falja këtë, o Zarathustra, një zemre të vjetër e të devotshme pape!”

“Po ti, - i tha Zarathustra shtegtarit dhe hijes, - ti që i thua vetes, e pohon se je një shpirt i lirë? Ndërsa, në të vërtetë, kështu ti sillesh më keq se sa me vajzat e tua të liga brune, o besimtari i ri dhe i keq!”

“Goxha keq, - ia kthen shtegtari dhe hija. - Këtu po, që ke të drejtë; po ç’mund të bëj unë vallë? Zoti i vjetër rilindi, o Zarathustra, mund të thuash ç’të duash. Njeriu më i shëmtuar është fajtor i gjithë kësaj: është ai që e rizgjoji. Nëse thotë se e vrau një ditë vdekja, për sa i përket zotave, është gjithmonë një paragjykim.”

“Po ti, - briti Zarathustra, - ti, magjistar i vjetër e i keq, ç'bëre vallë? Kush mundet në këtë kohë të lirë të vazhdojë të besojë se ti beson në një perëndi-gomar? Ishte një budallallëk ky që bëre e ti, që je njeri inteligjent, si arrite deri këtu?”

“O Zarathustra, - përgjigj magjistari inteligjent, - ke të drejtë, ishte një budallallëk, që tani po më rëndon shumë.”

“E ti, - i tha pastaj Zarathustra të ndërgjegjësuarit të shpirtit, - pa mendo pak e zëri pak hundët. Nuk ndjen asgjë kundra ndërgjegjes tënde? Nuk është vallë aq fin shpirti yt për këtë lutje e për temjanin kundërmues të vëllezërve të tu?”

“Ka diçka, - u përgjigj i ndërgjegjësuarit, e zuri hundët. - Ka diçka në këtë spektakël, që i bën mirë madje edhe ndërgjegjes sime.

Ndoshta është e vërtetë që nuk duhet të besoj në Zot, por një gjë është e sigurt: Zoti, nën këtë aspekt, më duket se shfaqet akoma në formën më të denjë të besimit.

Zoti duhet të jetë i përjetshëm, sipas dëshmisë së më besimtarëve: ai që ka kaq shumë kohë, nuk i dhimbset koha. Në një mënyrë të tillë, një qenie e këtij lloji mund të arrijë të bëjë shumë gjëra.

E kush ka shumë shpirt, do të bënte mirë të dashurohej deri në marrëzi, pas budallallëkut dhe çmendurisë. Pa mendo për veten tënde, o Zarathustra!

Në të vërtetë, edhe ti vetë, mund të ktheheshe në gomar, falë harresës dhe mençurisë së tepërt. Nuk përshkruan vallë me dëshirë, një i urtë i përkryer, rrugët më të mundimshme? Çehrja, ta tregon o Zarathustra, çehrja e fytyrës tënde.

“Po edhe ti, së fundi,” - ia briti Zarathustra, duke iu drejtuar njeriut më të shëmtuar, që ishte akoma në tokë me krahun e ngritur lart drejt gomarit (po i jepte për të pirë verë).

“Fol, o i papërshkrueshëm, ç'ke bëre vallë? Më dukesh i ndryshuar, syri yt djeg zjarr, manteli i sublimes mbështjell shëmtinë tënde. Ç'ke bëre vallë?”

Mos është e vërtetë ajo ç'ka thonë ata, që ti e rizgjove? E përse? Nuk qe më mirë i vdekur dhe i varrosur?

Ti vetë më dukesh i zgjuar: ç'ke bërë vallë? Ç'ke përkëmbyer? Si je konvertuar? Fol, o i papërshkrueshëm!”

“O Zarathustra, - u përgjigj njeriu më i shëmtuar, - ti je një kopuk! Nëse rron ose u rizgjua, apo vdiq përfundimisht, kush nga ne të dy mund ta dijë më mirë? Po të pyes ty. Por një gjë e di, pikërisht nga ty e kuptova një ditë, o Zarathustra se, “kush do të vrasë në mënyrën më absolute, qesh”.

Jo me zemërimin, por më të qeshurën vritet: kështu the një ditë. O Zarathustra, ti i fshehuri, ti shkatërruesi pa zemërim, ti shenjt i rrezikshëm, je një kopuk!”

2.

Atëherë ndodhi që Zarathustra, i habitur nga të gjitha këto përgjigje dashakeqe, bëri një brofje nga prapa, deri te porta e shpellës. Iu drejtua gjithë miqve e ulëriti me zë të lartë:

“Të gjithë ju të çmendur! Palaço që fshiheni e maskoheni përpara meje! Sa shumë i gufoi zemra secilit prej jush nga gëzimi dhe ligësia, aq sa u bëtë si fëmijët, çka do të thotë të devotshëm, sepse nisët sërish të luteni, po njëlloj si ata, duke thënë me duart e palosura: “O Zoti im!”.

Ndaj, tash largohuni nga kjo shkollë fëmijësh, siç e shndërruat shpellën time; në të sot po bëhen aq vocërrakë. Freskojeni jashtë entuziazmin tuaj foshnjor dhe rropamën e zemrave tuaja.

Sigurisht, nëse nuk bëheni si fëmijë, nuk keni për të hyrë në Mbretërinë e Qiejve: jemi njerëz, duam Mbretërinë tokësore.

3.

E përsëri Zarathustra nisi të flasë. “O miqtë e mi të rinj, - tha, - ju të jashtëzakonshmit, Njerëz të Epërm, sa shumë po më pëlqeni tani, që jeni ribërë të hareshëm! Jeni gjalluar e lulëzuar të gjithë: më ngjan se luleve që tash jeni bërë, u duhen festa të

reja, një lloj kuraje e çartur, diçka si një rit i shenjtë a si festa e gomarit, ndonjë i çmendur i hareshëm si Zarathustra, një erë e stuhishme, që të fryjë e të qartësojë shpirtrat tuaj.

Mos e harroni këtë natë e këtë festë të gomarit, o Njerëz të Epërm! Atë që ju sajuat këtu, pranë meje, unë po e marr si një ogur të mirë, se gjëra të tilla i sajojnë vetëm ata që janë duke u shëruar. Festojeni sërish këtë festë të gomarit, bëjeni për veten tuaj, por edhe për mua! Për kujtimin tim!”

Kështu foli Zarathustra.

Kënga e dehur

Ndërkaq që të gjithë, njëri pas tjetrit, kishin dalë jashtë, të rigjalluar në ajrin e freskët të natës, kur Zarathustra mori për dore më të shëmtuarin e njerëzve, për t'i treguar botën e tij mbrëmjesore, hënën e rrumbullakët dhe kataraktet e argjendta të ujit pranë shpellës. Së fundi, ndaluan aty, në heshtje, njëri pranë tjetrit, njerëz të moshuar, por me zemër të fortë e të ngushëlluar, të mrekulluar se ndihen kaq mirë në tokë, teksa fshehtësia e heshtjes së natës zbriste gjithnjë e më thellë nëpër zemrat e tyre. E përsëri Zarathustra mendoi me vete: sa më pëlqejnë këta Njerëz të Epërm! Por nuk ua tha, sepse mendonte të respektonte lumturinë dhe heshtjen e tyre të re.

Ndodhi, pikërisht në këtë kohë madhështore, gjëja më e mrekullueshme. Njeriu i shëmtuar nisi të gulçonte e të teshtinte; kur arriti të shqiptonte fjalë, nga goja i shpërtheu befas një pyetje e kulluar dhe harmonike, një pyetje e mirë, e qartë dhe e thellë, që ua gufoi gjoksin gjithë atyre që e dëgjuan.

“O ju, miqtë e mi, të gjithë sa jeni, - tha njeriu i shëmtuar, si po ju duket? Për dashurinë e kësaj dite, për herë të parë, unë jam i lumtur që kam jetuar.

Nuk do lodhem së thëni kështu. Ia vlen të jetosh në tokë:

një ditë të vetme, një festë e kaluar me Zarathustrën më mësoi ta dashuroj tokën.

Kjo është vallë jeta? Ia them dhe ia përsëris Vdekjes. Epo mirë, pra, në është kështu, le ta fillojmë sërish.

Miqte e mi, si ju duket? Nuk doni ta përsërisni edhe ju me mua: kjo është vallë jeta? Pra, për dashurinë e Zarathustrës, le të fillojmë sërish!”

Kështu foli më i shëmtuari i njerëzve, kur s'donte shumë të vinte mesnata. Po ç'mendoni se ndodhi atëherë? Sapo Njerëzit e Epërm dëgjuan pyetjen e tij, u bënë papritmas të ndërgjegjshëm për transformimin dhe shërimin e tyre, bashkë me borxhin që kishin ndaj atij që e kishte bërë këtë gjë. Atëherë vrapuan te Zarathustra, duke e falënderuar, admiruar, adhuruar, duke i puthur duart e duke e festuar secili sipas mënyrës së vet: disa qeshnin, të tjerë qanin. Profeti plak kërcente nga gëzimi, po edhe pse, siç tregojnë shumë rrëfimtari, ai ishte dendur plot me verë të ëmbël, më shumë i dendur ai ishte me jetën e ëmbël e ndihej pa grimë lodhjeje. Madje, disa tregojnë se edhe gomari pat kërcyer; jo rastësisht, njeriu i shëmtuar i kish dhënë edhe atij të pinte verë. Gjërat mund të kenë shkuar në një mënyrë a në një tjetër, por, edhe pse, në të vërtetë atë natë gomari nuk kërcëu, ndodhën gjëra shumë më të mëdha, të çuditshme e të mrekullueshme se sa kërcimi i gomarit.

Shkurt, ashtu siç thotë vetë Zarathustra: ç'rëndësi ka?

2.

Mirëpo, Zarathustra, teksa po ndodhnin të gjitha këto gjëra me njeriun e shëmtuar, mbeti aty, në këmbë, si një i dehur: vështrimin e shuar, gjuhën belbëzuese dhe hapin e lëkundur. Kush mund ta thoshte vallë sot se të ç'lloji ishin mendimet që kalonin në ato momente në mendjen e Zarathustrës? Megjithatë, dukej qartë se shpirti i tij ishte tërhequr për larg e fluturonte në vende të huaja, si mbi një vargmal tjetër malesh. Kështu

është shkruar, midis dy deteve, endacak midis të shkuarës dhe së ardhmes, si një re e dendur.

Po më pas, ngadalësisht, ndërsa Njerëzit e Epërmeshtrë ngonin në krahë, ai u kthye në vete, duke e larguar me duar turmën e atyre që donin ta adhuronin e të atyre që ishin të shqetësuar për të; e vazhdoi të heshte. Pastaj, papritmas ktheu kokën shpejtësisht, si të kish dëgjuar diçka. Vuri gishtin në gojë dhe tha: Ejani! Ja, teksa gjithçka përreth u bë e qetë dhe u ëmbëlsua, nga thellësia mbërrinte tingulli i ngadaltë i një kambane. Zarathustra zgjati veshët, njëlloj si Njerëzit e Epërm; vuri përsëri gishtin në gojë e tha sërish: Ejani! Ejani! Po vjen mesnata! - e zëri i tij ndryshoi. Megjithatë, vazhdoi të mos lëvizte: heshtja rritej, rritej edhe fshehtësia e ëmbël e pritjes, të gjithë rrinin me veshët ngrehur. Madje, edhe gomari dhe kafshët e Zarathustrës, shqiponja dhe gjarpri, bashkë me ta e gjithë shpella e Zarathustrës, e ftohta hënë e rrumbullakët dhe vetë nata. Mirëpo, Zarathustra vendosi për të tretën herë gishtin te goja, duke thënë: Ejani! Ejani! Atëherë nisi të ecë. Erdhi ora! Le të fillojmë të ecim nëpër natë!

3.

O ju, Njerëz të Epërm, po ecim drejt mesnatës. Unë dua t'ju them diçka në vesh, ashtu siç më foli edhe mua në vesh ajo kambanë e vjetër, aq ëmbëlsisht e fshehtësisht, aq tmerrësisht, aq prej thellësisë së zemrës, siç më foli kjo kambanë e mesnatës, që ka kundruar shumë më tepër gjëra se sa një njeri. Ajo kumboi për etërit tanë në orët e dhimbjes.

Ahi! Ahi! Si psherëtin! Si qesh në ëndërr! Antikja, e thella, e thella mesnatë? Heshtni! Heshtni!

Tash dëgjohen gjëra që gjatë ditës nuk mund të dëgjohen; tash në këtë atmosferë të ftohtë, në të cilën fashitet çdo zhurmë e zemrës suaj, tash po që ajo flet, ndihet dhe nëpër shpirtrat largpamës të natës. Ahi! Ahi! Si psherëtin! A nuk po e dëgjon se si po të flet fshehtësisht, tmerrësisht nga thellësia e zemrës, antikja,

e thella, e thella mesnatë?

O njeri, dëgjo!

4.

Mjerë unë! Ku shkoi vallë koha? Mos zbrita vallë nëpër puse të thella? Bota po fle.

Ahi! Ahi! Qeni ulërin, hëna po rishkëlqen. Do të parapëlqejta të vdisja më shumë se sa t'ju thosha ç'mendon e ndjen zemra ime në mesnatë.

Po unë tash jam i vdekur. Gjithçka mori fund. Po ti, o merimangë, ç'po end rreth meje?

A do vallë gjak? Ahi! Ahi! Vesa po bie, erdhi ora: ora që më akullon e më bën të dridhem, që pyet, kërkon e lut: "Kush ka vallë aq zemër për gjithë këtë? Kush duhet të jetë zotëria i tokës? Kush do të donte të thoshte se kjo është udha juaj, o përrenj të mëdhenj e të vegjël!

Po vjen ora, o njeri! E dëgjon, ti, o Njeri i Epërm! Këto fjalë janë vetëm për veshë fin, për veshët e tu. Ç'thotë e thella mesnatë?

5.

Kështu ndihem i frymëzuar nga ora dhe shpirti im po vallëzon. Vepra e ditës! Vepra ditore! Kush duhet të jetë zotëria i tokës?

Hëna është e ftohtë, hesht era! Ahi! Ahi! Fluturoni shumë lart? Po, ju vallëzoni: veçse një këmbë nuk është një flatër.

O ju, kërcimtarë të mrekullueshëm, i gjithë gëzimi po shkon tej. Vera është bërë uthull, çdo kupë është turbulluar, varret përpiqen të thonë ndonjë fjalë.

Ju nuk fluturoni aq lart e varret belbëzojnë: "Çlirojini, pra, të vdekurit! Përse vallë është kaq e gjatë nata? Hëna nuk na bën të dehur?

Ju, o Njerëz të Epërm, çlirojini, pra, varret, rizgjojini të vdekurit! Oh! Po ç'po gërryen vallë krimbi? Ora po afrohet, po

buçet kambana, gërhet ende zemra, urithi vazhdon të gërmojë, urithi i zemrës. Ah! Ah! E thellë është bota!

6.

E ëmbra lirë! Oh, e ëmbra lirë! Unë e dua tingullin tënd, të dehurin tingullin tënd. Prej thellësisë së kohës, nga ç'largësi po mbërrin tingulli yt! Nga përtej; nga liqenet e dashurisë. Ti! kambanë antike; ti e ëmbra lirë! Çdo dhimbje t'u ngulit në zemër, dhimbja e etërve, dhimbja e gjyshërve, dhimbja e stërgjyshërve, e fjala juaj t'u bë e arrirë; e arrirë si vjeshta e pasditja e artë e si zemra ime vetmitare; edhe ti po flet; bota po bëhet e arrirë, vreshti po brunohet, e tash mund të vdesësh, të vdesësh nga lumturia. Ju, o Njerëz të Epërm, a e ndieni parfumin? Sepse kudo shpërhapet një parfum i fshehtë, një gulçim e kundërmim i përjetësisë, një parfum i trëndafiltë vere në brune të praruar me lumturi antike, të dehur me lumturinë mortore të mesnatës, e cila po këndon: e thellë është bota, më e thellë se ç'e kujton dita.

7.

Lërmë! Lërmë! Unë jam shumë i qelibartë për ty. Mos më prek! A s'është vallë e përkryer bota ime?

Lëkura ime është shumë e kulluar për duart e tua. Lërmë o budallaqja, e marrosura dhe e afshëta ditë! Nuk është më e qartë se ty mesnata? Më të fortit duhet ta trashëgojnë botën, më pak të njohurit, më të ashprit, shpirtrat që i përkasin mesnatës, më të qartës e më të thellës se çdo dite.

O ditë, duke u kalamendur, ti po më kërkon? Po kërkon lumturinë tënde? Ti e di mirë që unë jam i pasur, vetmitar, një minierë thesaresh, një peshtaf i vërtetë plot me thesare.

O botë, a më do? Jam për shijet e tua goxha mondan? Jam për ty shumë **priftëror**? Jam për ty shumë hyjnor? O ditë, dhe ti, o botë, jini shumë qesharakë, sepse nuk keni duar më të mençura, nuk arrini të rrokni lumturi më të thella, një dhimbje më të

thellë, një lloj Zoti, por ruhuni që t'i shtrini kthetrat drejt meje. Dhimbja e gëzimi im janë të thellë. O e çuditshmja ditë, unë nuk jam një zot, as edhe një ferr hyjnor! E thellë është dhimbja.

8.

Dhimbja hyjnore është akoma dhe më e thellë, o botë e çuditshme! Shtriji duart drejt dhimbjes hyjnore, jo drejt meje! Ç'jam vallë unë? Një lirë e ëmbël e dehur, një lirë e mesnatës, një kabanë kumbuese, që s'e kupton askush, por që duhet të flasë për shurdhët, o ju Njerëz të Epërm! Përderisa ju nuk më kuptoni!

Aty përposh! Përposh! O rini! Ora e mesditës! Po zbret dita! Erdhi mbrëmja e pas saj nata e më pas mesnata, qeni ulërin, kështu dhe era. A nuk është era një qen?

Hungërin, kuit, ulërin. Ahi! Ahi! Si psherëtin, si qesh, si grahmon e gulçon, mesnata!

Sa e kthjellët flet, edhe pse e dehur nga poezia! Mos e ka tejkaluar vallë me dehje vetë dehjen e saj? Është pra më e zgjuar se kurrë ndonjëherë? Ndoshta po ripërtypet?

Dhimbja e saj po ripërtypet e po ëndërron, e thella, antikja mesnatë, ëndërron akoma kënaqësinë e vet. Po, kënaqësinë se, nëse dhimbja tashmë është e thellë, kënaqësia është akoma dhe më e thellë se dhimbja.

9.

Po ti, o hardhi, përse më dalldis? Unë të preva! Unë jam mizor, a e sheh? Ti po gjakosesh! Ç'do të thotë lavdi, për mizorinë time të dehur?

Gjithçka që është e përkryer, çdo gjë e arrirë do të vdesë! Kështu flet ti! I bekuar, i bekuar qoftë biçaku i krasitësit! Se, dhe në të kundërt, gjithçka e paarrirë do të vdesë. Oh ç'dhimbje! [Nisur nga ky intuicion i konvergencës së të kundërtave, Niçe identifikon kënaqësinë me dhimbjen; por gjithsesi, doktrina e tij

bazohet në ekzaltimin e kënaqësisë, si më të thellë se dhimbja, dhe si zbulesë e vërtetë e pafundësisë së jetës. Mbi këtë intuicion të filozofit gjerman themelohet doktrina dekadente e pjesës më të madhe të hedonizmit bashkëkohor, nga D'Annunzio te Barbus, Lawrence, etj.]

Thotë dhimbja: “Kalo! Ik, ik, ik, o dhimbje! Mirëpo, gjithçka që vuan do të jetojë, për t’u bërë e arrirë, e gëzueshme, lakmitare dhe e dëshirueshme për largësitë marramendëse, për qartësinë më të lartë. Unë dua trashëgimtarë, thotë çdo gjë që vuan, dua “fëmijë, nuk dua vetveten”.

Ndërsa kënaqësia nuk do trashëgimtarë, nuk do fëmijë. Gëzimi do vetëm vetveten, do përjetësinë, do rikthimin e përjetshëm, do identitetin e përjetshëm me vetveten.

Thotë dhimbja: “Copëtohu, o e përgjakura zemër! Ec, këmbë! Flatër, fluturo! Shko përpara! Ngjitu dhimbje! Përpara, kurajë! Le të shkojmë! Zemra ime e vjetër, thotë dhimbja: Ik tej!

10.

Po ju, o Njerëz të Epërm, ç’mendoni? Jam vallë ndonjë profet, një ëndërrimtar, një i dehur? Jam interpretues ëndrrash? Një kabanë e mesnatës?

Një pikë vese? Një kundërmim e parfum i përjetësisë? Nuk po e ndjeni? Nuk po e nuhasni?

Nuk e shihni që bota ime është e përkryer dhe se mesnata është edhe mesditë?

Dhimbja është edhe kënaqësi, mallkimi edhe bekim, nata edhe një diell. Ndaj, largohuni ose mësoni se një i ditur është edhe një i marrë.

A i keni thënë ndonjëherë po kënaqësisë? O miqtë e mi, atëherë ju i keni thënë po edhe çdo dhimbjeje. Të gjithë gjërat mes tyre janë të lidhura, të zinxhirzuara, të dashuruara me njëra-tjetrën. Nëse do të kishit dashur dy herë të njëjtën gjë që patët

pasur njëherë, nëse do të kishit thënë ndonjëherë: “Ti më pëlqen, o kënaqësi! Shko tej, o çast ikanak!”, atëherë do të kishit dashur që gjithçka të rikthehej.

Gjithçka përsëri, gjithçka përjetësisht, gjithçka e lidhur, e zinxhirzuar, e dashuruar me njëra-tjetrën, oh, atëherë po që ju do ta donit tokën, ju të përjetshmit, që dashuroheni në përjetësi e për çdo kohë, duke i thënë dhimbjes: “Shko, por kthehu përsëri!”. Sepse çdo gëzim e do përjetësinë!

11.

Çdo gëzim e do përjetësinë e të gjitha gjërave, do mjaltin dhe llumin, do mesnatën e dehur, do varret, do ngushëllimin e lotëve përmbi varre, do perëndimin e artë. E ç’gjë nuk do gëzimi! Gëzimi është më i etur, më i përzemërt, më i uritur, më i tmerrshëm dhe i fshehtë se çdo dhimbje; ai do vetveten, ia zhyt asaj dhëmbët thellë; vullneti i unazës lufton me të [Aluzioni i qartë me “Unazën e Nibelungëve” të Wagnerit. “Vullneti i unazës” është vullneti i fuqisë, i pasurisë, shkak, sipas Wagnerit, i rrënimit të Nibelungëve, të perëndimit të zotave të botës. Te Niçe, si profet i vullnetit të fuqisë, ajo bëhet motiv i lartësimit], do dashurinë, urrejtjen, është e mbytur plot me pasuri, gra, është mrekullibërëse, dhuron, i jep lëmoshë kujtdo, e falënderon atë që e merr, madje kërkon edhe të urrehet [Aluzion ndaj motivit mazokist të kënaqësisë që nxirret nga poshtërimi dhe nga dhimbja fizike e morale], kaq i pasur është gëzimi, që ka etje dhimbjeje, ferri, urrejtje, poshtërimi, masakrimi, që ka etje për botën. E këtë botë, oh, ju e dini se ç’është!

Edhe juve, o Njerëz të Epërm, edhe juve iu afrohet gëzimi, i pafrenueshmi, i lumturi gëzim; i afrohet dhimbjes suaj. Oh, ju shkarravina të vetvetes! Çdo gëzim që është i përjetshëm priret drejt papërkryeshmërisë dhe gabimit.

Sepse çdo gëzim e do vetveten, andaj do dhe dhimbjen. O lumturi, o dhimbje! Oh, copëtohu, zemër! Mësoni, pra, ju o Njerëz të Epërm se kënaqësia do përjetësinë.

Kënaqësia e do përjetësinë e të gjitha gjërave, të thellën, të thellën përjetësi.

12.

A e kuptuat kënaqësinë time? A e kuptuat se ç'dua të them? Forca, pra! Epo mirë! Ju, o Njerëz të Epërm, këndomëni këngën time të vallëzimit! Harmonizojeni ju vetë këngën me titull "Akoma dhe një herë", kuptimi i së cilës është "Në çdo përjetësi"!

Këndojeni ju, o Njerëz të Epërm, baladën e Zarathustrës!

O njeri, dëgjo!

ç'thotë vallë e thella mesnatë?

Fli, fli, nga një ëndërr e thellë jam zgjuar:

e thellë është bota,

akoma më e thellë se ç'e mendon dita.

E thellë është dhimbja

gëzimi më i thellë se dhimbja.

Thotë dhimbja: ik!

Por çdo gëzim e do përjetësinë:

e do të thellën, të thellën përjetësi!

Shenja

Në mëngjesin që vijoi atë natë, Zarathustra brofi nga shtrati i tij, shtrëngoi rripin dhe doli nga shpella, i fortë dhe i zjarrtë si dielli që shfaqet në agim maleve akoma të mbështjella me re.

"Ti, o konstelacion i madh, - tha, siç kish thënë një herë. - Ti, o sy i thellë i gëzimit, ç'do të qe vallë gjithë lumturia jote, nëse nuk do të kishte kë të ndriçoje? Nëse të gjitha krijesat do të qëndronin në shtëpitë e tyre, ndërsa ti ndriçoje e shpërhapje gjithë bujarinë e ngrohtësisë tënde, ç'do të ndjente vallë krenaria jote?"

Kur ja! Po flenë akoma Njerëzit e Epërm, ndërsa unë jam zgjuar. Ata, pra, nuk janë miqtë e mi të vërtetë! Ndoshta unë nuk i prisja këta njerëz në malet e mia!

Po shkoj drejt mundimit tim, drejt ditës sime, por ata nuk i kuptojnë shenjat e mëngjesit tim, e hapi im nuk është për ta thirrja e rizgjimit.

Po flenë akoma në shpellën time, ëndrrat e tyre do të nginjen akoma me këngët e mia të dehura. Mirëpo, veshi që dëgjon ç'ka them, veshi i bindur, atyre u mungon.

Kështu i foli Zarathustra zemrës së vet, kur u ngrit dielli, e u hodhi një shikim tejqyrës hapësirave qiellore, sepse po dëgjonte sipër vetes britmën therëse të shqiponjës së tij.

“Epo mirë!, - i thirri. - Kështu më pëlqen, kjo është ajo që më duhet. Kafshët e mia janë zgjuar, sepse edhe unë jam zgjuar.

Shqiponja ime është zgjuar e përshëndet diellin si unë. Me kthetra shqiponje do ta mbërthejë dritën e re. Ju jeni kafshët e mia të vërteta; unë ju dua.

Po, në të vërtetë, më mungojnë akoma njerëzit e mi të vërtetë.

Kështu foli Zarathustra, por në atë çast ndodhi që ai ndjeu të mbështillej nga një tufë e panumërueshme zogjsh; rrahja e aq shumë flatrave dhe zhaurima përreth tij ishte kaq e fortë, sa ai mbylli sytë. Në fakt, tufa e zogjve ra mbi të si një re, si re shigjetash që përplasat mbi një armik të ri. Por, përkundrazi, ishte veçse një re dashurie që mbështillte një mik të ri.

“Ç’po më ndodh?” - mendoi Zarathustra, i habitur në zemër, dhe e lëshoi veten duke rënë ngadalë mbi gurin e madh që gjendej në hyrje të shpellës së tij. Aq më tepër që, ndërsa tundte krahët përreth vetes, sipër dhe poshtë, për t’u mbrojtur nga zogjtë delikatë, ja teksa i ndodhi diçka akoma më e veçantë: i zhyten gishtërinjtë, pa e kuptuar, në një lëmsh të ngrohtë qimesh. Përpara tij u dëgjua fort një hungërimë, një hungërimë e ëmbël dhe e gjatë luani.

“Mbërriti shenja,” - tha Zarathustra, e zemra e tij qeshi. Kur gjithçka iu qartësua para syve, ai pa t’i prehej përpara këmbëve një bishë e fuqishme që i turfullonte kokën aty në gjunjë e që s’donte t’i shqitej. Aq e madhe ish dashuria e saj, e ngjashme me atë të një qeni që rigjen padronin e vet.

Mirëpo, edhe pëllumbat, në dashurinë e tyre, nuk qenë më të pakët se luani; çdo herë që një pëllumb çikte fytyrën e luanit, bisha tundte kokën e mahnitur dhe qeshte.

Duke vështruar këtë skenë, Zarathustra tha një fjalë të vetme: bijtë e mi, bijtë e mi, pastaj heshti. Mirëpo, zemra e tij qe e lirë e nga sytë lotët nisën t’i binin nëpër duar. Nuk shihte më asgjë, rrinte aty i ulur, i palëvizur, pa u mbrojtur aspak edhe nga kafshët. Pëllumbat nisën të fluturonin dhe t’i uleshin mbi shpatulla, duke i ledhatuar flokët e zbardhur e duke bërë lojëra delikate pambarim. Luani i fuqishëm vijonte të lëpinte pa reshtur lotët që pikonin në duart e Zarathustrës, duke hungëritur e ulëritur me droje.

Kështu po bënin kafshët.

E gjitha kjo zgjati për një kohë të gjatë a shumë të shkurtër, sepse, për të thënë të vërtetën, nuk ekziston ndonjë kohë tokësore për gjëra të këtij lloji. Ndërkaq, Njerëzit e Epërm qenë zgjuar në shpellën e Zarathustrës e ishin vënë të gjithë në rresht, për të takuar Zarathustrën e për t’i dhënë përshëndetjen e mëngjesit, sepse, teksa qenë zgjuar, kishin kuptuar se ai nuk ishte në mes tyre. Por, sapo arritën te porta e shpellës, i paraprirë nga zhurmat e hapave të tyre, luani brofi me vrull, duke braktisur Zarathustrën e duke u vërsulur te shpella me një ulërimë të egër. Njerëzit e Epërm, duke e dëgjuar të ulërinte, ulëritën të gjithë së bashku, si të qenë një gojë e vetme, duke u kthyer prapa me rrëmbim e duke u zhdukur në çast.

Zarathustra, i trullosur dhe i pështjelluar, u ngrit nga vendi; pa me habi përreth, pyeti zemrën e vet, u mendua e mbeti vetëm.

“Ç’gjë dëgjova vallë? - tha më në fund ngadalë. - Ç’më ndodhi?”

E nisi ta mbërthente një kujtim, kur befas, arriti të kuptonte gjithçka kish ndodhur dje dhe sot.

“Ky është guri, - tha, ndërsa po përkëdhelte mjekrën, - mbi të cilin qeshë ulur në mëngjes. Këtu u ndesha me profetin, këtu dëgjova britmën e parë, britmën e madhe të dhimbjes.

O ju, Njerëz të Epërm, ishte pikërisht dhimbja juaj ajo, për të cilën më foli dje në mëngjes ai profet plak. Donte të më tundonte e të më yshte t’i bashkohesha dhimbjes suaj.”

“O Zarathustra, - më thoshte, - po vij të të tundoj për mëkatin tënd të fundit.”

“Për mëkatin tim të fundit? - briti Zarathustra, e qeshi i mërzitur me fjalët e tij. - E ç’m’u kursye për mëkatin tim të fundit.”

E përsëri, Zarathustra u zhyt thellë në vetvete, duke ndenjgur rishtazi mbi gur e duke medituuar. Papritmas u ngit.

“Mëshirë!” [Fjalë për fjalë, dhimbja ime (Leid) dhe dhembshuria ime (Mitleid). Gati një ironi, edhe një herë kundër Wagnerit që, veçanërisht te “Persifali” e kish bërë dhembshurinë themelin e vizionit të tij moral të botës.]

“Mëshirë për Njerëzit e Epërm!” - briti me zë të lartë. Fytyra iu bë e bronzte. Por për këtë ka ende kohë!

Pasioni dhe dhembshuria ime, e ç’rëndësi kanë?

A mos kërkoj unë vallë lumturinë? Unë kërkoj ta çoj deri në fund veprën time!

Ngrehu, pra! Erdhi luani, bijtë e mi më erdhën pranë. Zarathustra u bë i pjekur, ora ime mbërriti.

Ky është mëngjesi im, dita ime po çel. Ngrehu pra, eja tek unë, ti, o ora e madhe e mesditës!”

Kështu foli Zarathustra, i fortë e i zjarrtë si dielli i agimit, kur ngrihet maleve akoma të mbështjella me re.

Tani po ju urdhëroj të më harroni mua e të gjeni vetveten, pasi vetëm kur të më keni mohuar do të kthehem te ju.

Paskëtaj, do të bëheni miqtë e mi dhe bijtë e një shprese. Atëherë, unë do të jem me ju, për të festuar së bashku mesditën e madhe.

Te gjithë zotat kanë vdekur: tani duam të rrojë Mbinjeriu; kjo qoftë në mesditën e madhe dëshira jonë e mbrame.

* * *

Ju shikoni lart, kur prireni kah lartësimin. E unë shoh poshtë, në thellësi, sepse tashmë jam i lartuar.

Kush prej jush mund të qeshë e njëherësh të jetë i lartuar?

Kush ngjitet nëpër male të larta, qesh sipër të gjitha tragjedive e të gjitha trishtimeve të shtira!

* * *

Mjerë të dashuruarit që nuk kanë një majë, që të ngrihet mbi mëshirimin e tyre!

Kështu më tha një ditë djalli: “Edhe Zoti e ka ferrin e tij, domethënë dashurinë e vet për njerëzit”.

E kam dëgjuar rishtazi shqiptimin e këtyre fjalëve: “Zoti vdiq; e vrau mëshirimi i tij për njerëzit”.

ISBN 99956-706-6-6

